



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH

Adresa: Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjia "Holta", Rruga "10 Korriku",
Gramsh, Shqipëri. Tel/Fax: +35551322272,
Web : www.bashkiagramsh.gov.al

DOKUMENTI
I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK
MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Përgatitur nga:

Rodion Gjoka, Inxhinier mjedisi

Kristi Bashmili, Inxhinier mjedisi

Xhesika Hoxha, Inxhiniere mjedisi

Prof. Sherif Lushaj, Ekspert i bujqësisë e mjedisit, Certifikatë me Vendimin nr. 6, Nr. 006Regj

Rudina Toto, Eksperte e planifikimit mjedisor, Certifikatë me Vendimin nr. 12, Nr. 246 Regj

Silvi Jano, Ekspert i planifikimit të peizazhit

Ani Shtylla, Ekspert i GIS dhe planifikimit

Edlira Xhafaj, Eksperte e GIS

Ada Lushi, Eksperte e përpunimit grafik

Imeldi Sokoli, Ekspert i planifikimit të territorit



Tabela e Përmbajtjes

Parathënie	7
Autorësia dhe Kontributet	7
Përmbledhje Jo-Teknike	9
1. Hyrje.....	9
1.1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor	9
1.2. Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme	9
1.3. Metodologjia për hartimin e VSM-së: Procesi.....	10
1.4. Kuadri ligjor i VSM-së	11
2. Analiza e territorit të Bashkisë Gramsh	11
2.1. Situata mjedisore	11
2.2. Shërbimet publike.....	14
2.3. Ndryshimet klimatike dhe rreziqet	15
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të propozimeve të PPV-së	15
4. Masa për zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së	20
Hyrje.....	24
1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Gramsh.....	24
1.1. Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme	24
2. Metodologjia për hartimin e VSM-së.....	28
2.1. Procesi	28
2.2. Kuadri ligjor.....	30
2.3. Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera	36
2.4. Format e vlerësimit	45
3. Plani i Zhvillimit të Territorit.....	51
3.1. Plani i Propozimeve Territoriale	51
3.2. Fashat, Zonat dhe Qendërsitë.....	53
3.3. Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës	71
3.3.2. Njësitë strukturore të territorit.....	76
3.4. Shërbimet dhe infrastrukturat publike	83
3.5. Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së.....	85
3.5.2. Projektet e Zbatuara me fisha ne periudhe kohore	86
4. Analiza mjedisore e territorit të Bashkisë Gramsh	93
4.1. Pozicioni dhe elementët e fortë në territor	93
4.1.2. Elementët e fortë në territor dhe elementët përjashtues	93
4.1.3. Gjeologo- inxhinieria, burimet natyrore dhe pasuritë minerale	99
4.1.4. Hidrogjeologjia dhe hidrografia.....	106
4.1.7. Zonat e mbrojtura.....	111
4.1.8. Përfundime	115
4.2. Metabolizmi i territorit.....	116
4.3. Burimet ujore sipërfaqësore	125
4.4. Ajri	149
4.5. Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti.....	156
4.6. Toka.....	199
4.7. Shërbimet Publike.....	205
4.8. Ndryshimet klimatike dhe rreziqet	226
4.9. Zonat e nxehta mjedisore	232



4.10. Trashëgimia historike dhe kulturore	236
5. Vlerësimi mjedisor i ndikimit të PPV-së.....	242
5.1 Detyrimet ligjore e institucionale	242
5.2 Vlerësimi i planit të zhvillimit të territorit	254
6. Masat mbrojtëse për mjedisin	289
6.1 Masa për parandalimin / zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së	289
6.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore	291
6.2.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore	293
6.3. Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura	295
6.4. Masa për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.....	303
6.5 Masa për mbrojtjen e tokës	305
6.6 Masa për mbrojtjen e pyjeve e kullotave.....	310
6.7 Masa për trajtimin e zonave të nxehta mjedisore.....	311
6.8. Masa për menaxhimin e mbetjeve.....	311
7. Plani i veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore.....	314
7.1 Plani i veprimit: monitorimi, treguesit e vlerësimit e institucionet e monitorimit	314
7.2 Çështjet institucionale, ligjore dhe instrumentet që lidhen me masat mjedisore	321
Shtojca 1: Lista e institucioneve/bashkëpunëtorëve të kontaktuar	325
Shtojca 2: Përmbledhje e Degjesave me Publikun në kuadër të VSM-së.....	326

Lista e Tabelave

Tabela 1. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisore	18
Tabela 2. Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit	31
Tabela 3. Format i inventarit paraprak të informacionit për VSM-në	36
Tabela 4. Peshat specifike e elementëve/kritereve të vlerësimit.....	46
Tabela 5. Simbolika e vlerësimit të ndikimit në mjedis.....	47
Tabela 6. Paraqitja përfundimtare e vlerësimit	47
Tabela 7. Vlerësimi i përputhshmërisë mes objektivave të Planit dhe të VSM-së	49
Tabela 8. Vlerat e përdorura në vlerësimin e përputhshmërisë mes objektivave të Planit dhe atyre të VSM-së	49
Tabela 9. Parashikimi i popullsisë deri në vitin 2032.....	82
Tabela 10: Fazimi i projekteve strategjike, Bashkia Gramsh	86
Tabela 11 Boniteti i tokave bujqësore sipas NjA-ve dhe Fshatrave në Bashkinë Gramsh	110
Tabela 12. . Vendndodhja e profileve të monitorimit	127
Tabela 13. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në Basenin e Lumit Seman	128
Tabela 14. . Ndryshimet totale (erozioni fundor/akumulimet) ndër vite në Lumin Seman	128
Tabela 15. . Thellimi i shtratit të Lumit Seman e Osum për shkak të erozionit fundor	129
Tabela 16. . HEC-et në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll	130
Tabela 17. HEC-et në pellgun e lumit Seman	131
Tabela 18. Dëmtime të brigjeve të lumit Devoll	133
Tabela 19. Karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë në Lumin Devoll.....	133
Tabela 20. Pikat e monitorimit të lumit Devoll	134
Tabela 21. Vendndodhja e aktivitetetve të liçencuara për shfrytëzimin e inerteve lumore	148
Tabela 22. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri	152



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Tabela 23. Përdorimi i tokës sipas zonave, Bashkia Gramsh	157
Tabela 24. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri	166
Tabela 25. Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Gramsh	168
Tabela 26. Specie të faunës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Gramsh	172
Tabela 27. Specie të florës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Gramsh	180
Tabela 28. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave	187
Tabela 29. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh	189
Tabela 30. Sistemet territoriale, Bashkia Gramsh	200
Tabela 31. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës (km ²)	200
Tabela 32. Tipologjitë sipas NJA-ve	201
Tabela 33. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë	202
Tabela 34. Sasia e plehrave kimik të përdorur në Bashkinë Gramsh, 2016.....	204
Tabela 35. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm	206
Tabela 36. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Gramsh	209
Tabela 37. Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Gramsh,	218
Tabela 38. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperaturës (Referuar Tem. Mes. 1990)	227
Tabela 39. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend	228
Tabela 40. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime	228
Tabela 41. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990.....	229
Tabela 42. Të dhëna mbi heshtat e gjetura	240
Tabela 43. Lista e monumenteve kulturore dhe historike sipas IKMT	240
Tabela 44. Detyrimet ligjore dhe institucionale Ligji Neni Detyrimet Ligjore/Institucionale për Bashkitë	242
Tabela 45. Objektivat mjedisorë.....	255
Tabela 46. Përkrahja specifike e elementëve/kritereve të vlerësimit	256
Tabela 47. Pikët e grumbulluara nga 6 elementët/kriteret e ndikimit për OM1 (Ajër) (tabele ilustruese) ..	256
Tabela 48. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të shprehur në vlerësim sasior, konvencional e cilësor	257
Tabela 49. Konvertimi i pikëve të ndikimit të projektit në pikë përputhshmërie	257
Tabela 50. Përputhshmëria e shprehur në vlera numerike dhe vlerësimi cilësor përkatës.....	258
Tabela 51. Vlerësimi i përputhshmërisë për Objektivin Strategji 1	258
Tabela 52. Objektivat e programet e Planit	259
Tabela 53. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të Projekteve në Objektivin 01	260
Tabela 54. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të objektivës 02.	262
Tabela 55. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të objektivës 03.	264
Tabela 56. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të Objektivit 04.....	265
Tabela 57. Përputhshmëria e objektivave mjedisore me projektet strategjike	266
Tabela 58. Përputhshmëria e objektivave dhe progameve të planit me OM-të	276
Tabela 59. Përputhshmëria e objektivave (në %)	277
Tabela 60. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit.....	278
Tabela 61. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore.....	279
Tabela 62. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit.....	280
Tabela 63. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore.....	280
Tabela 64. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisore	286
Tabela 65. Përputhshmëria totale e Planit me Objektivat Mjedisore.....	287
Tabela 66. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara).....	302
Tabela 67. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së.....	316
Tabela 68. rekomandime për përmirësimin e monitorimit të mjedisit.....	323



Lista e Figurave

Figura 1. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë Gramsh.....	10
Figura 2. Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh	14
Figura 3. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë Gramsh.....	28
Figura 4. Vzioni Territorial i Bashkisë Gramsh	51
Figura 5. Fashat, zonat dhe qendërsitë në Bashkinë Gramsh	53
Figura 6. Shembull i ndërtimit të bujtinave	55
Figura 7. Shembull i një tregu	56
Figura 8. Skema konceptuale e Zgjerimit të Bulevardit	57
Figura 9. Shembull i rehabilitimit dhe sistemit të rrugëve.....	58
Figura 10. Skemë Konceptuale për ndërtimin e By- Passit	59
Figura 11. Skemë Konceptuale e Zhvillimit të Shtigjeve	60
Figura 12 Shembull i ndërtimeve të hapësirave të shërbimit për rrugët	60
Figura 13. Shembull i ndërtimit të terminalit të autobuzëve	61
Figura 14. Shembull rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zona rekreative të zonave ripariane.....	62
Figura 15. Shembull i rikonstruksionit të shesheve	63
Figura 16. Shembull i rikonstruksioneve të shesheve.....	63
Figura 17. Shembull i rikonstruksionit të shesheve	63
Figura 18. Skema Konceptuale e Rivalizimit të bregut të Liqenit të Banjës	64
Figura 19. Shembuj të dizenjimit të hapësirave rekreacionale	65
Figura 20. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Gramsh	84
Figura 21: Fazimi i ndërhyrjeve në njësitë strukturore, Bashkia Gramsh.....	85
Figura 22. Fazimi i ndërhyrjeve në rrjetin infrastrukturor, Bashkia Gramsh.....	86
Figura 23. Pozicioni gjeografik	93
Figura 24 Harta e elementëve të fortë në Bashkinë Gramsh	96
Figura 25 Harta e Pjerrësisë së terrenit në përqindje	97
Figura 26 Harta e territorit.....	97
Figura 27: Harta e Shpejtësisë së Erës.....	98
Figura 28: Harta e Rrezatimit Diellor	99
Figura 29: Harta Gjeologjike- Inxhinierike	101
Figura 30: Harta e Gjeologo- Inxhinierike dhe pasuritë minerale	106
Figura 31: Harta Hidrografike dhe Hidrogjeologjike	108
Figura 32: Harta e Rrezikut gjeologjik	110
Figura 33: Harta e zonave të mbrojtura	115
Figura 34. Energjia në Rajon.....	118
Figura 35. Figura Uji në Rajon.....	119
Figura 36. Fluksi i Energjisë në Bashkinë Gramsh	120
Figura 37. Fluksi i Ujit në Bashkinë Gramsh	122
Figura 38. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Gramsh.....	123
Figura 39. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Gramsh	124
Figura 40. Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Gramsh	126
Figura 41. pH i ujërave të Devollit	135
Figura 42. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Devoll	135
Figura 43. Baseni i Lumit Devoll: Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull.....	136
Figura 44. . Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Devoll.....	136
Figura 45. Metalet e rënda në Basenin e Lumit Devoll	137
Figura 46. Harta hidrogjeologjike, Bashkia Gramsh	141
Figura 47. Klasifikimi dhe sipërfaqja e Akuiferëve në Bashkinë Gramsh (në km ²)	142



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Figura 48. Ujësjiellësit e Bashkisë Gramsh dhe burimet e furnizimit me ujë të tyre	145
Figura 49. Sasia e CO ₂ që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë	150
Figura 50. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite	151
Figura 51. Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vend	151
Figura 52. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara	152
Figura 53. Përmbajtja e sqfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)	153
Figura 54. % Makinave që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër.	154
Figura 55. Struktura e fondit pyjor e kullosor, Bashkia Gramsh (ha)	157
Figura 56. Harta e fondit pyjor 1984 dhe 2015	160
Figura 57. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)	161
Figura 58. Zonë ripariante e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë	162
Figura 59. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës	163
Figura 60. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi	167
Figura 61. Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh	200
Figura 62. Mbivendosje e përdorimit të tokës	203
Figura 63. Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Gramsh	211
Figura 64 Hierarkia e mbetjeve	213
Figura 65. Venddepozitimi i mbetjeve urbane B. Gramsh	219
Figura 66. Propozimi për vend-depozitimin e mbetjeve Inerte	220
Figura 67. skema e propozuar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë	225
Figura 68. Propozim për St. Transferimi, Pikë Kompostimi dhe Venddepozitim inertesh	225
Figura 69. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës	227
Figura 70. Figura 70. Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve, Cërrojë, Bashkia Gramsh	234
Figura 71. Vend-depozitimi i ri i mbetjeve urbane, Bashkia Gramsh	235
Figura 72. Mur i brëndshëm nga kalaja Kodrionit (Irmanaj)	236
Figura 73. Gjetje arkeologjike ne territorin e bashkise	237
Figura 74. Dëmtimi i themeleit të murit perimetral të kalasë së Tërvolit.	239
Figura 75. Kalorësi Dardan (object zbukurimi I shek. IV-III p.e.s) dhe Heshta nga tumula të luftëtarëve	240
Figura 76. Kultivimi i kodrave me drejtim përreth kodrave	309



Parathënie

Hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është ndërmarrë në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit të Bashkisë Gramsh. Procesi i hartimit të këtij dokumenti është zhvilluar paralelisht me procesin e hartimit të PPV-së, sikurse përcaktohet në Ligjin Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Hartimi i PPV-së dhe VSM-së ka nisur në korrik të vitit 2017, pas vendimit të Këshillit Bashkiak për të miratuar Nismën e Hartimit të PPV-së dhe me përfundimin e reformës administrativo-territoriale përmes krijimit të bashkive të reja.

Në raportin e VSM-së janë analizuar përbërësit mjedisorë dhe janë marrë parasysh të gjitha ndikimet e mundshme, që propozimet e PPV-së mund të kenë në mjedis. Rëndësi e veçantë i është kushtuar dhënies së rekomandimeve e masave për prandalimin apo zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis nga këto propozime dhe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e bashkisë.

Në zbatim të ligjeve në fuqi, gjatë procesit të hartimit të këtij raporti janë kryer konsultime të vazhdueshme me specialistë dhe institucione vendore e qendrore, si dhe me grupe të interesit. Përgjatë procesit të hartimit të VSM-së janë zbatuar të gjitha kërkesat që burojnë nga Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe aktet nënligjore të tij, mbi mënyrën e vlerësimit, përfshirjen dhe njoftimin e institucioneve të linjës (mjedisit) nga autoriteti propozues, institucioneve të tjera, forumit qytetar të krijuar në kuadër të PPV-së dhe të publikut të gjerë. Janë kryer gjashtë dëgjesa dhe konsultimit me publikun, nga të cilat dy kanë qenë të dedikuara për VSM-në, në përputhje me VKM Nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

Raporti i VSM-së ka synuar të sigurojë masa për mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të PPV-së. Pavarësisht këtij koordinimi mes PPV-së dhe analizave mjedisore, disa nga propozimet e Planit kanë mundshmëri të pasojave negative në mjedis, për shkak të natyrës dhe të nivelit ekzistues të teknologjisë. Për të shmangur apo minimizuar këto pasoja, VSM-ja propozon masat përkatëse dhe një plan hapash për zbatim.

Në përfundim të hartimit të VSM-së, grupi i punës shpreh mirënjohjen për të gjitha institucionet dhe individët, që ishin pjesë e pandashme e procesit, duke dhënë ekspertizë, këshilla, të dhëna, komente dhe mbështetje praktike mbi mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të këtij raporti.

Ky proces nuk do të ishte realizuar në mënyrë të suksesshme pa rolin e rëndësishëm dhe drejtimin aktiv nga vetë Kryetari i Bashkisë Gramsh, Znj. Luljeta Dollani.

Informacioni i përdorur për hartimin e këtij dokumenti është bërë i mundur falë kontributit të të gjitha drejtorive të Bashkisë Gramsh, Institucioneve të tjera dhe punës së grupit në terren.

Autorësia dhe Kontributet

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Gramsh me mbështetjen financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me mbështetjen teknike të MetroPOLIS sh.p.k, nën drejtimin e Kryetares së Bashkisë Gramsh Znj. Luljeta Dollani



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Grupi i punës: Rodion Gjoka, Rudina Toto, Kristi Bashmili, Xhesika Hoxha, Sherif Lushaj, Silvi Jano, Ani Shtylla, Edlira Xhafaj, Ada Lushi, Imeld Sokoli.

Ndihmuan në përpunimin e të dhënave në GIS dhe hartimin e këtij dokumenti:

Rovena Plaku dhe Greta Kukeli

Grupi i Punës së Bashkisë Gramsh: Ali Çohodari, Blendi Coho, Dhori Nishku, Fiorentina Xhangolli, Manjola Çekrezi, Gezim Dollani, dhe Elidjan Koci.

Institucione bashkëpunuese: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdMZ, Drejtoria Rajonale e Mjedisit-Elbasan, Agjencia e Basenit Ujor të lumit Seman, Ujësjellës-Kanalizime Gramsh, Forumi qytetar, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Shoqëria Civile, NGO, Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar, Instituti Gjeoshkencës Energjisë Mjedisit dhe Ujërave, Ministria Bujqësisë, AZHBR, etj.



Përmbledhje Jo-Teknike

1. Hyrje

1.1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është ndërmarrë në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh. Hartimi i këtij dokumenti është zhvilluar paralelisht me procesin e hartimit të PPV-së, sikurse përcaktohet në Ligjin nr. 91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”. Hartimi i PPV-së dhe VSM-së ka nisur në nëntor të vitit 2016, pas vendimit të Këshilit Bashkiak për të miratuar Nismën e Hartimit të PPV-së dhe me përfundimin e reformës administrativo-territoriale përmes krijimit të bashkive të reja.

Raporti i VSM-së ka synuar të sigurojë masa për mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të PPV-së. Pavarësisht këtij koordinimi mes PPV-së dhe analizave mjedisore, disa nga propozimet e Planit kanë mundshmëri të pasojave negative në mjedis, për shkak të natyrës dhe të nivelit ekzistues të teknologjisë. Për të shmangur apo minimizuar këto pasoja, VSM-ja propozon masat përkatëse dhe një plan hapash për zbatim.

Në raportin e VSM-së janë analizuar të gjithë përbërësit mjedisorë dhe janë marrë parasysh të gjitha ndikimet e mundshme, që propozimet e PPV-së mund të kenë në mjedis. Rëndësi e veçantë i është kushtuar dhënies së rekomandimeve e masave për prandalimin apo zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis nga këto propozime.

Qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Gramsh reflekton drejtpërdrejtë qëllimin e ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, sipas nenit 1 të tij, konkretisht: të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis.

1.2. Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme

Gjatë procesit të VSM-së janë patur parasysh një numër i caktuar objektivash mjedisorë të cilët kanë shërbyer si udhëzues në hartimin e PPV-së Gramsh. Këto janë:

- Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Përbushja e objektivave afatmesme për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufinjve maksimal e normave të lejuara nga Bashkimi European.
- Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e bashkisë, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësore e nëntokësore, përfshirë ujin e pijshëm, ujërat bregdetare dhe brigjet.
- Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejtë me të.
- Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.
- Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të




ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

- Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.
- Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.
- Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.
- Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

1.3. Metodologjia për hartimin e VSM-së: Procesi

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është proces sistematik, që parashikon e vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrën e duhur që në fazat më të hershme të vendimmarrjes për instrumentin e planifikimit.

Figura 1. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017.



Qartësia mbi detyrimin për hartimin e VSM për PPV-në e Bashkisë, vjen edhe nga VKM-ja nr. 507, datë 10.6.2015, “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

1.4. Kuadri ligjor i VSM-së

VSM-ja është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi ku ligjet kryesore janë:

Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet përgjegjëse dhe procedurat sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Krahas procedurave, Ligji përcakton planet dhe programet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor ku përfshihet edhe hartimi i planeve vendore të planifikimit të territorit.

VKM-ja Nr. 507, datë 10.06.2015 “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”

VKM Nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”

2. Analiza e territorit të Bashkisë Gramsh

2.1. Situata mjedisore

Pozicioni gjeografik: Bashkia Gramsh gjendet në qendër të vendit tonë. Ajo përbëhet nga 10 NjA: Gramsh, Pishaj, Poroçan, Kukur, Lënie, Kodovjat, Skëndërbegas, Kushovë, Tunjë dhe Sult. Ajo kufizohet nga bashkitë e Elbasanit dhe Përrenjasit në Veri, nga bashkitë Pogradec dhe Maliq në Lindje, nga Skrapari në Jug, dhe nga bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik në Perëndim. Bashkia Gramsh ka lidhje relativisht të mira me bashkitë e tjera përmes rrugëve interurbane.

Topografia: Territori i Bashkisë Gramsh është pjesë e Krahinës Malore Qendrore, Ultësirës Perëndimore, dhe Krahinës Malore Jugore me një relief kodrinor-malor, Zonat më të larta në këtë bashki gjenden në pjesën lidore dhe jug-lindore. Në zonën perëndimore kemi në përgjithësi relief kodrinor, ndërkohë zona më e ulët ndodhet përgjatë luginës së lumit Devoll¹, që kalon në zonën qendrore të bashkisë. Lartësia maksimale arrin 2,373 metra mbi nivelin e detit, me majën e Valamarës. Niveli i pjerrësive në Bashkinë Gramsh fillon nga 0.0075% deri në 128.36%. Zona fushore në pjesën qendrore të bashkisë, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët që varion nga 0.0075 deri në 18.12%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi që shkojnë deri në 40.77%.

Klima: Në Bashkinë e Gramshit mbizotëron klima mesdhetare kodrinore, nënzona jugperëndimore, që shtrihet deri në 800-1,000m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore, nënzona juglindore, në pjesën e sipërme të relievit deri në lartësinë 2,373m. Klima, relievi i larmishëm dhe sipërfaqet ujore, krijojnë mundësinë për plotësimin e nevojave për të gjitha kulturat bujqësore². Temperatura mesatare e ajrit është 12.3°C-15.1°C për zonat e ulëta dhe 9.5°C-10.9°C për zonën malore³.



Hidrografia: Burimet nëntokësore i klasifikojmë sipas llojeve të akuiferëve. Llojet e këtyre akuiferëve që ndeshen këtu janë:

1. **Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje të ulët;
2. Akuiferët me porozitet çarje-karst, me ujëmbajtje tepër të ndryshueshme, vende - vende shumë të lartë;
3. **Akuiferët me porozitet poro- çarje**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje lokale të ulët;
4. **Akuiferët me porozitet çarjesh**, me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme, mesatare deri shumë të ulët;
5. **Praktikisht jo akuiferë**, që përfaqësojnë një mjedis gjeologjik me porozitet të pamjaftueshëm për të mbajtur e qarkulluar në sasira të mjaftueshme ujrash për të furnizuar komunitetet me ujë të pijshëm.

Burimet natyrore: Lumi Devoll përshkon bashkinë e Gramshit nga jug-lindja në veri-perëndim në një gjatësi prej 49km. Regjimi i rrjedhjes së këtij lumi përcaktohet nga reshjet dhe nga shkrirja e dëborës, pra nga ushqyerja me përrrenjt më të vegjël. Si i tillë ai ka dy periudha me prurje të madhe, një në Nëntor/ Dhjetor dhe tjetra në Mars/ Prill. Prurjet e mëdha në këto periudha shpesh rezultojnë edhe në përmbytje sidomos në pjesën veriore të bashkisë.

Ndër rezervuarët dallohet **ujëmbledhësi i Banjës** i rrethuar me kodra të veshura me pyje. Ky ujëmbledhës ka ardhur si rezultat i ndërtimit të digës së Banjës. Si rezultat rrjedhja e lumit të Devollit ka ndryshuar. **Liqeni i Dushkut** (në Kumian) dhe **Posnovishtë**, etj. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit. Këto liqene në përgjithësi kanë karakter allkunajor, sidomos ato që gjenden në zonën e Grabovës.

Rrëshqitjet: Rrëshqitjet shfaqen përgjithësisht në ato zona ku bazamenti i truallit përbëhet kryesisht argjila, flishe dhe flishoidalë dhe më pak në shkëmbinj ranorë dhe konglomerate, ku ka dhe kontraste më të theksuara të ndërtimit gjeologo-inxhinierik, gjeomorfologjisë, dhe elementeve të shtrueshmërisë së shtresave gjeologjike.

Nga përshkrimi që ju bë më lart llojeve shkëmbore të rajonit si dhe i mbizotërimit të relievit kryesisht kodrinor, duket qartë se rajoni i studimit është mjaft i prekshëm nga ky fenomen. Deri më tani janë evidentuar reth 26 raste rrëshqitjesh nga rilevimet gjeologo – inxhinierike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Rrëzimet: Ndodhin në zonën malore atje ku pjerrësia e shpatit i kalon 40°, dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të butë në profilin e shpatit. Situata të tilla janë të shumta në territorin e bashkisë. Ky fenomen ndihmohet edhe nga zhvillimi i madh i tektonikave bllokore dhe ndrydhëse, të cilat e kanë coptuar së tepërmi bazamentin shkëmbor.

Vatrat e erozionit: Ky fenomeni më i përhapur në Bashkinë Gramsh, si pasojë e përbërjes argjilore dhe flishore të tokave dhe shpyllëzimet e shumta. Vihet re më shumë në Gramsh, prorocan dhe Skenderbegas. Erozioni shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozioni sipërfasor dhe ai fundor.



Zonimi Gjeoteknik: Bashkia Gramsh bën pjesë në pllakën tektonike të Albanideve⁴ të Jashtme, si në atë Perëndimore edhe në atë Lindore (të ndërmjetme); më saktë në nën zonën Berat, nën zona Tomorr dhe nën zona Cukall. Kjo bashki bën pjesë edhe në pllakën tektonike të Albanideve të Brendshme, më saktë në zonën Mirdita me Ofiolite të Jurasikur të mesëm.

Tërmetet: Kalimi i thyrjes Vlorë – Elbasan – Shkup, nga e cila gjenerohet një pjesë e mirë e lëvizjeve sizmike në Shqipëri, kalon në veri të kufinjve të bashkisë së Gramshit e vendos atë brenda zonës VII – VIII ballë, pra në një zonë me rrezikshmëri të lartë sizmike (kujtojmë se zona maksimale është ajo me intensitet IX ballë). Në Bashkinë e Gramshit kemi një termet të shënuar në vitet e fundit. Ai ka ndodhur me datë 26 Nëntor 2015, 3 km në jug të qytetit të Gramshit, me Magnitudë 3, i thellë 17 km⁵.

Ajri: Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Gramshit dhe Bashkinë Gramsh në përgjithësi mungojnë. Megjithatë, për arsyt e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti: Kushtet klimatike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike në territorin e Bashkisë Gramsh kanë mundësuar rritjen e një larmishmërie drurësh dhe shkurrësh. Ndër to veçohen dushku, pisha e egër, pisha e zezë, ahu, dëllinja dhe shkoza, të cilat përbëjnë disa nga llojet që janë përshtatur më së miri në territorin e Bashkisë si dhe ndikojnë në përmirësimin e klimës që karakterizon këtë zonë dhe kanë rëndësi të lartë për ekonominë e zonave dhe mirëqënien e popullsisë lokale. Sot, Bashkia Gramsh ka në pronësi të saj 54,840.34 ha sipërfaqe fond pyjor, struktura e të cilit përbëhet nga rreth 35,731 ha pjyje, 10,095 kullotë dhe 9,012 ha sipërfaqë djerr, inproduktive, ujore dhe bimë pyjore.


Në territorin e Bashkisë së re të Gramshit gjenden pasuri të shumta natyrore. Format e larmishme të relievit dhe luhatjet e lartësive kanë ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme të cilat ofrojnë mundësinë për zhvillimin e florës dhe faunës në territor. Në territorin e bashkisë gjendet një pjesë e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit (Pjesa veriore e parkut), i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 21 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zonë. Monumentet e Natyrës ndahen në 7 gjeo-monumente dhe 14 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjendje të mirë biologjike dhe estetike. Në tabelën më poshtë gjenden të listuara Zonat e Mbrojtura në territorin e Bashkisë Gramsh dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Përdorimi i Tokës: Sipërfaqja totale e Bashkisë Gramsh është 739.98 km². Sipas analizës territoriale, sistemi natyror zë rreth 79.87% të territorit (591.05 km²). **Sistemi natyror** është i përqëndruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe malore. **Sistemi bujqësor** renditet i dyti, duke zënë afërsisht 13.7% të territorit (101.39 km²) dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Devoll, në pjesën më të ulët të qytetit të Gramshit, zonë në të cilën janë përqëndruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën qendrore të territorit, **sistemi urban** ndërthuret me sistemin natyror



dhe me sistemin infrastrukturor. Sistemi urban, i cili zë 6.05%, është përqëndruar kryesisht në qytetin e Gramshit. Ky sistem shtrihet edhe përgjatë akseve kryesore rrugore, siç është segmenti Gramsh-Cërrik-Elbasan dhe segmentet rrugore që lidhin qendrën e bashkisë me njësitë administrative, që kanë distancë të vogël me qytetin e Gramshit. Në pjesën tjetër të Bashkisë Gramsh, sistemi urban është pikësor dhe ndërthuret me sistemin natyror dhe sistemin bujqësor. Në territorin e Gramshit ka edhe sipërfaqe të konsiderueshme *ujore* që në total zënë një sipërfaqe prej 36.59 km². Kategoria e përdorimit *banim*, zë një sipërfaqe totale 5.14 km² dhe është e përqëndruar kryesisht në pjesën e qytetit ndërsa në fshatra zë më pak sipërfaqe dhe ka shpërhapje më të madhe, ndërsa kategoria *industri* dhe *ekonomi* zë 0.45 km² të gjithë sipërfaqes së Gramshit.

Figura 2. Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

2.2. Shërbimet publike

Furnizimi me ujë: Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gramsh, e cila ofron shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe gjithashtu siguron largimin e ujërave të ndotura.

Bashkia e Gramsh siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik në pjesën më të madhe nga burimi i kërpicës në malin e Tomorrit rreth në jug-lindje të qytetit të Gramshit në një lartësi prej 390m mbi nivelin e detit. Prurja maksimale e këtij burimi 1m³/s, me një regjim të qëndrueshëm.

Ujërat e ndotura: Shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Gramshit dhe pjesërisht në Kodovjat dhe Çekin nëpërmjet sistemit të kanalizimeve. Sa i përket qytetit të Gramshit shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak



se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij. Vitet e fundit janë bërë ndërhyrje duke rikonstruktuar vetëm problematikat kryesore të sistemit të kanalizimeve në Gramsh.

Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe ujërat shiut. Ujrat e përdorura trajtohen në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, i cili u ndërtua në vitin 2016.

Në të gjithë fshatrat e NjA-se përdoren gropa septike jashtë kushteve higjieno-sanitare për largimin e ujërave të ndotura urbane nga shtëpitë, shpesh hasen raste ku ujrat e ndotura derdhen direkt në trupat ujorë sipërfaqësor, përrenj dhe lumenj.

Mbetjet e ngurta urbane: Gjatë viti të shkuar Bashkia Gramsh ka gjeneruar rreth 8,810t/vit⁶, thënë ndryshe, afërsisht 24.1 t/ditë (gjenerim për të gjithë territorin e bashkisë). Norma mesatare e prodhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë është 0.7 kg/ditë/banor. Norma e gjenerimit për bizneset është 10 kg/ditë, kjo për bizneset e vogla dhe të mëdha, ndërsa për institucionet është 12 kg/ditë. NjA-ja Burrel prodhon rreth 9.5 t/ditë mbetje urbane, ose rreth 39.4% të mbetjeve të gjeneruara në territorin e bashkisë. Sasia më e madhe e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë vijnë nga sektori familjar, e ndjekur nga biznesi i vogël, biznesi i madh dhe me sasinë më të vogël të gjeneruar renditen institucionet. Nga sasia totale e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë rreth 72% e tyre prodhohet nga sektori familjar, rreth 22% nga biznesi i vogël dhe i madh, rreth 6% nga institucionet.

2.3. Ndryshimet klimatike dhe rreziqet

Ndryshimet klimatike në Rajon: Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në formë të ndryshme si:

- rritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- ulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi i regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)⁷.

Fenomene të tilla parashikohet të kenë pasojat të theksuara në zhvillimin e rajonit sepse kanë mundësi të shkaktojnë përmbajtje, pakësimin e ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbajtje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshime në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshime të habitateve, pakësimin e numrit dhe llojeve të specieve, shtimin e llojeve të huaja invazive, së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.⁸

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të propozimeve të PPV-së

Projektet e propozuara në Planin e Bashkisë Gramsh janë hartuar duke patur parasysh njëkohësisht gjendjen e mjedisit në territorin e Bashkisë dhe problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me shërbimet që Bashkia i ofron qytetarëve të saj. Projektet synojnë arritjen e pesë objektivave specifike të Planit që janë:

- O1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.



- O2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.
- O3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.
- O4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.

Zbatimi i projekteve së bashku me projektet që parashikohen në Planin e Detajuar Vendore pritet të ketë ndikim konkret në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe gjendjes së mjedisit. Ndërkohë, ndikimi i tyre gjatë fazës së zbatimit mund të shkaktojë përkeqësimin e përkohshëm të gjendjes mjedisore të Bashkisë Gramsh.

Duke qenë se projektet mbulojnë fusha të ndryshme, ata janë të ndryshëm për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis. Me qëllimin përcaktimin e ndikimeve të mundshme të projekteve në mjedis gjatë fazës së zbatimit dhe në një periudhë kohore afatgjatë, si dhe përcaktimin e natyrës së ndikimeve dhe masave zbutëse, u bë vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik dhe Plani.

Në bazë të analizës së ndikimit, rezultoi se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Konkretisht, në nivel objektivi të planit, rezultatet paraqiten si më poshtë:

- Projektet e O.1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët. : nga 15 projektet e O.1, rezultoi se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim mesatar në ajër ujë dhe tokë, biodiversitet, ndërkohë në, pyje, peizazh dhe klimë ndikimi do të jetë i ulët, ndërsa përbërësit e kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë do të kenë një ndikim të papërfillshëm.
- Projektet e O.2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën. : nga 37 projektet e O.2, rezultoi se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim mesatar në përbërësit ajër, ujë, tokë, biodiversitet, pyje, peizazh dhe ndikim të ulët në klimë, ndërsa në kulturë e socio-ekonomi kanë ndikim të papërfillshëm.
- Projektet e O.3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike. : ky përmbledh



në vetëvete 22 projekte, rezulton se projektet do të kenë ndikim të ulët në përbërësit e mjedisit si ajër, ujë, tokë, biodiversitet, pyje, klimë dhe peizazh, ndërsa në përbërësit e tjerë (kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë) do të ketë një ndikim të papërfillshëm.

- d. *Projektet e O.4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.*: nga 10 projektet e O.4, rezulton se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit mjedisorë: pyje, ajër, klimë, kulturë, shëndet dhe socio ekonomi, ndërkohë që në ujë, tokë, peizazh dhe biodiversitet ndikimi rezulton mesatar.

Vlerësimi numerik (sasi) i ndikimit në mjedis është bërë duke patur parasysh se gjatë zbatimit të projekteve do të merren masat teknike për zbutjen e ndikimit, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të ndikimit, është vlerësuar edhe përputhshmëria ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh dhe objektivave të VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi është kryer fillimisht në nivel projekti dhe ka përfunduar në nivel objektivash. Për vlerësimin e përputhshmërisë janë paraqitur 5 nivele të cilat janë:

1. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të: Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm,
2. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të: Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.
3. Lidhja/përputhshmëria është e zbehtë: Përputhshmëria është e dobët edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
4. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale): Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM-së.
5. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të: janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Rezultatet e analizës së përputhshmërisë në nivel Plani të Bashkisë gramsh janë paraqitur më poshtë:



Tabela 1. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Përputhshmëria Totale	1.47	1.56	1.41	1.42	2.29	2.05	2.23	2.95	2.92	2.03

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Bashkia Gramsh, nga procesi i vlerësimit të Përputhshmërisë, ka rezultuar se Plani ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisorë. Ky tregues mund të interpretohet në mënyrë të përmblëdhur duke theksuar se ndikimet në mjedis nga zbatimi i programeve dhe projekteve të PPV-së do të jenë konkrete dhe të matshme. Këto ndikime janë referuar në seksionin e mësipërm (5.2.1) dhe në bazë të tyre janë hartuar masa shoqëruese (referuar në seksionin 6) të cilat nëse respektohen nga zbatuesit dhe monitorohen me përpikmëri nga institucionet përgjegjëse (të referuara në seksionin 5.1), mund të zbutin ndikimin në mjedis në nivele më të ulta edhe pse nuk mund ta eliminojnë fenomenin plotësisht.

Duke iu referuar tabelës përmblëdhëse të Përputhshmërisë në nivel PPV-je, është vlerësuar se Objektivat Mjedisorë Ajër, Tokë dhe Biodiversitet janë në kufinj të kategorizimit me përputhshmëri të zbehtë, afër mesatares. Për këtë arsye masat e referuara për këto elementë nevojitet që të trajtohen me rreptësi.

Lidhur me ujin, pyjet, peizazhin, dhe klimën janë vlerësuar se këto objektiva janë në përputhshëmi të pjesshme. Duke qendruar nën presionin e ndikimit të fortë njerëzor, këto elementë të mjedisit janë përballur me sfida të forta ndër vite për të cilat vetëm kohët e fundit janë hartuar politika dhe ndërhyrje konkrete të cilat synojnë parandalimin e përkeqësimit të gjendjes dhe përmirësimin e saj në rang Republike dhe jo vetëm në Bashkinë e Gramshit.

Kultura dhe cilësia e jetës janë dy përbërës mbi të cilët është punuar veçanërisht për të krijuar një harmoni natyrore dhe përmirësim të vlerave qoftë natyrore, të shëndetit publik dhe trashëgimisë kulturore e historike duke identifikuar vlerat thebësore dhe identitetin e kësaj Bashkia.

Në tabelën e mëposhtme reflektohen Projektet e Planit të PPV-së të shpërndara në % në bazë të niveleve të përputhshmërisë që ato kanë ndaj Objektive Mjedisore.



Tabela 2. Përputhshmëria totale e Planit me Objektivat Mjedisorë

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisorë	% e OM me Perputh. e Larte / Projekt	% e OM me Perputh.e Pjesshme / Projekt	% e OM me Perputh.te zbehte / Projekt	% e OM me Perputh. Neutrale / Projekt	% e OM pa Përputhje / Projekt
Objektivat Programet e Planit					
Përputhshmëria Totale	37.1%	30.6%	14.6%	13.0%	4.7%

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Përgjithësisht, shumica e përputhshmërive në nivel mesatar dhe të ulët lidhet më tepër me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet e infrastrukturës, veçanërisht nga projektet me shtrirje të gjere sipërfaqësore dhe sektorë të ndryshëm si energji, ujë, etj.

Nga rezultatet e mësipërme rezultojnë se:

1. Në total, nga 80 projekte të PPV-së, 37.1% e tyre kanë përputhshmëri të lartë me objektivat mjedisore. Pra ndikimi që projektet do të kenë në mjedis do të jetë i papërfillshëm dhe, në disa raste, ato janë hartuar si një domosdoshmëri e rehabilitimit të gjendjes mjedisore për Bashkinë Gramsh.
2. Rreth 30.6 % e fondit të projekteve kanë përputhshmëri mesatare, çka nënkupton se ndikimi i tyre do të jetë i ulët dhe mund të zbutet ndjeshëm me marrjen e masave të parashikuara në legjislacionin shqiptar (masat përcaktohen gjatë hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) gjatë fazës së zbatimit. Monitorimi i këtyre masave është element kyç në ruajtjen e nivelit të përputhshmërisë edhe gjatë fazës së operimit të këtyre projekteve.
3. Vetëm 14.6 % e projekteve nga 80 që janë propozuar në Planin e Bashkisë Gramsh kanë përputhshmëri të zbehtë. Në këtë rast qoftë respektimi qoftë monitorimi i përpiktë i masave shtrënguese mjedisore nuk do të sillte neutralizim të plotë të ndikimeve, por thjesht do të kufizohej me zbutjen e ndikimit të projekteve tek objektivat mjedisore.
4. Projektet e vlerësuara me përputhshmëri neutrale kanë të bëjnë kryesisht me hartime planesh, studimesh, investimesh dhe ngritjesh kapacitetesh njerëzore. Pra projekte dhe ndërhyrje të cilat bartin një ndikim mjedisor me peshë fare të vogël (13 %) krahasuar me ndërhyrjet fizik është faktorizuar si neutral.
5. Vetëm 4.7 % e projekteve nuk përputhen me objektivat mjedisore (OM-t), kjo është një përqindje fare e vogël, pasi kjo është gjeneruar në totalin e elementeve të vlerësuara, ndaj nuk do të thotë që një projekt i caktuar do të jetë plotësisht pa përputhshmëri me OM-të.



Ndikimet që rrejdhin nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor janë vlerësuar kryesisht të kenë karakter me intensitet të ulët dhe në disa raste rehabilitues e të domosdoshëm për të sistemuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit në Bashkinë Gramsh.

Ndikimet pozitive afatgjatë identifikohen kryesisht në përmirësimin e cilësisës së jetës dhe nivelit kulturor të shoqërisë, kjo si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të parashikuara në këtë PPV.

Ndikimet pozitive në popullatë dhe pasuri materiale do të vijnë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës rrugore dhe të shërbimeve në përgjithësi gjë që do të çojë në përmirësimin e lëvizjes së banorëve brenda dhe jashtë Bashkisë duke shkurtuar kohën e udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

4. Masa për zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së

Masa mbrojtëse për burimet ujore sipërfaqësore

- Monitorimi i menjëhershëm i Lumit Devoll: gjatë studimit për cilësinë e ujërave të lumit Devoll vërehen numër i limituar i stacioneve të monitorimit dhe të indikatorëve të matur.
- Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter i inerteve lumore në Devoll: Lumenjtë e Basenit të Devollit janë shfrytëzuar për inerte në rrjedhën e mesme dhe të poshtme.
- Kontrolli i shkarkimeve industriale dhe te ndotura urbane në ujërat sipërfaqësore
- Hartimi i një Plan Veprimi për praktikën e mira bujqësore.
- Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor dhe një plani ndërbashkiak për menaxhimin e lumit Gramsh.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit ujor.

Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore (akuiferët)

- Zbatimi dhe mbrojtja e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve (legale/ilegale).
- Ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit për inertet lumore
- Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktivitetetve që ushtrohen në zonë.
- Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikën e Mira Bujqësore.
- Pasqyrimi i rezervave vjetore të ujërave nëntokësore.

Masa për mbrojtjen e peizazhit

- Peizazhi Urban: Futja dhe ndërthurja e përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane (sipërfaqe të gjelbërta, sipërfaqe ujore).
- Peizazhi industrial: Të merren masa në drejtim të uljes së ndikimit negativ vizual të zonave industriale.
- Peizazhi natyror: Të synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrore.



- Peizazhi rural: Mbrojtja e peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij, duke e konsideruar si pjesë të pandashme të peizazhit natyror.

Masa për mbrojtjen e biodiversitetit

- Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij në brëndësi të territorit të bashkisë, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura.
- Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qendrore, AKM, ARM, AKZM, ADZM).
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të njihet kapaciteti i territorit për kullotje dhe të merren masa për ndalimin e kullotjes, aty ku vlerësohet e nevojshme.
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve mjekësore dhe aromatike, në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qendrore, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Linjës, ARM, AKM, etj.).
- Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara në shkallë vendi (në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).
- Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjes së pyjeve (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrollin dhe zbatimin e tij, ndërsa sa i përket gjuetisë Bashkisë i lind detyrim nga ligji për mbrojtjen e faunës dhe ligji për mbrojtjen e biodiversitetit).
- Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore.

Masa për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe materiale të AdZM Elbasan në funksion të menaxhimit të ZM Gramsh,
- Bashkëpunimi i Bashkisë Gramsh me AdZM Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, në mënyrë të veçantë Monumentet e natyrës dhe Parkun Kombëtar Mali i Tomorrit,
- Hartimi i planit të emergjencave në rast zjarri dhe rreziqesh gjeologjike në Zonat e Mbrojtura si në pjesën e Tomorrit dhe në pjesën e malore të bashkisë, ku aksesimi është i vështirë.
- Promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura me qëllim zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për menaxhimin e tyre,
- Kontrrolli i vazhdueshëm i zbatimit të lejes për HEC-et të cilët kanë ulur ndjeshëm sasinë e ujit që duhet të rrjedhë në gjendje të lirë,



- Marrja e masave për mbrojtjen e erozionit për brigjet e lumenjve apo përrrenjve që kalojnë në ZM,
- Studime për kapacitetin kullotës që kanë ZM-të. Nuk ka një studim të mirëfilltë për këtë fenomen i cili është i pranishëm në çdo zonë të mbrojtur.
- Te zbatohet shkalla e mbrojtjes të zonave të mbrojtura sipas ligjit në fuqi (Të gjitha shkallët e mbrojtjes së ZM-ve në Gramsh).

Masa për përmirësimin e mbrojtjen e cilësisë së ajrit

- Hartimin i Projekteve duke bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik dhe transport alternativ (këmbësor, biçikleta, etj.).
- Përfshirjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Planet Sektoriale të transportit publik, transportit rrugor, zhvillimit urban, industrial, të tokës, pyjeve, etj.
- Menaxhimi i integruar i mbetjeve sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave, që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre).
- Bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë , i ndërtimeve, etj.
- Ndërmarrjen e nismave të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të tipit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi si dhe pjesëmarrja aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve.
- Krijimi i stacioneve të përhershme të monitorimit të ajrit me qëllim monitorimin ditor dhe mundësisht orar (24/7) të cilësisë së ajrit në zonat me aktivitet Industrial dhe zonat urbane (Komsit dhe Burrel).

Masa për mbrojtjen e tokës

- Studime të mirëfillta mbi erozionin duke përdorur modele bashkëkohore për parashikimin e erozionit të shkaktuar nga shiu ose era (përdorimi i ekuacionit universal për humbjen e dherave-USLE ose parashikimi i erozionit nga shiu-ËPP⁹) në të gjithë sipërfaqen e bashkisë me qëllim përcaktimin e shkallës/shtrirjes së erozionit në të gjithë territorin.
- Kufizimi i sipërfaqeve që kalojnë nga tokë pyjore në tokë bujqësore / urbane,
- Për përmirësimin e sipërfaqeve të tokave të gërryera, të braktisura, të zhveshura dhe të shpyllëzuara Hartimi dhe zbatimi i Planit për Shtimin e Sipërfaqeve Pyjore.
- Hartimi i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve
- Hartimi i Planit për Menaxhimin e zonave kullimore (në zonat kodrinore)
- Trajnimi i fermerëve për përdorimin e praktikave të mira bujqësore
- Përmirësimi i kanaleve ujitëse dhe kulluese
- Ruajtja ose mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet



- Ndalimin e çdo zënie ose përdorimi të paligjshëm të tokës në territorin e bashkisë në zbatim të Ligjit nr. 7501 “Për Tokën” i ndryshuar, Neni 21.
- Hartimin e një Plani Veprimi për Informimin e Bujqërve për praktikat e mira bujqësore me qëllim uljen e erozionit në toka bujqësore dhe rritjen e prodhueshmërisë së tokave.
- Mbikqyrja e punës për përmirësimin e zonave të gërryera në tokat bujqësore

Masa për trajtimin e zonave të nxehta mjedisore

- Rehabilitimi i menjëhershëm i vend-depozitimit të vjetër të mbetjeve urbane me qëllim shmangien e ndotjes së tokës e ujërave nëntokësore, nëpërmjet shllamit që krijohet nga shpërbërja e mbetjeve.
- Rehabilitimin mjedisor të ish-zonës industriale në qytetin e Gramshit
- Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit gjatë rehabilitimit të zonave të mbrojtura. Më konkretisht, rekomandohet transportimi i dheut të hequr pa u depozituar fillimisht në zonat përreth duke shmangur kështu ndotjen e zonës, përdorimin e makinerive të përshtatshme, shmangien e incidenteve që mund të ndodhin nga grumbullimi i mundshëm i gazit në shtresat e poshtme të mbetjeve të depozituara, etj.



Hyrje

1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Gramsh

Qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Gramsh reflekton drejtpërdrejt qëllimin e ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, sipas nenit 1 të tij, konkretisht: *të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis.*

1.1. Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme

Mbi bazën e qëllimit të VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë Planit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për PPV-në. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Kombëtar të Territorit (dokumenti i VSM-së), si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të PPV-së në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Përmbushja e objektivave afatmesme për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimal e normave të lejuara nga Bashkimi European.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. çlirimi i ndotësve në ajër, si pasojë e aktivitetit njerëzor (industri, transport, djegie e mbetjeve, ndërtim, etj.), me ndikim negativ në ekosistem dhe shëndetin e njeriut dhe përtej vlerave të lejuara. Në fokus janë sasi të shkarkuara dhe numri i ditëve kur tejkalohe vlerat, si dhe burimet përkatëse;
- ii. dëmtimi i objekteve historike e monumenteve të kulturës (p.sh. nga shiu acid, PM-të etj.);
- iii. depozitimi i ndotësve në ujë dhe tokë, ç’ka luan rolin e përcjellësit të efekteve negative tek njerëzit dhe biodiversiteti;
- iv. ndotja nga niveli i zhurmave (përgjithësisht nga aktiviteti njerëzor);
- v. përforsimi i efektit serë dhe i skenareve negative të ndryshimeve klimatike.

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e bashkisë, mbi burimet dhe trupat ujq sipërfaqësor e nëntokësor, përfshirë ujin e pijshëm, ujërat bregdetare dhe brigjet.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. ndotje e ujërave nga aktiviteti njerëzor (bujqësi, turizëm, industri, transport, energjitikë, urbanizim, shkarkim mbetjesh të patrajuara etj.), e për pasojë e tokës dhe produkteve bujqësore, si dhe efektet negative në shëndetin e njeriut dhe në biodiversitet;
- ii. ndikimi i drejtpërdrejtë negativ në cilësinë e ujit të pijshëm, përmes prekjes së akuiferëve dhe burimeve për popullsinë;



- iii. ndotje e ujërave për aktivitet argëtues e për pasojë edhe dëmtimi i ekonomisë së turizmit;
- iv. përmytje dhe erozion detar dhe i brigjeve ujore;
- v. kripëzimi i tokave, veçanërisht në bregdet, për shkak të prishjes së ekuilibrit mes ujërave të ëmbla dhe të kripura përgjatë vijës bregdetare.

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejt me të.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. fragmentimi i tokës bujqësore, konvertimi i saj në përdorime të tjera dhe humbja e tokës;
- ii. ndotja e tokës bujqësore nga kimikatet në bujqësi, aktiviteti urban dhe mbetjet (urbane, industriale, inerte, spitalore, të lëngshme, e të rrezikshme), aktiviteti industrial e faktor të tjerë;
- iii. përdorimi i tokës për ferma të prodhimit të energjive të rinovueshme dhe infrastruktura të tjera;
- iv. rritja e rrezikut të përmytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, erozioni, si dhe rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor;
- v. degradimi i tokës.

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. fragmentimi, ndarje, barriera dhe humbje/dëmtim i habitateve;
- ii. dëmtimi i zonave të mbrojtura natyrore, apo atyre që kanë status të veçantë ruajtjeje;
- iii. humbja apo rrezikim i specieve;
- iv. ndërhyrja në linjat e migrimit të kafshëve/shpendëve;
- v. zhurma shqetësuese për llojet e popullatat;
- vi. ndotja e ekosistemit dhe dëmtimi i shërbimeve të tij në funksion të biodiversitetit;
- vii. rrezatime nga aktiviteti urban.

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. fragmentimi, humbje dhe dëmtim i pyjeve;



- ii. humbja të specieve të veçanta, të rralla apo të mbrojtura;
- iii. dëmtimi i korridoreve natyrore;
- iv. pakësimi i lëndës së parë në funksion të ekonomisë;
- v. dëmtimi i strukturës sociale-ekonomike të zonës rurale;
- vi. rritja e efektit serë dhe efekteve të tjera negative me pasojë ndryshime klimatike.

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. fragmentimi i peizazhit dhe elementeve të matricës;
- ii. dëmtimi i siluetave vizuale, estetike;
- iii. dëmtim i habitatit dhe humbja e shërbimeve të ekosistemit përkatës të çdo elementi të matricës peizazhistike;
- iv. rritja e rrezikut të përmytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, erozionit, dhe rreziqeve të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor;
- v. dëmtimi i ekonomive agrare e rurale.

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. rritje e temperaturave dhe çrregullimi i treguesve të motit, duke përkeqësuar jo vetëm shëndetin njerëzor dhe kushtet e jetesës (me të cilat është përshtatur organizmi njerëzor dhe i specieve të tjera), por edhe prodhimtarinë në sektor të ndryshëm (bujqësi, energji, turizëm etj.);
- ii. pakësim i burimeve ujore, dhe për pasojë mungesë në furnizimin e popullsisë dhe vaditjen e tokës bujqësore. Kjo mund të çojë edhe në tjetërsime të ekosistemeve dhe shkretëtirëzim;
- iii. rritje e rrezikut të përmytjeve, përparimit të detit drejt tokës, kripëzimit të tokave dhe ujërave të ëmbla, rrëshqitjeve, shembjeve, erozionit, si dhe rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore;
- iv. probleme social-ekonomike, që lidhen me zhvendosjen e popullsisë dhe aktivitetit ekonomik, përfshirë mungesën e punësimit, ndarjet dhe konfliktet sociale në kohë krize;
- v. humbje në biodiversitet dhe dëmtim të ekosistemeve dhe shërbimeve përkatëse;
- vi. nxjerrje jashtë shfrytëzimit të infrastrukturës aktuale për prodhimin e energjisë përmes burimeve hidrike;
- vii. kosto financiare e ekonomike për të përballuar krizën do të jenë shumë të larta.



Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. dëmtim i materialeve të përdorura në objektet përkatëse, si pasojë e shkarkimeve të ndotësve në ajër dhe ujë;
- ii. humbje e trashëgimisë si pasojë e aktivitetit njerëzor dhe kryesisht urban e industrial, përfshirë infrastrukturat;
- iii. rritje e rrezikut të përmbytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, e rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor.

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

- i. dëmtim i shëndetit dhe pasojat sociale përkatëse;
- ii. dëmtim i vlerave dhe burimeve ekonomike, qofshin natyrore apo të krijuara nga njeriu;
- iii. ulje e sigurisë së jetës dhe aksidentet;
- iv. rënie e ndërgjegjësimit të banorëve mbi dëmin që shkakton në mjedis aktiviteti njerëzor dhe mbetjet e krijuara në qytete.

Të gjitha ndikimet e mësipërme janë të mundshme të ndodhin, nëse territori i Bashkisë së Gramshit nuk do të planifikohet në mënyrë të integruar e gjithëpërfshirëse, sikundër edhe nëse për një pjesë të propozimeve të planit (të shpjeguara në vijim) nuk do të merren masat e duhura mjedisore.




2. Metodologjia për hartimin e VSM-së

2.1. Procesi

Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013, “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” përcakton detyrimin për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh. Sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, procesit të vlerësimit strategjik mjedisor i nënshtrohen planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshirë dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”¹⁰. Sipas ligjit, në nenin 7 të tij përcaktohen edhe hapat nëpër të cilat duhet të kalojë procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së. Këto hapa, bashkë me metodologjinë teknike, janë përmbledhur në figurën e mëposhtme.

Në kontekstin më të gjerë, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik, që parashikon e vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrën e duhur që në fazat më të hershme të vendimmarrjes për instrumentin e planifikimit.

Figura 3. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë Gramsh



Burimi: Ligji nr. 91/2013 dhe VKM nr. 219, datë 11.03/2015; Përpunoi: MetroPOLIS, 2017

Po ashtu, qartësia mbi detyrimin për hartimin e VSM për PPV-në e Bashkisë, vjen edhe nga VKM-ja nr. 507, datë 10.6.2015, “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasojë negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.



Grupi i punës për hartimin e PPV-së dhe VSM-së i ndoqën fazat e procesit, si më poshtë:

- a. Njoftimi i ministrisë nga Bashkia është kryer në periudhën korrik të vitit 2017. Procesi për krijimin e bazës së të dhënave të PPV-së nisi në korrik, moment ky i cili perkon dhe me marrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, me vendim të Keshillit Bashkiak nr. 70 datë. 25.08.2017 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit”. Si pjesë e marrjes së nismës:
 - U hartua dokumenti i nismës në përputhje me kërkesat ligjore,
 - U ngrit forumi qytetar (Forum i Këshillmor Vendor) për PPV-në, sipas VKM nr. 686,
 - U realizua një takim publik – Degjese e parë publike për marrjen e nismës, si pjesë e të cilit u prezantua procesi që do të ndiqej për hartimin e planit, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve pjesëmarrëse, përfshirë forumin e qytetarëve, dhe produktet e lidhura me PPV-në, përfshirë VSM-në si detyrim ligjor dhe nevojë reale për të trajtuar çështjet e mjedisit në planifikim,
 - U njoftua marrja e nismës dhe nisja e VSM-së në Regjistër dhe në mjetet e komunikimit elektronik që përdor Bashkia,
 - U njoftua Ministria e Mjedisit për nisjen e procesit të PPV-së e për rrjedhjet dhe VSM-së me anë të shkresës zyrtare me nr. Protokoll 5935, datë 11.09.2017.
- b. Konsultimi me grupet e interesit, për çështjet që trajtohen në raportin e VSM-së, është realizuar nëpërmjet 4+2 takimeve publike dhe përmes takimeve individuale, sipas rastit.
 - Takimi i parë publik përkon me takimin për nismën e PPV-së.
 - Takimi i dytë publik përkon me takimin për analizat e PPV-së, ku një prej analizave të diskutuara në takim publik ishte ajo mjedisore (me të gjithë përbërësit mjedisorë sipas raportit, përfshirë metabolizmin e territorit).
 - Takimi i tretë publik u realizua specifikisht vetëm për diskutimin e raportit paraprak të VSM-së.
 - Takimi i katërt publik përkon me takimin për konsultimin e strategjisë së zhvillimit të territorit, në të cilin u diskutua edhe për dimensionin mjedisor të propozimeve të strategjisë.
 - Takimi i pestë publik përkon me konsultimin mbi propozimet për infrastrukturën dhe shërbimet publike në kuadër të PPV-së, duke i vlerësuar propozimet jo vetëm nga pikëpamjet teknike, ekonomike, sociale e territoriale, por edhe mjedisore e të peizazhit.
 - Takimi i gjashtë publik u realizua specifikisht vetëm për diskutimin e raportit përfundimtar të VSM-së.

Në takimet publike në të cilat VSM-ja është diskutuar së bashku me PPV-në, pjesëmarrja ka qenë e gjerë dhe ka përfshirë jo vetëm institucione e grupe interesi që lidhen me mjedisin, por edhe forumin qytetar të plotë, si edhe banorë e pronarë që kanë marrë pjesë në mënyrë



spontane në takim.

Në takimet publike të dedikuara vetëm për VSM-në, pjesëmarrja ka qenë më e specializuar në drejtim të mjedisit, duke përfshirë përfaqësues të forumit qytetar, agjencitë rajonale për mjedisin, ujërat, tokën bujqësore, ish-drejtoritë pyjore (specialistët përkatës), biznese të cilat kanë ndikim në mjedis, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, OJF-të mjedisore etj. Në mënyrë më të detajuar, informacioni për pjesëmarrjen në takime publike dhe institucionet apo organizatat e kontaktuar e të konsultuar gjendet në Shtojcën 1 të dokumentit të VSM-së.

- c. Hartimi i raportit paraprak u realizua gjatë periudhës korrik - dhjetor. Konsultimet në lidhje me këtë raport paraqiten më lart dhe mbyllen me takimin e dytë publik, të dedikuar për VSM-në. Gjatë kësaj faze është kryer grumbullimi i pjesës më të madhe të informacionit. Megjithatë, si rezultat i takimit të dytë publik (i VSM-së), shumë nga institucionet e përfshira (pjesëmarrëse në takim) reflektuan mbi informacionet e dhëna deri në atë moment apo të disponuara nga grupi i punës, dhe dorëzuan në Bashki një sërë informacionesh të reja apo të përditësuara. Ky veprim ndikoi pozitivisht në rifreskimin e informacionit dhe të analizës.
- d. Hartimi i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor është realizuar në periudhën dhjetor 2017. Edhe gjatë kësaj periudhe pati disa momente të marrjes/shkëmbimit të informacionit me burime specifike, por puna u përqendrua kryesisht në realizimin e vlerësimit mjedisor të PPV-së dhe në hartimin e masave përkatëse mjedisore.
- e. Shqyrtimi i propozimit dhe deklarata e Ministrisë realizohet me dorëzimin e materialit përfundimtar tek autoritetet përgjegjëse.
- f. Vendimi i autoritetit miratues vjen pas shqyrtimit të materialit.
- g. Monitorimi dhe raportimi i pasojave në mjedis të planit është një proces në vazhdim, i cili do të realizohet nga Bashkia dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Planin e Veprimeve, pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

2.2. Kuadri ligjor

- Kuadri ligjor i VSM-së

Kuadri ligjor shqiptar i VSM-së përafrohet plotësisht me kuadrin ligjor ndërkombëtar. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër e këtij kuadri i cili përfshin Ligjin Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe dy vendime të Këshillit të Ministrave që e kanë plotësuar atë në vitet e fundit.

Ligj Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet përgjegjëse dhe procedurat sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Krahas procedurave, Ligji përcakton planet dhe programet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor ku përfshihet edhe hartimi i planeve vendore të planifikimit të territorit. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe



të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara".

Në dy vitet e fundit, ligji i mësipërm është plotësuar nga dy VKM-të si vijojnë:

- **VKM-ja Nr. 507, datë 10.06.2015** "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- **VKM Nr. 219, datë 11.03.2015** "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"

Protokolli i VSM-së, Konventa Espoo-s (UNECE 1991): Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe rëndësia e Protokollit të VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo-s (UNECE 1991) i cili përcakton detyrimet e palëve për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të aktiviteteve të caktuara që në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Ky dokument konsiderohet si një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtrajnë kushtet e vlerësimeve strategjike.

o Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit

Për hartimin e VSM-së në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit për Bashkinë Gramsh është i rëndësishëm edhe kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit. Ky kuadër përfshin kryesisht ligjet kryesore përkatëse të përbërësve të mjedisit, të përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit: uji, toka, ajri, pyjet, kullotat, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura. Këto ligje shërbejnë si bazë për analizimin e gjendjes në mjedis në territorin e Bashkisë dhe përcaktimin e masave që duhen marrë në të ardhmen nga Bashkia Gramsh për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të Planit të Përgjithshëm Vendor edhe në vitet në vazhdim.

Tabela 2. Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit

Fushat / Përbërësit e mjedisit	Ligjet
Mbrojtja e Mjedisit	Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
	VKM Nr. 1189 Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit";
	VKM Nr. 47, Datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit";
	VKM Nr. 46, Datë 29.01.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave".
Vetëqeverisja Vendore	Ligj Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Burimet Ujore	Ligj Nr. 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 111/2012 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

	<p>VKM Nr. 273 datë 07.05.2004 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Ujit”;</p>
	<p>VKM Nr. 945, datë 09.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”;</p>
	<p>VKM Nr. 939, datë 09.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”;</p>
	<p>VKM Nr. 954, datë 16.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës”;</p>
	<p>VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”;</p>
	<p>Ligji Nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”;</p>
	<p>VKM Nr.342, datë 04.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”;</p>
	<p>VKM Nr. 268, datë 06.04.2016 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”.</p>
Toka dhe Bujqësia	<p>Ligji Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën (i ndryshuar)”;</p>
	<p>Ligji Nr. 130/2014 Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;</p>
	<p>Ligji Nr. 131/2014 Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”;</p>
	<p>VKM Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT-et në qarqe dhe ZMMT në komuna dhe/ose Bashki”</p>
	<p>VKM Nr. 410, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”</p>
	<p>Udhëzim Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”;</p>
	<p>Vendim Nr. 143, datë 24.2.2016 Për disa ndryshime në vendimin Nr. 460, datë 22.05.2013, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;</p>
	<p>VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”.</p>
Ajri	<p>Ligji Nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”;</p>



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

	<p>VKM Nr. 594, datë 10.09.2014 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit”;</p> <p>VKM Nr. 352, datë 29.04.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.</p>
Biodiversiteti (flora dhe fauna)	<p>Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9587, Datë 20.07.2006, “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;</p> <p>Ligji Nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”;</p> <p>Ligj Nr. 41/2013 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për Mbrojtjen e Faunës së Egër”;</p> <p>VKM Nr.84, datë 27.01.2009 “Për caktimin e kriterëve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit”;</p> <p>Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9587, Datë 20.07.2006, “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;</p> <p>Ligji Nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
Pyjet dhe Kullotat	<p>Ligji Nr 48/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar”;</p> <p>Ligji Nr 49/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”;</p> <p>Vendim Nr.436, datë 8.6.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”;</p> <p>VKM Nr. 215, datë 16.03.2016 “Për krijimin e task-forcës “Roja e Gjelbërt” për marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim të pyjeve publike e private”;</p> <p>VKM Nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”;</p> <p>Udhëzim Nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.</p>
Mbetjet	<p>Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;</p> <p>Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;</p> <p>Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”;</p> <p>Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;</p>



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

	<p>VKM Nr. 333, datë 26.01.2011 “Për Administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”;</p> <p>Ligji Nr. 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”;</p> <p>VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”;</p> <p>Vendim Nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”;</p> <p>VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”;</p> <p>Vendim (Projekt) Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;</p> <p>VKM Nr. 608, datë 17.09.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;</p> <p>UDHËZIM Nr. 1738, datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”;</p> <p>VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për manaxhimin e mbetjeve inerte”;</p> <p>VKM Nr. 843, datë 14.10.2015 “Për mbylljen e ndërmartjes së furnizimit industri-miniera dhe krijimin e qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të kimikateve të rrezikshme”.</p>
Zhurmat	<p>Ligji Nr 39/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”;</p> <p>VKM Nr. 587, datë 07.07.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.</p>
Ndryshimet Klimatike	<p>Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;</p> <p>Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”;</p> <p>Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” (Direktiva 2008/1/EU e ndotjes industriale).</p>
Hidrokarburet	<p>Ligji Nr. 19/2015 Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin Nr. 7746, Datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” ;</p>



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

	<p>Ligji Nr. 71/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës , gazit e nënprodukteve të tyre”</p>
	<p>Ligji Nr. 143/2014 Për një ndryshim në ligjin Nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” (i ndryshuar);</p>
	<p>Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”;</p>
	<p>Urdhër Nr. 101, datë 17.4.2015 Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin Nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”;</p>
	<p>VKM Nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor”;</p>
	<p>VKM Nr. 19, datë 14.01.2015 “Për procedurat dhe kushtet për dhënie, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”</p>
	<p>Ligji Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.</p>
Shërbimet Publike	<p>Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për shëndetin publik dhe inspektoriatin sanitar shtetëror” i ndryshuar;</p>
	<p>Ligji Nr.9915, datë 12.5.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8102 /1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”;</p>
	<p>Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;</p>
	<p>Ligji Nr. 37/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet e Republikës së Shqipërisë”;</p>
	<p>VKM Nr. 145 datë 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”;</p>
	<p>Ligji Nr.9860, datë 21.1.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8518, datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”;</p>
	<p>VKM 1340/2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujesjellës-kalizimeve”;</p>
	<p>Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”;</p>
	<p>Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p>



2.3. Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera

Për të kryer analizat mjedisore në kuadër të PPV-së dhe VSM-së janë mbledhur një sërë informacionesh, burimi i të cilave janë institucionet publike, studimet dhe raportet e ndryshme të hartuar nga profesionistë të fushës dhe matjet e drejtpërdrejta e vëzhgimet vizuale. Hapi i parë i këtij procesi ishte krijimi i formatit të inventarit të të dhënave që nevojiteshin dhe metodologjisë për grumbullimin e tyre. Sa më poshtë paraqet listën e treguesve paraprakë që u konsideruan për inventarin e informacionit. Mbi bazën e kësaj liste u përpiluan letrat zyrtare, të cilat Bashkia ua nisi institucioneve dhe organizatave përkatëse, me të cilat ndoqi në vijim procesin për të siguruar këto të dhëna.

Tabela 3. Formati i inventarit paraprak të informacionit për VSM-në

Nr.	Fusha	Komente
1	Industria	Çështjet e mjedisit: përfshirë në seksionet e ajrit, ujit, tokës e mbetjeve më poshtë.
1.1	Lloji i industrisë (sipas funksioneve, nënkategorive të përdorimi të tokës)	Bashkitë dhe Përdorimi i Tokës
2	Energjia	
2.1	Energjia e konsumuar për banorë (këh/banor)	
2.2	Nr. i HEC-eve në zonë	Të ndërtuar dhe të pritshëm
2.3	Kapaciteti i prodhimit/ HEC	
2.4	Totali i energjisë së prodhuar në zonë	
2.5	Totali i energjisë së prodhuar	
2.6	Sasia e energjisë prodhuar nga burime të rinovueshme	
3	Turizmi	
3.1	Lloji i turizmit (detar, gjuetie, etj)	
3.2	% e vizitorëve të pranishëm jashtë stinës së turizmit	
3.3	Sipas llojit, efekti e turizmit ne florë, faunë, ose zona të mbrojtura)	
3.4	% e tokës bujqësore e përdorur për ndërtime/infrastrukturë në fushën e turizmit	
3.5	Njerëz që udhëtojnë për në qytet	Numër ose % / ditë
3.6	Numri i shtretërve (hotelier)	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

3.7	Numri i hoteleve	
3.8	% e të punësuarve në turizëm	
3.9	Netë për person në vit	
4	Bujqësia	
4.1	Sasia në ha e tokës bujqësore	
4.2	Sasia në ha e tokës bujqësore me cilësi të lartë	Boniteti
4.3	Sasia në ha e tokës bujqësore të humbur (shndërruar në zonë banimi/ industriale/ etj.) gjatë 10 viteve të fundit.	Nga hartat
4.4	% e bujqësisë familjare <i>versus</i> bujqësisë industriale	Studime, organizata fermerësh dhe <i>vëzhgim</i>
4.5	Sasia në ha e tokave bujqësore me vlerë jo shumë të lartë, ose toka pa vlerë bujqësore (jo prodhuese, ose shpate kodrash etj, që zakonisht njerëzit i braktisin).	Boniteti
4.6	Numri/sasia e zonave të mbrojtura në tokë bujqësore	Nga hartat e zonave të mbrojtura zyrtare
4.7	Numri i zonave të mbrojtura në tokë private	Nga hartat e zonave të mbrojtura zyrtare
4.8	Sasia/lloji i plehrave kimike të përdorura në bujqësi	Raportet e mjedisit në nivel baseni ujor
4.9	Lloji i rasteve të ndotjeve të raportuara nga bujqësia (pesticide, pleh kimik etj.)	Raportet e mjedisit në nivel baseni ujor dhe <i>vëzhgim</i>
4.10	Mënyra/sasia e plehut të prodhuar nga kafshët për fermë (nëse ky është rasti)	
4.11	Metoda e kultivimit të tokës (intensive-industriale, biologjike, e ndërmjetme etj)	
4.12	Sipërfaqe e sipërfaqeve të përmytshme/ përmytura	Nga harta dhe <i>vëzhgim</i>
5	Blegtoaria	
5.1	% e tokës e përdorur si kullotë	
5.2	Sipërfaqe e pyjeve dhe kullotave	
5.3	Numri/lloji i gjedheve	Zyra rajonale veterinarë



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

5.4	Lloji i fermave (intensive,etj.)	Zyra rajonale veterinare
5.5	Numri i rracave të rralla, vendore	Zyra rajonale veterinare
6	Peshkimi	
6.1	Të dhëna rreth biodiversitetit në burimet ujore	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
6.2	Të dhëna rreth sasisë së peshkuar	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
6.3	Të dhëna rreth kapacitetit bartës	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
7	Transporti	
7.1	Numri/% e qytetarëve që përdorin transport privat	<i>Ndikimi në përdorim toke, peizazh, biodiversitet, ndotje ajri/zhurma, siguri rrugore</i>
7.2	Numri/% e qytetarëve që përdorin transport publik	
7.3	Ndotësit e shkarkuar në ajër nga përdorimi i automjeteve	Shih seksionin e ajrit
7.4	Zonat me ndotje akustike (sip. sipas decibel)	
8	Rrugët	
8.1	% e sipërfaqes së rrugëve në raport me sipërfaqen totale të tokës bujqësore	
8.2	% e tokës bujqësore/ pyjeve/ ligatinave/ habitateve/etj. të humbur për ndërtim rrugësh	Harta, pas 1990, krahaso me topografiket
8.3	% e rrugëve kryesore në qendra të banuara (për të parë nivelin e zhurmës)	
8.4	Distanca rrugësh sipas kategorive nga zonat e mbrojtura natyrore dhe monumente kulture	Në hartë
8.5	Sasia në km e rrugëve që ndërpresin breza të gjelbër, korridore të gjelbra, korridore shpendësh/kafshësh?	
8.6	Sasia në km e rrugëve që izolojnë (ndajnë) zona të banuara/habitate të ndryshme	
9	Furnizimi me ujë	
9.1	% e Gjatësisë së lumenjve që konsiderohet të kenë ujë të një cilësie të mirë (të pijshëm)	



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

9.2	% Gjatësia e lumenjve që konsiderohet të kenë ujë të një cilësie të dobët	
9.3	Sipërfaqe ujore jo lumore me uje te pijshem (sip dhe % ndaj totalit)	
9.4	Numri i zonave me ujëra të përdorshme për plazh/banjo	
10	Ujërat e Zeza	
10.1	Kapaciteti total i përpunimit të ujërave të zeza	
10.2	Numri i impianteve të pastrimit të ujërave të zeza në funksionim	
10.3	% e popullsisë e lidhur me sistemin e ujërave të zeza	
10.4	% e aktiviteteve industriale lidhur me sistemin e ujërave të zeza	
10.5	Numri i shtëpive të palidhura me sistemin e ujërave të zeza	
11	Mbetjet e ngurta urbane	
11.1	Volumi total i mbeturinave të grumbulluara nga Bashkia/qyteti	
11.2	Volumi i mbeturinave të prodhuara për banor/qytet-ose-fshat	
11.3	% e mbeturinave të depozituara në <i>landfill</i> / vendgrumbullim	
11.4	% e mbeturinave të ricikluara	
11.5	% e mbeturinave të djegura me incenerator	
11.6	% e mbeturinave të kompostuara	
11.7	Kapaciteti i impianteve të pranishme në territor për trajtimin e mbeturinave të ricikluara	
11.8	Kapaciteti i inceneritoreve/teknologjive të tjera në territor për djegien e mbeturinave	
11.9	Kapaciteti i landfillleve	
11.10	Numri i vendgrumbullimeve	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

12	Mbetjet spitalore	
12.1	Sasia e mbetjeve spitalore	
12.2	% e trajtimit të mbetjeve spitalore	
12.3	% e mbetjeve të përziera me mbetjet e tjera	
12.4	% e mbetjeve të ricikluara	
13	Mbetjet industriale, toksike dhe të dëmshme	
13.1	Sasia totale e mbetjeve të prodhuara	
13.4	Kapaciteti i landfilleve për grumbullimin e këtyre lloj mbetjesh	
13.5	% e këtyre mbetjeve e eksportuar	
13.6	% e mbetjeve të trajtuara në vend	
14	Mbetje të tjera	
15	Toka	
15.1	Sasia në ha e tokës sipas përdorimit: urbane/rurale, e braktisur (industriale, minerale etj.), bujqësore, pyje, zona të rëndësishme së veçantë, sipërfaqe ujore etj.	Sipas kategorive bazë të përdorimit të tokës
15.2	Sasia në ha e tokës bujqësore me cilësi të lartë	Boniteti
15.3	Sasia në ha e zonave të gjelbëra përreth qendrave urbane	Si tek infrastruktura
15.4	Sasia në ha e tokave të braktisura (pa përkujdesje)	Kordinim me tokat bujqësore dhe natyrore
15.5	Sasia në ha e tokave të ndotura	
15.6	Sasia në ha e hapësirave natyrore	Koordinim me nënkategoritë e përdorimit të tokës dhe Corine
15.7	% e tokës bujqësore të mbrojtur me ligj	Boniteti (Kat. I-IV)
15.8	Sasia e tokës/të dhëna humbur nga erozioni/shembjet e tokës sipas llojeve	
16	Uji	
16.1	Cilësia e ujit të lumenjve dhe burimeve nëntokësore, duke përfshirë edhe ujin e pijshëm	Raportet e gjendjes se mjedisit dhe <i>vëzhgim</i>



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

16.2	Cilësia e ujit sipërfaqësor	Raportet e gjendjes se mjedisit dhe <i>vëzhgim</i>
16.3	Sasia e ujit nëntokësor	
16.4	Sipërfaqja e përgjithshme e tokës nën ujitje	
16.5	Sasia e përgjithshme e ujërave në rezervuare	
16.6	Numri i impianteve për trajtimin e ujit të përdorshëm	
16.7	Sasia e ujit të nxjerrë nga nëntoka për ta pirë	
16.7	Numri i shtëpive lidhur me sistemin e furnizimit me ujë	
16.8	Numri i shtëpive të palidhura me sistemin e furnizimit me ujë	
16.9	Sasia e ujit që është trajtuar në impiante me qëllim për ta pirë	
16.10	Sedimentet dhe aluvionet	
16.11	Të dhëna rreth trupave ujorë ku është shfaqur fenomeni i eutrofikimit	
16.12	Llojet e ndotësve të pranishëm në ujë nga aktivitete urbane (bizneset e riparimit të makinave, industria)	
16.13	Numri dhe sipërfaqja e ligatinave dhe gjendja e tyre (në nivel uji)	
16.14	% e sasisë së ujit të ndotur të trajtuar në raport me sasinë totale	
17	Biodiversiteti	
17.1	Numri/lloji i specieve	
17.2	Numri dhe llojet e habitateve dhe funksionet	
17.3	Numri i specieve në zhdukje/shfrytëzim të tepruar jashtë kapacitetit bartës	
17.4	Numri i habitateve në zhdukje, degradim, copëtim, ndryshim/shfrytëzim të tepruar	
17.5	Sasia në ha e sipërfaqes së habitateve natyrore të mbrojtura me ligj	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

17.6	Numri i specieve invazive	
17.7	Specie, familje, gjini, ndarë sipas habitateve (ujore, tokësore, moçalore, lumore, detare etj.)	
17.8	Vlera të rralla (pasuri e vendit që duhen ruajtur), zona të mbrojtura	
17.9	Vlera të veçanta që mendohet të shfrytëzohen për zhvillimin e vendit/turizem	
17.10	Statusi i specieve (të kërcënuara globalisht, të mbijetuara nga marrëveshje ndërkombëtare, të zhdukura, të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla, të prekshme, të panjohura etj.)	
17.10	Numri i biokorridoreve dhe vendndodhja e tyre, roli që luajnë	
18	Pyjet	
18.1	Sasia në ha e sipërfaqeve të pyjeve, pozicioni	Disa ndërthuren me biodiversitetin
18.2	Sasia në ha e sipërfaqeve të shpyllëzuara	
18.3	Lloji i drunorëve, pëmtarisë sipas zonave/habitateve	
18.4	Llojet e specieve të humbura për për shkak të shpyllëzimit	
18.5	Numri i specieve të veçanta, sasia në copë dhe shpërndarja,	
18.6	Numri i specieve me vlerë të rrallë ekologjike ose tregtare/ekonomike	
18.7	Numri i zjarreve në pyje gjatë viteve të fundit (trendi)	
19	Ajri	Gazrat e përfshira në ligjin për mbrojtjen e ajrit
19.1	Sasia e ndotësve të shkarkuar në atmosferë nga industritë/aktivitete të tjera/transporti/ndërtimet	SO ₂ , oksid nitrik (N ₂ O), lëndë të grimcuara (hi, pluhur)
19.2	Sasia e lëndëve djegëse fosile të djegura	Plumb(Pb), O ₃ , benzen, monoksid karboni (CO)
19.3	Numri i ditëve që ozoni (O ₃) kalon vlerat e lejuara prej 120 µg/m ³	Dioksid karboni (CO ₂), klorofluorokarbonet(CFC-të), perfluorokarbonet (PFC-të)



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

19.4	Numri i ditëve NO ₂ kalon vlerat e lejuara me ligj prej 200 µg/m ³	<i>Kadmiumi (Cd), Arseniku (As), Nikeli (Ni), Mercuri(Hg), Radoni (Rn)</i>
19.5	Numri i ditëve grimcat e imëta PM ₁₀ kalojnë kufijtë e lejuar me ligj prej 50 µg/m ³	
19.6	Numri i ditëve grimcat e imëta PM _{2.5} kalojnë kufijtë e lejuar prej 50 µg/m ³	
19.7	Përqëndrimet e akumuluarat të ozonit që kalojnë prej 70 µg/m ³	
19.8	Përqëndrimet mesatare vjetore të NO ₂ (µg/m ³)	
19.9	Përqëndrimet mesatare vjetore të PM ₁₀ (µg/m ³)	
19.9	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme >65 dB(A) gjatë ditës	
19.10	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme >55 dB(A) gjatë natës	
19.11	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme > 65dB(A) gjatë ditës	
19.12	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme > 55dB(A) gjatë natës	
19.13	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme (nga trafiku ajror) >65 dB(A) gjatë ditës	
19.14	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme nga trafiku ajror >55 dB(A) gjatë natës	
20	Ndryshimet klimatike	
20.1	Të dhëna rreth ndryshimit të temperaturës në përgjithësi	
20.2	Të dhëna rreth sasisë së reshjeve në vite	Mujore, vjetore, ekstremet, Instituti i Meteorologjisë
20.3	Të dhëna rreth shkrirjes së akujve	
20.4	Të dhëna rreth ngritjes së nivelit të detit (stuhitë, erozion bregdetar/ujor, kripëzim tokash)	
20.5	Të dhëna rreth përmytjeve, stuhive dhe erërave të forta	Sipërfaqe, vitet përkatëse,



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

20.6	Të dhëna rreth thatësisrës (ulja e sasisë/cilësisë së ujit, sa herë)	
20.7	Të dhëna rreth shembjeve të dheut	
20.8	Temperaturat mesatare vjetore, stinore, ekstremet	
20.9	Sasia e përdorur e energjisë nga karburantet fosile/energji e rinovueshme në raport me totalin e energjisë	
20.10	Sasia e gazrave serë (CO ₂ ; N ₂ O; CH ₄ ; O ₃) të shkarkuar në atmosferë	
20.11	Sasia e energjisë së përfituar nga masat për rritjen e efikasitetit energjetic	
21	Ndotja dhe dëmi mjedisor sipas llojeve	
22	Efektet e ndryshimeve klimatike	
23	Peizazhi	Sipas ligjit për zonat e mbrojtura dhe komponentë të tjerë.

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Hapi i dytë ishte procesi i studimit (*desk review*) të materialeve (dokumente e raporte) ekzistuese dhe të dhënave e informacioneve që burojnë prej tyre. Informacionet e grumbulluara në këtë mënyrë, të kombinuara me faktet e dokumentuara gjatë vëzhgimit vizual, përbën bazën parësore për plotësimin e inventarit mjedisor paraparak dhe hartimin e raportit fillestar të analizës mjedisore.

Hapi i tretë ishte realizimi i vëzhgimit të parë vizual për burimet dhe vlerat mjedisore në të gjithë territorin e Bashkisë. Për këtë qëllim u përgatitën harta itinaresh dhe gjatë vëzhgimit vizual u mbajtën shënime informacionet, si dhe u dokumentua realiteti përmes fotografive.

Hapi i katërt ishte realizimi i takimeve me të gjitha institucionet, të cilave i'u dërguan letra zyrtare, me qëllim marrjen e informacioni dhe konsultimit shkencor e profesional mbi temat përkatëse. Lista e institucioneve të kontaktuara jepet e detajuar në Shtojcën 2 të këtij dokumenti. Burimet kryesore publike të informacionit kanë qenë: Bashkia me të gjitha departamentet e saj, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura elbasan, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Ministria e Bujqësisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, INSTAT-i, bizneset, Agjencia e Basenit Ujor të Semanit, Agjencia Kombëtare e Territorit, etj.

Si kërkesë ligjore nga VKM-ja nr. 671, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", u realizua edhe analiza e metabolizmit të territorit. Kjo është një analizë mjedisore e cila vlerëson flukset që përshkrijnë (hyjnë, procesohen/përdoren dhe dalin) një territor të caktuar dhe më konkretisht: ujin, energjinë, ushqimin (produktet bujqësore e



blegtorale) dhe mbetjet. Analiza synon të përcaktojë efikasitetin e përdorimit të këtyre fluksve në territor, dhe mbetjet që ato krijojnë në të. Gjithashtu, metabolizmi i territorit ka për qëllim të lidhë territorin si objekt i planifikimit me burimet mjedisore dhe përdorimin e tyre.

Analiza të tjera të realizuara janë të formës sasiore dhe cilësore, mbi bazën e shifrave dhe fakteve të siguruar. I gjithë informacioni (i mundshëm) është hedhur dhe përpunuar në GIS (sistemet gjeografike të informacionit) dhe analizën me mbivendosje të shtresave (*overlay analysis*). Për shembull, informacioni sasior, cilësor dhe hartografik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar mbi vlerësimin e gjeorreziveve në Shqipëri në nivel qarku (Qarku i Elbasan) është studiuar dhe vendosur si bazë për shumë harta të tjera tematike. Mbivendosja e shtresave të informacionit, synon të nxjerrë në pah zonat apo hapësirat ku rreziku mjedisor është me i lartë.

Po ashtu është realizuar analiza e fondit pyjor, duke përdorur të dhënat e burimeve zyrtare (përfshirë hartat) dhe imazhet në foto ajrore dhe duke krahasuar ndryshimet e ndodhura në kohë. Është realizuar harta e sistemit të kullimit dhe vaditjes, apo harta e problemeve mjedisore, e pikave të nxehta dhe ndotëse, etj. Njëkohësisht, është realizuar edhe analiza e peizazhit, ku fillimisht është hartografuar matrica natyrore dhe më pas, në të, janë evidentuar të gjitha sipërfaqet sipas tipologjive peizazh-formuese. Harta të tjera janë ato të shërbimeve publike (furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura), etj.

2.4. Format e vlerësimit

Vlerësimi mjedisor është kryer për programet dhe projektet e PPV-së, të cilat u hartuan fillimisht në strategji, u rishikuan në planin e zhvillimit dhe u plotësuan më tej edhe gjatë hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Vlerësimi i tyre për ndikimin në mjedis bëhet në mënyrë cilësore dhe sipas rastit, edhe sasiore. Kriteret që përdoren për vlerësim bazohen në Shtojcën 1 të ligjit 91/2013, ku përcaktohen disa kriteret ndihmëse për vlerësimin, si më poshtë:

1. **Cilësia e përbërësve të mjedisit** në zonën e ndikimit të mundshëm të planit apo programit të propozuar dhe **problemeve mjedisore ekzistuese** në këtë zonë.
2. **Ndikimet negative mjedisore që mund të rezultojnë** nga zbatimi i planit ose programit, duke konsideruar:
 - a. **mundësinë e shfaqjes** së ndikimeve negative,
 - b. **kohëzgjatjen dhe natyrën** e tyre;
 - c. **mundësinë e riaftësimit** të gjendjes së mjedisit, si pasojë e ndaljes së ndikimeve negative në të (**kthyeshmëria ose pakthyeshmëria** e ndikimit në mjedis);
 - d. **natyrën kumulative** të ndikimeve;
 - e. **natyrën ndërkufitare** të ndikimeve;
 - f. **madhësinë dhe shtrirjen hapësinore** të ndikimeve negative;
 - g. **pasojat e dëmshme** të tij në mjedis, për shkak të cilësive mjedisore ekzistuese.
3. Shkalla në të cilën plani ose programi mund të ketë **ndikim në zonat e mbrojtura, peizazh** apo **trashëgiminë kulturore e arkeologjike** të mbrojtur me ligj.



4. Shkalla e **përputhjes ose jo të planit** apo programit të propozuar **me objektivat kombëtarë e vendorë të mbrojtjes së mjedisit** dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në vend.”

Nga kriteret e pikës 2/e, natyra ndërkufitare e zhvillimeve nuk është e aplikueshme për Bashkinë e Gramshit, për shkak të pozicionimit të saj gjeografik.

Për të realizuar vlerësimin e ndikimit të projekteve në objektivat mjedisore (përbërësit e mjedisit) sipas kriterëve të mësipërme, është krijuar tabela e mëposhtme. Kriteret e mësipërme janë përdorur me pesha në vlerësim, sipas tabelës së mëposhtme. Pesha më e madhe i është dhënë natyrës së ndikimit, zonës/grupit të prekur (madhësia) dhe faktit nëse ka dëme apo jo në mjedis. Vlerësimi për çdo kriter bëhet me **0 (keq), 10 (i mirë)** dhe një vlerësim **të ndërmjetëm** i cili merr pikë nga **0.1 deri në 9.9**. Kur pikët shumëzohen me peshën përkatëse, ato japin vlerën numerike të vlerësimit të ndikimit të projektit në përbërësin përkatës mjedisor, që përkon edhe me Objektivin Mjedisor të VSM-së.

Pra, në parim, sa më tepër pikë merren në vlerësim, aq më i vogël është ndikimi negativ në mjedis. Kjo vlen si në nivel kriteri, ashtu edhe në nivel vlerësimi total për një projekt të planit. Kjo do të thotë se **vlerësimi total i ndikimit në mjedis sipas kësaj tablele, për një propozim të caktuar të PPV-së, lëviz nga 0 (shumë negativ ose me ndikim të shumë të lartë negativ) në 10 pikë (shumë pozitiv ose pa ndikim negativ).**

Tabela 4. Pesha specifike e elementëve/kritereve të vlerësimit

	Elementët / Kriteret e vlerësimit	Pesha %	Pikët e vlerësimit (në varësi të nivelit të ndikimit)		
1	Mundësia e shfaqjes	10%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9
2	Kohëzgjatja	20%	E menjëhershme & qëndrueshme	E vogël, e papërfillshme	Afatshkurtër, ose afatgjatë
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9
3	Natyrë e ndikimit	20%	Shkatërron habitatin	Neutrale	Dëmton shërbime të caktuara të ekosistemit
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9
4	Mundësia e riaftësimit të ndikimit	10%	Kthim i plotë	Nuk ka kthim të ndikimit	E pjesshme
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9
5	Natyrë kumulative	20%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

6	Madhësia/Shtrirja	20%	Sipërfaqe e madhe & popullsi	Pikësore, e kufizuar dhe jo popullsi	E ndërmjetme
	Pikët		0.1	10	0.2-9.9

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Duke qenë se vlerësimi, pavarësisht metodologjisë numerike/sasiore (*multi-criteria analysis*) të zgjedhur, mbart edhe peshë subjektive, vlerësuesit shprehen edhe në tekst, pra në mënyrë cilësore e jo vetëm sasiore, për ndikimin në mjedis të çdo projekti. Teksti përshkruan ndikimin e mundshëm, nëse nuk merret asnjë masë mjedisore, pra në skenarin 0 të ndërhyrjeve mjedisore. Anash tekstit vendoset masa e marrë zbutëse. **Vlerësimi numerik (sasior) tregon ndikimin në mjedis në rastin kur parashikohet marrja e masave zbutëse, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.**

Në varësi të pikëve që grumbullon secili propozim, jepet vlerësimi final sipas tabelës (matricës) së vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur në vijim. Për këtë qëllim pikët shndërrohen në shenja konvencionale, që e bëjnë tabelën lehtësisht të lexueshme. Konvertimi kryhet sipas këtij rregulli:

Tabela 5. Simbolika e vlerësimit të ndikimit në mjedis

Pikët e Vlerësimit	Simbolika e matricës së vlerësimit dhe kuptimi përkatës	
0.1 – 3 pikë		Ndikimi i lartë/shumë i lartë (shkatërrues mbi shëndetin dhe mjedisin)
3.1 – 6 pikë		Ndikim mesatar (pa garanci për shëndetin dhe mjedisin, pamvarësisht nga masat zbutëse)
6.1 – 8.5 pikë		Ndikimi i ulët (në rast se masat zbutëse dhe parandaluese rrespektohen)
8.6 – 10 pikë		Ndikimi i papërfillshëm (nëse zbatohen masat, dhe nuk çënohet ekuilibri natyror)
Vlerësimi i pa aplikueshëm		Ndikim neutral ose pa ndikim (ndikime të mundshme janë të përkohshme, afatshkurtra dhe mjedisi vetripërtërihet pa ndërhyrje)

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela përfundimtare e vlerësimit do të ketë formatin në vijim dhe në qelizat e vlerësimit do të hidhen simbolet e mësipërme sipas pikëve vlerësuese.

Tabela 6. Paraqitja përfundimtare e vlerësimit

Bashkia Gramsh: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazh	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O1: Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm duke ruajtur balancat mes sektorëve dhe në mbështetje të zhvillimit bujqësor/blegtoral dhe agropërpunimit										



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O2: Rritja e konkureshmërisë së Bashkisë Gramsh, nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë së saj në rajon dhe përmirësimit të aksesit dhe rrjetit infrastrukturor rrugor										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O3: Mbrojtja e burimeve natyrore dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit si baza për zhvillimin e turizmit dhe përmirësimin e jetës qytetare në Gramsh										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O4: Orientimi i zhvillimit territorial dhe infrastrukturor me qëllim zbutjen e pabarazive sociale dhe harmonizimin e nevojave të banorëve ekzistues dhe atyre të pritshëm										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Vlerësimi tjetër që kryhet, nisur nga Shtojca I e ligjit Nr.91/2013, është ai i përputhshmërisë ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit dhe objektivave të VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi nis nga projektet dhe përfundon tek objektivat. Tabela 8 paraqet formatin e vlerësimit të përputhshmërisë, ndërsa Tabela 9 paraqet vlerat numerike të cilat përdoren për të kryer vlerësimin, sipas kategorive/niveleve të përputhshmërisë. Janë paraqitur 5 nivele të përputhshmërisë:

- Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të:** Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm.
- Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të:** Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.



8. **Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë:** Përputhshmëria është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që impakti neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
9. **Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale):** Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM.
10. **Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të:** janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Tabela 7. Vlerësimi i përputhshmërisë mes objektive të Planit dhe të VSM-së

Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektiva, Programe, Projekte të PPV-së										
O1:										
O1P1:										
Pr1:										
O1P2:										
Pr1:										
O2:										
O2P1:										
Pr1										

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPolis, 2017

Tabela 8. Vlerat e përdorura në vlerësimin e përputhshmërisë mes objektive të Planit dhe atyre të VSM-së

Niveli i përputhshmërisë	Vlerësimi numerik	Vlerësimi mesatar
1. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të	3	2.51 – 3.00
2. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të	2	1.50 – 2.49
3. Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë	1	0.01 – 1.49



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

4. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale)	0	0.00
5. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të	-1	Negativ

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPolis, 2017

Një tjetër element përputhshmërie, që do të verifikohet, është edhe sasia (e matur në %) e objektiveve mjedisore për të cilat çdo projekt ka:

- Përputhshmëri të lartë (PL),
- Përputhshmëri të pjesshme (PP),
- Përputhshmëri të zbehtë (PZ),
- Përputhshmëri neutrale (PN),
- Mungon përputhshmëria (PG).

Pra, kështu matim jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por edhe kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat OM dhe në sa prej tyre (e matur në % ndaj totalit prej 9 OM-ve) arrihet, ose çënohet përputhshmëria e lartë.




3. Plani i Zhvillimit të Territorit

3.1. Plani i Propozimeve Territoriale

3.1.1. Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Gramshit hartohet mbi bazën e gjetjeve dhe përfundimeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupe interesi e institucione publike dhe reflektime të grupit të punës, gjatë studimit të kontekstit rajonal, në të cilin ndodhet bashkia. Po ashtu, vizioni i Gramshit bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit të prezantuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dhjetor 2015

Figura 4. Vzioni Territorial i Bashkisë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

Vizioni Territorial i Zhvillimit të Bashkisë Gramsh: Bashkia Gramsh një bashki me standarte të lartë jetese e integruar mirë me rrjetet rrugore rajonale dhe kombëtare me zona të konsoliduara urbane dhe rurale të cilat kanë akses të mirë më njëra tjetrën. Bashkia Gramsh një bashki me ekonomi të zhvilluar dhe të bazuar në sektorin bujqësor blegtoral dhe në zhvillimet turistike, por edhe në sektorin e shërbimeve dhe atë industrial.

Koncepti i propozuar për zhvillimin e Gramshit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. Këto janë themele të forta, të cilat garantojnë që i gjithë komuniteti të përfitojë sot, duke iu trashëguar njëkohësisht brezave të ardhshëm një territor e mjedis të shëndetshëm e të vetëpërtëritshëm, krahas zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm.

Urbanizimi është një proces dinamik, por i kontrolluar e me rritje graduale në Gramsh. Ai fokusohet në forcimin dhe konsolidimin e qendrave ekzistuese, si dhe shfrytëzimin e drejtë të hapësirave publike dhe orientimin drejt qendërve urbane të zhvillimit. Në këtë mënyrë shërbimet sillen më afër komunitetit, në mënyrë efektive nga pikëpamja ekonomike dhe mbi



të gjitha, krijohet një klimë e shëndetshme për biznesin, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë. Përmes fuqizimit të ekonomisë rurale së saj, Bashkia Gramsh synon të konsolidojë profilin si pol rajonal i zhvillimit ekonomik turistik dhe bujqësor, duke u bërë konkurrues në nivel vendi dhe më gjerë. Duke u mbështetur tek parimet e subsidiaritetit, synohet përforcimi i një rrjeti shumë-qëndërsish në territor, të decentralizuara si pole të zhvillimit ekonomik dhe administrativ. Këto qëndra të përbëra nga vendbanime cilësore dhe aktivitete ekonomike plotësuese brenda rrjetit, kulmojnë me qytetin e Gramshit, ku fokusohet shumica e aktiviteteve urbane dhe e shërbimeve publike e komunitare.

- **Vizioni i përgjithshëm dhe projektet që ndërmerren në kuadër të PPV-së, Gramsh**

Me qëllim konkretizimin e strategjisë së zhvillimit të territorit të Bashkisë Gramsh, Vizioni i bashkisë është zbërthyer dhe detajuar më tej në objektiva Strategjike (4) dhe Programe strtegjike të zhvillimit. Në këtë mënyrë Bashkia e Gramshit do të mundet të arrijë më lehtë objektivat e saj strategjik për 15 vitet e ardhshme, duke i lidhur në mënyrë direkte projektet strategjike të cilat impaktojnë drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social të saj.

Vizioni i Bashkisë Gramsh mbështetet në 5 parime kryesore të cilat i shërbejnë thellimit të potencialeve aktuale të bashkisë Gramsh si dhe realizimit të zhvillimit të qëndrueshëm e aftgjatë të territorit.

1. Diversifikimi dhe bashkëjetesa e sektorëve të ndryshëm ekonomikë: bujqësi, industri, turizëm dhe ofrimi i shërbimeve;
2. Mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore;
3. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit natyror dhe ujor;
4. Lidhja e territorit nëpërmjet akseve parësore automobilistike dhe dytësore peizazhistike/rekreative;
5. Përmirësimi i kushteve të jetesës nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike.

Parimi i parë, diversifikimi i sektorëve ekonomikë, i përgjigjet karakterit divers të Bashkisë së Gramshit, si një nga vecantitë me anë të së cilës kjo bashki mundet të konkurojë në rajon.

Në territorin e bashkisë së Gramshit identifikohen 3 sektorë kryesorë të ekonomisë, që do të jenë motorët e zhvillimit të punësimit për 15 vitet e ardhshme: **bujqësia**, nëpërmjet konsolidimit të tokave bujqësore, përmirësimit të infrastrukturave bujqësore si sistemi i ujitjes dhe kullimit, pikave të magazinimit bujqësor etj; **insdustrinë** agroindustriale dhe industrinë energjitike, si një nga sektorët më të rëndësishëm bashkinë e Gramshit; **turizmin** si një nga sektorët drejt zhvillimit në bashkinë e Gramshit i cili do të nxjerr më tepër në pah vlerat dhe potencialet ende të pazbuluara të kësaj treve.

Me qëllim sigurimin e bashkëjetesës së këtyre sektorëve, si dhe zhvillim ekonomik të barabartë nga pikëpamja e shtrirjes hapësinore, Vizioni Strategjik i Zhvillimit të territorit mbështete në karakteristikat spikatëse të secilit vendbanim duke propozuar në të njëjtën kohë dhe specializimin e secilit prej vendbanimeve sipas skemës së mëposhtme:



Njësia administrative Gramsh si qender kryesore e bashkise Gramsh ka funksione administrative si dhe fokus në zhvillimin e shërbimeve kryesore bashkiake duke u orjentuar drejt agro-përpunimit të produkteve. Gjithashtu do të marri rëndësi zhvillimi i sektorit të hotelerisë për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të turizmit.

Njësitet administrative si **Kushovë, Lenie, Kukur, Poroçanë, Tunjë, Sult** janë njësi të cilat kanë prioritet zhvillimin bujqësor dhe blegtoral si dhe zhvillimin e aktiviteteve turistike.

Njësitet administrative **Pishaj, Kodovjat, Skënderbegas** kanë prioritet zhvillimin e sistemit bujqësor të kombinuar me sistemin e shërbimeve kryesore përgjatë luginës së Devollit.


Parimi i 2-të dhe 3-të shfaqen në masat për ruajtjen e tokës bujqësore, si dhe për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, pyjeve, rehabilitimin e zonave ripariane (përgjatë Lumit Devoll kryesisht), në masat për mbrojtjen e vijës bregliqenore, mbrojtjen e akuiferëve dhe cdo lloj mase tjetër të këtij karakteri, të përshkruar në seksionin 2.3.

Parimi 4 adreson lidhshmërinë në nivel bashkie, dhe më konkretisht mënyrat sesi do të përmirësohet lidhja mes qendrave rurale dhe qendrës së Bashkisë së Gramshit. Kjo lidhje realizohet në dy nivele: 1 nëpërmjet rrugëve automobilistike, të cilat përmirësojnë lidhshmërinë edhe nëpërmjet vendosjes së linjave të transportit publike, 2 nëpërmjet propozimit të akseve me karakter peizazhistik, në funksion të turizmit, ekoturizmit, dhe promovimit të vlerave historike dhe kulturore të Bashkisë së Gramshit.

Parimi 5 vjen si përgjigje e 4 parimeve të mësipërme, për të strehuar nevojat për akomodimin e shërbimeve të reja dhe përmirësimin e aseteve ekzistuese me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës.

3.2 Fashat, Zonat dhe Qendërsitë

Figura 5. Fashat, zonat dhe qendërsitë në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017



Në bazë të leximit dhe në kuadër të thellimit të vizionit strategjik si element gjenerues zhvillimor identifikohen këto element:

Fashat e Lumit Devoll, Lumit të Tomorricë, Përroit të Verçës dhe Lumit të Holtës këto element zhvillohen si zona rekreative dhe mjedisore duke përfshirë dhe brigjet e tyre. Këto fasha rehabilitimit mjedisor dhe trajtimit peisazhistik.

Zonat Natyrore në skajë të bashkisë. Këto zona janë hapsirat natyrore të cilat përmbajnë potencialin kryesor për zhvillimin turistik të zonës. Këto zona I nënshtohen rehabilitimi mjedisor dhe trajtimit peisazhistik si dhe përmirësimit të aksesit

Zonat Bujqësore në pjesën qendrore të bashkisë paraqesin një element tjetër zhvillimor i cili janë tokat bujqësore. Këto toka i nënshtrohen konsolidimit bujqësor e cila do të sjellë një përmirësim të sektorit bujqësor dhe rritje të produkteve bujqësore e blegtorale.

Qendërsitë urbane janë elementi tjetër gjenerues, të cilat kryesisht i nënshtohen konsolidimit urban, intensifikimit dhe dendsifikimit në rastin e qytetit të Gramshit. Siç dihet urbanizimi është një process dinamik i cili orientohet sipas nevojave. Në bashkinë e Gramshit synohet që zonat e urbanizuara të konsolidohen duke ruajtur qendërsitë ekzistues dhe duke ruajtur tokat natyrore e bujqësore.

- **Transformimet Strategjike dhe platforma e ndërhyrjeve në territor**

- 1. Ndërtimi një pike grumbullimi të produkteve bujqësore në hyrjen jugore të qytetit**

Bashkia Gramsh has sot si problem mungesën e një pike grumbullimi për produktetbujqësore. Pika e grumbullimit propozohet të ndërtohet në hyrjen jugore të qytetit, ndërsa projekti përfshin hartimin e projektit të objektit të pikës së grumbullimit si dhe zbatimin e tij. Kjo pikë grumbullimi synon të shërbejë si qendër rajonale duke furnizuar në këtë mënyrë edhe bashkitë fqinje. Sipas projektit, kjo qendër grumbullimi do të ketë ambientet e magazinimit dhe të parkimit të mjeteve të transportit. Ky projekt siguron efikasitet më të lartë të prodhimit dhe tregtimit bujqësor të produkteve të serave dhe të arave si dhe ka potencial të mbledh edhe prodhime bujqësore në nivel rajoni.

- 2. Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në hyrjen jugore të qytetit**

Ndërtimi i kësaj qendre agro-industriale ka ndikim pozitiv në ekonominë e Bashkisë së Gramshit dhe krijon mundësi për përpunimin dhe tregtimin e tyre. Ky projekt hartohet me synimin për t'i ardhur në ndihmë prodhuesve në shkallë rrethi që të kenë mundësi të shesin prodhimet e tyre me qëllim përpunimin e tyre. Kjo përfshinë një gamë të gjerë produktesh si ato bujqësore e blegtorale. Kjo qendër agro-industriale është menduar të pozicionohet në hyrjen jugore të qytetit të Gramshit. Bashkia Gramsh ka kapacitete prodhuese për produktet bujqësore dhe blegtorale të larta dhe duhet krijuar mundësia e përpunimit dhe tregëtimit të tyre brënda territorit të bashkisë. Tregëtimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore në Bashkinë Gramsh ndikon në rritjen ekonomike të bashkisë.

- 3. Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh**

Projekti do të përfshijë një analizë të detajuar të problematikave të sistemit vadites dhe kullues në të gjitha njësitet si dhe do të evidentohen zonat të cilat kanë nevojë për rehabilitim



dhe ndërhyrje fizike. Projekti do të konsistojë në ndërhyrje fizike si p.sh., pastrim i kanaleve, zgjerim i tyre, shtim dhe mirëmbajtje. Një menaxhim i mirë i sistemit vaditës dhe kullues është i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në prodhimin bujqësor, cilësinë e tokave bujqësore dhe ndihmon në shmangien e përmbytjeve. Aktualisht, sistemi ujitës dhe kullues në Bashkinë e Gramshit ka probleme të shumta fizike, sepse është mjaft i amortizuar dhe kërkon mirëmbajtje dhe ndërhyrje të vazhdueshme në mënyrë që tokat të furnizohen me ujë në të gjitha stinët sidomos në stinën e verës. Projekti do të ndikojë në përmirësimin fizik të kanaleve duke i kthyer ato në kanale vaditëse dhe kulluese funksionale. Projekti do të rinovojë sistemin ujitës dhe do të përmirësojë qarkullimin e ujit duke shmangur përmbytjet.

4. Projekti për ndërtimin e bujtinave në zonat turistike të bashkisë Gramsh (Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabove, Liq i Dushkut)

Ky projekt hartohet në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës mbështetëse për turistët të cilët shprehin interesin e tyre për të vizituar këtë zonë dhe pikat e saj turistike më të preferuara për ata. Këto bujtina do të ofrojnë shërbime për turistët dhe do të kenë kapacitete të konsiderueshme që mbulon nevojat. Në zonat turistike si: Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabove, Liqeni i Dushkut, ndodhen vendbanime të cilat kanë banesa të cilat mund të kthehen në bujtina dhe vet banorët t'i menxhojnë ata për të mirëpritur turistët. Projekti është i rëndësishëm pasi mbështet nismat e promovimit të turizmit. Zhvillimi i turizmit sjell mbështetje për ekonominë e zonës. Projekti pritet të ketë si rezultat ngritjen e bujtinave në vendbanimet pranë zonave turistike, trajnimin e komunitetit të përfshirë në këtë projekt si dhe rritjen e numrit të vizitorve.

Duhet theksuar që këto projekte ndodhen në zona urbane eksistuese, të cilat janë pranë zonave turistike, apo zonave të mbrojtura (Monumentet e Natyrës). Këto ndërhyrje në asnjë mënyrë/rast nuk do të çenojnë perimetrin e sigurisë për Monumentet e Natyrës me rreze prej 200m.

Figura 6. Shembull i ndërtimit të bujtinave



Burimi: STUDIO GELLNER, ITALI, 1954



5. Restaurimi i bllokut qendror të banimit në qytetin e Gramshit si një zone e cila ruan arkitekturën e kohës së diktaturës dhe zhvillimi i bizneseve të vogla me qëllim diversifikimin e veprimtarisë ekonomike të zonës.

Ky projekt hartohet në kuadër të përmirësimit të kushteve fizike, mjedisore, higjienike, funksionale dhe estetike të bllokut qendror të banimit në qytetin e Gramshit, me synimin e rigjenerimit të këtij blloku urbane, dhe rritjes së vlerës së truallit në këtë zonë administrative me potencial zhvillimin e veprimtarisë ekonomike. Projekti ka si synim pastrimin, ridizenjimin dhe mobilimin urban të bllokut qendror të banimit, projektimin estetik e funksional të hapësirës, duke i dhënë mundësinë zhvillimit të bizneseve të vogla me synim përmirësimin e veprimtarisë ekonomike në qytetin e Gramshit duke u konsideruar si një zonë e rëndësishme për banorët. Projekti i shërben rigjenerimit të zonave urbane të ndërtuara në stilin e realizmit socialist, të cilat do i nënshtrohen ndërhyrjeve vitalizuese. Projekti rivitalizon bllokun qendror të banimit, si qendër të aktiviteteve turistike/ekonomike potenciale të bashkisë Gramsh dhe gjithashtu mundëson akses më të mirë në zonën qendrore.

6. Rehabilitimi dhe rigjenerimi i zonës së tregut aktual të perimeve në Gramsh

Bashkia e re Gramsh ka një potencial të madh të prodhimit të produkteve bujqësore, por tregtimi i tyre ngelet një problem i vazhdueshëm. Për këtë arsye, sot në Bashkinë e Gramshit ndjehet tepër e nevojshme të rehabilitohet tregu aktual në të cilin tregtohen prodhimet bujqësore të zonës. Projekti për rehabilitimin dhe rigjenerimin e zonës së tregut përfshin hartimin e projektit të rigjenerimit të objektit të tregut si dhe zbatimin e tij. Tregu synon të shërbejë si treg rajonal duke furnizuar në këtë mënyrë edhe bashkitë fqinje. Sipas projektit, tregu i ri do të ketë ambientet e magazinimit, të shitjes si dhe të parkimit të mjeteve të transportit. Projekti do të shërbejë për tregtimin e produkteve bujqësore dhe do të ndikojë në zhvillimin ekonomik lokal të bashkisë duke rritur fitimet dhe numrin e të punësuarve.

Figura 7. Shembull i një tregu



Burim: MIRALES TAGLIABUE I SANTA CATERINA MARKET, SPANJË, BARCELONA, 2007

7. Rigjerimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës ish-industriale në hyrje të qytetit dhe zhvillimi i saj si zonë shërbimesh tregtare punishtesh dhe si zonë banimi.

Ky projekt synon të zgjidhë në mënyrë përfundimtare problematikën e mbetjeve industriale në këtë zonë të rëndësishme ish-industriale të bashkisë. Projekti ka si fokus rehabilitimin mjedisor të tokës dhe strukturave në zonat ish industriale. Pas aplikimit të strategjive të rehabilitimit mjedisor dhe konstruktiv/arkitektonik të ndërtesave, pastrimit të tokës, shtimit të gjelbërimit që i përgjigjet funksioneve rigjeneruese, projekti synon t'i kthejë zonat në



qendra të integruara me qytetin, të fokusuar në ofrimin e shërbimeve tregtare dhe punishtesh. Nëse ky projekt integrohet me projektet e tjera të parashikuar, për studimin e rikuperimit të nivelit të ndotjes në tokë nga këto aktivitete, atëherë këto zona i përgjigjen mirë kërkesës në nivel qyteti për zgjerim të zonave të banimit. Ky projekt do sjellë një përmirësim mjedisor të ndjeshëm në qytetin e Gramshit dhe do risjellë në funksionim një zonë që përbënte një barrë vizuale dhe mjedisore për qytetin. Realizimi i projektit do të ndikonte në krijimin e profilit turistik të bashkisë dhe qytetit.

8. Zhvillimi i zonës së bulevardit të ri si zonë shërbimesh tregtare dhe banimi në të dy krahët e bulevardit

Projekti fokusohet në nevojat e zhvillimit të shërbimeve tregtare fillimisht që do të nxisin zhvillimin ekonomik të qytetit të Gramshit. Kjo e integruar me zhvillimin e banimit në të dy krahët e bulevardit përbënë një element nxites për zhvillimin e qytetit dhe i jep mbështetje atij. Projekti konsiston në ndërtim dhe rehabilitim. Ndërhyrjet konsistojnë në përmirësim të fasadave të objekteve, krijimin e hapësirave të nevojshme për ofrimin e shërbimeve tregtare, zgjerim të trotuareve, pajisje me sinjalistikën e duhur rrugore, dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme. Projekti vjen si nevojë e rritjes dhe përmirësimit të zhvillimit të zonës në qytetin e Gramshit. Rritja e rëndësisë së zonës duke u konsideruar një zonë potenciale e qytetit.

Figura 8. Skema konceptuale e Zgjerimit të Bulevardit



Burimi: METROPOLIS, 2017

9. Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e disa seksioneve të rrugës orbitale Dushk-Sult-Sarasel-Jaçe-Brasnik-Dumbreas-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur- Rrashtan- Gjerë- Holtas-Poroçan-Drizë.

Sistemi rrugore përbënë një nga pika kryesore të zhvillimit të bashkisë. Disa nga akset kryesore të cilat mundësojnë lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme të qytetit të Gramshit,



kanë shfaqur shenja amortizimi nga përdorimi ndër vite. Duke vështirësuar kalimin e qytetarëve me automjete si dhe kalimin e këmbësorëve nga dëmtimi ose mungesa e trotuarëve në disa segmente përgjatë këtyre askseve. Sa i përket gjëndjes së infrastrukturave, është vënë re se pjesa më e madhe e rrugëve lokale paraqitet në gjëndje të pashtruar dhe me një nevojë emergjente për rikonstruktim. Projekti konsiston në rehabilitim dhe sistemim të disa seksioneve rrugore orbitale si:

Dushk-Sult-Sarasel-Jançe-Brasnik-Dumbreas-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur- Rrashtan- Gjerë- Holtas-Poroçan-Drizë.

Ky projekt i rëndësishëm për infrastrukturën e bashkisë do të sillte rritje të aksesueshmërisë në territorin e Bashkisë Gramsh si dhe zvogëlimin e kohës mesatare të udhëtimit dhe rritja e sigurisë së udhëtarëve.

Figura 9. Shembull i rehabilitimit dhe sistemit të rrugëve



Burimi: LJB ARCHITECTURE AND LANDSCAPE, NORVEGJI, 2012

10. Projekti për ndërtimin e By-Passit të qytetit në anën lindore të tij

Ndërtimi i **By-Passit** të Gramshit është një zgjidhje shumë e mirë për të shmangur trafikun në pjesën e brëndshme të qytetit, por ai nuk do jetë efikas nëse nuk do të lidhet me rrjetin rrugor të bashkisë në anën lindore të saj. Projekti do të synojë të krijojë një lidhje më funksionale dhe efikase të **By-Passit** të Gramshit dhe qendrës së qytetit. Projekti do të fokusohet në rehabilitimin e rrugëve kryesore si dhe ndërtimin e kryqëzimeve. Projekti do të jetë teknik dhe do të bazohet në të gjithë parametrat teknikë bashkëkohorë duke siguruar në këtë mënyrë zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve, ndriçimin e tyre, kanalizimet nëntokësore dhe pajisjen me sinjalistikë dhe trotuare. Ky projekt do të rrisë cilësinë e jetesës së banorëve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave publike dhe do t'i shërbejë komunitetit të Bashkisë Gramsh, por edhe qytetarëve të cilët kalojnë transit në këto zona. **By-Passi** do të jetë më tepër funksional dhe efikas.



Figura 10. Skemë Konceptuale për ndërtimin e By- Passit




Burimi: METROPOLIS, 2017

11. Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacione të ndryshme nga qyteti në drejtim të destinacioneve turistike të bashkisë

Qyteti i Gramshit gjendet në rrëzë të një zone të thellë malore dhe me vlera të mëdha mjedisore e kulturore. Qyteti i Gramshit duhet të shërbejë si qytet akomoduese dhe potencial turistik për këtë zonë dhe në të njëjtën kohë si pikënisja e itinerareve të ecjes në natyrë për të gjithë zonën pasi përmbanë një seri vendesh me inters turistik dhe kulturor. Krijimi i një rrjeti shtigjesh peizazhistike/turistike në Gramsh do të mundësojë atij një marketing më të mirë të vlerave turistike të bashkisë. Këto shtigje i mundësojnë turistëve që të vizitojnë pika të ndryshme turistike dhe të mund të shijojnë peisazhin e bukur të kësaj zone. Ky projekt do të ndikojë në rritjen e të ardhurave të gjeneruara nga shtimi i numrit të vizitorëve dhe gjithashtu në rritjen e punësimit në sektorin e turizmit (punime artizanale/shërbime). Ky projekt do të sjell forcimin e sektorit të hotelerisë nëpërmjet përfshirjes në paketa turistike.



Figura 11. Skemë Konceptuale e Zhvillimit të Shtigjeve



Burimi: METROPOLIS, 2017

Figura 12 Shembull i ndërtimeve të hapësirave të shërbimit për rrugët



Burimi: LJB ARCHITECTURE AND LANDSCAPE, NORVEGJI, 2012

12. Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobuzëve në qytetin e Gramshit

Gjendja e këtij stacioni paraqitet jo e mirë. Mungesa e një vendqëndrimi të caktuar, orareve fikse të lëvizjes dhe itinerareve, cilësia e dobët e automjeteve të cilat ofrojnë shërbimin, etj., sjellin nevojën emergjente për sistemimin dhe zgjerimin e terminalit në shërbim të njerëzve. Terminali aktual është në përmasa të vogla, dhe nuk mbulon dot gjithë shërbimin aktual urban, ndërkohë që shumë linja ndërqytetëse nisen nga pozicione sporadike në qytet.



Projekti parashikon zgjerimin e terminalit në pozicionin ku është sot, si pozicion afër qendrës dhe i aksesueshëm lehtësisht në nivel qyteti. Terminali do përmbajë vende parkimi, mundësi parkimi dhe shërbimi për linjat e autobusëve urbane dhe linjat e furgonëve dhe autobusëve ndërqytetës. Ky projekt ndikon në përmirësimin e cilësisë së transportit publik, përfshi këtu oraret e transportit dhe cilësinë e automjeteve; Ndihmon sektorin privat të transportit të vendoset në një vendqëndrim dhe nxit konkurrencën e pastër.

Figura 13. Shembull i ndërtimit të terminalit të autobuzëve



Burimi: METARAUM, Gjermani, Stuttgart, 2015

13. Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit

Zona e kalasë së Irmajit është shumë interesante nga pikëpamja e peisazhit dhe e kontributit që ajo mund të jap në shtimin e vlerave mjedisore përveç atyre kulturore që vet kalaja përfaqëson. Gjithashtu rezultat pozitiv i pyllëzimit shmang erozionin e shpateve dhe rrëshqitjen së tokës i cili mund të rrezikoj zonat e banuara. Projekti synon të rivlerësojë peizazhin kodrinor si potencial për t'u shndërruar në një park për Bashkinë Gramsh. Kjo do të rrisi numrin e vizitorve pasi kthehet në një potencial natyror të zonës. Ky projekt shërben për integrimin e Gramshit në rrjetin e itinerareve natyrore rajonale e turistike, duke e kthyer qytetin në qendër potenciale turistike dhe shërben për të ofruar një hapësirë të shëndetshme rekreative për vendbanimet. Gjithashtu projekti ndikon në rritjen e vlerave turistike të zonës.

14. Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit

Zona që shtrihet në dy njësitë Lenie dhe Kukur është shumë interesante nga pikëpamja peisazhistike dhe përfaqëson vlera natyrore. Në territorin e këtyre njësisive ndodhen pika të ndryshme turistike të cilat i vijnë në ndihmë krijimit të parkut. Projekti synon të rivlerësojë peizazhin kodrinor të njësisive Lenie dhe Kukur. si potencial për t'u shndërruar në një park rajonal jo vetem për Bashkinë Gramsh. Kjo do të rrisi numrin e vizitorve pasi kthehet në një potencial natyror të zonës. Ky projekt shërben për integrimin e Gramshit në rrjetin e itinerareve natyrore rajonale e turistike, duke e kthyer qytetin në qendër potenciale turistike. Projekti shërben për të ofruar një hapësirë të shëndetshme rekreative për vendbanimet;


Ndikon në rritjen e vlerave turistike të zonave.



15. Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll

Lumi Devoll, me ndërtimin e hidrocentralit të Banjës ka pësuar ndryshime në shtrirjen e tij pasi është formuar liqeni. Projekti konsiston në analizimin e gjëndjes mjedisore të Lumit të Devollit dhe rehabilitimin e zonës ripariane të tij. Projekti do të përfshijë fillimisht një analizë të detajuar të cilësisë së ujërave të lumit dhe evidentim të përshkueshmërisë së ujërave të ndotura në shtresat nëntokësore. Më pas do të rishikohet segmenti i përzgjedhur për ndërhyrje mbi bazën e një studimi parafizibiliteti, për të përcaktuar zonën e ndërhyrjes. Gjithashtu do të evidentohen dhe do të shmangen ndotësit e lumit. Një tjetër ndërhyrje, pjesë e këtij projekti është rikthimi i zonave ripariane përgjatë lumit, zona në të cilat do të jetë e nevojshme të kryhen edhe prishje ndërtimesh të mundshme si dhe ripyllëzime. Në përfundim, për të shmangur rrezikun e përmbytjeve dhe erozionin e brigjeve, veç rehabilitimit të zonës ripariane, do të ndërhyhet në disa segmente me korracim lumor vegjetativ dhe/ose me gabione. Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ujërave të lumit dhe këto ujëra do të jenë më të sigurt për përdorim në bujqësi. Fasha e lumit do të mundësohet si zonë rekreative për qytetarët dhe rehabilitimi i kësaj fashe do të ndikojë ndjeshëm në shëndetin e qytetarëve.

Figura 14. Shembull rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zona rekreative të zonave ripariane



16. Rikonstrukcioni i shesheve të qendrave të njërive administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë

Ky projekt hartohet në kuadër të përmirësimit të kushteve fizike, funksionale dhe mjedisore të qendrave të njërive administrative rurale të Bashkisë Gramsh. Aktualisht qendrat e njërive Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë **kane nevojë për rikonstrukcion të shesheve qendrore**. Është e rëndësishme të krijohet një imazh më pozitiv i qendrave rurale, në funksion të potencialit turistik të zonës dhe ofrimit të shërbimeve më cilësore ndaj banorëve. Projekti ka si synim pastrimin, ridizenjimin, shtrimin dhe mobilimin urban të shesheve qendrore të këtyre administrative, për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve në to. Projekti mundëson akses më të mirë në fshatrat kryesore të Bashkisë Gramsh dhe




ndihmon në përmirësimin e imazhit të njësive administrative, në funksion të zhvillimit të potencialeve të turizmit natyror dhe kulturor.

Figura 15. Shembull i rikonstruksionit të shesheve



Burimi: METROPOLIS, SHQIPERI, PUSTEC, 2016

Figura 16. Shembull i rikonstruksioneve të shesheve



Burimi: ENRICO SASSI ARCHITETTO, ZVICER, ISONOGNO, 2016

Figura 17. Shembull i rikonstruksionit të shesheve



Burimi: METROPOLIS I SHQIPERI I TAMARE | 2016 (imazhet para dhe pas ndërhyrjes)




17. Projekti për rikonstruksionin e Stadiumit dhe Pallatit të Sportit në qytet

Dy prej atraksioneve sportive më të rëndësishëm të qytetit të Gramshit janë ndërtuar para viteve 90'. Gjatë 25 viteve të fundit, ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve fizike kanë qënë të pakta. Stadiumi i Vjetër tashmë e ka të nevojshëm rikonstruksionin, për shkak të shkallës së lartë të amortizimit dhe gjithashtu në të njëjtin stad është dhe pallati i sportit. Përgatitja e projektit arkitektonik e konstruktiv dhe kryerja e punimeve për rikonstruksionin e stadiumit të vjetër dhe pallatit të sportit në qytetin e Gramshit. Ky projekt i cili përfshin rikonstruksionin e dy atraksioneve sportive të qytetit realizohet për arsye të nxitjes dhe angazhimit të të rinjve në aktivitete sportive.

18. Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës

Ky projekt ka për qëllim rivitalizimin e bregut të liqenit të Banjës i krijuar nga ndërtimi i digës për hidrocentralin e Banjës mbi lumin Devoll. Duke qënë se qyteti i Gramshit ka akses të drejtpërdrejt në këtë liqen ai i shërben tashmë qytetit si një pikë rekreative e cila duhet të përdoret në dobi të qytetit në rastin e rivitalizimit dhe gjenerimit të aktiviteteve rekreative natyrore. Me qëllim parandalimin e fenomenit të erozionit dhe shkatërrimit të vlerave peizazhiste, projekti për rivitalizimin e bregut të liqenit të Banjës parashikon kryerjen e një sërë vlerësimesh mjedisore me qëllim hartimin e veprimeve strategjike dhe prezantimin e masave për parandalimin dhe mbrotjen e bregut të liqenit nga erozioni si dhe zhvillimin dhe mbrotjen e peizazhit. Ky projekt do të ndikojë në ruajtjen e cilësisë së ujërave të liqenit. Ujërat e liqenit do të jenë më të sigurt për përdorim në bujqësi. Bregu i liqenit do të mundësohet si zonë rekreative për qytetarët dhe rehabilitimi i këtij bregu do të ndikojë ndjeshëm në shëndetin e qytetarëve.

Figura 18. Skema Konceptuale e Rivitalizimit të bregut të Liqenit të Banjës



Burimi: METROPOLIS, 2017



19. Projekti për ndërtimin e zonës rekreative të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll

Ky projekt ka për qëllim rritjen e sipërfaqeve të zonave rekreative pranë qytetit të Gramshit në fushën e bregut të Lumit Devoll. Ai konsiston në shtimin e sipërfaqes së gjelbërt të qytetit dhe në përshtatjen e një hapësire shlodhese dhe shfrytëzuese për banorët. Zonat rekreative të qytetit janë të rëndësishme për mirëqenien e banorëve, për këtë arsye projekti ka si fokus shtimin e gjelbërimit me drurë të ndryshëm dekorativ të përshtatshëm për mjedisin dhe klimën e zonës, gjithashtu krijimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Fusha në bregun e liqenit do të mundësohet si zonë rekreative për qytetarët dhe do të rrisi sipërfaqet e gjelbërta në qytet. Ky projekt do të ndikoj në përmirësimin e peisazhit të qytetit.

Figura 19. Shembuj të dizenjimit të hapësirave rekreative



- Platforma e ndërhyrjeve në territor

Ndërsa transformimet strategjike të territorit kanë rëndësi dhe efekt katalitik, janë zonat e tjera të territorit ato në të cilat banorët kryejnë aktivitetin e tyre të përditshëm dhe jetojnë. Në përgjithësi këto përbejnë zonat e banimit, ku në të shumtën e rasteve akomodojnë dhe një sërë shërbimesh, aktiviteteve institucionale e tregëtare, zona rekreative etj. Nga ana tjetër janë dhe territoret bujqësore e natyrore (në disa raste edhe të gërshetuara me banimin e shërbimet) parimi i zhvillimit të së cilave është ruajtja (konservimi) konsolidimi dhe ripërtëritja në ato segmente/fragmente ku është ndërprerë habitatit natyror. Plani i zhvillimit të territorit ofron një platforme të mënyrës sesi duhet të ndërhyet në këto zona me qëllim sigurimin e jetëgjatësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre përkrah përmirësimit cilësor të tyre.

Nga pikëpamja metodologjike, mënyrat e ndërhyrjeve bazohen në: tipologjinë hapësinore e ndërtimore që kanë aktualisht territoret dhe vendbanimet e ndryshme në bashki; analizën e strehimit, cilësisë së strukturave dhe territoreve, treguesit ekzistues të zhvillimit (intensitet, koeficient i shfrytëzimit të tokës për ndërtim, hapësirë publike dhe rrugë, dendësitë etj.) analizën e peisazhit natyror dhe fragmentimin e tij, interes e bashkisë e të komunitetit për të intensifikuar zhvillimin e zonave të banimit në të ardhmen.

Si rrjedhojë, platform e bashkisë për mënyrat e ndërhyrjeve në territor bazohet në këto masa:



- **Plotësimin me rrjet rrugor** të niveleve të ndryshme, të të gjithë zonave të banuara dhe ristrukturimin e infrastrukturës publike kudo që është e nevojshme, nëpërmjet shtimit dhe eficientimit të itinerareve të transportit publik me qëllim rritjen e aksesit mes Gramshit dhe qendrave rurale, dhe lidhjen e ketyre të fundit me rrjetin rajonal të lëvizjes.
- **Ripërtëritjen e zonave** që kanë humbur funksionin apo cilësinë, sikundër dhe rikonceptimin e zonave që kanë premise, por nuk kanë cilësi të strukturave dhe hapësirës
- **Konsolidimin dhe/ose mbushjen** e dendësimin e zonave të cilat kanë një tipologji të caktuar, të cilat ja vlen të ruhen dhe të nxitet zhvillimi në to.
- **Konservimin dhe konsolidimin e tokës bujqësore** dhe ekosistemeve natyrore duke marrë edhe masa për përmirësimin e rigjallërimit të tyre sipas nevojës.
- **Rehabilitimin mjedisor** dhe, sipas rasti, historik të zonave kryesisht natyrore me qëllim nxjerrjen në pah të vlerave, vënien e tyre në funksion të komunitetit dhe zhvillimit të turizmit alternativ (vernakolar) në zonë.
- **Rritjen e rivlerësimin e hapësirës publike** jo vetëm në qendrat e qytetit e të vendbanimeve, por edhe në zonat e banimit. Kjo hapësirë në disa raste përcaktohet në hartë/territory se ku do të ndodhet (rastet e përmendura në seksionin e transformimeve strategjike më sipër), dhe në rastet e tjera jepet përmes treguesit të Kshp-së. Propozimet për ndërtimin/rikonstruktimin e shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore, qendrave kulturore e sociale janë në funksion të rritjes së hapësirës publike.

- **Objektivat strategjike, programet strategjike dhe projektet**

Në përmbushje të Vizionit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Gramsh, dhe në respektim të plotë të parimeve të sipërpërmendura, janë hartuar katër objektiva kryesore të cilat synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshëm, specifikë dhe të monitorueshëm për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye në tabelën e veprimit janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që bashkia do të kryerë për zbatimin e PPV-së.

1. **Objektivi strategjik 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.**
2. **OIP1:** Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në bashkinë Gramsh, zhvillimi i sektorit të shërbimeve, si dhe zhvillimit të sektorëve bujqësorë blegtoralë e turistik në zonat me karakter natyror.
3. *Pr.1: Ndërtimi një pike grumbullimi të produkteve bujqësore hyrjen jugore të qytetit.*
4. *Pr.2: Ndërtimi i tregut të ri industrial në hyrjen jugore të qytetit.*



5. *Pr.3: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në hyrjen jugore të qytetit.*
6. *Pr.4: Ndëtimi i thetores për prerjen e gjësë së gjallë në hyrjen jugre të qytetit.*
7. *Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh*
8. *Pr.6: Projekti për rehabilitimin e rezervuarëve ujitës të bashkisë Gramsh*
9. *Pr.7: Projekti për ndërtimin e bujtinave në zonat turistike të bashkisë Gramsh (Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabove, Liq i Dushkut)*
10. *Pr.8: Projekti për krijimin e ofertave turistike të bashkisë grmash si dhe marketimi e brandimi i tyre në funksion të zhvillimit të sektorit të turizmit*
11. **O1P2:** Nxitja dhe zhvillimi i ndërtimeve nëpërmjet zgjerimit dënsifikimit dhe diversifikimit të tyre për zhvillimin e sektorit të shërbimeve në qytet
12. *Pr.9: Restaurimi i bllokut qendor të banimit në qytetin e gramshit si një zonë e cila ruan arkitekturën e kohës së diktaturës dhe zhvillimi i bizneseve të vogla me qëllim diversifikimin e veprimtarisë ekonomike të zonës*
13. *Pr.10: Rehabilitimi dhe rigjenerimi i zonës së tregut aktual të perimeve në Grmash*
14. *Pr.11: Rigjenerimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës ish-idustriale në hyrje të qytetit dhe zhvillimi i saj si zonë shërbimesh tregtare punishtesh dhe si zonë banimi.*
15. *Pr.12: Rigjenerimi dhe rehabilitimi i zonës së ish-repartit ushtarak si zonë banimi si dhe për ndërtimin e banesave sociale.*
16. *Pr.13: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i zonës së ish uzinës së baterive dhe zhvillimi i saj si zonë banimi.*
17. *Pr.14: Zhvillimi i zonës së bulevardit të ri si zonë shërbimesh tregtare dhe banimi në të dy krahët e bulevardit.*
18. **O1P3:** Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre
19. *Pr.15: Mbështetja e zhvillimit të bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar.*
20. **Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.**
21. **O2P1:** Konsolidimi i lidhjeve të bashkisë së Gramshit në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore.
22. *Pr.1: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Elbasan-Gjinar-Zavlinë Porocan-Kukur-Lenie-Strelcë*
23. *Pr.2: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh -Tunjë- -Jançë – Kostren-Roshnik-Berat*
24. *Pr.3: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Grmash-Tunjë-Katërlis-Sarasel-Lumas*
25. *Pr.4: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh –Kukur-Përrenjas*
26. *Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjupe-Dushk-Kutërqarë-Dragot-Mollas*



27. **O2P2:** Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësisve rurale me njëra-tjetrën dhe me Gramshin.
28. *Pr.6: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e disa seksioneve të rrugës orbitale Dushk-Sult-Sarasel-Jançe-Brasnik-Dumbreas-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur-Rashtan-Gjerë-Holtas-Poroçan-Drizë*
29. *Pr.7: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh- Skendebegas*
30. *Pr.8: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Lenie*
31. *Pr.9: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Fushërangës-Liras-Sinan-Tervol-Venizë-Broshtan-Posnovisht-Kishtë-Zmashë*
32. *Pr.10: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Çekin-Perikë-Xhams-Tervol*
33. *Pr.11: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Bulçar- Liqeni i Dushkut (rruga e vjetër)*
34. *Pr.12: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Duzhe-Lubinje-Dufshan-Sult*
35. *Pr.13: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovic-Dufshan*
36. *Pr.14: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Shëmrizë-Ostrenth*
37. *Pr.15: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Sotirë*
38. *Pr.16: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjupë-Dushk-Banjë*
39. *Pr.17: Projekti për ndërtimin e urave në fshatrat Liras, Skenderbegas Lenie dhe Kushovë*
40. **O2P3:** Sistemimi i rrjeteve rrugore në nivel qyteti për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zonat rurale.
41. *Pr.18: Projekti për ndërtimin e By-Passit të qytetit në anën lindore të tij.*
42. *Pr.19: Projekti për ndërtimin e rrugës gjatsore përgjatë bregut të lumit Devoll.*
43. *Pr.20: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës diagonale nga rrethrrutullimi i terminalit të autobuzave tek Pallati i Kulturës.*
44. *Pr.21: Projekti për ndërtimin e zgjatimit të Bulevardit kryesor të qytetit.*
45. *Pr.22: Projekti për ndërtimin e rrugës nga Terminali deri në hyrje të By-Passit të ri të qytetit.*
46. *Pr.23: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve Llapushaj, Kocaj, dhe Devolli.*
47. **O2P4:** Integrimi i bashkisë së Gramshit në tërësinë e itinerareve të gjelbra në nivel qyteti dhe në nivel rajonal nëpërmjet infrastrukturës së lehtë e turistike.
48. *Pr.24: Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacione të ndryshme nga qyteti në drejtim të destinacioneve turistike të bashkisë*
49. *Pr.25: Ndërtimi i korsive të biçikletave kalimeve, këmbësore përgjatë dhe shesheve si pika vrojtimi të natyrës përgjatë By-passit në anën lindore të qytetit.*
50. *Pr.26: Ndërtim i korsive të bicikletave dhe kalimeve këmbësore përgjatë lumit Devoll në pjesën e qytetit.*
51. *Pr.27: Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkallëve të qytetit përgjatë përrenjve si shoqëruese të elementeve natyrore duke stimuluar levizshmërinë e qendrueshme në qytet.*



52. **O2P5:** Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për të gjithë territorin e bashkisë
53. *Pr.28: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimi i tubacioneve të reja të ujërave të zeza në NjA-të Sult, Pishaj, Kushovë, Kodovjat dhe Skenderbegas.*
54. *Pr.29: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e gropave spetike si pas standrateve në fshatrat që nuk kanë akses në KUZ.*
55. *Pr.30: Projekti për rhabilitimin e rrejtit të brendshëm ëe ujësjellësit të qytetit të Grmashit*
56. *Pr.31: Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*
57. *Pr.32: Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve duke ndarë ujërat e bardha nga ato të zeza në qytet, si dhe duke siguruar mbulim me rrjet për të gjithë bashkinë.*
58. **O2P6:** Programi për përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie.
59. *Pr.33: Projekti për zhvillimni i një sistemi transporti publik brenda bashkisë për të siguruar aksesin sa më të mirë të NjA-ve me qytetin e Gramshit*
60. *Pr.34: Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobusëve në qytetin e Gramshit.*
61. *Pr.35: Projekti për ndërtimin dhe rehabilitimin e vendqendrimeve të automjeteve që kryejnë transportin rrethëytetas në NjA-të e bashkisë Gramsh.*
62. *Pr.36: Projekti për ndërtimin e parkimeve të automjeteve në hyrje dhe dalje të qytetit si dhe në qendrat e NjA-ve.*
63. *Pr.37:Projekti për rehabilitimin dhe shtimin e ndricimit rrugorë në Qytetin e Gramshit dhe qendrat e NjA-ve të Bashkisë Gramsh.*
64. **Objektivi strategjik 3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.**
65. **O3P1:** Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane duke përfshirë strategjitë për mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e vendit të depozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike.
66. *Pr.1: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.*
67. *Pr.2: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi sipas standarteve të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta.*
68. *Pr.3: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike si dhe ndërtimi i pikës së kompostimit të mbetjeve organike.*
69. **O3P2:** Programi për krijimin e parqeve rajonale në zonat mjedisore që cilësohen si zona me biodiversitet të lartë duke mbrojtur dhe konservuar faunën dhe florën si dhe elementet e fortë natyror, peizazhistik, e historiko- kulturor.
70. *Pr.4: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit.*
71. *Pr.5: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit.*



72. **O3P3:** Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve përrrenjve dhe zonave me rrezik natyror.
73. *Pr.6: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll.*
74. *Pr.7: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë përroit të Tomorricës, Vërçës dhe Holtës.*
75. *Pr.8: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumi Devoll dhe liqeni i Hidrocentralit të Banjës..*
76. *Pr.10: Ndërtimi i pritave malore dhe ndërmarrja e fushatave të mbjelljes së bimësisë për zbutjen e veprimtarisë së erozionit në zonat e zhveshura malore.*
77. *Pr.11: Projekti për pyllëzimin e kodrave në afërsi të lagjes Llapushaj në qytetin e Gramshit si dhe në zonën e Liqenit të Dushkut.*
78. **Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.**
79. **O4P1:** Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet.
80. *Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Grabovë, Nartë, Mashan, Holtas, Gjerë dhe shkollës Asllan Shahini qytet Gramsh.*
81. *Pr.2: Ndërtimi i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Kukuçovë, zgjupë, Kabash dhe Lleshaj.*
82. *Pr.3: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.*
83. *Pr.4: Rikonstruksioni i plotë i shkollës së mesme në Tunjë*
84. *Pr.5: Rikonstruksioni i ndërtesave publike të njësive administrative Kushovë dhe Sult*
85. *Pr.6: Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore në fshatrat Siman dhe Ermenjë si dhe ndërtimi i qendrës shëndetësore në fshatrat Bratile dhe Kokël.*
86. *Pr.7: Rikonstruksioni i Spitalit të Qytetit të Gramshit*
87. **O4P2:** Rikonstruksioni ndërtimi dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive administrative dhe fshatrave
88. *Pr.8: Ndërtimi i sheshit në afërsi të kishës në zgjatimin e bulevardit të ri të qytetit.*
89. *Pr.9: Rikonstruksioni i shesheve të qendrave të njësive administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë*
90. **O4P3:** Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.
91. *Pr.10: Projekti për rikonstruksionin i godinës së Komisarariatit Policor dhe kthimi në zyra për shërbime administrative të institucionit të Bashkisë Gramsh.*
92. *Pr.11: Projekti për rikonstruksionin e bibliotekës së qytetit*
93. *Pr.12: Projekti për rikonstruksionin e muzeut të qytetit*
94. *Pr.13: Projekti për rikonstruksionin i Stadiumit dhe Pallatit të Sportit në qytet .*
95. *Pr.14: Projekti për rikonstruksionin Pallatit të Kulturës në qytet.*



96. **O4P4:** Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Gramsh, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.
97. *Pr.15: Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës*
98. *Pr.16: Projekti për ndërtimin e zonës rekreative të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll*
99. *Pr. 17: Projekti për ndërtimin e parkut tërthor të qytetit i cili lidh parkun e bregut të lumit me zonën e kodrave në pjesën lindore të qytetit.*
100. *Pr.18: Projekti për ndërtimi varrezave të reja të qytetit*

3.3. Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Për të siguruar e përmbushur vizionin e zhvillimit dhe realizimin e objektivave të përcaktuar në “Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Gramsh”, Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë përcakton kategoritë, nënkategoritë dhe funksionet bazë të përdorimit të tokës për çdo njësi strukturore. Për sa i përket përdorimit të tokës, vetë objektivat dhe programet/projektet përkatëse synojnë ruajtjen e tokës natyrore dhe bujqësore si potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të kësaj bashkie, krijimin dhe përmirësimin e kushteve bazë të banimit për të përmbushur nevojat bazë të banorëve aktual dhe atyre të pritshëm, si dhe zbutjen e pabarazive sociale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave të cilat rrisin aksesueshmërinë, dhe përmirësimin e shërbimeve publike në cdo njësi administrative. Në lidhje me përdorimin e tokës, parimet kryesore që janë ndjekur nga PPV-ja janë:

1. Promovimin e përzierjes së funksioneve dhe shmangien e zonave monofunksionale brenda qytetit dhe vendbanimeve në tërësi. Miksi në rastin e bashkisë së Gramsh është i nevojshëm për ti bërë zonat më të jetueshme dhe të pasura me shërbime. Miksi gjithashtu zbut dominimet e monofunksionalitetit të banimit, të cilat tentojnë ti kthejnë zonat e banimit në zona “fjetoreje”.
2. Plani shmang mbivendosjen e përdorimeve të papërputhshme pranë njëra tjetrës, dhe në rastet kur kjo është e pamundur të shmanget atëher plani propozon masta mbrojtëse për secilin nga përdorimet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Masat e tilla si distancat apo brezat mbrojtës paraqiten në rregulloren e PPV-së në seksionin e përdorimeve të ndaluara dhe të kushtëzuara sikurse dhe në pasaportat përkatëse për secilën nga njësitë strukturore.
3. Kur përdorimet nuk janë banim, tentojnë përgjithësisht të jenë më monofunksionale. të tilla janë psh.rastet e infrastrukturave madhore, zonave natyrore dhe bujqësore, zonat ripariene, parqet kombëtare dhe rajonale dhe zona ekonomike e ish-SMT-së. me qëllim zhvillimin e tyre të pashqetësuar nga përdorime të tjera përreth plani e garanton nëpërmjet parashikimit të masave mjedisore, brezave dhe distancave mbrojtëse dhe pyllëzimeve.

Respektimi i rëndësisë kombëtare në territor dhe i të gjitha kushtëzimeve sektoriale është parimi kyç që ka drejtuar mënyrën sesi janë propozuar ndërhyrjet/ndryshimet e PPV-së. Disa nga kushtëzimet që mund të përmendim janë: Ligji nr. 9358 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” – kufizimin në konvertimin e fondit pyjor (aktualisht legjislacion i ri në proces); Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” – përcaktimi i brigjeve



të trupave ujorë (5m – 20m dhe 100m – 200m) dhe veprimtaritë e lejuara në brigje; “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” – distancat nga akset rrugore; VKM-ja nr. 671 “Për miratimin e rregullores së planifikimit” – standarde dhe tregues të planifikimit për shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, breza mbrojtës, distanca të mbrojtjes, lartësitë, intensitetet etj. ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; VKM-ja nr. 410, datë 27.06.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të 288 procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës” dhe VKM-ja nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore” – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar – kufizimet në zonat e mbrojtura dhe zonat buferike të tyre etj.

Ilustrime sesi këto kushtëzime ndikojnë në territor paraqiten në hartën me titull “Rëndësia Kombëtare në territor”, sikurse dhe në figurat e mëposhtme

Në mënyrë të përgjithshme propozimet për përdorimin e tokës përshkruhen si më poshtë:

Kategoria bazë “banim” (A): Kategoria bazë “banim” (A): Sistemi urban përfshin rreth 0.82% të territorit dhe vendbanimet kryesisht shtrihen përgjate luginës së Devollit dhe zonave fushore si dhe në masë më të vogël në pjesët e tjera të territorit. Duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim është përllogaritur kërkesa dhe oferta për programe sociale të strehimit në të cilën është vënë re që mungesa për fonde për ndërtimin e banesave dhe mungesa e të ardhurave të mjaftueshme për familje është i lartë. Duke patur parasysh potencialin e madh të tokës natyrore, dhe qëllimin për të ruajtur vlerat natyrore dhe peizazhistike të Bashkisë së Gramshit, dhe duke konsideruar si tepër të nevojshme ruajtjen e tokës bujqësore dhe konsolidimin e saj përgjatë lumit Devoll (përfshi këtu dhe kushtëzimet ligjore për konvertimin e saj në tokë truall), PPV-ja parashikon përgjithësisht zgjerimin e kategorisë Banim në zonën e qytetit të Gramshit, konkretisht në qendër propozohet një intensitet më i lartë dhe duke u larguar nga qendra më e ulët. Në njësitë administrative me karakter më rural, për kategorinë banim, PPV-ja fokusohet më tepër në konsolidimin e zhvillimeve ekzistuese, dhe pjesërisht në mbushjen e njësisve strukturore.

Në qytetin e Gramshit, ku është përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë, PPV-ja parashikon një shtrirje perspektive në jug të qytetit ekzistues, zona në të cilat procesi i zhvillimit ka nisur më herët. Kjo lidhet dhe me rivlerësimin e idesë së krijimit të unazës së re të qytetit në drejtimin veri – jug e propozuar nga plani rregullues (projekt ide) i vitit 1987.

Zgjerimi i zonave të reja të banimit do të jetë në përputhje me terrenin dhe preferencat e banorëve si edhe do të respektohet tradita pozitive e lartësive së kateve të objekteve të banimit.

Zhvillimi i kësaj kategorie apo zgjerimit të qytetit parashikohet të ndodhë duke filluar me qendërsitë urbane janë elementi tjetër gjenerues të cilat kryesisht do t'i nënshtohen konsolidimit urban dhe intensifikimit dhe dendifikimit në rastin e qytetit të Gramshit. Siç dihet urbanizimi është një proces dinamik i cili orientohet sipas nevojave. Në bashkinë e



Gramshit synohet që zonat e urbanizuara të konsolidohen duke ruajtur qnedërsitë ekzistues dhe duke ruajtur tokat natyrore e bujqësore. Njësitë e kësaj kategorie bazë propozohen pranë infrastrukturave rrugore ekzistuese, të cilat do të nënshtrohen rishtrukturimit dhe përmirësimit të cilësisë së tyre, dhe pranë akseve të reja të propozuara rrugore.

Disa nga njësitë strukturore të kategorisë “banim” (A), kryesisht ato të fshatrave të njësive administrative dhe një pjesë e qytetit, do të jenë të përbëra edhe nga sipërfaqe të kategorisë “shërbime”, të natyrës që i shërbejnë zonave të banuara ndërsa në zonat e banuara në qender të qytetit propozohet shtim të objekteve institucionale dhe arsimore dhe në rastin e atyre ekzistues propozohet një rikonstruksion të tyre.

Kategoria bazë “industri dhe ekonomi (IE): Industria, është një nga sektorët me traditën më të vjetër në Bashkinë e Gramshit, kryesisht ajo energjitike, ajo e demontimit të armeve në Çekin, ish industria e prodhimit të baterive dhe industria e lehte e perpunimit dhe grumbullimit agroushqimor dhe bujqësor. Në keto zona ish industriale propozohet të kthehen në zona mikse me përdorim shërbime dhe banim në dy ekstremitetet e qytetit. Propozohen gjithashtu hidrocentrale përgjate lumit të Graboves në Lenie dhe lumit të Tomorrices në Holte. Ndërsa për sa i përket ish Uzines së Baterive dhe kabanoneve si zona mikse mund të orientohen drejt përdorimeve rezidenciale dhe shërbimeve, por me për shkak të afërsisë së këtyre industrive me njësi të kategorisë “banim”, propozimi i një rehabilitimi mjedisor dhe rikrijimi i brezave mbrojtës (zonave buferike rreth tyre) është kusht i padiskutueshëm për zhvillimin e tyre.

Duke qenë se zhvillimi i industrisë tekstile pati një terheqje të madhe, kohë më parë u hap një punishte rrobaqëpsie, dhe shumë shpejt mendohet të hapet edhe një fabrikë këpucësh. Në këtë mënyrë territori i ish zonës industriale në hyrje të qytetit (veri) do të shihet si një zonë ekonomike e qytetit duke qenë se do të ketë dhe sistemimin e zonës së transportit të jashtëm.

Kategoria bazë “bujqësi” (B): Bujqësia përfshin rreth 13.7 % të territorit i cila pozicionohet kryesisht përgjatë luginës së Devollit ku terreni është më i ulët kryesisht me toka arë. Ruajtja dhe konservimi në masë më të gjerë të kësaj kategorie është një nga prioritetet e bashkisë Gramsh. Në njësitë e parashikuara me përdorim tokë të kategorisë bazë “bujqësi” parashikohet konservimi i tyre dhe përgatitja ose pajisja me infrastrukture bujqësore. Në rastin kur njësitet të cilat kanë presion zhvillimi do të behen konvertime të mundshme të tokës bujqësore dhe në rastin kur parashikojnë akomodimin dhe alokimin e popullsisë së ardhshme. Duke qenë se Nj.A Gramsh ka një karakter të theksuar rural dhe bujqësia zhvillohet në ferma të vogla familjare, si një bujqësi tradicionale, duhet t’i kushtohet një rëndësi të vecantë përqendrimit të industrisë së lehtë agroushqimore, pra propozohet zmadhimi i fermave së paku deri në 1,5- 2 herë të madhësisë ekzistuese me zbatimin e tregut të tokës dhe bashkimi i pronës, kooperimi i fermerëve, rritja e aftësisë ujitëse etj.

Në Nj.A Gramsh propozohet ndërtimi i një qendre grumbullimi të produkteve dhe tregëtimit, të nxitet krijimi i shoqatave të prodhimit dhe shërbimit në zonën rurale, për të forcuar bashkëpunimin e prodhuesve dhe rritur interesin e fermerëve nëpërmjet përmirësimeve të teknologjisë së prodhimit dhe rritjes së shkallës së mekanizmit bujqësor, të përshtatur me terrenin dhe madhësinë e fermës, të përmirësohet infrastruktura bujqësore, si konsolidimi i tregjeve të shumicës në afërsi të njësive administrative apo qytetit, për grumbullimin e prodhimeve të fermerëve privatë.



Kategoria bazë “shërbime” (S): Ky përdorim parashikohet të sistemohet në zonën qendrore dhe përgjate aksit kryesor të qytetit të Gramshit, dhe në qendrat e zonave rurale, kryesisht i përzier me kategorinë bazë “banim”.

Kategoria bazë “përdorime të veçanta” (V): Në këto kategori do të bëjnë pjesë të gjitha ato njësi të cilat në përdorimin ekzistues të tokës i përkasin nënkategorisë “varreza”. Për secilën nga këto njësi, PPV-ja parashikon rehabilitimin dhe konservimin e hapësirave për varreza dhe krijimin e brezave mbrojtës të tyre.

Kategoria bazë “ujëra” (U): Kjo kategori përfshin të gjitha sipërfaqet ujore të bashkisë Gramsh të cilat janë: lumi i Devollit, Përroi i Tomorrocës, Përroi i Grabovës, Përroi i Vërrces, Përroi i Holtës dhe Përroi i Pashtreshit, Liqeni I Banjes. Liqeni i Zi, Liqeni Bratilës, Liqeni i Dushkut (në Kumian) dhe Posnovishtë, etj. Në rastet kur kjo kategori është e dëmtuar apo ndotur nga aktiviteti njerezor, industrial apo bujqësor do të parashikohet rehabilitimi i tyre dhe rindërtimi i zonave ripariene (përgjatë lumit Devoll dhe përrenjëve) në zonat ku ajo është zhdukur apo dëmtuar krejtësisht si pasojë e përmbytjes si dhe trajtimi peizazhistik i tyre dhe gjithashtu konservimi i tyre duke minimizuar demet e erozionit me ane të masave mjedisore (vegjetative), forcimi dhe trajtimi i brigjeve ujore. Për njësitë strukturore, (liqeni I Banjes) përveç trajtimit peizazhistik të tyre parashikohet dhe kthimi i tyre në zona rekreative dhe çlodhëse për banorët e kësaj bashkie. Kthimi i tyre në zona ripariene dhe pyllëzimi në masën e duhur do të minimizojnë problemet mjedisore të erozionit aktiv.

Kategoria bazë “natyrore” (N): Njësi Gramsh rrethohet nga një kurore e gjelber e përbërë nga zona të mbrojtura me vlera kombëtare si mali i Tomorrit, Kanionet e Sinetit (Sarasilit), Liqenet e Vallamarës, Ujëvara e Sotirës, Kanioni i Holtës, Shpella e Kabashit dhe me vlera lokale si gryka e Grabovës, karsti i Tërvollit, liqeni i Dushkut, liqeni i Zi (Lenie), burimi termal i Holtës etj. Në këtë kategori, dy parqet me të rëndësishme janë ai i Lenie – Kukur dhe parku Hirmajit të cilat parashikohet si parqe rajonale me propozim nderhyrjesh konsolidim dhe konservim. Për shkak të aktivitetit bujqësor, ka raste kur sipërfaqet natyrore, dhe vecanërisht ato pyjore janë fragmentuar, duke shpëputur në këtë mënyrë korridoret natyrore të tyre. PPV-ja parashikon gjithashtu dhe rehabilitimin e të gjitha njësive të cilat i përkasin kategorisë bazë “natyrore”, si dhe shtrimin e sipërfaqeve të tyre në rastet kur kemi ndërprerje të habitateve.

Kategoria bazë “trashëgimi dhe monumente kulturore” (M): Bashkia e Gramshit është mjaft e pasur me monumente kulturore dhe natyre, si dhe mjaft objekte të Traditës. Kultura dhe Trashëgimia, të ndërthurura me natyrën e pakrahasueshme janë dy potencialet kryesore për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Gramsh. Sipas listës së monumenteve kulturore kësaj zone do të jenë zona të parashikuara sipas buffer-it ligjor 50 m distancë në ruajtje të tyre në baze të ligjit respektiv. Prioritet duhet të ketë konservimi dhe restaurimi në rast nevojë.

Kategoria bazë “institucione” (IS): Plani i Përgjithshëm Vendor nuk parashikon ndryshime në këtë kategori bazë për sa kohë nuk propozohen vendosje të institucioneve të reja administrative në këtë bashki. Megjithatë për të shmangur amortizimin dhe degradimin e mëtejshëm të këtyre strukturave, parashikohet konservimi dhe restaurimi i tyre sipas rëndësise dhe nevojave.



Kategoria bazë “aktivitete sociale dhe rekreative” (AR): Sipërfaqja e kësaj kategorie pritet të rritet ndjeshëm në bashkinë Gramsh, kjo jo vetëm si pasojë e propozimeve të planit për hapjen e hapësirave të reja të gjelberta, por dhe si nevojë për hapësira të lira për popullsinë e ardhshme të bashkisë. Në njësitë administrative këto hapësira do të bëhen të mundura kryesisht në qendrat e njësive të cilat parashikohet t’i nënshtrohen rigjenerimit, për rikonstrukcionin e Stadiumit dhe Pallatit të Sportit në qytet. Si dhe zhvillimi social-kulturor rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.

Kategoria bazë “arsim” (AS): Duke iu referuar analizës së periferialitetit dhe hartës së mbulimit me rreze të shërbimit arsimor në bashkinë Gramsh, pothuajse të gjitha njësitë administrative shfaqin nevojën për përmirësimin e shërbimit arsimor, pavarësisht se hartat tregojnë për një mbulim të mirë me këtë shërbim. Megjithatë, siç sugjerohet edhe në seksionin e rekomandimeve të planit, parashikohet përmirësimi i cilësisë fizike të shkollave dhe kopshteve (kryesisht në njësitë administrative) dhe zgjerimi i oborreve të shkollave dhe kopshteve të cilat nuk përmbushin standardet e “Rregullores së planifikimit”.

Kategoria bazë “shëndetësi” (SH): PPV-ja parashikon shtimin e kësaj kategorie kryesisht në njësitë administrative ku ato mungojnë, ose nuk përmbushin aspak standardet për ofrimin e shërbimit. Për çdo njësi të kësaj kategorie bazë parashikohet rigjenerimi i strukturave të degraduara shëndetësore, zgjerimi i sipërfaqeve të tyre dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit.

- **Kategoria bazë “infrastrukturë” (IN):**

Infrastrukturë transporti

Kjo kategori përfshin të gjitha zgjerimet e mundshme në rrjetin rrugor të mundshëm, duke përfshirë këtu edhe hapjen e akseve të reja. Për të bërë të mundur akses më të mirë të venbanimeve me infrastrukturën rrugore propozohet orbitali i Gramshit i cili do të kalojë kryesisht përgjatë rrugës ekzistuese në kufinj të bashkisë. Ky itinerar do të bëjë që aksesin i fshatrave të jetë më i mirë ndërmjet tyre si dhe më qytetin e Gramshit. Itinerari kalon kryesisht në terren të thyer dhe në disa raste në rrugë ekzistuese. Orbitali do të ketë gjatësi 422 km dhe do të aksesoj 53 fshatra nga 139 fshatra që ka gjithsej bashkia e Gramshit.

Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon, gjithashtu, edhe zhvillimin e infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.

Infrastruktura energjitike

Bashkia Gramsh falë edhe potencialeve të mëdha hidrike parashikohet të kthehet në një qendër e rëndësishme energjitike rajonale. Momentalisht në Gramsh janë 4 hidrocentrale ekzistuese: hidrocentrali I Holtës, I Sotirës, I Lenies dhe I Banjës(pjesa e liqenit të HEC-it gjendet në territorin e bashkisë), për të cilat parashikohen masa mirëmbajtje për të siguruar funksionimin e tyre të vazhdueshëm. Plani parashikon ndërtimin e 10 hidrocentraleve të tjera përgjatë degëve të Devollit, përkatësisht në njësitë Kukur, Lenie, Kushovë dhe Skënderbegas, të cilat do të jepen në kuadër të zbatimit të plotë të legjislacionit dhe mbrojtjes së mjedisit. Këto infrastruktura madhore do të ndikojnë në uljen e papunësisë në bashki duke siguruar një sektorë të qëndrueshëm punësimi për banorët e



Gramshit por njëkohësisht ndikojnë në forcimin e rolit të tij në rajon si qendër e rëndësishme. Gjithashtu pjesë e propozimeve për këtë sektorë është edhe investimi në stacionin energjistik të Çekinit për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e tij.

Infrastrukturë menaxhimi mbetjesh

Përsa I përket kësaj infrastrukture plani parashikon rehabilitimin e pikës ekzistuese të grumbullimit pranë fshatit Çekrezë dhe ndërtimin në pot ë njejtin vend të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta dhe asaj të kompostimit të mbetjeve organike.

Si rezultat i transformimeve që ndodhin në lidhje me përdorimin e tokës ndryshon edhe harta e sistemeve territorial. Ndryshimet e sistemeve janë të ndryshme dhe mbeten subject i legjislacionit përkatës që të mund të realizohen. Pjesa më e madhe e transformimeve të sistemit territorial ndodhin për shkak të infrastrukturave të reja që propozohen, qoftë ato rrugore ashtu edhe ato të ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, stacioneve të transferimit, pikave të grumbullimit bujqësor etj. Në mënyrë të përmbledhur tabelat në vijim paraqesin transformimet e sistemeve me qëllimet përkatëse dhe një bilanc të territorit në bazë sistemi.

3.3.1. Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike

- 1. Stacioni Multimodal i Bashkisë Gramsh:** Me përmirësimin e sistemit infrastrukturor të Bashkisë së Gramshit, PPV-ja parashikon gjithashtu dhe strukturimin e një sistemi të integruar të transportit publik, sic shpjegohet dhe në nënkapitujt më poshtë. Me qëllim mirëorganizimin e këtij shërbimi, PPV-ja parashikon ngritjen e stacionit multimodal të Bashkisë Gramsh në hyrje të qyteti e Gramshit. Stacioni është parashikuar të pozicionohet në veri të qytetit. Pozicionimi i këtij stacioni në këtë pikë, lehtëson lidhjen e automjeteve me unazën e qytetit të Gramshit e cila lidhet drejtëpërdrejtë dhe më shpjeg me arteriet kryesore që lidhin Bashkinë me njësitë e tjera fqinje, duke shmangur rëndimin e trafikut gjatë orëve të pikut në bulevardin kryesor të qytetit.
- 2. Parku Rajonal Lenie – Kukur dhe ai I Irmajit:** parqet shtrihen në dy njësite Lenie dhe Kukur dhe në njesinë Irmaj. Të dy parqet janë shumë interesante nga pikëpamja peizazhistike dhe përfaqsojnë vlera të mëdha natyrore. Në territorin e këtyre njësiteve ndodhen pika të ndryshme turistike të cilat i vijnë në ndihmë krijimit të parkut e cila do të sjelli një rritje të numrit të vizitorve pasi kthehet në një potencial natyror të zonës dhe integrimin e Gramshit në rrjetin e itinerareve natyrore rajonale e turistike dhe për të ofruar një hapësirë të shëndetshme rekreative për vendbanimet.

3.3.2. Njësitë strukturore të territorit

Ndarja në zona në bashkinë e Gramshit bazohet në kufijtë e njësiteve administrative, të cilat janë hartuar zona më vete gjatë hartimit të planit. Kodet për secilën nga zonat janë vendosur si më poshtë:

Gr: Gramsh

Ko: Kodovjat

Sk: Skënderbegas

Tu: Tunjë



Su: Sult

Po: Poroçan

Le: Lenie

Kk: Kukur

Pi: Pishaj

Përcaktimi i njësive strukturore ka marrë parasysh faktin se ndarja në njësi strukturore bëhet me qëllim që të lehtësojë procedurat e zbatimit të instrumenteve të planifikimit dhe të drejtojë e kontrollojë zhvillimet që do të ndodhin në territor. Bashkia e Gramshit është ndarë në 577 njësi strukturore. Metodologjia për ndarjen e njësive strukturore është mbështetur në përcaktimet ligjore të rregullores së planifikimit të miratuar me VKM nr. 671 në vitin 2015. Referuar përcaktimeve ligjore, njësitë plotësojnë një ose disa prej kushteve të mëposhtme:

- a. Kufizimin nga rrjeti rrugor ekzistues, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve dhe, sipas rastit, kufizimin nga linja e propozuar hekurudhore, kanalet kulluese dhe vaditëse, përrenjtë dhe vija të tjera ujore;
- b. Njësia strukturore garanton kompaktësimin dhe njëtrajtshmërinë e tipologjisë hapësinore ekzistuese duke patur në mend edhe atë të propozuar;
- c. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
- d. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të duke u bazuar në kategoritë e njëjta të përdorimit të tokës, duke përfshirë këtu edhe funksionet apo aktivitetet homogjene;
- e. Ekzistencën e vlerave të rëndësishme të trashëgimisë kulturore
- f. Kufij të tjerë natyrorë (kryesisht në njësitë strukturore natyrore) si shpatet e kodrave, ndryshimet e vegjetacionit etj.
- g. Përcaktimin e zonave me prioritet zhvillimi për realizimin e një projekti me rëndësi.
- h. Kufijtë e zonave të mbrojtura dhe parqeve Kombëtare e Rajonale

Veç këtyre kritereve janë marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si më poshtë:

- Vijat e dukshme në hartë/fotografi ajrore të pronësisë apo të ndarjes së qartë të përdorimeve;
- Qëllimi i synuar në të ardhmen për zhvillimin në zonë;
- Ndërhryjet përmirësuese/plotësuese infrastrukturore;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Mënyra e ndërhryjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Qëllimi i synuar për mbrojtjen apo konservimin e territoreve dhe elementeve territoriale të caktuara;
- Kushtëzime ligjore sektoriale;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.

Kushtet dhe rregullat e zhvillimit për çdo njësi strukturore janë përcaktuar në “Rregulloren e planifikimit të PPV-së”. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe përcaktimi i zonave të cilat do të zhvillohen përmes Planeve të Detajuara Vendore (PDV). Kriteret për përzgjedhjen e



zonave për PDV janë përcaktuar në rregulloren e planifikimit të miratuar me VKM nr. 671 në vitin 2015. Këto kritere janë:

- a) zhvillim dhe/ose rizhvillim sipas parashikimeve të PPV-së;
- b) ndryshim i përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të kësaj rregulloreje;
- c) investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit sipas parashikimeve të PPV-së;
- ç) programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte sipas parashikimeve të PPV-së dhe ligjit të planifikimit.

Veç këtyre kritereve, sipas rastit, janë marrë në konsideratë edhe kriteret e mëposhtme:

- Mënyra e ndërhyrjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Lehtësia e realizimit të zhvillimit në bazë parcele përkundrejt atij në bazë zone/njësie dhe mënyra e menaxhimit të procesit;
- Prioriteti kohor i bashkisë për ndryshime/zhvillim në zonë;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.

Llojet e ndërhyrjeve në territor janë përcaktuar për secilën njësi strukturore dhe në mjaft njësi gjenden më shumë se një ndërhyrje. Llojet e ndërhyrjeve bazohen në përcaktimet e ligjit të planifikimit dhe të rregullores së planifikimit (VKM nr. 671), por i përmbushin dhe i tejkalojnë këto përcaktime për t'iu përshtatur sa më tepër kontekstit. Për këtë qëllim, lista e ndërhyrjeve në territor dhe përkufizimet përkatëse janë si më poshtë:

1. **Zhvillim** (*Development*): Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturën përkatëse. Në raste të veçanta zhvillimi mund të përfshijë vetëm programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu zhvilluesit për ndërtime private. Zhvillimi ka efekt në ndryshimin e çmimit të tokës dhe përgjithësisht e ngre atë.
2. **Rizhvillim** (*Redevelopment*): Është zhvillim që kryhet përsëri në një zonë e cila është zhvilluar më parë. Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese si të formës e strukturës, ashtu edhe funksioneve dhe/ose treguesve të zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).
3. **Rikonceptim**: Është një formë e rizhvillimit, por e fokusuar kryesisht në elemente të dizajnit urban e arkitektonik të objekteve dhe rimendim të funksioneve të objekteve ekzistuese duke i përshtatur ato. Mund të përfshijë edhe prishje objektivësh në raste të caktuara me qëllim çlirimin e hapësirës publike, por nuk nënkupton ndërtime të reja. Veçanërisht treguesit e rrugëve dhe të hapësirës publike mund të përmirësohen. Intensiteti mund të rritet lehtësisht në ndonjë rast si rezultat i shtesave të mundshme në lartësi, ose të mbetet i pandryshuar.
4. **Ristrukturim** (*Restructuring, Reconstruction*): Ndodh për infrastrukturën kur janë të degraduara, të dëmtuara ose shumë të vjetëruara dhe riparimi nuk është i mjaftueshëm. Veç ndërhyrjeve strukturore mund të ndryshohen edhe parametrat e infrastrukturës në fjalë. Kështu, p.sh. rruga mund të zgjerohet dhe të pajiset me elemente sigurie shtesë



etj. Elementet e rrjetit të furnizimit me ujë apo të largimit të ujërave të ndotura mund të zëvendësohen dhe të ripërmasohen, si dhe i gjithë sistemi mund të zgjerohet/intensifikohet në pjesë të caktuara të tij. Kjo mënyrë ndërhyrjeje mund të përdoret për rrugët në veçanti, por edhe për zonat që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën e tyre.

5. **Rigjenerim, Rinovim, Rijetësim, Ripërtëritje, Rivitalizim, Rikualifikim** (*Regeneration, Reneçal, Revitalization, Requalification*): Është një formë rihvillimi që ka për qëllim të risjellë në jetë apo funksion zona të caktuara të cilat e kanë humbur atë, janë degraduar fizikisht, nuk janë më tërheqëse dhe të frekuentuara, paraqesin mungesë sigurie, si dhe kanë rënie të vlerës së pronës dhe kanë nevojë për rikonceptim nga pikëpamja e dizajnit urban, arkitekturor dhe të peizazhit urban. Zona të tilla mund të jenë aktualisht në funksion, por jo cilësore dhe të vjetëruara, ose mund të jenë jashtë funksionit (si *greyfields* në qytete – p.sh. parkime apo qendra tregtare të braktisura dhe me infrastrukturë ekzistuese etj.). *Broënfields-at*, si zona industriale të braktisura apo jashtë funksionit dhe me ndotje, trajtohen përmes rehabilitimit mjedisor (si më poshtë), por paralelisht edhe me rigjenerim urban, duke pasur për qëllim rifutjen e tyre në treg dhe veprimtarinë e rritjes ekonomike.
6. **Rehabilitim** (*Rehabilitation*): Rehabilitimi mjedisor është rindërtimi i elementeve apo funksioneve ekologjike pa realizuar restaurim të plotë, kryesisht për qëllime njerëzore dhe jo natyrore. Mund të përfshijë një ose disa nga format e mëposhtme: restaurim mjedisor, rikrijime të pjesshme, reklamim dhe pastrim, zbutje efektesh ndotëse/negative etj. Është i barazvlefshëm me konceptin rigjenerim në rrafshin urban.
7. **Konsolidim, Kompaktësim** (*Consolidation*): Është një proces zhvillimi dhe rihvillimi në të cilin konsolidohet karakteri dhe tipologjia ekzistuese e zonës (urbane ose bujqësore) dhe për këtë kryhen punime ndërtimi, rindërtimi, ristrukturimi, rigjenerimi të pjesshëm, mbushjeje urbane, konservimi, pastrimi. Këto punime kombinohen në pesha të ndryshme
8. **Ngrirje** (*Development Freeze*): Është procesi i ngrirjes ose ndalimit dhe bllokimit të ndërhyrjeve zhvillimore të çdo forme në një territor të caktuar deri në marrjen e një mase të dytë më të përshtatshme për situatën përkatëse. Kryhet në pamundësi të marrjes së masës së duhur si rezultat i mungesës së informacionit, boshllëkut ligjor e institucional, ekzistencës së konflikteve të pazgjidhshme brenda periudhës së vendimmarrjes, proceseve të pambyllura gjyqësore, rreziqeve që mund të kanosen, të qenët në pritje të një vendimmarrjeje tjetër apo arsye të tjera penguese. Në varësi të rastit, autoritetet mund të marrin masa mbrojtëse, pyllëzuese, zbutëse të rrezikut, të garantimit të mbijetesës etj., nëse popullsia apo pronat në zonë janë të rrezikuara nga ndonjë faktor specifik.
9. **Dendësim** (*Densification*): Kjo ndërhyrje propozon rritjen e dendësisë së zhvillimit të zonave urbane me dendësi të ulët duke promovuar përdorimin më eficient të tokës, si dhe të rrjeteve të shërbimeve dhe infrastrukturave. Dendësimi ka dy nënraste si më poshtë. Nëse të dyja nënrastet janë të pranishme, atëherë përdoret thjesht termi “dendësim”.
 - a. **Mbushje urbane** (*Urban Infill*): Kjo është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave boshe/të pandërtuara me ndërtime të reja



dhe me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra, treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me ata të parcelave që kanë ndërtime në momentin e mbushjes. Përgjithësisht, ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

- b. **Intensifikim** (*Intensive development*): Kjo është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit si në nivel zone, ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose ai i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave. Intensifikimi përfshin edhe procesin e mbushjes, por nuk synon të ruajë karakterin dhe tipologjinë ekzistuese në zonë. Ndryshon nga rihvillimi, pasi nuk synon të ndryshojë funksionin e zonës dhe përgjithësisht përdoret në zona (kryesisht) banimi.

10. **Konservim, Ruajtje** (*Conservation, Preservation*): Është procesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Procesi i konservimit/ruajtjes nuk nënkupton ngrirje, por shmangie nga aktivitetet dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet të cilat i nënshtrohen konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligjente e duke shmangur çdo lloj aktiviteti apo ndërhyrjeje dëmtuese/ndotëse. Masat që merren mund të përfshijnë si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim, dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen e tyre natyrore për t'i mbrojtur nga ndërhyrjet me karakter dëmtues/ndotës. Në rastin e zonave historike mund të përfshihen edhe procese rigjenerimi pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. **Zhvendosje** (*Relocation*): Është procesi i zhvendosjes dhe i rivendosjes në një territor të ri të një funksioni të caktuar (përfshirë objektet dhe strukturat përkatëse). Zhvendosja (rialokimi) shoqërohet me prishjen ose lëvizjen e objekteve/strukturave dhe, për rrjedhojë, edhe të popullsisë që jeton në to apo të përdoruesve përkatës.

12. **Trajtim peizazhistik** (*Landscaping*): Mund të realizohet në zona urbane, natyrore dhe bujqësore. I shërben funksionit kryesor të zonës, por ka vlerë ekologjike përpos asaj estetike. Në çdo rast, ky trajtim modifikon karakteristikat e dukshme të zonës, si: paraqitjen e bimësisë dhe të elementeve ujore, format e tokës dhe të trupave ujorë, efektet e motit apo të mikroklimës etj. Metodatat që përdoren janë: krijimi i korridoreve biologjike, ripyllëzimet, mbjellja e bimëve në një formacion të caktuar, rehabilitimi dhe restaurimi mjedisor, zbutja ose eliminimi i fragmentimit të matricës natyrore ose komponentëve të ekosistemit, rikrijimi ose restaurimi i zonave ripariane dhe brigjeve ujore në tërësi, kombinimet e elementeve bimore me ato ujore dhe historike për të krijuar një mesazh apo atmosferë të caktuar etj.

3.3.3. Parashikimi demografik dhe strehimi

Projeksionet e popullsisë luajnë një rol themelor në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendorë pasi ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen



demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë ketu edhe studimin e tregut.

Bashkia e Gramshit në 1 janar 2016, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 24,484 banorë, prej të cilëve 12,5 mijë meshkuj dhe 11,9 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 35% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 65% si popullsi rurale

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Gramsh, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore përgjatë periudhës 2016-2031, llogaritet të jetë rreth 1.3%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031, e krahasuar me vitin 2016, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia. Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2016-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rënie me rreth 1.3% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brëndshëm

Popullsia rezidente e bashkisë Gramsh deri në vitin 2021, do të performojë tregues të varesisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e “dividentit demografik”.

Popullsia sipas Gjendjes Civile:

Skenarët e rritjes së popullsisë sipas Gjendjes Civile: Ndërkohë, nëse do të përlllogarisim rënien e popullsisë duke u mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile, atëherë do të ndjekim metodologjinë e mëposhtme:

Llogarisim koeficientin e rënies (R) së popullsisë në Bashkinë Mat, duke u mbështetur në të dhënat e Gjendjes Civile:

$$R = \left[\left(\frac{P_n}{P_0} \right)^{1/n} - 1 \right] \times 100 \quad \text{ku,} \quad \begin{array}{l} R - \text{Renia e popullsisë} \\ P_n - \text{Popullsia e vitit për të cilin bëhet projeksioni} \\ P_0 - \text{Popullsia aktuale} \\ n - \text{Numri i viteve të ndërmjetme} \end{array}$$

$$R_{2011-2016} = \left[\left(\frac{39,825}{38,736} \right)^{1/5} - 1 \right] \times 100$$

$$R_{2011-2016} = -0.3 \%$$

$$P_n = P_0 \times (1 + R/100)^n$$

$$P_{2023} = P_{2016} \times (1 - R/100)^5 = 38,736 \times (1 - 0.3/100)^5 = 36,799$$

$$P_{2027} = P_{2023} \times (1 - R/100)^5 = 36,799 \times (1 - 0.3/100)^5 = 34,959$$

$$P_{2032} = P_{2027} \times (1 - R/100)^5 = 34,959 \times (1 - 0.3/100)^5 = 33,211$$



Tabela 9. Parashikimi i popullsisë deri në vitin 2032

Gjendja Civile	2016	2023	2027	2032
NjA Gramsh	14,425	13,704	13,019	12,368
NjA Pishaj	8,132	7,725	7,339	6,972
NjA Kodovjat	3,189	3,030	2,878	2,734
NjA Kukur	3,200	3,040	2,888	2,744
NjA Kushovë	1,056	1,003	953	905
NjA Lenie	1,306	1,241	1,179	1,120
NjA Poroçan	1,812	1,721	1,635	1,554
NjA Skenderbegas	2,123	2,017	1,916	1,820
NjA Sult	1,280	1,216	1,155	1,097
NjA Tunje	2,213	2,102	1,997	1,897
Bashkia Gramsh	38,736	36,799	34,959	33,211

Burimi: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016

Llogaritjet sipas burimeve të mësipërme paraqesin tendenca shumë të ndryshme të uljes së popullsisë. Praktikisht, sipas INSTAT, popullsia e Gramshit dhe Gjendja Civile bazuar në tabelen me sipër do të zvogëlohet. Duke marrë parasysh pasaktësitë që mbartin të dyja burimet, sa i përket informacionit, sikurse edhe pasiguritë e zhvillimit në nivel kombëtar, nuk është e mundur të përzgjedhësh një vlerë kundrejt tjetrës. Plani hartohet duke reflektuar tendencën rritëse sipas Gjendjes Civile, por fazohet duke reflektuar tendencën zbritëse sipas INSTAT-it. Kjo mënyrë duket të jetë më realiste dhe i jep mundësi Bashkisë: i) të ketë lirshmëri në lejimin e zhvillimit në territor; ii) të vetërregullojë politikën e saj pas tre viteve të para dhe në vazhdim çdo tre vjet, duke rishikuar planin dhe treguesit e tij, për t'iu përshtatur realitetit dhe zhvillimeve që mund të ndodhin. Shifra në rënie e INSTAT-it, është një paralajmërim për Bashkinë, që të mos synojë zhvillime shumë intensive, pasi një popullsi në rënie ndikon në rënie të tregut të tokës dhe rënie të kërkesës për ndërtimit. Nga ana tjetër, shifrat në rritje sipas Gjendjes Civile, sugjerojnë që Bashkia duhet të ketë njohuri të mira të kapacitetit mbajtës (popullsia maksimale që mund të shërbehet në një njësi sipas treguesve) të çdo njësie strukturore në territor, dhe të fazojë furnizimin me infrastruktura kapitale në njësitë më prioritare.

3.3.4. Instrumentet e drejtimit të zhvillimit

Zonat e Zhvillimit të Biznesit (ZZB) është një partneritet publik privat me anë të të cilit pronarët e pronave dhe bizneseve zgjedhin të kontribuojnë financiarisht për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe promovimin e zonës së tyre tregëtare. ZZB-të ofrojnë një sërë shërbimesh private në bashkë rendim me shërbimet publike vendore dhe investojnë në prosperitetin afatgjatë ekonomik të zonave të tyre. Shërbimet e ofruara nga ZZB janë protësuese për shërbimet e ofruara për zonën nga bashkia. Bashkia Gramsh parashikon njësinë strukturore të qendrës së Gramshit, si njësinë më të mundshme në Bashkinë e Gramshit për zbatimin e instrumentit të ZZV-së. Ppv parashikon rihvillimin e zonës në një periudhë afatgjatë jo vetëm në qëndër por edhe përgjatë bulevardit kryesor gjithashtu



dhe zgjatimin e tij duke e shndërruar atë në zonën më të rëndësishme multifunksionale jo vetëm për qytetin e Gramshit por për të gjithë Bashkinë. Zona përvec rritjes në intensitetin e ndërtimit për qëllime banimi, parashikon dhe akomodimin e një sërë shërbimesh, zonash rekreative dhe aktiviteteve sociale, stacionin multimodal të bashkisë etj.

Tarifa e Përmirësimit (TF) janë tarifa që vendos dhe mbledh NJQV-ja për investimet e kryera në rrugë, ujësjellës-kanalizime, dhe objekte të tjera të cilat kanë ndikuar që tokat private pranë tyre “të jenë më të mira” për zhvillim. Tarifa e përmirësimit ka lidhje me ndikimin e infrastrukturës publike në vlerën e tokës/pronës përgjatë së cilës krijohet. Ndryshe nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila synon të rikuperojë disa nga kostot që zhvillimi i ri do të krijojë tek infrastruktura publike, tarifat e përmirësimit lidhen drejtpërdrejt me fitimet e pronarit të tokës nga rritja e vlerës së tokës/pronës.

Bashkia shoqëron çdo instrument financiar për drejtimin e zhvillimit dhe krijimin e hapësirës publike me një platformë komunikimi dhe transparence me publikun në çdo hap të zbatimit të tij.

3.4. Shërbimet dhe infrastrukturat publike

3.4.1. Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale

Duke iu referuar pozicioni gjeografik ku shtrihet bashkia e Gramshit, projektet Kombëtare dhe rajonale do të kenë impakt në këtë bashki. Projekti më i rëndësishëm që ka Shqipëria sipas SETTO (South- East Transport Observatory, institucion i rëndësishëm që orienton strategjitë e transportit në Ballkan, e cila unifikon prioritetet e infrastrukturës së vendeve që janë pjesë e saj në bazë të strategjive kombëtare) është Boshti Qendror Jugor, i cili ndonëse nuk kalon brenda kufirit të bashkisë Gramshit, pritet të ketë impakt në lëvizshmërinë e kësaj bashkie me vendet e tjera duke parë që në planin rregullues të bashkisë Gramsh propozohen dy lidhje rajonale me këtë korridor të rëndësishme të vendit, një lidhje në Mollas në pjesën veri-pendimore dhe një lidhje në perëndim të bashkisë ku lidhet me Lumasën e Kucovës dhe më pas me Boshtin qendror jugor.

Boshti Qendror Jugor, është një nga investimet infrastrukturore më të rëndësishme që pritet të ndërtohet në vendin tonë pas Rrugës së Kombit. Kjo infrastrukturë ndërthuret me Korridorin VIII në aksin verior me Tiranën (Autostrada A3), i cili nis nga Papëri (sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 të publikuar nga AKPT), vazhdon në drejtim të Cërrikut-Kuçovës-Beratit-Memaliajt. Në Memaliaj bëhet dhe lidhja e drejtpërdrejtë me korridorin tjetër me rëndësi ndërkombëtare, Korridori i Kaltër, i cili është një tjetër korridor ndërkombëtar që nis në Itali (Trieste) dhe vazhdon në Kroaci, Mal të Zi, në Shqipëri dhe përfundon në Kallamat të Greqisë. Boshti Qendror Jugor (Elbasan-Tepelenë) ka rëndësi të madhe sepse kjo infrastrukturë do të sjellë një lidhje më optimale ndërmjet Shqipërisë qendrore dhe jugore. Ky korridor është rreth 180 km i gjatë. Aktualisht është ndërtuar 10% dhe po planifikohet të ndërtohet edhe 15% e këtij korritori .

Plani i përgjithshëm kombëtar (PPK) 2015-2030 që është miratuar në Maj 2016, ka vendosur disa direktiva të rëndësishme, të cilat do të zbatohen edhe në planet e përgjithshme vendore që hartohen. Një nga elementet kryesore të Planit Kombëtar është infrastruktura dhe transporti në nivel kombëtar dhe rajonal. Boshti qendror jugor, i cili është një nga infrastrukturat më të rëndësishme që pritet të ndërtohet nuk do të ketë impakt




brënda kufinjve të bashkisë Gramsh por do të bëjë të mundur akses më të mirë ndërmjet bashkive dhe më tej, sidomos lidhjet e bashkisë së Gramshit me pjesën jugore të Shqipërisë.

Përsa i përket impaktit të PPK-së në Bashkinë Gramsh mund të përmendim rrugën e re që pritet të përfundojë e cila është në ndërtim, aksi Gramsh-Maliq do të bëjë të mundur lidhjen e Gramshit me Korçën dhe pjesën jug-lindore të vendit. Ky itinerar bën të mundur që bashkia Gramshit të shërbejë dhe si urë tranziti për destinacionet në juglindje të vendit duke parë që shkurton në kohë si dhe ky itinerar është peisazhistik.

Sipas propozimeve të PPK-së, në bashkinë e Gramshit kalojnë itineraret peisazhistike ndërlihdës, të cilat bëjnë të mundur lidhjen e kësaj bashkie me Elbasanin në pjesën veriore dhe shkon në Korçë në pjesën jugore dhe më tej. Ka një sërë itineraresh peisazhistik që kalojnë në Gramsh duke parë peisazhin fantastik që ka kjo bashki sidomos në pjesët perëndimore dhe lindore të bashkisë.

Figura 20. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Gramsh



Burimi: SEETO, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Gramshi ka vetëm një lidhje vertikale (Papër- Korçë) dhe në nivel rajoni propozohen lidhje tërthore në mënyrë që bashkia të ketë akses me Elbasanin nëpërmjet Zavalinës si dhe lidhja me Kucovën duke kaluar nëpërmjet itinerarit që kalon nga Saraseli. Lidhja me Kucovën do të bëjë të mundur që në të ardhmen të lidhet me Boshtin qendror jugor. Dy lidhje të tjera të rëndësishme janë: lidhja me Cërriku në Mollas nëpërmjet Dragotit si dhe lidhja me Beratin. Këto dy lidhje do të bëjnë të mundur akses më të mirë me bashkitë që ndodhen në pjesën perëndimore të bashkisë Gramsh. Një tjetër itinerar i rëndësishëm që propozohet është lidhja me Pogradecin nëpërmjet Kukurit. Duhet theksuar që terreni në këtë bashki është i thyer dhe këto itinerare do të shtrihen në një periudhë afatgjatë duke u bazuar në strategjitë kombëtare të infrastrukturës. Akset infrastuktorore ndërbashkiake janë kompetencë e institucioneve të pushtetit qendror.



3.5. Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së

3.5.1. Fazat e zbatimit të planit


Metodologjia e ndjekur për kryerjen e fazimit të Plani të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh, është bërë duke analizuar 3 komponentë kryesorë në 3 periudha të ndryshme kohore. Intervalet kohore të përcaktuara janë si më poshtë:

- Periudha afatshkurtër : 1 deri në 3 vjet
- Periudha afatmesme: 3 deri në 5 vjet
- Periudha afatgjatë: më shumë se 5 vjet

Përcaktimi i perudhës së parë (1 deri në 3 vite) përputhem me periudhën e veprimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, duke i dhënë mundësi kështu bashkisë të planifikojë më mirë shpenzimet e saj gjatë kësaj periudhe dhe të ndër marrë masat e nevojshme për rishikim e projekteve dhe mobilizimin e të ardhurave me qëllim realizimin e shpenzimeve kapitale për vitet në vazhdim. Megjithatë një panoramë më të detajuar të fazimit të secilit nga projektet madhore të Bashkisë së Gramshit e reflekton Plani i Investimeve Kapitale (dokument bashkangjitur Planit të Përgjithshëm Vendor)

Në këtë kuadër Bashkia e Gramsh parashikon fazimin sipas ndërrhyrjeve në njësitë strukturore si më poshtë:

Figura 21: Fazimi i ndërrhyrjeve në njësitë strukturore, Bashkia Gramsh




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Për sa i përket ndërrhyrjeve në infrastrukturë, sikurse përmendet edhe në kapitullin e mësipërm platforma e ndërrhyrjeve në rrjetin infrastrukturor parashikon zgjerimin e akseve ekzistuese, ndërtimin e akseve të reja dhe rehabilitimin e akseve ekzistuese. Figura e mëposhtme paraqet një panoramë më të detajuar të ndërrhyrjeve sipas periudhave kohore të ndërrhyrjeve të parashikuara nga PPV-ja. Me qëllim arritjen e objektivit për përmirësimin



e aksesit dhe lidhjes më të mirë të vendbanimeve të Gramshit, PPV parashikon marrjen e masave të menjëhershme (në tre-vjecarin e parë) për rehabilitimin e rrugëve rurale dhe akseve nëpër të cilat parashikohet kalimi i transportit publik. Akset e tjera të rëndësishme kombëtare si Via Skenderbeg, mbeten investime të një niveli më lartë qeverisës, megjithatë me qëllim rritjen e investimeve në infrastrukturë, Bashkia e Gramsh duhet të nxisë fillimin e ndërtimit të këtyre akseve në periudhën aftmesme të saj.

Figura 22. Fazimi i ndërhyrjeve në rrjetin infrastrukturor, Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

3.5.2. Projektet e Zbatuara me fisha ne periudhe kohore

Tabela 10: Fazimi i projekteve strategjike, Bashkia Gramsh

Objektivat, Programet dhe Projektet e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Gramsh	Periudha Afatshkurtër 0-5 vjeçare	Periudha Afatmesme 5-10 vjeçare	Periudha Afatgjatë 10-15 vjeçare
Objekivi strategjik 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.			
O1P1: Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në bashkinë Gramsh, zhvillimi i sektorit të shërbimeve, si			



dhe zhvillimit të sektorëve bujqësorë blegtoralë e turistik në zonat me karakter natyror.			
Pr.1: Ndërtimi një pike grumbullimi të produkteve bujqësore hyrjen jugore të qytetit			
Pr.2: Ndërtimi i tregut të ri industrial në hyrjen jugore të qytetit.			
Pr.3: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në hyrjen jugore të qytetit.			
Pr.4: Ndërtimi i thertoresh për prerjen e gjësë së gjallë në hyrjen jugore të qytetit.			
Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh			
Pr.6: Projekti për rehabilitimin e rezervuarëve ujitës të bashkisë Gramsh			
Pr.7: Projekti për ndërtimin e bujtinave në zonat turistike të bashkisë Gramsh (Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabove, Liq i Dushkut)			
Pr.8: Projekti për krijimin e ofertave turistike të bashkisë Gramsh si dhe marketimi e brandimi i tyre në funksion të zhvillimit të sektorit të turizmit			
O1P2: Nxitja dhe zhvillimi i ndërtimeve nëpërmjet zgjerimit dënsifikimit dhe diversifikimit të tyre për zhvillimin e sektorit të shërbimeve në qytet			
Pr.9: Restaurimi i bllokut qendror të banimit në qytetin e Gramshit si një zonë e cila ruan arkitekturën e kohës së diktaturës dhe zhvillimi i bizneseve të vogla me qëllim diversifikimin e veprimtarisë ekonomike të zonës			
Pr.10: Rehabilitimi dhe rigjenerimi i zonës së tregut aktual të perimeve në Gramsh			
Pr.11: Rigjenerimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës ish-industriale në hyrje të qytetit dhe zhvillimi i saj si zonë shërbimesh tregtare punishtesh dhe si zonë banimi.			
Pr.12: Rigjenerimi dhe rehabilitimi i zonës së ish-repartit ushtarak si zonë banimi si dhe për ndërtimin e banesave sociale.			
Pr.13: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i zonës së ish-uzinës së baterive dhe zhvillimi i saj si zonë banimi.			
Pr.14: Zhvillimi i zonës së bulevardit të ri si zonë shërbimesh tregtare dhe banimi në të dy krahët e bulevardit.			
O1P3: Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre			



Pr.15: Mbështetja e zhvillimit të bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar.			
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.			
O2P1: Konsolidimi i lidhjeve të bashkisë së Gramshit në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore.			
Pr.1: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Elbasan-Gjinar-Zavlinë-Porocan-Kukur-Lenie-Strelcë			
Pr.2: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh -Tunjë- -Jançë –Kostren-Roshnik-Berat			
Pr.3: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Grmash-Tunjë-Katërlis- Sarasel-Lumas			
Pr.4: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh –Kukur- Përrenjas			
Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjurë-Dushk-Kutërqarë-Dragot-Mollas			
O2P2: Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njëjse rurale me njëra-tjetrën dhe me Gramshin.			
Pr.6: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e disa seksioneve të rrugës orbitale Dushk-Sult-Sarasel-Jançe-Brasnik-Dumbreas-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur- Rrashtan- Gjerë- Holtas-Poroçan-Drizë			
Pr.7: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh- Skendebegas			
Pr.8: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Lenie			
Pr.9: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Fushërangës-Liras-Sinan-Tervol-Venizë-Broshtan-Posnovisht-Kishtë-Zmashë			
Pr.10: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Çekin-Perikë-Xhams-Tervol			
Pr.11: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Bulçar- Liqeni i Dushkut (rruga e vjetër)			
Pr.12: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Duzhe-Lubinje-Dufshan-Sult			
Pr.13: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovic- Dufshan			
Pr.14: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Shëmrizë-Ostrenth			



Pr.15: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Sotirë	■		
Pr.16: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjuhë-Dushk-Banjë	■	■	■
Pr.17: Projekti për ndërtimin e urave në fshatrat Liras, Skenderbegas Lenie dhe Kushovë		■	■
O2P3: Sistemimi i rrjeteve rrugore në nivel qyteti për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zonat rurale.	■	■	■
Pr.18: Projekti për ndërtimin e By-Passit të qytetit në anën lindore të tij.	■	■	
Pr.19: Projekti për ndërtimin e rrugës gjatsore përgjatë bregut të lumit Devoll.	■		
Pr.20: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës diagonale nga rrethrutullimi i terminalit të autobuzave tek Pallati i Kulturës.	■		
Pr.21: Projekti për ndërtimin e zgjatimit të Bulevardit kryesor të qytetit.		■	
Pr.22: Projekti për ndërtimin e rrugës nga Terminali deri në hyrje të By-Passit të ri të qytetit.		■	
Pr.23: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve Llapushaj,Kocaj dhe Devolli.	■		
O2P4: Integrimi i bashkisë së Grmashit në tërësinë e itinerareve të gjelbra në nivel qyteti dhe në nivel rajonal nëpërmjet infrastrukturës së lehtë e turistike.	■	■	■
Pr.24: Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacione të ndryshme nga qyteti ne drejtim të destinacioneve turistike të bashkisë	■	■	
Pr.25: Ndërtimi i korsive të biçikletave kalimeve,këmbësore përgjatë dhe shesheve si pika vrojtimi të natyrës përgjatë By-passit në anën lindore të qytetit.		■	
Pr.26: Ndërtim i korsive të bicikletave dhe kalimeve këmbësore përgjatë lumit Devoll në pjesën e qytetit.		■	
Pr.27: Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkallëve të qytetit përgjatë përrenjve si shoqëruese të elementeve natyrore duke stimuluar levizshmërinë e qendrushme në qytet.	■	■	
O2P5: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për të gjithë territorin e bashkisë	■	■	■
Pr.28: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimi i tubacioneve të reja të ujërave të zeza në NjA-të Sult, Pishaj, Kushovë, Kodovjat dhe Skenderbegas.	■	■	



Pr.29: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e gropave spetike si pas standrateve në fshatrat që nuk kanë akses në KUZ.			
Pr.30: Projekti për rhabilitimin e rrejtit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit të Grmashit			
Pr.31: Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna,Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë,Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë			
Pr.32: Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve duke ndarë ujërat e bardha nga ato të zeza në qytet, si dhe duke siguruar mbulim me rrjet për të gjithë bashkinë.			
O2P6: Programi për përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie.			
Pr.33: Projekti për zhvillimni i një sistemi transporti publik brenda bashkisë për të siguruar aksesin sa më të mirë të NjA-ve me qytetin e Gramshit			
Pr.34: Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobuzëve në qytetin e Gramshit.			
Pr.35: Projekti për ndërtimin dhe rehabilitimin e vendqendrimeve të automjeteve që kryejnë transportin rrethëytetas në NjA-të e bashkisë Gramsh.			
Pr.36: Projekti për ndërtimin e parkimeve të automjeteve në hyrje dhe dalje të qytetit si dhe në qendrat e NjA-ve.			
Pr.37:Projekti për rehabilitimin dhe shtimin e ndriçimit rrugorë në Qytetin e Gramshit dhe qendrat e NjA-ve të Bashkisë Gramsh.			
Objektivi strategjik 3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritimit me potencialet rajonale turistike.			
O3P1: Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane duke përfshirë strategjitë për mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e vendit të depozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike.			
Pr.1: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.			
Pr.2: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi sipas standarteve të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta.			



Pr.3: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike si dhe ndërtimi i pikës së kompostimit të mbetjeve organike.			
O3P2: Programi për krijimin e parqeve rajonale në zonat mjedisore që cilësohen si zona me biodiversitet të lartë duke mbrojtur dhe konservuar faunën dhe florën si dhe elementet e fortë natyror, peizazhistik, e historiko-kulturor.			
Pr.4: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit.			
Pr.5: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit.			
O3P3: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariante të lumenjve përrenjve dhe zonave me rrezik natyror.			
Pr.6: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariante të lumit Devoll.			
Pr.7: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë përroit të Tomorricës, Vërçës dhe Holtës.			
Pr.8: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumi Devoll dhe liqeni i Hydrocentralit të Banjës..			
Pr.10: Ndërtimi i pritave malore dhe ndërmarrja e fushatave të mbjelljes së bimësisë për zbutjen e veprimtarisë së erozionit në zonat e zhveshura malore.			
Pr.11: Projekti për pyllëzimin e kodrave në afërsi të lagjes Llapushaj në qytetin e Gramshit si dhe në zonën e Liqenit të Dushkut.			
Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.			
O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet.			
Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Grabovë, Nartë, Mashan, Holtas, Gjerë dhe shkollës Asllan Shahini qytet Gramsh.			
Pr.2: Ndërtimi i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Kukuçovë, zgjupë, Kabash dhe Lleshaj.			
Pr.3: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.			
Pr.4: Rikonstruksioni i plotë i shkollës së mesme në Tunjë			
Pr.5: Rikonstruksioni i ndërtesave publike të njëjësive administrative Kushovë dhe Sult			



Pr.6: Rikonstruksioni i qendrave shëndetsore në fshatrat Siman dhe Ermenjë si dhe ndërtimi i qendrës shëndetsore në fshatrat Bratile dhe Kokël.			
Pr.7: Rikonstruksioni i Spitalit të Qytetit të Gramshit			
O4P2: Rikonstruksioni ndërtimi dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive administrative dhe fshatrave			
Pr.8: Ndërtimi i sheshit në afërsi të kishës në zgjatimin e bulevardit të ri të qytetit.			
Pr.9: Rikonstruksioni i shesheve të qendrave të njësive administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë			
O4P3: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.			
Pr.10: Projekti për rikonstruksionin i godinës së Komisarariatit Policor dhe kthimi në zyra për shërbime administrative të institucionit të Bashkisë Gramsh.			
Pr.11: Projekti për rikonstruksionin e bibliotekës së qytetit			
Pr.12: Projekti për rikonstruksionin e muzeut të qytetit			
Pr.13: Projekti për rikonstruksionin i Stadiumit dhe Pallatit të Sportit në qytet .			
Pr.14: Projekti për rikonstruksionin Pallatit të Kulturës në qytet.			
O4P4: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Gramsh, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.			
Pr.15: Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës			
Pr.16: Projekti për ndërtimin e zonës rekreacionale të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll			
Pr. 17: Projekti për ndërtimin e parkut tërthor të qytetit i cili lidh parkun e bregut të lumit me zonën e kodrave në pjesën lindore të qytetit.			
Pr.18: Projekti për ndërtimin e varrezave të reja të qytetit			



4. Analiza mjedisore e territorit të Bashkisë Gramsh

4.1. Pozicioni dhe elementët e fortë në territor


4.1.1. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Gramsh

Bashkia Gramsh gjendet në qendër të vendit tonë. Ajo përbëhet nga 10 NjA: Gramsh, Pishaj, Poroçan, Kukur, Lënie, Kodovjat, Skëndërbegas, Kushovë, Tunjë dhe Sult. Ajo kufizohet nga bashkitë e Elbasanit dhe Përrenjasit në Veri, nga bashkitë Pogradec dhe Maliq në Lindje, nga Skrapari në Jug, dhe nga bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik në Perëndim. Bashkia Gramsh ka lidhje relativisht të mira me bashkitë e tjera përmes rrugëve interurbane.

Distancat më të favorshme me qytetet kryesore janë:

- Tiranë, 83.3 km, 1 orë dhe 43 minuta- Përmes rrugës Autostradës Tiranë- Elbasan, dhe më pas duke ndjekur rrugë interurbane.
- Durrës, 99.8 km, 1 orë dhe 55 minuta- Duke ndjekur rrugën nga Kavajë- Rrogozhinë- Cërrik.
- Elbasan, 44.2 km, 1 orë.
- Fier, 108 km, 2 orë
- Vlorë, 144 km, 2 orë e 36 minuta.
- Lushnjë, 80.1 km, 1 orë e 30 minuta
- Korçë, 83.3 km, 2 orë.

Figura 23. Pozicioni gjeografik



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

4.1.2. Elementët e fortë në territor dhe elementët përjashtues

Territori përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme të cilat ushtrojnë ndikim te njëri tjetri. Pjesët apo elementët të cilët ndikojnë më shumë, apo kanë veçori më sipkatëse mund të



konsiderohen si elementë të fortë në territor. Elementët mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/ pengojnë zhvillimin. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/ qëndror, por edhe sipërfaqësor në formën e fashave të ndikimit. Elementët e tillë mund të jenë natyrorë, por edhe artificialisht të krijuar nga njeriu.

- **Elementët e fortë natyrore**

Vetë morfologjia e terrenit të Bashkisë Gramsh paraqet një element të fortë që ka ndikuar në shtrirjen e vendbanimeve, dhe paraqet potencialet për zhvillimin e kësaj bashkie në të ardhmen. Karakteri malor që përshkohet nga lugina lumore që krijojnë kanione, është ndoshta elementi më i fortë e terheqës i kësaj bashkie. Një element tjetër natyror është edhe pasuria e shumtë ujore, si liqenet, Lumi i Devollit dhe Përrenjtë e shumtë që e ushqejnë atë. Lumi i Devollit lidhet jo vetëm më ujitjen e tokave dhe peshkimin, por edhe me vlerat turistike e peizazhistike.

Tokat bujqësore janë gjithashtu një element me rëndësi për këtë bashki. Ato strihen përgjatë lugines së Devollit. Duke qënë se klima në bashki është e favorshme për rritjen e kulturave të ndryshme, mund të paraqiten potenciale për kultivimin në masë të produkteve bujqësore.

Liqenet në Gramsh përbëjnë pika të forta që mund të terheqin më shumë vizitorë, për shkak edhe të biodiversitetit si psh Liqeni i Dushkut i cili në sezonin e verës mbulohet nga zambakët e ujit. Ndër këto elementë natyre, mund të përmendim edhe monumentet e natyrës të cilat janë jo vetëm pika me interes zhvillimi, por duke pasur statusin e monumentit janë më të njohura dhe të mbrojtura si pjesë të tjera të territorit.

Monumentet e natyrës që shërbejnë edhe si pika të forta të territorit mund të përmendim:

1. Parku i Tomorrit- Gjendet në jug perëndim të bashkisië. Pavarësisht se sipërfaqja e këtij parku në Gramsh nuk është shumë e madhe, ai mund të konsiderohet si një pikë e fortë. Ky park ka rëndësi jo vetëm si zonë pyjore me biodiversitet por edhe se lidhet me një nga malet më të njohura të Shqipërisë, me Malin e Tomorrit. Ky park mund të konsiderohet si pika fillestare për krijimin e itinerareve që lidhin zonat natyrore pyjore në Gramsh.
2. Shpella e Kabashit- është një shpellë e cila vetëm vitet e fundit ka filluar të ekspolohehet. Ajo mund të shndërrohet në një pikë puristike, gjithmonë duke marrë masat e duhura për mbrojtjen e monumentit.
3. Karsti i Tërvolit- ofron një peisazh interesant në formën e hojeve të bletës, i cili vjen nga procesi i vazhduar i karstit.
4. Kanioni i Holtës- është një nga pikat tashmë më të vizituara në Gramsh. Ky kanion paraqet bukuri të rrallë me ujërat dhe shkëmbinj, duke ofruar mundësi për aktivitete të ndryshme si ngjitje në shkëmbinj, notim, piknikë etj.
5. Gurrët e Krushqëve,
6. Kanioni i Sinecit ose Saraselit- ky kanion ka shpate të thepisura, është i gjatë rreth 15 km, i thellë 300m dhe me gjerësi 20-30m.
7. Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit,
8. Tarraca e Ballores,



9. Liqeni i Dushkut- është një liqen allkunajor, i cili ofron edhe një pasuri të madhe të zambakëve të ujit. Ky liqen rrethohet edhe një pyll i dendur pishash, dhe së bashku krijojnë një ekosistem me vlera peisazhiste dhe natyrore.
10. Liqenet e Valamarës- janë tre liqene allkunajore. Ofrojnë pamje fantastike përgjatë gjithë vitit. Gjatë verës kanë ujë të pastër dhe të freskët, ndërsa gjatë dimrit sipërfaqja e tyre ngrin.
11. Liqeni i Zi – Lenie- bën pjesë gjithashtu në liqenet allkunajore të Bashkisë Gramsh. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe Ujërat e këtij liqeni janë përdorur nga banorët edhe për kurim nga reumatizma.
12. Moçalet e Grabovës,
13. Burimet e Kërpicës,
14. Ujëvara e Sotirës- është një nga bukuritë më madhështore të Bashkisë së Gramshit. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m.
15. Rrobulli i Valamarës,
16. Rrobulli i Grabovës.

• **Elementët e fortë artificiale**


Elementët e fortë artificiale në këtë bashki nuk janë aq të shumtë në numër si ata natyrorë, por kanë një ndikim shumë të madh. Mund të permendim këtu rezervuarin e Banjës, i cili u krijuar artificialisht me ndërtimin e HEC të Banjës. Ky rezervuar gjendet në hyrjen Veriore të Bashkisë Gramsh, dhe pamja e tij të shoqëron përgjatë rrugës. Rezervuari rrethohet nga kodra të veshura me pyje dhe përbën një element shumë të fortë për zhvillimin e turizmit ujqor për aktivitete si lundrim, ecje etj. Përveçse këtij rezervuari me rëndësi në territorin e bashkisë janë edhe monumentet e kulturës:

1. Kalaja e Kabashit
2. Kalaja e Tërvolit
3. Ujësjellësi në përroin e Ranxës
4. Fortifikim mesjetar
5. Kalaja e Irmajt
6. Kalaja e Prrjenjasit
7. Kezma
8. Kisha e Grabovës
9. Kalaja e Grabovës së Poshtme
10. Ura e gurtë
11. Rrënojat e urës antike

Kalaja e Tërvolit, Kalaja e Irmajt janë tregojnë që në bashki këmi vendbanime të hershme ilire dhe janë një provë e vazhdimësisë së ilirëve në territor. Disa nga monumentet e tjera si Kisha e Grabovës, janë të rëndësishme edhe për kulturën fetare në bashki. Mbrojtja e këtyre monumneteve është me rëndësi për Bashkinë Gramsh, pasi ata mund të përdoren si pika turistike, të cilat ndërthuren me pasurinë e shumë natyrore të bashkisë.



Figura 24 Harta e elementëve të fortë në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Në përfundim vlen të theksohet që, Bashkia Gramsh ka një pozicion të favorshëm gjeografik pas ndodhet në distanca të vogla nga qytetet e mëdha të vendit dhe rrugët janë në përgjithësi me cilësi të mirë. Gjithashtu në këtë bashki kemi shumë pasuri natyrore e kulturore të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e vendbanimeve, por edhe paraqesin potenciale për zhvillimin e turizmit malor dhe kulturor. Duke qënë se në përgjithësi kjo bashki mbetet në përgjithësi e pazbuluar nga masa turistike, duhet patur kujdes me ndërhyrjet turistike, pasi vlerat duhet të mbrohen krahas promovimit të tyre.

4.1.3. Topografia dhe klima

Topografia

Territori i Bashkisë Gramsh është pjesë e Krahinës Malore Qendrore, Ultësirës Perëndimore, dhe Krahinës Malore Jugore me një reliev Kodrinoro-malor, Zonat më të larta në këtë bashki gjenden në pjesën lidore dhe jug-lindore. Në zonën perëndimore kemi në përgjithësi reliev kodrinor, ndërkohë zona më e ulët ndodhet përgjatë luginës së lumit Devoll¹¹, që kalon në zonën qendrore të bashkisë. Lartësia maksimale arrin 2,373 metra mbi nivelin e detit, me majën e Valamarës. Pranë përroit të Grabovës ndodhet masivi malor i Valamarës, ndërsa përroi i Tomorricës buron nga mali i Tomorrit në jug-lindje të territorit të Bashkisë Gramsh. Në pjesën lindore të bashkisë kemi krijimin e liqeneve në lartësitë 1,500-1,800m mbi nivelin e detit¹².


Niveli i pjerrësive në Bashkinë Gramsh fillon nga 0.0075% deri në 128.36%. Zona fushore në pjesën qendrore të bashkisë, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët që varion nga 0.0075 deri në 18.12%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi që shkojnë deri në 40.77%. Megjithatë, në zonat kodrinore hasim edhe pjerrësi që shkojnë deri në 45%, por kjo më shumë haset në zonat e majave të kodrave dhe kurrizive kodrinore. Në shpatet e thepisura



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**


të maleve që ndodhen në pjesën juglindore pjerrësia varion 46 mbi 128.36%. Pjerrësia e terrenit tregon edhe për kanionet e shumta që krijohen përgjatë rrjedhjes së lumenjve si kanioni I Holtës. Ndikimi i relievit dallohet edhe në shpërdarjen e vendbanimeve duke qënë se zonat kryesore të banimit janë përgjatë Luginës Lumore të Devollit.

Figura 25 Harta e Pjerrësisë së terrenit në përqindje



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Figura 26 Harta e territorit



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017




Hartat e mësipërme paraqesin leximin e terrenit përmes pjerrësisë në përqindje dhe lartësisë në metra. Siç mund të shihet nga këto lexime, kuptohet që pjesa më e lartë është pikërisht në kufirin lindor të bashkisë dhe zonat qendrore dhe perëndimore janë më lehtësisht të aksesueshme pasi kanë terren më të ulët. Ky lexim i territorit ndihmon për të kuptuar jo vetëm gjendjen ekzistuese në bashki përsa i përket shpërndarjes së vendbanimeve. Karakteri kodrinor malor i kësaj bashkie tregon edhe potencialet për shfrytëzimin e turizmit malor, duke qënë se kemi male, pyje të dendura dhe të paprekura, kanione, shpella dhe liqene në lartësi të madhe mbidetare.

• Klima

Në Bashkinë e Gramshit mbizotëron klima mesdhetare kodrinore, nënzona jugperëndimore, që shtrihet deri në 800-1,000m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore, nënzona juglindore, në pjesën e sipërme të relievit deri në lartësinë 2,373m. Klima, relievi i larmishëm dhe sipërfaqet ujore, krijojnë mundësinë për plotësimin e nevojave për të gjitha kulturat bujqësore¹³. Temperatura mesatare e ajrit është 12.3°C-15.1°C për zonat e ulëta dhe 9.5°C-10.9°C për zonën malore¹⁴.

Për sa i takon erërave siç mund ta vëmë re edhe në figurën më poshtë, shpejtësia e tyre nuk është e madhe. Në pjesën veriore të bashkisë shpejtësia mesatare e erës është 1.5 m/s, në zonën qendrore të bashkisë është 1.6-2 m/s. Zona jugore e bashkisë ka shpejtësinë më të lartë, me vlera që shkojnë 2.1-2.5 m/s. Megjithatë edhe këto vlera nuk paraqesin potencial të madh për zhvillimin e energjisë së erës¹⁵.

Figura 27: Harta e Shpejtësisë së Erës



Burimi: Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore¹⁶; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017


Pjesa më e madhe e reshjeve bien gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit dhe më pak në periudhën e verës dhe pranverës për shkak të aktivitetit ciklonik. Sasia mesatare e reshjeve vjetore është rreth 1,200 mm shi në vit. Muaji më i lagësht i vitit është nëntori, kurse muaji



me i thatë është korriku, ndërsa reshjet e dëborës bien në zonat malore dhe qëndrojnë aty pa shkrirë 2-3 muaj¹⁷.

Në territorin e Bashkisë Gramsh vlera mesatare e rrezatimit diellor më e ulët ndodh në muajin Dhjetor, dhe vlera më e lartë në Korrik. Në pjesën lindore të luginës Devollit mesatarja e orëve me diell në vit varion nga 2,300 deri në 2,500; ndërkohë në anën lindore të luginës kjo shifër shkon nga 2,500 deri në 2,700. Për sa i përket energjisë dhe rrezatimit diellor, në zonën lindore, ku relievi është më malor, kemi një mesatare ditore prej 3.79-4.11 kËh/m², kurse pjesa perëndimore rezulton me 4.11 – 4.25 kËh/m². Mesatarja vjetore e rrezatimit shfaq që zonat me energji më të madhe janë në zonën perëndimore me 1,500-1,600 kËh/m², dhe zona lindore paraqet vlera më të ulëta nga 1,300-1,500 kËh/m². Kjo shpërndarje e rrezatimit diellor tregon që zonat më favorshme për shfrytëzimin e energjisë diellore gjenden në skajet perëndimore të Bashkisë Gramsh.

Figura 28: Harta e Rrezatimit Diellor



Burimi: SolarGIS¹⁸; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

4.1.3. Gjeologo- inxhinieria, burimet natyrore dhe pasuritë minerale

- **Kushtet gjeologo- inxhinerike**

Bashkia Gramsh bën pjesë në pllakën tektonike të Albanideve¹⁹ të Jashtme, si në atë Perëndimore edhe në atë Lindore (të ndërmjetme); më saktë në nën zonën Berat, nën zona Tomorr dhe nën zona Cukall. Kjo bashki bën pjesë edhe në pllakën tektonike të Albanideve të Brendshme, më saktë në zonën Mirdita me Ofiolite të Jurasikur të mesëm.

Klasifikimi gjeologo-inxhinierik i shkëmbinjve dhe dherave të rajonit është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe përfshin tre kategori shkëmbinjsh, të cilat janë bërë duke marrë si kriter bazë rezistencën në shtypje një boshtore (Rsh). Në territorin e bashkisë Gramsh shkëmbinj të pëfshihen në dy nga tre kategoritë e këtij klasifikimi:

- shkëmbinj mesatarë Rsh = 50 – 500 bar



- shkëmbinj të fortë Rsh > 500 kg/cm²

Në shkëmbinj të mesatarë përfshihen:

- Shkëmbinj të efuzivo-sedimentarë të Triasikut të mesëm-Jurasikut të poshtëm, të vendosur në pjesën lindore;
- Depozitimet e melanzhit “bllaqe në matris” të Jurasikut të sipërm;
- Depozitime të flishit të hershëm me moshë Jurasik të sipërm (Titanian) - Kretak të Poshtëm në periferitë të masivëve Shpat e Devoll;
- Depozimet e kalimtare të Kretakut të sipërm të nënzonës Krasta, me përhapje në lindje të rajonit;
- Gëlqerorët biomikritikë të Paleocenit të zonës tektonike Kruja me përhapje në antiklinalin e Tërvollit;
- Të gjithë llojet e flisheve me moshë nga Paleocen – Eoceni, Eoceni dhe Oligoceni që i përkasin të tre zonave tektonike të përfaqësuara në territorin e Bashkisë Gramsh.

Në shkëmbinj të fortë përfshihen:

- Dunitet dhe lercolitet plagjioklazike të Jurasikut të mesëm (masivet ofiolitike Shpat, Vallamarë e Devoll), pra të gjithë shkëmbinj të ultrabazikë të territorit.
- Shkëmbinj të gëlqerorë pllakorë të Triasikut të mesëm – Jurasikut të mesëm në veri të Gurit të Topit. Gëlqerorët e Triasikut të sipërm-Jurasikut të poshtëm me përhapje të kufizuar në perëndim të masivëve ofiolitike Shpat e Vallamarë.
- Flishi i kuq i Kretakut të poshtëm të nënzonës tektonike Krasta me përhapje në Gribë e Listec.
- Gëlqerorët e Kretakut të sipërm të zonës tektonike Kruja në Tërvoll dhe formacioni karbonatik “Kosorja” i nënzonës tektonike Krasta në zonat e Lisecit, Gribës Grabovës, Lenies e Vidhanit.
- Gëlqerorëve organogjeno-coprizorë të Eocenit që i përkasin zonës Kruja me përhapje në antiklinalet Tërvoll dhe Valesh dhe zonës Jonike në periklinalin e Marakut.

Dherat, të cilat nga pikëpamja gjeologjike - inxhinierike janë formime që kërkojnë në mënyrë kategorike përmirësim të vetive gjeoteknike gjatë hapjes së themeleve për ndërtim klasifikohen në bazë të kriterit të kohezionit (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse). Në Bashkinë Gramsh dallohen si dhera pa kohezion ashtu dhe me kohezion.

Në dherat pa kohezion përfshihen depozitime aluviale të shtratit të lumenjve me moshë Holocen dhe brekçiet kryesisht peridotite me çimentim ranor të Pleistocenit.

Në dherat me kohezion futen Depozitime taracore aluviale, zhavore popla ranorë, argjila, suargjila; me trashësi që arrijnë deri 2-3 metra me të formuara gjatë Pleistocenit të sipërm.

Vlerësimi i kushteve gjeologjike-inxhinierike të trojeve të ndërtimit

Janë vlerësuar duke kombinuar kushtet gjeomorfologjike dhe vetitë fiziko mekanike të shkëmbinjve. Siç mund të shihet edhe në analizën topografike në territorin e Bashkisë Gramsh mbizotëron një terren i thyer, me një zhillim të madh të erozionit.


Në bazë të klasifikimit gjeologjiko-inxhinierik të shkëmbinjve të kryer më lart, shihet se në territor ndahen dy kategori shkëmbinjsh dhe dy kategori dherash, secila me karakteristikat e veta specifike fiziko-mekanike. Përhapje të madhe kanë depozitimet e flishit,



karakteristikat e të cilave duhen marrë parasysh me vëmendje të veçantë gjatë projekteve të ndërtimit apo veprave të infrastrukturës, por edhe të veprave për shfrytëzim mineral. Në kuadër të këtij plani mund të jepen rekomandime të përgjithshme, të cilat duhet të mbahen parasysh dhe të thellohen në projektimet e veprave konkrete inxhinierike.

Duhet mbajtur parasysh dhe fakti se rajoni ku gjendet qyteti i Gramshit si qendra më e madhe e banuar ndodhet mbi shkëmbinj të butë, dhe pranë depozitimeve të dherave pa kohezion. Karakteristikat gjeologjike, gjeologo – inxhinierike të kombinuara me fenomenet e rrezikut gjeologjik, kushtet klimaterike dhe ato gjeomorfologjike mund të sjellin dëme jashtëzakonisht të mëdha me shkatërrime e me humbje jetësh njerëzore nëse nuk merren parasysh dhe bëhen llogaritje të ndërthuruara.

Figura 29: Harta Gjeologjike- Inxhinierike



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

Analiza gjeologjike dhe e pasurive minerale Në pikëpamje të ndarjes në zona tektonike, në këtë hapësirë administrative takohen në pjesën lindore formacione të zonës tektonike Mirdita, pjesë e e Albanideve të brendshme. Pjesë përbërëse të kësaj zone tektonike që përfaqësojnë këtu janë formacione që i përkasin nënzonës Hajmeli dhe pjesë të masivëve ofiolitikë të Shpatit në veri të rajonit dhe masivëve ofiolitikë të Vallamarës e Devollit përkatësisht në jugperëndim e perëndim të territorit të kësaj bashkie.

Albanideve të jashtme i përkasin formacionet që bëjnë pjesë në nënzonën tektonike Krasta pjesë përbërëse e zonës tektonike Krasta-Cukali, formacione të nënzonës tektonike Dajti pjesë përbërëse e zonës tektonike Kruja dhe të nënzonës tektonike Berati përbërëse e zonës tektonike Jonike.

Përhapjen më të madhe e kanë formacionet gjeologjike që i përkasin zonës tektonike Kruja. Më poshtë vijojmë me përshkrimi stratigrafik të bashkisë.

- Depozitimet e **Triasikut të poshtëm të mesëm** janë formacionet më të vjetra të kësaj bashkie. Përfaqësohen litologjikisht nga ranorë, gëlqerorë rreshporë e



gëlqerorë ranorikë, të alternuar me gëlqerorë të kuq nyjorë amonitikë, gëlqerorë silicorë, shiste argjilitore e silicorë radiolaritikë, të shoqëruar me shkëmbinj vullkanikë bazikë, mesatarë dhe acidë. Këto depozitime vendosen në pjesën lindore të rajonit të Bashkisë Gramsh në veri të Gurit të Topit.

- Depozitimet e **Triasikut të mesëm-Jurasikut të poshtëm** përfaqësohen nga fragmente të vegjël në skajet perendimore të masivëve të Shpatit dhe Devollit të depozitimeve të formacionit vullkanogjeno sedimentar.
- **Mosha Triasik i mesëm – Jurasik i mesëm** takohet kryesisht në veri të Gurit të Topit me gëlqerorët pllakorë me sicilorë.
- **Triasiku i sipërm – Jurasiku i poshtëm**, përfaqësohet nga gëlqerorë në trajtë fragmentesh në perëndim të masivëve ofilitikë të Shpatit e Vallamarës.
- **Mosha e Jurasikut** përfaqësohet nga depozitime karbonatike të Jurasikut të mesëm të sipërm dhe nga depozitimet e Jurasikut të sipërm. Depozitimet e **Jurasikut të mesëm** të sipërm janë në trajtën e blloqeve të përbëra nga ndërshtresa silicorësh radiolaritikë, me gëlqerorë biomikritikë pllakor që vendosen në jugperëndim dhe perëndim të masivit të Vallamarës. Depozitimet e **Jurasikut të sipërm** i përkasin melanzhit “blloqe në matriks” masa kryesore e të cilit ndërtohet nga argjilite alevrolitorë. Pjesa më e sipërme e këtij melanzhi përbëhet nga brekçet dhe tufo brekçet ofiolitike. Përhapja e këtyre depozitimeve është mjaft e vogël në jug dhe në lindje të masivit të Devollit dhe në perëndim të masivit të Vallamarës
- **Jurasiku i sipërm-Kretaku i poshtëm.** Këto depozitime i përkasin flishit të hershëm i cili përhapjen më të madhe e ka midis masivëve të Shpatit dhe Vallamarës. Gjithashtu ka përhapje fragmentare në veri dhe jug të masivit të Devollit. Ky flish përfaqësohet nga ndërthurje mergelorësh e gëlqerorësh mergelorë radiolaritikë me tintinidë, argjilite, alevrolite, ranorë si dhe material brekçoz e konglobrekçoz. Materiali copëzor mbizotërues është ai ofiolitik.
- **Depozitimet Kretake.** Në këto depozitime përfshihen depozitimet e Kretkut të poshtëm atij të sipërm dhe depozimet e kalimtare të Kretakut të sipërm. **Kretaku i poshtëm** përfaqësohet prej flishit gëlqeror-argjilor-mergelor i zonës së Krastës. Takohen në rajonet e Gribës dhe Lisecit ku përbën bërthamat e antiklinaleve. Përbëhen nga pakoja e poshtme e “flishit gri” dhe ajo e sipërme e “flishit të kuq”. **Kretaku i sipërm** përfaqësohet nga formacione karbonatike që i përkasin zonës tektonike Kruja dhe nënzonës tektonike Krasta. *Zonës tektonike Kruja* i përkasin depozitimet karbonatike që ndërtojnë bërthamën e antiklinalit të Tërvollit ku dallohen dy pako ajo dolomitore dhe ajo e gëlqerorëve organogjene dhe gëlqerorëve shpatik me pamje masive. Pjesa e sipërme e kësaj pakoje vazhdon deri në Paleogjen. *Nënzonës tektonike Krasta* në rajon i takojnë depozitimet e formacionit karbonatik “Kosore” me përhapje në zonat e Lisecit, Gribës Grabovës, Lenies e Vidhanit si pjesë përbërëse e antiklinaleve.
- **Depozimet e kalimtare të Kretakut të sipërm** i përkasin gjysmës së sipërme të Maastichtianit. Përfaqësojnë një kalim nga formacioni karbonatik në atë flishor të paleogjenit. Pjesa e poshtme përbëhet nga gëlqerorë, alevrolite, mergele e ranorë dhe mbi to vendoset material terrigjen që kalohen në flish. Gjendet në antiklinalet e Gribës, Lisecit, Grabovës dhe Lenies.



- **Depozitimet e Paleogjenit** kanë përhapjen më të madhe sipërfaqësore në rajonin e Bashkisë së Gramshit. Depozitimet e kësaj moshe përhapen në nënzonën Krasta, zonën Kruja dhe atë Jonike. Takohen këtu depozitime të Paleocenit, Paleocen – Eocenit, Eocenit, Oligocenit (i poshtëm, i mesëm dhe i sipërm).
- **Depozitimet e Paleocenit** takohen në formacione që i përkasin zonës tektonike Kruja. Ato takohen në antiklinatin e Tërvollit dhe përbëhen kryesisht nga gëlqerorë shtresë mesëm deri shtresëtrashë. Këta gëlqerorë u përkasin dy pakove, nga të cilat pakoja më e sipërme ka vazhdim edhe në Eocen (Paleogjen i mesëm). Në pjesën më të sipërme gëlqerorët dallohet zhvillimi i gropave karstike të mbushura me bokside.
- **Depozitimet e Paleocen – Eocenit** përhapen nga Shënepremtja në Porçani në veri e në kufirin perëndimor të masivit ofiolitik të Devollit në jug. Sipërfaqja e përhapjes është e madhe nëpër të gjithë rajonin e përhapjes së nënzonës Krasta. Depozitimet përfaqësohen nga flish dhe flishoide, kryesisht ranoro-alevrolitor, të alternuar me ranorë shtresë trashë deri masivë, horizonte vithisëse e konglomerate.
- **Depozitimet e Eocenit** të nënzonës Krasta takohen vetëm sektorin e krahut lindor të Gribës dhe përfaqësohen nga flishe argjilo-ranor me konglomerate e gëlqerorë konglomerate. Në territorin që i përket zonës Kruja ato shfaqen në përbërje të bërthamave antiklinale të Tërvollit dhe Valeshit. Në territorin që i përket zonës Jonike depozitimet e Eocenit takohen në formën e gëlqerorëve organogjeno-coprizorë dhe mikritikë ashtu si dhe në zonën Kruja, në zonën e periklinalit të Marakut (territori i fshatit Luzaj).
- **Depozitimet e Oligocenit** kanë përhapje të madhe në territorin e bashkisë. Ato përhapen në hapësirën që zënë zonat tektonike Kruja dhe Jonike. Depozitimet e Oligocenit të poshtëm që i përkasin zonës Kruja rrethojnë antiklinalin e Tërvollit, duke zënë një hapësirë të madhe mes flishit të Paleocen – Eocenit të nënzonës Krasta në lindje dhe depozitimeve flishit të Oligocenit të mesëm në perëndim që i përkasin zonës Kruja. Në jug kontaktojnë me masivin e Devollit. Përfaqësohen nga flish argjilo-alevrito-ranor me horizonte vithisëse dhe olistolite gëlqerorësh. Po të njëjta përbërje kanë edhe depozitimet e kësaj moshe që i përket zonës tektonike Jonike. Ato shtrihen në perëndim të territorit të kësaj bashkie në zonat e Belesovës, Përrenjasit. Mbi këto depozitime kalon kufiri i bashkisë me bashkitë e Cërrikut dhe Kuçovës.
- **Oligocenit të mesëm** i përkasin zonës tektonike Kruja dhe Jonike. Depozitimet që i përkasin zonës Kruja përbëjnë aksin qendror të bashkisë Gramsh. Mbi këto depozitime është vendosur dhe vetë qyteti i Gramshit. Përbëhen nga flish argjilo-alevrito-ranor.
- Po të njëjtën përbërje kanë **depozitimet që i përkasin zonës Jonike** të cilat janë të pranishme në pjesën perëndimore të rajonit dhe marrin pjese në ndërtimin e krahut lindor të antiklinalit të Marakut dhe të sinklinalit të Tunjës. Përshkojnë territorin e bashkisë në trajtën e një brezi nga veriu ku kufizohen me liqenin e Banjës deri në kufirin jugor me bashkitë Berat dhe Skrapar



- **Oligoceni i sipërm** përfaqësohet nga depozitime që i përkasin zonës tektonike Kruja, të përbëra nga flish argjilor-ranor, copa gëlqrorësh dhe gëlqerorë masivë, të cilat takohen në veri të Galigatit.
- **Mosha Neogjen** përfaqësohen vetëm nga depozitime me moshë Akuitanian të cilat takohen në jug të Tërvollit me një përhapje mjaft të vogël sipërfaqësore. Përbërja është konglomerate me zaje kryesisht magmatike e më pak karbonatike.
- **Depozitimet Kuaternare** gjejnë përhapje në rajonin e Bashkisë Gramsh. Në pikëpamje moshore përkasin Pleistocenit, Pleistocen-Holocenit dhe Holocenit. Janë të llojeve të ndryshme gjenetike. **Depozitimet e Pleistocenit** kanë përhapje të vogël dhe origjinë kryesisht glaciale. **Depozitimet e Pleistocen – Holocenit** përbëhen nga një facie e përzier, koluvionesh, deluvionesh, proluvionesh që përfaqësohen litologjikisht nga rëra, alevrite e argjila. Përfaqësimin më të madh e kanë në pjesën lindore të rajonit. Depozitimet e Holocenit në këtë rajon përhapje përgjatë rrjedhjes së lumit Devoll dhe përrenjve Holtë dhe Vërçë. Dallojmë depozitimeve të shtratit të lumit, kemi edhe formime të vjetra taracore në kuota më të larta se shtrati i sotëm i lumit. Këto formime aluviale përfaqësohen litologjikisht nga zhavorre, rëra, alevrite, argjila. Janë objekt i shfrytëzimit si inerte.
- **Shkëmbinjtë magmatikë.** Këto shkëmbinj i përkasin formacioneve që përfshihen në zonën Mirdita. Në Bashkinë Gramsh gjejnë përhapje: **Shkëmbinjtë vullkanikë** të Triasikut të poshtëm dhe të mesëm që takohen në sektorin e Gurit të Topit. Përbëhen nga vullkanite bazaltikë mesatarë dhe acidë. Fragmente vullkanogjeno-sedimentarë (Triasik i mesëm-Jurasik i poshtëm) që përhapen kryesisht në periferi të masivëve ofiolitikë të Shpatit dhe Devollit, të përfaqësuara nga llava jastëkore bazaltike, rryma lavore e më rrallë shkëmbinj piroklastike bazaltikë, të ndërthurur me radiolarite e rreshpe silicoro-argjilitore. Formacioni ofiolitik i Jurasikut të mesëm pjesë e brezit perëndimor të ofioliteve me përhapje në masivin e Shpatit, Devollit dhe Vallamarës. Shtroja metamorfike me moshë të Jurasikut të mesëm që ndeshet në perëndim të masivit të Shpatit (në jug të Poroçanit) dhe masivit të Devollit, si brez i ngushtë fragmentesh të shkëputur.

Përsa i përket pasurive minerale, Bashkia e Gramshit ka një numër të vogël vendburimesh dhe shfaqjesh të mineralizuara, kryesisht jometalorësh. Këto përmblihen në vendburime e shfaqje argjilash, dolomitësh dhe tufesh. Lënda e parë karbonatike, argjilat, magnezitet etj. që gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh, plotëson kushtet sasimore e cilësore të nevojshme në fushën e industrisë së ndërtimit, infrastrukturës, etj.

Por në këtë rajon ka dhe depozitime të cilat ku megjithëse nuk janë zbuluar deri më tash shtratime naftë-gazmbajtëse, përsëri paraqesin perspektivë në këtë drejtim.

- **Mineralet jometalore**

Përsa i përket **argjilave** më i rëndësishmi është vendburimi i argjilave Kodovjat. Ky vendburim ka përmasat të mëdha në shtrirje midis 40 - 50 m deri në 250-300 m dhe trashësi mesatare deri 80 m. Sasia e rezervave gjeologjike është disa mijëra tonë me përmbajtje SiO_2 në 53.4%., $\text{Al}_2\text{O}_3=11.11\%$, $\text{MgO} = 5.38\%$ dhe $\text{CaO} = 7.56\%$.



Dolomit përfaqësohen nga vendburimi i Tërvollit me një gjendje rezervash gjeologjike prej rreth 52 milionë tonësh. Përmasat e vendburimit janë 240 metra në rënie dhe 1500 metra në shtrirje. Trashësia maksimale e tyre shkon deri në 50 metra. Kalçiumi dhe magneziti janë mineralet kryesore. Origjina e vendburimit është sedimentare.

Tufet përfaqësohen nga tufet potasike të vendburimit me origjinë sedimentare të Qerretit. Mineralet kryesore në këtë vendburim janë xhami vullkanik, kuarci, feldshpati, shoqërues potasi, biotiti, kalciti, magnezit etj., ndërsa mineralet dytësorë janë ranorë dhe argjilorë. Vendburimi i Qerretit gjendet rreth 10 km nga qyteti i Gramshit. Perspektiva e këtij vendburimi mbetet e hapur në drejtim të rënies. Gjendja aktuale e rezervave gjeologjike është 207,000 ton me përmbajtje $K_2O = 5.28\%$, $Na_2O = 1.74\%$, $Al_2O_3 = 11.2\%$, $SiO_2 = 54.3\%$.

Gjithashtu në Bashkinë Gramsh dallohen disa shfaqje të këtij mineralizimi jometalor në Sultë, Dufaban, Lubinjë, Duzhë, Tunjë, Jançe, Katerlis, Ermenj, Përroi Qerhisë, Llallaj e Drizë.


Magnezitet gjendet në vendburimin e Gramshit. Ky vendburim është i tipit gjenetik sedimentar me moshë kuaternare. Përmasat janë në shtrirje 50-100 metra, me trashësi 0.4 m - 0.6 metra dhe trashësi mesatare 0.5 m. Format e magneziteve janë shtresore. Janë zbuluar 100,000 ton rezerva magneziti me përmbajtje $MgO = 41.5\%$. Gjithashtu në Bashkinë Gramsh takohen edhe disa shfaqje të mineralizuara të magneziteve në Bulçar, Kodovjat, Osehtë, Qerret, Cerujë e Trashovice. Mineralizimi i magneziteve gjendet në tarracat lumore të lumit Devoll midis depozitimeve flishore të oligocenit të mesëm. Origjina e tyre është sedimentare lumore dhe përfaqësojnë produkte të shkatërruara dhe të transportuara të magneziteve.

- **Perspektiva naftë-gaz mbajtëse**

Bashkia Gramsh përfshihet në bllokun 2 të kërkimit të naftës. Prania e vendburimeve të naftës në vendburimet e Kuçovës dhe Pekishtit në perëndim të kësaj bashkie dhe e shenjave të naftës në flishin e rajonit të Dumresë flet për mundësinë e një perspektivë të mundshme dhe në këtë rajon. Strukturat më perspektive janë Vargu antiklinal Letan-Valesh-Tërvoll i cili është vargu antiklinal më lindor në rajonin e kësaj bashkie, ku gjejnë zhvillim nga jugu në veri strukturat e Tërvollit, Valeshit dhe Letanit dhe vargu strukturor Galigat-Kozan ku ndodhet ngritja antiklinale e Galigatit, e cila është njësi strukturore më jugore e këtij vargu strukturor. Në këto struktura mungojnë studimet e thelluara për naftë-gazmbajtjen.



Figura 30: Harta e Gjeolojiko- Inxhinierike dhe pasuritë minerale



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

4.1.4 Hidrogjeologjia dhe hidrografia

- **Kushtet Hidrogjeologjike**

Burimet nëntokësore i klasifikojmë sipas llojeve të akuiferëve. Llojet e këtyre akuiferëve që ndeshen këtu janë:

6. **Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje të ulët;
7. Akuiferët me porozitet çarje-karst, me ujëmbajtje tepër të ndryshueshme, vende - vende shumë të lartë;
8. **Akuiferët me porozitet poro- çarje**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje lokale të ulët;
9. **Akuiferët me porozitet çarjesh**, me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme, mesatare deri shumë të ulët;
10. **Praktikisht jo akuiferë**, që përfaqësojnë një mjedis gjeologjik me porozitet të pamjaftueshëm për të mbajtur e qarkulluar në sasira të mjaftueshme ujërash për të furnizuar komunitetet me ujë të pijshëm.

Akuiferët me porozitet çarje (tipi 1) kanë përhapjen më të madhe, por akuiferët karstik (tipi 2), që vlerësohen me ujëmbajtjen më lartë, janë burimet më të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijshëm. Akuiferë të tillë mund të përmendim akuiferin e Tërvollit apo atë të Tomorrit. Nga akuiferi i Tërvollit ushqehen burimet ujore që burojnë në fshatrat Kërpic e Sotirë, nga ku furnizohet dhe qyteti i Gramshit dhe zonat përreth.

Në përgjithësi të gjithë burimet e rrethit Gramsh pavarësisht prurjes së tyre që luhet nga 0,001 deri në 1000 l/s. Resurset e përgjithshme dinamike vlerësohen të jenë 2030 l/s.

Resurset ujore sipërfaqësore të kësaj bashkie përfaqësohen kryesisht nga prurjet ujore të lumenjve Devoll dhe Tomorricë të cilat përshkrijnë nga jugu drejt veriut territorin e



bashkisë Gramsh. Lumi Devoll ka prurje mesatare 49,5 m³/s, dhe mineralizimi të ujit 390 mg/l.

- ***Kushtet Hidrografike***


Pasuria ujore e Gramshit përbëhet kryesisht nga lumenj, përroinj dhe nga liqene. Lumi i Devollit është lumi kryesor, i cili e përshkon bashkinë nga jugu në veri. Ai ushqehet nga Përroi i Tomorrocës, Përroi i Grabovës, Përroi i Vërrces, Përroi i Holtës dhe Përroi i Pashtreshit.

Lumi Devoll përshkon bashkinë e Gramshit nga jug-lindja në veri-perëndim në një gjatësi prej 49km. Regjimi i rrjedhjes së këtij lumi përcaktohet nga reshjet dhe nga shkrirja e dëborës, pra nga ushqyerja me përrenjt më të vegjël. Si i tillë ai ka dy periudha me prurje të madhe, një në Nëntor/ Dhjetor dhe tjetra në Mars/ Prill. Prurjet e mëdha në këto periudha shpesh rezultojnë edhe në përmytje sidomos në pjesën veriore të bashkisë. Lumi fillon në bashki nga fshati i Kullollasit në NjA të Skënderbegasit dhe përroi i Tomorricës i cili vjen nga Kotka në NjA të Kushovës. Këto dy degë bashkohen në Mashani duke vazhduar ndërmjet fshatrave Pishaj dhe Ostenthi. Lumi përshkon qytetin e Gramshit duke vazhduar më tej në Zgjupa, Kuterqara e Cingar dhe del nga territori i bashkisë për të vazhduar në drejtim të Qytetit të Cërrikut. Brenda territorit të bashkisë, Devolli mbledh ujërat e një sërë përrenjsh të ndryshëm si Përroi i Grabovës, Përroi i Tomorricës, i Vërrces, të cilët ndodhen në jug të bashkisë. Në pjesën veriore të lumit Devoll, në zonën ku lumi është në dalje nga territori i bashkisë, Devolli mbledh ujërat e Përroit të Holtës dhe Përroit të Pashtreshit. Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër të madh burimesh ujore sipërfaqësore, siç janë kanioni i Holtës, ujëvara e Sotirës dhe burimet termo-minerale në Holtë.

Ndër rezervuarët dallohet **ujëmbledhësi i Banjës** i rrethuar me kodra të veshura me pyje. Ky ujëmbledhës ka ardhur si rezultat i ndërtimit të digës së Banjës. Si rezultat rrjedhja e lumit të Devollit ka ndryshuar. Kapaciteti²⁰ i këtij rezervuari është 200 milion m³, dhe lartësia e digës është 158 masl. Pavarësisht nga impakti pozitiv për sa i përket krijimit të energjisë me atë të kësaj dige, do kemi edhe disa impakte të karakterit negativ. Duke qënë se në vende të caktuara tashmë lumi i Devollit²¹ do të silltet si liqen, kemi humbjen e disa specieve endemike që ishin më parë prezente, duke qënë se edhe cilësia e ujit do të ketë ndryshime. Gjithashtu mund të themi se humbja e tokave bujqësore në këtë zonë, ndikojnë negativisht në aspektin socio- ekonomik të familjeve që mbahen nga këto toka. Në Bashkinë Gramsh duhet të përmendim edhe liqenet, të tillë si: **Liqeni i Zi**, **Liqeni Bratilës**, **Liqeni i Dushkut** (në Kumian) dhe **Posnovishtë**, etj. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit. Këto liqene në përgjithësi kanë karakter allkunajor, sidomos ato që gjenden në zonën e Grabovës. Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.



Figura 31: Harta Hidrografike dhe Hidrogeologjike



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

4.1.5. Gjeorreziku

Gjeorrezizet janë reziqe me natyrë natyrore që mund ti kanosen një zone. Origjina e këtyre reziqeve është:

- Gjeologjike- Termete, rënie shkëmbinjsh, rrëshqitje tokash
- Atmosferike- stuhi bore, stuhi ere, thatësira
- Hidrologjike- përmytje
- Biofizike-zjarrje në pyje, epidemic

Në Bashkinë Gramsh hasim në përgjithësi vatra erozioni, dhe në disa raste hasim edhe fenomenet e termeteve.

- Rrëshqitjet dhe Vatrata e erozionit

Rrëshqitjet, vatrata e erozionit, shtretërit e lumenjeve dhe tërmetet janë fenomenet me përhapje në këtë rajon.

Rrëshqitjet shfaqen përgjithësisht në ato zona ku bazamenti i truallit përbëhet kryesisht argjila, flishe dhe flishoidalë dhe më pak në shkëmbinj ranorë dhe konglomerate, ku ka dhe kontraste më të theksuara të ndërtimit gjeologo-inxhinierik, gjeomorfologjisë, dhe elementeve të shtrueshmërisë së shtresave gjeologjike.

Nga përshkrimi që ju bë më lart llojeve shkëmbore të rajonit si dhe i mbizotërimit të relievit kryesisht kodrinor, duket qartë se rajoni i studimit është mjaft i prekshëm nga ky fenomen. Deri më tani janë evidentuar reth 26 raste rrëshqitjesh nga rilevimet gjeologo – inxhinierike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Ndikojnë për ta nxitur këtë fenomen faktorët si ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura shëmbore, zhvillimi tektonik, erozioni, përmbajtja e lartë e ujrave nëntokësore, rrëshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet antropogjene etj. Fenomeni i



rrëshqitjeve është kryesisht i përhapur gjeografikisht në rajonin lindor verilindor të bashkisë në rajonet ku përhapen flishe.

Erozioni gjithashtu është një fenomen me përhapje në rrethin e Gramshit, me përhapje dhe ky në zonat flishore e flishoidale. Përhapet në zonat kodrinore dhe nxitet mjaft nga mungesa e pyllëzimit.

Shtretërit e lumenjve janë zona të ekspozuara ndaj rrezikut gjeologjik, për shkak të gërryerjeve që shkaktojnë rrymat lumore të cilat kanë ndryshime të vazhdueshme të prurjes dhe drejtimit të lëvizjes. Këto nxiten edhe prej formacioneve të dherave pa kohezion që vendosen në shtretërit dhe taracat lumore. Ky rrezik shtohet mjaft afrimin e periudhës të lagësht. Ai çon deri në dëmtim apo shkatërrim të veprave inxhierike, si ura, rrugë që shkojnë paralel brigjeve mbi taraca lumore apo ndërtesa.

• *Tërmetet*


Tërmetet janë dukuri natyrore ose artificiale të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha në njerëz dhe në material. Ato shkaktohen nga disa faktorë si përplasja e pllakave të Tokës, shpërthimet nëntokësore etj. Dukë qënë se janë të paparashikueshëm ato shkaktojnë akoma më shumë dëme pasi parandalimi i tyre është i paarritshëm. Megjithatë njohja e efekteve, dhe zonave më të prirura për aktivitet të lartë sizmik pakëson pasojat negative të tërmeteve. Shqipëria bën pjesë në zonën sizmike Alpine, ku gjenerohet rreth 15% e energjisë sizmike të globit tokësor²². Përveç pllakave sizmike, kemi edhe mikropllaka, njësi më të vogla ndarëse, dhe për vendin tonë me rëndësi paraqet mikropllaka Adria, që shtrihet ndërmjet pllakës Afrikane dhe Euro-Aziate. Përplasja e pllakës Adria me Albanidet është shkaku kryesor i tërmeteve në vënd, dhe si pasojë kemi një aktivitet të theksuar sizmik. Shqipëria karakterizohet nga zona me aktivitet zismik të ndryshëm:

- Mikro aktivitet sizmik intensive: $1.0 < M < 3.0$
- Tërmete të vegjël: $3.0 < M < 5.0$ këto janë më të shpeshtë
- Tërmete të rrallë me madhësi mesatarë: $5.0 < M < 7$
- Tërmete më të rrallë të fortë: $M > 7$

Kalimi i thyrjes Vlorë – Elbasan – Shkup, nga e cila gjenerohet një pjesë e mirë e lëvizjeve sizmike në Shqipëri, kalon në veri të kufinjve të bashkisë së Gramshit e vendos atë brenda zonës VII – VIII ballë, pra në një zonë me rrezikshmëri të lartë sizmike (kujtojmë se zona maksimale është ajo me intensitet IX ballë). Në Bashkinë e Gramshit kemi një termet të shënuar në vitet e fundit. Ai ka ndodhur me datë 26 Nëntor 2015, 3 km në jug të qytetit të Gramshit, me Magnitudë 3, i thellë 17 km²³.



Figura 32: Harta e Rrezikut gjeologjik



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

4.1.6. Boniteti i tokave bujqësore

Në Bashkinë Gramsh vërehet se tokat e NjA-ve nuk janë shumë cilësore përse i përket prodhueshmërisë së tyre. Si pasojë e terrenit malor dhe kodrinor NjA-të e skajeve në bashki kanë toka më pak cilësore siç janë NjA-të Poroçan, Kukur dhe Lenie. Në NjA-të Pishaj, Kodovjat, Sult, Skenderbegas, Tunjë dhe Kushovë tolësia e tokës sëhtë më e mirë por gjithatë në nkëto NjA ka fshatra te cilat nuk kanë toka cilësore. Përgjithësisht cilësia e tokavë përse i përket prodhueshmërisë është me e lartë në pjësnë qendrore të bashkisë përgjatë luginës së Lumit Devoll.

Tabela 11 Boniteti i tokave bujqësore sipas NjA-ve dhe Fshatrave në Bashkinë Gramsh

Fshati	Bonite ti	Fshati	Bonite ti	Fshati	Bonite ti	Fshati	Bonite ti
NjA Pishaj		Kokël	5	Kukuçovë	6	Kukur	6
Pishaj	4	Posnovisht	7	Kutërçarë	6	Grazhdan	6
Trashovicë	4	Shelcan	6	Kodër	5	Gribë	7
Shëmriçë	5	Bersnik Sipërm	4	Zgjuhë	4	Kalaj	6
Ostrenth	6	Bersnik Poshtëm	4	Fushë	4	Mukaj	6
Gurrëz	6	Mashan	5	Dufshan	6	Rashtan	6
Cerunjë	5	Broshtan	7	Grekan	7	Rmath	7
Çekin	4	Zamishtë	7	NjA Tunjë		Snosën	6
Qerret	4	NjA Skenderbegas		Tunjë	5	Sojnik	6
Koçaj	5	Skenderbegas	5	Duzhë	6	Vreshtas	6



Vinë	6	Bletëz	6	Irmanj	6	NjA Kushovë	
Fshat-Gramsh	6	Ermenj	5	Jançe	6	Kushovë	5
Drizë	4	Fushëz	4	Katërlis	7	Bregas	4
Cingar Sipërm I	7	Harunas	5	Lubinjë	5	Gjeraqinë	6
Cingar Poshtëm I	5	Kotkë	6	Oban	6	Dumderas	6
Galigat	7	Kullotas	6	Përrenjas	6	Brasnik	6
Kotorr	5	Lemnushë	6	Plepas	6	Ulovë	5
Gjergjovinë	6	Nartë	4	Sarasel	6	Kërpicë	5
Storre	6	Siman	7	Tunjë e Re	6	Sotirë	5
Liras	6	Shembërdhenjë	5	NjA Poroçan		NjA Lenie	
Tërvol	7	Vidhan	6	Poroçan	6	Lenie	6
NjA Kodovjat		Zenelas	5	Lleshan	7	Bicaj	7
Kodovjat	4	NjA Sult		Gjërë	7	Grabovë Sipërme	6
Bratilë	5	Sult	6	Kabash	6	Grabovë Poshtme	6
Bulçar	5	Mazrek	6	Holtas	6	Karatë	7
Kishtë		Dushk	4	NjA Kukur		Valth	6

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

Tabela e mësipërme paraqet bonitetin e tokave në bashkinë Gramsh sipas NjA-ve dhe fshatrave të tyre. Boniteti i tokave paraqet cilësinë e tokave në bazë të prodhueshmërisë së tyre duke renditur cilësinë nga 1 në 10 ku 1 është cilësia më e mirë e tokave dhe 10 është cilësia më dobët e tokave.

4.1.7. Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore²⁴. Zonat e mbrojtura mund të jenë të tipit të gjeomonumeteve, zonave natyrore ose zona me rëndësi kulturore.

- **Zonat e mbrojtura natyrore**

Në territorin e Bashkisë së Gramshit gjenden pasuri të shumta natyrore. Në territorin e bashkisë gjendet një pjesë e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit (Pjesa veriore e parkut), i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 21 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zone. Gjeomonumentet janë shumë fenomene të rralla gjeologjike e gjeomorfologjike. Për nga rëndësia gjeomonumentet në territorin e kësaj bashkie listohen pesë gjeomonumente me vlera kombëtare dhe dhjetë gjeomonumente me vlera lokale të cilat po i listojmë në vijim:

Me vlera kombëtare:

- Kanionet e Sinecit (Saraselit);



- Liqenet e Vallamarës;
- Ujëvara e Sotirës;
- Kanioni i Holtës;
- Shpella e Kabashit;

Me vlera lokale:

- Gryka e Grabovës;
- Karsti i Tërvollit;
- Tarraca e Ballorës (Qytezës);
- Gurët e Krushqëve në Lisec;
- Liqeni i Dushkut;
- Burimet e Kërpicës;
- Liqeni i Zi (Lenie);
- Gëlqerorët me makrofaunë Tërvoll;
- Terracat e Sulovës;
- Burimi termal i Holtës;

Monumentet e Natyrës ndahen në 7 gjeo-monumente dhe 14 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjendje të mirë biologjike dhe estetike. Më poshtë vijon një përshkrim më i detajuar i këtyre zonave të mbrojtura.

Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit: Në pjesën jugore të territorit të Bashkisë Gramsh ndodhet një pjesë prej 1,280 ha e PK Mali i Tomorrit. Parku shquhet për biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Specie dominuese në floristike përmendim ahun, pishën e zezë, robullin dhe kullotat subalpine e alpine. Gjithashtu parku është një habitat i rëndësishëm për një gamë të gjerë të specieve faunistike, ndër të tjera përmendim gjitarët e mëdhënj ariu – *Ursus arctos*, ujku – *Canis lupus*, ndërsa shpendët përfaqësohen nga rrëmbenjësit e ditës dhe të natës, harabelat, etj²⁵. Krahas vlerave shkencore dhe ekonomisë natyrore, parku i Tomorrit ofron një gamë të gjerë vlerash peizazhi, çlodhëse dhe historiko-kulturore, të cilat mundësojnë zhvillimin e turizmit në natyrë dhe atij historiko-kulturor në këtë zonë. Parku kombëtar “Mali i Tomorrit” menaxhohet nga AKZM-ja. Parku ka një projektplan menaxhimi që është hartuar në vitin 2014 nga Ministria e Mjedisit²⁶.

Shpella e Kabashit²⁷: Ndodhet në afërsi të fshatit Kabash, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. E formuar në shkëmbinj të gëlqerorë të kretës së sipërmë, është e gjatë rreth 120 m. Ende nuk është eksploruar. Pjesa e njohur formon një labirinth të vërtetë dhe është e mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë.

Karsti i Tërvollit²⁸: Ndodhet në malin e Tërvollit, i cili është i përbërë nga gëlqerorët e kretës së sipërme. Në kreshtën e tij të sheshtë është i zhvilluar fuqimisht procesi i karstit, i cili ka formuar një peizazh të mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik.

Gurrët e Krushqëve²⁹: Ndodhen në afërsi të fshatit Lisec të Bashkisë të Gramshit. Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çudiçme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria gërryrrëse e erës. Legjenda i lidh ata me "ngrirjen e krushqëve, që kishin shkuar për të marrë nusen".

Kanioni i Sincit ose Saraselit³⁰: Ndodhet pranë fshatit të Saraselit të NJA-së së Sultit. Përfaqëson një kanion të madh të formuar në gëlqerorët e kretës së sipërme nga veprimtaria



karstike dhe erozive e përroit të Seraselit. Është i gjatë rreth 15 km, i thellë rreth 300 m dhe i gjerë rreth 20-30 m. Ka shpate të thepësura.

Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit³¹: Ndodhet në afërsi të Grabovës së Sipërme dhe është i formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit homonim, degë e Devollit. Është rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1,5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m. Ka shpate të thepësura.

Tarraca e Ballores (Qytezës)³²: Ndodhet në krahun e majtë të lumit të Devollit, në afërsi të fshatit të Ballores. Përfaqëson një fragment të nivelit të parë të tarracës lumore të formuar nga lumi i Devollit dhe lumi i Tomorricës, degë e tij. Është e gjatë rreth 800 m dhe e gjerë rreth 200 m. Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepësuar, 15 m të lartë. Në shpinën e saj ka mbetje arkeologjike, që tregojnë për praninë e një vendbanimi prehistoric.

Liqeni i Dushkut³³: Ndodhet në afërsi të fshatit Lenie, në rrëzën veriperëndomore të malit të Komianit, në lartësinë 1,105 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m. Ka botë të pasur të gjallë, në të cilën dallohen sidomos zambakët e mbëdhenj të ujit. Rrethohet nga një pyll i dendur pishash me sipërfaqe rreth 12 ha. Së bashku me pyllin rrethues formon një ekosistem tepër interesant liqenor e pyjor. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Kodovjat – liqeni i Dushkut.

Liqenet e Valamarës³⁴: Ndodhen në malin e Valamarës, të vendosura në një cirk të madh kompleks akullnajor, në lartësinë rreth 2,200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Lenie. Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m, të veçuara nga njeri tjetri prej depozitimesh morenike. Liqeni më i madh ka përmasa mesatare 600 m gjatësi dhe 200 m gjerësi. Kanë ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Janë të pasura me një botë të gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpinë.

Liqeni i Zi – Lenie³⁵: Gjendet në lartësinë 1,634 m, në afërsi të fshatit Lenie. Përfaqëson një liqen me origjinë akullnajore. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe. Forma e liqenit është e përzgatur, rreth 1,000 – 1,200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m. Drurët e pyllit janë drurë me moshë shekullore. Ujërat e liqenit përdoren edhe për kurim sëmundjesh si reumatizma, por ende nuk ka studime të këtij lloji.

Moçalet e Grabovës³⁶: Gjendet në shpatin e malit të Valamarës, në lartësinë 1,550 m mbi nivelin e detit. Nga ana administrative i përket fshatit Grabovë e Sipërme. Njihet edhe me emrat Moçalet, Gropa e Kryqit dhe Prishtakoll. Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1,000 m, gjerësi 400 – 450 m e sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungut 25 – 35 cm, perimetri trungjeve 80 – 100 cm, ndërsa mosha është 150 vjeçare. Pylli është përreth një livadhi, ku derdhen mjaft burime nga ana lindore e tij.

Burimet e Kërpicës³⁷: Ndodhet në afërsi të fshatit Kërpicë. Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flishit të luginës së Tomorricës. Dallohen për regjim të rregullt të prurjes, ujët e pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një pamje me bukuri mahnitëse.



Ujëvara e Sotirës³⁸: Ndodhet në shpatin lindor të malit të Tomorrit, në afërsi të fshatit të Sotirës. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distancë mjaft të madhe. Krijon një pamje me bukuri mahnitëse.

Robulli i Valamarës³⁹: Gjendet në malin e Valamarës, 1,500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 10 ha. Lartësia e drurëve është rreth 30 m, diametri i trungjeve është mbi 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 70 – 100 cm. Mosha e tyre është 150 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë.

Rrobulli i Grabovës⁴⁰: Gjendet në afërsi të malit të Valamarës, ndaj nga banorët njihet edhe me emrin Valamara e Vogël. I përket fshatit Grabovë e Sipërme. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 8 ha. Pylli i rrobullit ka formë drejtkëndëshe me gjatësi 400 – 500 m, e gjerësi 150 – 200. Lartësia mbi nivelin e detit është 1,500 m. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungjeve është 25 – 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 60 – 100 cm. Mosha e tyre është 100 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë.

Dushku i Bulçarit⁴¹: Ndodhet në fshatin Sojnik në lartësinë 1,100 mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grupe drurësh dushku. Ka formë të përzgatur me gjatësi 2,000 – 3,000 m, gjerësi 200 – 300 m. Drurët përfaqësohen nga pisha e zezë dhe dushk, përreth liqenit të Dushkut rreth 12 ha. Në afërsi të liqenit ka livadhe me bimësi barishtore, bimësi ujore e gjallesa të tjera. Lartësia e drurëve është 15 – 25 m, diametri i trungjeve është 15 – 35 cm, perimetri i tyre është 50 – 110 cm. Mosha e drurëve të pishës është 150 vjeçare. Janë të ruajtur mirë.

Dushkaja e Katër Lisave⁴²: Gjendet në fshatin Katërlis, NJA Tunjë të Bashkisë Gramsh, në lartësinë 850 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll dushku, me sipërfaqe rreth 1 ha. Grupi i drurëve ka formë drejtkëndëshi me gjatësi 200 – 250 m e gjerësi 40 – 50 cm. Lartësia e drurëve është 15 – 18 m, diametri i trungjeve është 30 – 40 cm, ndërsa perimetri i tyre arrin deri 120 cm. Mosha e drurëve është 80 – 100 vjeçare. Pas vitit 1990 ka patur dëmtim të pjesshëm të drurëve. Është në pronësi shtetërore.

Ahishtia e Rovjes⁴³: Gjendet në afërsi të fshatit Kukër (Rovë) të NJA-së me të njëjtin emër të Bashkisë Gramsh, 1,400 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll ahu. Pylli ka formën e një amfiteatri në shpatin malor me sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 15 – 35 m, diametri i trungut është 50 – 70 cm, perimetri i trungjeve është 100 – 200 cm, ndërsa mosha e tyre është 80 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë.

- ***Zonat e mbrojtura kulturore***


Monumentet e Kulturës në këtë Bashki variojnë që nga kalatë e fortifikimet mesjetare, në ndërtesa me rëndësi fetare. Ato janë të gjithë monumente të kategorisë së parë, pra janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonike dhe teknike. Lista e tyre vijon më poshtë:

1. Kalaja e Kabashit
2. Kalaja e Tërvolit
3. Ujësjellësi në përroin e Ranxës
4. Fortifikim mesjetar



5. Kalaja e Irmajt⁴⁴ – përfaqëson një vendbanim të hershëm ilir, rreth 2400 vjeçar, që vërtetohet nga zbulimet arkeologjike dhe gjetjet e ndryshme rreth saj. Mbetjet e kalasë, përfaqsohen nga një mur guri reth 25 m linear në formën e shkronjës L.
6. Kalaja e Prrijenjasit
7. Kezma
8. Kisha e Grabovës
9. Kalaja e Grabovës së Poshtme
10. Ura e gurtë
11. Rrënojat e urës antike

Figura 33: Harta e zonave të mbrojtura



Burimi: AKZM; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

4.1.8. Përfundime

Nga studimi i problematikës gjeologjike në Bashkinë Gramsh që përfshin ndërtimin gjeologjik, kushtet gjeologo-inxhinierike, faktorët e rrezikut gjeologjik, karakteristikat e akuiferëve e resurset dinamike të ujrave nëntokësorë, por dhe sipërfaqësorë dhe praninë e gjeomonumenteve mund të nxjerrim këto përfundime:

- Në këtë rajon megjithëse shfaqet prania e një game të gjerë shkëmbinjsh duke filluar nga ata magmatikë e deri në depozitime Kuaternare të krijuar prej Triasikut të mesëm (afërsisht 242 milion vjet më parë) e deri në kohët e sotme e që i përkasin tre zonve tektonike të Albanideve të brendshme e të jashtme, formacionet kryesore shkëmbore që mbizotërojnë janë ato flishoidale.
- Depozitimet flishoidale shfaqen që nga lloji i flishit i vjetër i Jurasikut të sipërm-Kretakut të poshtëm, por mbizotërues janë llojet e flisheve që i përkasin zonave Krasta Cukali, Kruja dhe Jonike. Në kuadër të planit rregullues ky lloj formacioni shkëmbor duhet marrë seriozisht në konsideratë. Ai përfshihet në llojin e *shkëmbinjve mestarisht të fortë dhe ndërtojnë kryesisht zonën*



kodrinore e pjesërisht atë malore, në të cilat mundësa e lindjes së fenomenit të rrezikut gjeologjik është më e madhe.

- Në zonën kodrinore për momentin dallohet një hapësirë mbizotëruese, ku momentalisht nuk dallohen dëmtime në banesa të ndodhuara nga fenomene të rrezikut gjeologjik, dhe pjesa tjetër ku këto fenomene (rëshqitje, erozion) janë të shfaqura. Mungesa e shfaqjes së fenomeneve të tilla ndodh për faktin se ndërtimet nuk e kanë prishur ekuilibrin e shpateve. Ky ekuilibër duhet vazhuar të ruhet dhe në të ardhmen. Rritja e ekzagjeruar e dendësisë së ndërtimeve, lartësisë së ndërtesave dhe sipërfaqes së tyre mund të çojë në prishje të ekuilibrit të sipërpërmendur.
- Zona përfshihet në rajonizimin sizmik VII-VIII ballë, çka e ekspozon ndaj një rreziku sizmik të lartë. Shkaku kryesor për këtë është afërsia me thyerjen Vlorë – Elbasan – Shkup. Kjo gjithashtu duhet marrë parasysh nga plani rregullues.
- Rreziku i erozionit lumor sugjeron që në brigjet lumore të mos parashikohen ndërtime, por të planifikohen mbjellje pemësh, me rrënjë të cilat të mundësojnë në rritjen e kohezionit të dherave pa kohezion që janë depozituar në brigjet e lumenjve duke ulur kështu erozionin dhe minimizimin e rrezikut.
- Gjithashtu fenomenet e erozionit dhe rëshqitjeve në këtë rajon janë ndikuar mjaft nga shpyllëzimet, prandaj plani duhet të nxisë pyllëzimin, sidomos në zona të planifikuar për ekskursionet turistike në rrugëtimet drejt gjeomonumenteve të zonës.
- Bazuar në këto që u thanë më sipër plani mund të parashikojë ndërtime jo shumë të larta në këtë zonë, maksimumi i të cilave të mos i kalojë 5 – 6 kate, ndërtesa të cilat duhet të ndërtohen në terrene të studiuara mirë në pikpamjen gjeologjike inxhinierike, në nivelin e ujrave nëntokësore në rënien e shtresave shkëmbore e sidomos të shtresëzimit të flisheve. Megjithatë lartësia dominuese e ndërtesave nuk duhet ti kalojë 3-4 kate.
- Bashkia e Gramshit merr sasinë më të madhe të ujit të pijshëm nga burime që burojnë nga akuiferët karstikë. Këto zenë 5% të burimeve por mbajnë mbi 90% të resurseve dinamike. Problemi i këtyre lloj akuiferësh është se ata janë mjaft të ekspozuar ndaj ndotjeve, prandaj planifikimi duhet të marrë parasysh mos parashikimin e ndërtesave apo objekteve të infrastrukturës në hapësirat e këtyre akuiferëve.
- Planin rregullues duhet të marrë parasysh dhe mbrojtjen nga ndotja të rrjedhave sipërfaqësore të cilat gjithashtu përbëjnë rezervë të rëndësishme ujore. Kjo duhet bërë duke marrë parasysh orientimin e duhur të derdhjeve të kanalizimeve të zonave të banuara, dhe gjithashtu duke caktuar një zonë për një landfill për grumbullimin e mbetjeve urbane, të cilat sot shkarkohen në brigjet e lumit dhe në liqenin e Banjës.

4.2. Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM nr. 671 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, metabolizmi I territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e




analizuara janë: fluksi i **energjisë**, fluksi i **ujit**, fluksi i **ushqimit** dhe fluksi i **mbetjeve**. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. **Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie**. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore, menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- ***Energjia në Rajon***

Rajon që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnje, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajguore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, Pogradec⁴⁵, ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: ***Bankers Petroleum*** (Patos-Marinëz), ***TransAtlantic*** (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), ***Sherwood*** (Kuçovë), ***Transoilgroup*** (Visokë); ***Phoenix*** (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Po ashtu, energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore e energjisë. Lumenj si **Shkumbini, Osuni, Devolli** përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike, vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë por edhe për bizneset industritë apo institucionet. Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që ka për t'u përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret në ultësirën perëndimore, Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veriperëndimore) mund të përdoret për prodhimin e energjisë. I gjithë territori i Bashkisë Gramsh ka erëra me shpejtësi që variojnë nga 2.1-2.5m/s⁴⁶. Pra shpejtësia e tyre nuk është e madhe. Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Rrezatimi arrin vlera nga 1,450 këh/m² deri në 1,650 këh/m²⁴⁷. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore. Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Gramsh gjenden edhe burime gjeotermale, temperatura e të cilëve arrin >80 °C. Përdorimi i kësaj energjie përveç efekteve pozitive, ka ndikim në mjedis dhe ekosistem, por nëse përdoren teknologjitë e duhura këto pasoja janë minimale. Nga përdorimi i energjisë gjeotermale efektet më të shpeshta negative janë ndotja e ajrit (nga gazërat që çlirohen) dhe ndotja e tokës.



Figura 34. Energjia në Rajon




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

- **Uji në Rajon**

Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj të më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë, në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve. Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë uji, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje dhe përcjellshmëri uji shumë të ndryshueshme shumë të lartë e të lartë, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, Gramshit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore janë çenuara nga ndotja. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përcimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.



Figura 35. Figura Uji në Rajon



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

- ***Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Gramsh***


Analiza e metabolizmit të territorit në Bashkinë e Gramshit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Gramshi ka një sipërfaqe prej 692 km² dhe popullsi 36,305 banorë⁴⁸. Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

- ***Fluksi i Energjisë***

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Gramsh. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë e janë të mbishfrytëzuara.



Figura 36. Fluksi i Energjisë në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e Bashkisë Gramsh: Territori i Gramshit shtrihet në një zone me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për këtë arsye ka dhe një shfrytëzim të konsiderueshëm të ujërave të lumenjve për prodhimin e energjisë hidrike. Gjithashtu, parashikohet që mbi Lumin Devoll të ndërtohen hidrocentrale të vegjël (>1MË) dhe hidrocentrale të mëdhenj (<50MË), që do të rrisin më shumë nivelin e shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore. Por prodhimi i energjisë nuk duhet kufizuar vetëm në energji hidrike, sepse ka potencial për t'u mbështetur edhe në energji të tjera alternative. Gramshi ka potencial për të prodhuar edhe energji gjeotermale, pasi në territorin e kësaj bashkie gjenden burimi termal i Përoit të Holtës me temperature 24 °C. Territori i Gramshit është pjesë e zonës gjeotermale Kruja, e cila shtrihet në rreth 180km dhe ka një gjerësi 4-5 km. Shqipëria ka një rrezatim diellor të konsiderueshëm për t'u përdorur si burim energjie. Gramshi ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kË/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të qarkut luhetet nga 1,615 në muaj (dhjetor) deri në 6,520 në muaj (korrik)⁴⁹. Gjatë gjithë vitit ka afërsisht 3000-4000 orë me diell⁵⁰. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike⁵¹. Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje: Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh⁵² dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MËh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit. Për vitin 2011, sipas INSTAT, numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri i Njërive Ekonomike Familjare është **722, 600 familje**. Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: Konsumi i



energjisë elektrike nga familjet (**2,587,535**)/nr. e familjeve (**722, 600**) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MËh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzohet nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike. Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në nivel Qarku, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 77% të NjEF-ve në Qarkun Elbasan përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (13%) dhe më pas nga energjia elektrike (7%)⁵³.

Tabela xx. Rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	2,821,977
Popullsia banuese gjithsej e numëruar	2,800,138
Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare	722,600

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Tabela xx. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	38,493	19,023	19,470
Dru	23,655	6,824	16,831
Energji elektrike nga rrjeti	3,183	2,918	265
Gaz	9,016	7,146	1,870
Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, naftë, etj.)	110	69	41
Pa ngrohje	2,529	2,066	463

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)


- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Gramsh dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim (uji i mbushur në shishe)*, dhe përdoret nga banorët, bizneset, industrinë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e Bashkisë Gramsh) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor⁵⁴. Qyteti, zona industriale, zona ekonomike dhe tokat bujqësore, ku ndodhin zhvillimet më të mëdha shtrihen mbi shtresa nëntokësore ujëmbajtëse. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 36.6 km² në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Në ujërat sipërfaqësore të Gramsh bënë pjesë lumi Devoll dhe degë të tij si: Përroi i



Tomorricës, i Holtës, i Verrcës dhe Përroi i Grabovës. Në pasuritë ujore të Bashkisë vend të rëndësishëm zënë dhe liqenet, si: Liqeni i Zi, Liqeni i Dushkut.

Figura 37. Fluksi i Ujit në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Qyteti dhe zona industrial (zona e ish-industriale) shtrihen përgjatë luginës së Devollit dhe pjesa më e madhe e tyre është e përqëndrar në qytetin e Gramshit. Territori i Gramshit është i pasur me ujëra nëntokësore. Qyteti i Gramshit, zonat ekonomike dhe industrial shtrihen mbi akuiferë me porozitet ndërkorrizore dhe përcjellshmëri uji shumë të lartë-të lartë. Burimet e ujërave nëntokësore ndodhen kryesisht në këto shtresa nëntokësore. Edhe shpimet janë bërë në këto shtresa. Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve, Bashkia Gramsh ka mbulim të pjesshëm të shërbimit të ujësjellësit. Në Njësine Administrative Pishaj, rrjeti i kanalizimeve ekziston në Fshatin Cekin (50%), Cerujë, Qerret, Pishaj (30%) dhe Shemrizë (20%). Në Njësine Administrative Kodovjat rrjeti mbulon rreth 30% të sipërfaqes dhe ekziston vetëm në fshatrat Kodovjat dhe Bersnik. Pjesa tjetër e fshatrave të komunes përdor ose gropa septike ose shkarkon direkt në Lumin Devoll. Njësitë e tjera Administrative (Kushovë, Skënderbegas, Sult dhe Lenjë) janë me gropa septike, të cilat janë kolektive ose individuale. Rrjeti kryesor i ujësjellësit shtrihet përgjatë luginës së Devollit nga burimi i Kërpicës në Gramsh. Ndonëse të gjitha njësive administrative iu ofrohet shërbimi i ujësjellësit, mbeten ende disa fshatra të cilët nuk mbulohen nga ky shërbim. Në zonat që nuk ofrohet ky shërbim, banorët e sigurojnë ujin nëpërmjet puseve individuale, burimeve ose krojeve malore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Gramsh, shfrytëzon pellgjun ujëmbajtës nëntokësor përgjatë lumit Devoll. Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat UK Gramsh dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë, numrin e




banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë.

- **Fluksi i ushqimit**

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Gramsh, analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku.

Figura 38. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në këtë rast për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturën ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave të Bashkisë Gramsh, në territorin e kësaj bashkie prodhohen bujqësore (kryesisht drufrutorë) dhe blegtorale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Toka bujqësore në Bashkinë Gramsh zë një sipërfaqe prej 10,142 ha, ndërsa zona natyrore dhe ajo bujqësore e pa kultivuar, e cila mund të përdoret për mbjelljen e pemëve frutore, zë një sipërfaqe prej 59,841 ha. Kjo tregon që Bashkia Gramsh ka territor të përshtatshëm për kultivimin e pemëve frutore dhe të perimeve të ndryshme. Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat të INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Sasia e produkteve që konsumohet (treg dhe eksport) është më e lartë se sasia e produkteve që prodhohen në territorin e Bashkisë Gramsh. Kjo ndodh sepse një pjesë e produkteve që




konsumohen nuk prodhohen në territorin e Gramshit. Arsye tjetër është se burimi i të dhënave është i ndryshëm. Prodhimet janë përcaktuar nga INSTAT, ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

- **Fluksi i Mbetjeve**

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia e Gramshit para ndarjes territoriale). Edhe në këtë territor shërbimi ofrohet në nivelin 60-70%. Venddepozitimi i mbetjeve në Gramsh ndodhet rreth 3 km larg qendrës së qytetit pranë brigjeve të Lumit Devoll në pjesën lindore të territorit.

Figura 39. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Ky venddepozitim është klasifikuar si jo sanitar, mbetjet të cilat depozitohen aty janë mbetje të ngurta urbane, por edhe mbetje të tjera. Në territorin e Bashkisë së Gramshit ka një makinë teknologjike e cila kryesisht operon në zonën e qytetit ndërkohë në Nja-të e tjera venddepozitimet janë pa kriter dhe gjenden në mënyre spontane në territoret përkatës. Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Gramsh, jemi mbështetur sërisht në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Gramshit. Sasia e gjeneruar në zonën urbane të qytetit të Gramshit arrin në vlerën 1.607-2,382 ton/vit. Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend depozitimi (jo sanitar) i vendosur pranë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ulin nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat



nëntokësore. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi.

- **Përfundime**

Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në nivel Qarkun është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përftohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Gramshi ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kE/m², energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Gramshi shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale si ai i Përoit të Holtës. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen. Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Gramshit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren pusët. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Gramsh është 122.5 m³/orë sasli e ujit në bashki është disa herë më e lartë. Ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë Njësisë Administrative Poroçan, Kukur, Lenië, Skënderbegas dhe Pishaj, ku ndodhin edhe aktivitetet më të mëdha industriale përgjatë Lumit Devoll. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës. Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Gramshit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.

4.3. Burimet ujore sipërfaqësore


4.3.1. Burimet ujore sipërfaqësore

Bashkia e Gramshit ka një rrjet të pasur hidrik. Territori i Bashkisë përshkohet nga Lumi Devollit, i cili mbetet trupi ujqor kryesor në Bashki. Lumi Devoll përshkon bashkinë e Gramshit nga jug-lindja në veri-perëndim në një gjatësi prej 49km⁵⁵. Lumi fillon në bashki nga fshati i Kullollasit në NjA të Skënderegasit dhe përroi i Tomoricës i cili vjen nga Kotka në NjA të Kushovës. Këto dy degë bashkohen në Mashani duke vazhduar ndërmjet fshatrave Pishaj dhe Ostenthi. Lumi përshkon qytetin e Gramshit duke vazhduar më tej në Zgjupa, Kuterqara e Cingar dhe del nga territori i bashkisë për të vazhduar në drejtim të Qytetit të Cërrikut. Lumi Devollit gjatë gjithë rrjedhës së tij konstatohet të ketë një furnizim të fuqishëm. Duke qënë se lugina e lumit Devoll mbledh ujërat e lartësive mbi 2000m të Tomorrit dhe Gurit të Zi, shpjegon edhe faktin që prurjen më të madhe e ka në muajt prill dhe maj, ku edhe lumi del nga shtrati, duke përmblytur tokat përgjatë bregut dhe gërryerjen e tyre, kryesisht në pjesën veriore të qytetit.



Brenda territorit të bashkisë, Devolli mbledh ujërat e një sërë përrrenjsh të ndryshëm si Përroi i Grabovës, Përroi i Tomorricës, i Vercës, të cilët ndodhen në jug të bashkisë. Në pjesën veriore të lumit Devoll, në zonën ku lumi është në dalje nga territori i bashkisë, Devolli mbledh ujërat e Përroit të Holtës dhe Përroit të Pashtreshit. Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër të madh burimesh ujore sipërfaqësore, siç janë kanioni i Holtës, ujëvara e Sotirës dhe burimet termo-minerale në Holtë. Ndër rezervuarët dallohet ujëmbledhësi në zonën e Banjës me të njëjtin emër, të rrethuar me kodra të veshura me pyje. Në Bashkinë Gramsh duhet të përmendim edhe liqenet, të tillë si: Liqeni i Zi, Liqeni Bratil, Liqeni i Dushkut (në Kumian) dhe Posnovishtë, etj. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga Bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit.

Figura 40. Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Gramsh



Burimi: SHGJSH; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

o Gjendja e burimeve ujore sipërfaqësore (problematikat)

Në dy dhjetëvjeçet e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve siç janë gërryerja e shtratin, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrëshqitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së tyre.⁵⁶Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmenaxhimi të gjatë që janë kryesisht i



ndryshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; ii) humbje të florës & faunës ujore, dhe iii) ndotje.

Hidromorfologjia e lumenjve dhe ndryshimet e saj lidhen kryesisht me tipare fizike të një lumit të cilat janë kryesisht⁵⁷: morfologjia e kanalit dhe lloji i rrjedhës (natyrale ose e modifikuar); përbërja litologjike e shtratit (lloji, sasia e përbërjes shkëmbore në shtrat); struktura dhe stabiliteti i brigjeve – mjaft e rëndësishme sepse tregon ndikimin që do të ketë lumi në gërryerjen e brigjeve dhe, si rrjedhojë, në sasinë e sedimentit që do të përfundojë në lumë; digat/pengesat përgjatë rrjedhës, të cilat ndikojnë në ndryshimin e shpejtësisë së rrjedhës së lumit dhe largësinë e rrjedhjes së lirshme të ujit deri në largësinë në të cilën është në gjendje të transportojë sedimentin; bimësia në shtratin e lumit (habitatet, biodiversiteti, bimët, etj); brezi i bimësisë mbrojtëse përgjatë brigjeve, përdorimi i tokës në afërsi (rreth 20 metra nga bregu) dhe gjerësia e zonës me ndikim nga përmblyjet.

Në vendin tonë, ndërhyrjet në lumenjë janë të shumëllojshme si në shtrat, ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosjen e mbulesës bimore. Ndryshime të tilla janë: marrja e materialeve inerte si rërë, zhavorr, gurë ose plisa, ndërtimet afër lumenjve, hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gërmimet e ndryshme, si dhe veprimtari të tjera që prodhojnë mbetje, shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj⁵⁸. Të gjitha këto ndërhyrje kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat edhe nga studimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve. Një përshkrim i shkurtër i rezultateve të analizës në lumin Osum dhe në basenin e Semanit në përgjithësi paraqitet më poshtë:

- o Thellimi i shtratit të lumit Seman (Osum e Devoll), erozioni i brigjeve

Me qëllim analizimin e gjendjes së lumenjve në vendin tonë dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit të fenomeneve gjeologjike dhe ndërhyrjes së njeriut në shtratin e tyre, SHGJSH-ja ka monitoruar⁵⁹ basenet e lumenjve në vend, ndër të cilët edhe basenin/pellgun e lumit Seman.

Pellgu i lumit Seman është monitoruar në pesë pika/profile monitorimi për periudhën 2008-2016. Këto profile janë shpërndarë në lumin Osum (dy pika) dhe në lumin Seman (tri pika). Në lumin Devoll nuk ka profile të monitoruara. Megjithatë, duke qenë se në zonën fushore përpara bashkimit lumenjtë Osum e Devoll paraqesin ngjashmëri hidromorfologjike, rezultatet e lumit Osum në dy pikat e monitorimit Urë-Vajgurore dhe Urë e Kuçit në Seman në një farë mënyre janë tregues edhe të gjendjes së lumit Devoll.


Tabela 12. . Vendndodhja e profileve të monitorimit

Nr.	Lumi	Vendi i profilin	Periudha e monitorimit
38	Seman	Ura e Re Berat	2008-15
39		Ura Vajgurore	2008-15
40		Ura e Kuçit	2009-15
41		Imësht	2009-16
42		Ura e Mbrostarit	2007-15

Burimi: SHGJSH, 2016; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016



Tabela 13. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratis të lumenjve në Basenin e Lumit Seman



Burimi: SHGJSH, 2016; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Ndër problematikat kryesore të nxjerra në pah nga ky monitorim është prania e **erozionit fundor** në segmente të ndryshme të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme (Tabela më poshtë). Në të gjitha pikat ka patur erozion të theksuar fundor, i cili shfaqet me *ulje të shtratis të lumit*. Më i theksuar është vënë re në *Urën Vajgurore* në vitet 2008-2015 (43.2cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në *Imësht* (34.8cm), *Ura e Mbrostarit* (19.4cm) dhe *Ura e Kuçit* me 13cm (Figura 49 më poshtë).


Tabela 14. . Ndryshimet totale (erozioni fundor/akumulimet) ndër vite në Lumin Seman

Nr.	Vendi i profilit të monitorimit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi Total	Ecuria deri 2015			Trendi 2011-2015		
				Erozion	Neutral		E	N	A
38	Ura e Re Berat	2008-15	-16.8	√			√		
39	Ura Vajgurore	2008-16	-43.2	√			√		
40	Ura e Kuçit	2009-15	-13.0		√		√		
41	Imësht	2009-16	-34.8	√			√		
42	Ura e Mbrostarit	2007-15	-19.4	√				√	


Burimi: SHGJSH, 2016; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017



Tabela 15. . Thellimi i shtratin të Lumit Seman e Osum për shkak të erozionit fundor



Erozioni Fundor në shtratin e lumit Seman (cm)



Burimi: SHGJSH

Shkurtimeisht, problematikat kryesore që janë vënë re gjatë monitorimit janë⁶⁰:

- Ulja e shtratin për shkak të erozionit fundor;
- Përmbytjet në zonën e poshtme të lumit Seman dhe në zona të caktuara të rrjedhës së tij;
- Ndotja e ujit (nga inertet, ndotje baktoreologjike të ujit etj.);
- Dëmtimi i florës dhe faunës së lumit;
- Dëmtimi i peizazhit lumor;
- Rrezikimet e objekteve inxhinierike (ura mbrojtëse, argjinatura etj.);
- Ulja e nivelit të ujërave nëntokësore në pusët e ujit, stacione pompimi jashtë funksionit.

Dëmtime të zonës ripariene: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariene e lumit Devoll ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në disa raste zona ripariene është *kultivuar si tokë bujqësore*. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave



bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Kjo është shumë e rëndësishme, duke ditur se akuiferi e porozitetet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët, shtrihet veçanërisht poshtë shtratit të lumit Devoll.

Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et: Pellgu i lumit Devoll është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-eve. Në fakt, në Basenin e Semanit deri më tani janë ndërtuar 6 HEC-e, ndërkohë që 5 të tjerë janë në ndërtim dhe 66 janë planifikuar për t'u ndërtuar.

Tabela 16. . HEC-et në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll

PELLGU UJËMBLEDHËS I DEVOLLIT				
Nr	Emërtimi i HEC-it	Kapaciteti	Lumi	Bashkia
Në prodhim				
1	Gjanç	1-10MË	NN	Korçë
2	Vithkuq	1-10MË	Treska	Korçë
3	Lenia	1-10MË	NN	Gramsh
4	Holta	1-10MË	NN	Gramsh
Në ndërtim				
1	Nicë	1-10MË	Nice	
2	Treska 1	1-10MË	Treska	Korçë
3	Treska 2	1-10MË	Treska	Korçë
4	Banjë	>50MË	Devoll	Cerrik
Planifikuar për t'u ndërtuar				
1	Belesova 1,2	1-10MË	NN	Kuçovë
2	Holt ë2	1-10MË	Holtë	Gramsh
3	Kabash-Holtë	0-1MË	Kabash	Gramsh
4	Sotirë 1	1-10MË	Sotirë	Gramsh
5	Sotirë 2	1-10MË	Sotirë	Gramsh
6	Skënderbegas	>50MË	Tomorricë	Gramsh
7	Kërpicë	1-10MË	Kërpicë	Gramsh
8	Dobrenjë-Tomorricë	0-1MË	Dobrenjë-Tomorricë	Gramsh
9	Kukur 1	1-10MË	Kukur	Gramsh
10	Kukur 2	1-10MË	Kukur	Gramsh
11	Kukur 3	1-10MË	Kukur	Gramsh
12	Kukur 4	1-10MË	Kukur	Gramsh
13	Kukur 5	10-50MË	Kukur	Gramsh
14	Bratila 1	>50MË	Devoll	Gramsh
15	Bratila 2	1-10MË	Devoll	Gramsh
16	Zerec 1	0-1MË	Zerec	Maliq
17	Zerec 2	0-1MË	Zerec	Maliq
18	Moglicë	>50MË	Devoll	Maliq/librazhd
19	Cemeric 1	1-10MË	Cemericë	Devoll Gramsh




**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

20	Cemerica 2	1-10MË	Cemicë	Devoll Gramsh
21	Cemerica 3	1-10MË	Cemicë	Devoll Gramsh
22	Strelce 1	0-1MË	Strelce	Maliq
23	Strelce 2	0-1MË	Strelce	Maliq
24	Lozhan 1	0-1MË	Dolanit	Maliq
25	Lozhan 2	0-1MË	Dolanit	Maliq
26	Verba 1	0-1MË	Verba	Patos
27	Verba 2	0-1MË	Verba	Patos
28	Babjen	0-1MË	Babjen	Maliq
29	Shpella poshtë 1	0-1MË	Poshtë	Korçë
30	Shpella poshtë 2	0-1MË	Poshtë	Korçë
31	Hohist	1-10MË	Devoll	Korçë
32	Grapsht	1-10MË	Devoll	Korçë
33	Vranisht	1-10MË	Devoll	Korçë
34	Stropan	1-10MË	Devoll	Korçë
35	Brecen Menkulas	1-10MË	Devoll	Korçë
36	Kuk Menkulas	1-10MË	Devoll	Korçë
37	Dobjan Menkulas	1-10MË	Devoll	Korçë
38	Miras Menkulas	1-10MË	Devoll	Korçë
39	Dardhë 1	0-1MË	Devoll	Korçë
40	Dardhë2	1-10MË	Devoll	Korçë

Burimi: AKBN dhe Riveratch.eu, Punoi: MetroPOLIS, 2017

HEC-et janë ndërtuar në degët kryesore të lumit Devoll, si dhe në degë të nivelit të dytë (degë të degëve), të cilat shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumin Devoll. Njëkohësisht, ata shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për lumin në fjalë.

Tabela 17. HEC-et në pellgun e lumit Seman



Burimi: Riveratch.eu, Punoi: MetroPOLIS, 2017



Deri më tani janë ndërtuar 4 HEC-e, janë në proces ndërtimi 4 HEC-e dhe është planifikuar ndërtimi i 40 HEC-eve në degët kryesore të Devollit dhe përgjatë trupit të tij. Në këtë moment nuk ka të dhëna rreth kohës kur është planifikuar ndërtimi i tyre.

Në vendin tonë lumenjtë janë shfrytëzuar për prodhimin e energjisë hidrike në 50 vitet e fundit. Megjithatë, edhe pse HEC-et sjellin përfitime ekonomike dhe prodhim energjie, ata kanë ndikimet e tyre në mjedis dhe, në qoftë se nuk ndërtohen sipas parimit të përdorimit të integruar të burimeve ujore (që nënkupton përdorimin e ujit duke patur parasysh edhe nevojat e sektorëve të tjerë të ekonomisë për ujë), rrezikojnë të shndërrohen në konflikte sociale.

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër ndikimet më të njohura renditet ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, HEC-et shkaktojnë:

- transformimin e rrjedhës së lumit në pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në sistem të një rezervuari artificial me ujëra të ndenjura,
- bllokimin e qarkullimit të peshqve ose specieve të tjera ujore,
- prishjen e ekuilibrave dhe të proceseve fizike dhe habitateve në rrjedhën mbas digës. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror duke shkaktuar prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve, si rrjedhojë dhe erozionin detar, të ishujve, të zonave pjellore të lumenjve dhe të zonave të tjera kënetore,
- ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror të trashë në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën për faktin se jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit,
- grumbullimin e sedimentit mbas digës që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme. Kur një lumë nuk merr sedimente mjaftueshëm, zakonisht tenton ta zëvendësojë atë duke gërryer brigjet e lumit, duke shkaktuar thellim të shtratit,
- thellimin e shtratit të lumit, i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifer.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në Devoll dhe në degët e tij, mendohet se ndikimi në mjedis dhe në bujqësi në zonat përreth mund të jetë i theksuar. HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit, mjaft e rëndësishme për bujqësinë në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për bujqësinë dhe sektorët e tjerë, edhe pse kjo mbetet objekt studimi në të ardhmen. Vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave dhe e sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit që ato lënë me rrjedhje të lirë mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës ose mbas digës në të ardhmen. Është shumë e rëndësishme të theksohet se lumi Devoll është jetik për zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë Gramsh dhe në bashkitë e tjera apo NjA nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye, ndryshimi i rrjedhës së ujit apo pakësimi i sasisë së ujit që mund t'u shkojë fshatarëve për përdorim në periudhat e kultivimit nuk përbën më një problem vetëm mjedisor por, mbi të gjitha, një problem social që kërkon zgjidhje të menjëhershme. Njëkohësisht, pakësimi i rrjedhës së lumit Devoll mund të çojë edhe në zvogëlimin e sasisë së ujërave të akuiferit të luginës së Devollit, i cili ushqehet nga lumi me të njëjtin emër. Ky akuifer shërben si burim për furnizimin me ujë të popullsisë së Bashkisë Gramsh. Me pak fjalë, digat e HEC-eve, në



rast se nuk janë planifikuar dhe nuk menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar në mënyrë që të garantojnë përdorimin e ujit edhe për bujqësi dhe aktivitetet të tjera ekonomike për popullsinë e zonave përreth, mund të shkaktojnë probleme të mëdha mjedisore dhe sociale.

Dëmtime të zonës ripariane: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e Devollit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tij përshkon toka bujqësore të kultivuara, në të shumtën e rasteve zona ripariane është *kultivuar si tokë bujqësore*. Gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.

Tabela 18. Dëmtime të brigjeve të lumit Devoll



Burimi: MetroPOLIS, 2017

Ndotja nga karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë. Bashkia Gramsh është e pasur me gurë gëlqerorë, të cilët janë shfrytëzuar gjerësisht në vitet e fundit. Lejet e dhëna për shfrytëzimin e këtyre mineraleve në periudhën 2001-2014 (Tabela x) janë 3⁶¹. Sipas lejeve të dhëna rezulton se sipërfaqja e territorit e shfrytëzuar për aktivitet minierar sipërfaqësor (për nxjerrjen e gurëve të ndryshëm) është 0.12km². Përveç prishjes së peizazhit, në rastet kur gërmimet janë sipërfaqësore, gëlqerorët ndotin mjedisin me retë e pluhurit që ngrenë gjatë aktivitetit të tyre. Sipas SHGJSH-së, “reja e pluhurit që krijohet nga ky aktivitet ndot në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme ajrin, ujërat sipërfaqësorë, tokat bujqësore”. Më poshtë është sjellë tabela e plotë e aktiviteteve minerare gëlqerore në Lumin Devoll, në harkun kohor 2001-2014 (Tabela x). Nuk ka informacion rreth numrit të aktiviteteve të braktisura, që nuk janë më në veprim, dhe ku sipërfaqet e aktivitetit të cilëve nevojitin ripërtëritje.

Tabela 19. Karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë në Lumin Devoll

Nr.	Vendi	Data	Lloji i mineralit	Km ²
1	Gramsh	28.06.2004	Gëlqeror	0.12
2	Lumi Devoll	03.04.2015	Gëlqeror	0.08
3	Shelcan	26.01.2009	Gëlqeror	0.02



Totali	0.22
--------	------

Burimi: AKBN dhe Ministria e energjisë dhe industrisë, 2015; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Ndotja: Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Gramsh, lumenjtë janë përdorur edhe si venddepozitime ose kanale të mbetjeve të ngurta ose të ujërave të ndotura urbane dhe industriale. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve, qytetet, që përshkohen nga lumi Devoll, e kanë shfrytëzuar këtë lumë për derdhjen e drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura urbane në lumë të patrajuara paraprakisht duke shkaktuar ndotje të ujit të lumit. Përveç ujërave të ndotura urbane, Lumi Devoll ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e zonës industriale në Gramsh dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tij. Si rrjedhojë, cilësia e ujërave të lumenjve është varfëruar ndër vite. Lumi është ndotur me produkte industriale, ujëra të ndotura urbane, produkte bujqësore etj.

Ndotja e monitoruar nga Co-PLAN/PLGP USAID: Duke patur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë Qendrore, dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, Co-PLAN-i⁶² kreu edhe monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Semanit në 12 pika të tij, degë e të cilit është dhe lumi Devoll në të cilin është kryer monitorimi në 2 pika të lumit. Disa nga pikat e monitorimit⁶³ dhe disa parametra kimikë⁶⁴ janë të përbashkët me monitorimet që kryen Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh si standardet shqiptare, ashtu edhe direktiva të ndryshme të Bashkimit European.

Parametrat e monitoruar janë si më poshtë:

- Parametra fiziko-kimikë: pH, tejdukshmeria, përçueshmëria elektrike, lënda e ngurtë pezull (TSS), lënda e ngurtë e tretur, oksigjeni i tretur, temperatura dhe nevoja biologjike për oksigjen
- Ushqyesit: N-NH₄, N-NO₃, N-NO₂, Sulfidet,
- Bakteria: bakteria koliform
- Metale të rënda: Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Mangnez (Mn), Nikel (Ni), Zink (Zn), Bakër (Cu), Co, Krom (Cr), Mërkur (Hg), Arsenik (As), Brominë (Br)

Tabela 20. Pikat e monitorimit të lumit Devoll

Pikat e Monitorimit	Lumi	Vendndodhja e pikës së marrjes së mostrave të ujit
Devoll 1	Devoll	Burimi, në Moglicë të Korçës
Devoll 2		Përpara bashkimit me lumin Seman


Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Të dyja pikat e monitoruara në lumin Devoll janë jashtë kufinjëve të Bashkisë Gramsh.

Nga monitorimi i kryer në Seman u vu re se ujërat e lumit Devoll janë *alkalinë* (pH >7)⁶⁵ në të gjitha pikat e monitorimit, që nga burimi deri në pikën para bashkimit me lumin Seman.



Figura 41. pH i ujërave të Devollit




Burimi: PLGP/Co-PLAN, 2015

Në lumin Devoll, *thellësia e depërtimit të dritës* nuk përbën problem sepse thellësia e lumit është e vogël pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së sipërme dhe të mesme të lumit. Njëkohësisht, lumi ka ujëra të rrjedhshme, të cilat kanë aftësi të pastrohen me shpejtësi. Përçueshmëria elektrike është brenda parametrave mjedisorë (nën 500 μ hos/cm)⁶⁶, të cilat krijojnë një mjedis të papërshtatshëm ujqor për zhvillimin e biodiversitetit. Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçueshmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore të përcjellshmërisë elektrike.

Vlerat e NBO_5 ⁶⁷ janë brenda normës⁶⁸ në të gjitha pikat e monitorimit. Megjithatë, duke patur parasysh derdhjen e ujërave të zeza në lumë, vlerat e NBO_5 tregojnë nevojën për ta analizuar këtë parametër në lidhje me faktorë të tjerë, që ndikojnë në vlerat e këtij parametri në ujërat e lumenjve (vendndodhja e burimeve kryesore të ndotjes në lumë si shkarkimet nga industria, pikat e derdhjes së ujërave të ndotura urbane, etj.).

Figura 42. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Devoll




Burimi: PLGP/Co-PLAN, 2015

Lënda e ngurtë pezull është <2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit, dhe shumë më e ulët se norma mjedisore⁶⁹. Të njëjtën ecuri ndjek edhe lënda e ngurtë e tretur, por që ka vlera më të larta krahasuar me lëndën pezull. Kjo lidhet me burimet e lëndës së ngurtë të tretur që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të lëndës së ngurtë të tretur vihen re në pikën e monitoruar pranë Bashkisë Kuçovë, dhe kjo mund të vijë si rezultat i grumbullimit nga rrjedha e mësipërme, por edhe nga gërryerja e tokës bujqësore.




Figura 43. Baseni i Lumit Devoll: Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull



Burimi: PLGP/Co-PLAN, 2015

Devollit ka përmbajtje brenda normave⁷⁰ të lejuara të **nitrateve** (N-NO₃) dhe përmbajtje të lartë të **nitriteve**⁷¹ (N-NO₂) duke filluar nga Moglica në Korçë deri në pikën ku bashkohet me lumin Seman. Përmbajtja e **amoniakut** (N-NH₄) në të dyja pikat e monitoruara përmbajtja është brenda normave të lejuara⁷². Ndërkohë, në rast se bazohemi në standardet e përdorura nga AKM⁷³, vlerat e nitrateve, nitriteve dhe amoniakut janë brenda normave të lejuara në të gjitha pikat e monitorimit, me përjashtim të pikës së Moglicës sa i përket nitrateve, ku vlerat e nitriteve klasifikohen si të kategorisë së tretë (gjendje e moderuar). Azoti, së bashku me përbërësit e tij, është një ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por i mbipërdorur në bujqësi si pleh kimik dhe për shkak të derdhjeve të ujërave të ndotura të gropave septike, shkakton ndotjen e ujërave të lumenjve. Ndërkohë, sulfatet në Devoll janë në nivele të ulëta krahasuar me vlerat e lejuara⁷⁴. Prania e sulfateve rritet gradualisht nga burimi në Moglicë deri në pikën ku bashkohet me Semanin, edhe pse vlerat mbeten gjithmonë brenda normave.

Figura 44. . Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Devoll




Burimi: PLGP/Co-PLAN, 2015



Nivele të larta të ndotjes në Devoll hasen për sa i përket bakterieve koliforme. Koliformet janë mbi nivelin e lejuar (200 Cfu/100ml)⁷⁵ në të gjitha pikat e monitorimit.

Metalet e rënda janë monitoruar vetëm në pikën ku bashkohet Devolli me Semanin, pikë e cila është monitoruar pasi lumi kalon territorin e Bashkisë Kuçovë. Ujërat janë të ndotur me plumb (Pb), Kadmium (Cd), Nikel (Ni), Arsenik (As), Hekur (Fe), dhe Krom (Cr)⁷⁶.

Figura 45. Metalet e rënda në Basenin e Lumit Devoll



Burimi: PLGP/Co-PLAN, 2015



Ndërkohë, vlerat e Zinkut (Zn) dhe të Arsenikut (Hg) janë brenda parametrave mjedisorë.

Si përfundim, rezultatet e monitorimit të ujit tregojnë se ujërat e Basenit të Devollit duhen monitoruar më tej, për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për bujqësi, larje dhe peshkim. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të gjithë bashkive nëpër të cilat kalon lumi Devoll.

Por duhet theksuar se, monitori i kryer nuk tregon nëse ndotja shkaktohet në Bashkinë e Gramshit, ndaj nevojitet që me monitorimin e mëtejshëm të ketë më tepër pika monitorimi për të përcaktuar burimet më specifike ndotëse.

o Burimet e ndotjes së burimeve ujore sipërfaqësore

Urbanizimi i rajoneve të pozicionuara thuajse në brigjet e lumenjve me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm, zgjerimi i metropoleve, zhvillimi i industrisë, i sektorit të bujqësisë dhe shumë aktivitete të tjera prodhuese ka shfrytëzuar ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore si pritësin ideal të shkarkimeve, duke i ndotur ato. Sot, rreth 60% e popullsisë vazhdon të përdorë burimet natyrore⁷⁷ ndërkohë që pjesa tjetër është ndikuar nga ndotjet e grumbulluara dhe është e detyruar të orientohet nga konsumi i ujit të ambalazhuar. Fatkeqësisht, kjo gjendje është krijuar kryesisht për arsyen se në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në Ligjin nr. 111/2012,⁷⁸ por zbatimi i tij në terren mbetet jo-efektiv.

Sot, burimet kryesore të ndotjes së lumenjve në territorin e Bashkisë janë të shumtë. Ndër ta përmenden shkarkimet e drejtpërdrejta të ujërave të ndotura në sipërfaqe ujore (*pa iu nënshtruar proceseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura*), përdorimi i zonave në brigjet e lumit për venddepozitime mbetjesh urbane e të ngurta (depërtimi i shllameve dhe derdhjet aksidentale të mbetjeve të ngurta në ujërat e rrjedhshëm të lumit krijon drejtpërsëdrejti ndotje), shkarkime të ujërave të ndotura industriale, shfrytëzimi i shtratit të Devollit për materiale inerte, shkarkimet dhe depërtimet e ujërave të përdorura në sektorin e bujqësisë drejtpërdrejt në lumë, shkarkimet e ujërave të larta në lumë, etj.

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes, i cili përshkon një shteg të caktuar gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujqor dhe, si përfundim, një mjedis pritës i cili bart këtë ndotje. Këtu vlen të theksohet, se pritësit kryesor të ndotjes së lumenjve janë deti Adriatik dhe më pak deti Jon. Për shkak të ndotjes së lumenjve, në deltat e lumenjve vërehen nivele të larta të ndotjes si nga cilësia e ujërave edhe nga mbetjet e ngurta. Efekti fillestar, që kanë këto ndotje të përmendura më lart, është dëmtimi i ekosistemit të ujërave të rrjedhshëm si dhe modifikimi i cilësisë së tyre në aspektin përmbajtësor të elementëve ushqyes. Konkretisht në Bashkinë Gramsh, ujërat sipërfaqësore të Lumit Devoll mbartin sasi të konsiderueshme të ujërave të ndotura urbane të cilat shkarkohen sistematikisht nga Bashkia Gramsh dhe NjA-të përreth. Më poshtë prezantohet një përmbledhje e shkurtër e burimeve kryesore të ndotjes së burimeve kryesore ujore (Lumit Devoll kryesisht) në Bashkinë Gramsh.

Ndotja nga venddepozitimet e mbetjeve urbane: Vend-depozitimi i vjetër i mbetjeve i cili përdorej deri para pak kohësh, paraqet probleme të mëdha lidhur me ndotjen e ujërave të Lumit Devoll dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, venddepozitimi i vjetër i Bashkisë Gramsh ndodhej në përgjatë përroit pranë fshatit Çekin, duke ndotur vazhdimisht ujërat sipërfaqësore të lumit Devoll si edhe akufierin e luginës së



tij. Kjo për arsye se ky venddepozitim ndodhet në një zonë të papërshtatshme gjeologjike për venddepozitim për shkak të territorit me shtresa gjeologjike me koeficient të lartë të depërtimit të ujërave nga sipërfaqja në akuifer. Duke patur si referencë hartat dhe raportet e SHGJSH-së⁷⁹, akuiferi, nga pjesa veriore e Gramshit deri në afërsi të Cërrikut është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze). Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat e lumit Devoll dhe më tej në ujërat e Akuiferit të luginës së lumit. Me pak fjalë, lëndët toksike që janë çliruar gjatë procesit të shpërbërjes së mbetjeve në këtë venddepozitim kanë depërtuar drejtpërsëdrejti në ujërat nëntokësore të Akuiferit të luginës së Devollit duke rrezikuar shëndetin e popullsisë së zonës si dhe duke ndotur Devollin dhe tokën përreth. Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh, të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në Akuiferin e luginës së Devollit. I njëjti problem paraqitet aktualisht në venddepozitim aktual të mbetjeve, i cili gjithashtu është i pozicionuar pranë një përroi në .

Ndotja nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane: Shërbimi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Bashkinë Gramsh, që para viteve 90, e ofron shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura urbane në brendësi të hapsirave të banuara të Qytetit Gramsh (Figura më poshtë). Këto ujëra të ndotura shkarkohen në ujërat sipërfaqësore të Lumit Devoll pa asnjë trajtim paraprak.

Në NjA-të e tjera shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura nuk ofrohet. Si zgjidhje e përkohshme kanë qënë dhe vazhdojnë të mbeten gropat septike pa kushte teknike të mbrojtjes mjedisore dhe sanitare. Ujërat e ndotura shkarkohen më pas në rrjedhën më të afërt ujore ose, në disa raste, edhe në kanalet e hapura.

Kolektorët dytësorë të lidhur me pusetat e shërbimit prej betoni të parafabrikuar, shkarkojnë në kolektorin kryesorë, ku prej tyre shkarkojnë drejtpërdrejt në lumin Devoll. Përmasat e tubacioneve variojnë nga Ø300- Ø800.

Në këtë sistem, siç raportohet nga vetë Bashkia Gramsh, ka mjaft seksione të dëmtuara ç'ka ka ndikuar në përkeqësimin e situatës mjedisore në ato zona ku ndodhin këto shkarkime të pakontrolluara.

Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane ka si qëllim primar të tij “rehabilitimin” e cilësisë së ujërave të ndotur në ato nivele, ku impakti i tyre do të ishte sa më minimal për trupat ujore natyrorë pritës. Në Bashkinë Gramsh aktualisht një impiant i tillë është projektuar të ndërtohet. Momentalisht, të gjithë elementët ndotës, që bartin këto ujëra shkarkohen në lumenj për të sedimentuar e depërtuar më pas në akuiferë, ndërsa një pjesë flokulojnë me rrjedhën ujore drejt ujërave detarë të kripur.

Ndotja nëpërmjet dampave ekologjike/septike: Dampat ekologjike/septike në vendin tonë janë venddepozitime specifike, ku depozitohen materialet e përdorura gjatë proceseve prodhuese të industrisë. Zona e Gramshit, edhe pse nuk ka një aktivitet të theksuar të industrisë, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit, nuk ka një dampë e cila të plotësojë kushtet teknike dhe higjieno-sanitare në të cilën mund të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit industrial, së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, supozohet se një pjesë e nënprodukteve të mbetjeve nga përzhvillimi i industrisë kanë përfunduar dhe përfundojnë sistematikisht në tokat ku janë pozicionuar këto dampa si dhe në ujërat e lumit Devoll.



Ndotja nga shkarkimet industriale: Në Gramsh ushtrojnë aktivitetin e tyre biznese të ndryshme në fushën e ndërtimit, agro-ushqimore, industri përpunuese etj. Sipas legjislacionit në fuqi për manaxhimin e mbetjeve industriale, bizneset duhet të mbajnë regjistrin e mbetjeve të prodhuara.

Megjithatë, situata lidhur me mbetjet industriale në Bashkinë Gramsh mbetet ende e paqartë dhe informacioni rreth këtij fluski mbetjesh nuk është lehtësisht i gjindshëm. Vlerësohet se Bashkia Gramsh prodhon në total rreth 24 ton⁸⁰ mbetje në ditë, por nuk është saktësisht e përcaktuar se sa është sasia e mbetjeve industriale nga totali i prodhuar.

Një aspekt problematik për ndotjen deri në ditët tona ka qënë mënyra e trajtimit të mbetjeve industriale dhe ndotjes nga shkarkimet në ujë dhe tokë nga Uzina e montimit të armëve në Çekin dhe Uzina e prodhimit të baterive. Shpeshherë, kushtet teknike të trajtimit të mbetjeve industriale, si edhe kushtet e lejes mjedisore, nuk zbatoheshin duke stokuar mbetjet industriale në afërsi të lumit. Kjo Uzinë tashmë shërben si Fabrikë e demontimit të armëve. Mbetjet ushtarake industriale që dalin nga procesi i demontimit ruhen brenda territorit të godinës, në pritje të depozitimit të tyre në vend-depozitime të përshtatshme që deri më tani mungojnë në vendin tonë. Si rrjedhojë, për aq kohë sa Shqipëria nuk ka një vend-depozitim të tillë, këto mbetje do të vazhdojnë të ruhen në territorin e uzinës.

Probleme të ndotjes së burimeve ujore përbën dhe venddepozitimi i kimikateve në qytetin e Gramshit. Në këtë venddepozitim janë akumuluar mbetje gjatë viteve. Sa i takon këtyre mbetjeve Bashkia nuk ka informacion rreth sasisë që është depozituar aty. Për momentin nuk ka asnjë plan për mënyrën se si do të trajtohen këto mbetje apo nëse ka një plan për transferimin apo trajtimin e tyre.

Një burim tjetër i ndotjes industriale janë edhe *ndërrimi apo grumbullimi i vajrave të makinave*, të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse. Ato lehtësisht mund të derdhen në tokë dhe në sipërfaqe e më pas të përfundojnë në lumë duke dëmtuar ekosistemin.

Ndotja nga sektori i bujqësisë: Kimikatet e përdorura në këtë sektor (pesticidet, plehrat kimikë etj.) prodhojnë një nivel të konsiderueshëm ndotjeje e cila shkakton shqetësime në florë dhe faunë si pasojë e elementëve kimikë e që shpërbëhen në këto ujëra. Ndotja shtohet në rast reshjesh, të cilat shpërlajnë tokën bujqësore dhe përfundojnë në burime ujore sipërfaqësore. Duke parë shtimin e sasisë së përdorur të pesticideve në bujqësi, me futjen e bujqësisë në një sipërfaqe të vogël të fushave të Gramshit, mendohet se bujqësia është shndërruar edhe në burim ndotës për lumin Devoll.

o Përfundime e rekomandime

Gramshi është i pasur me burime ujore. Devolli është burimi kryesor ujqor i cili përshkon territorin e bashkisë nga jug-lindja në veri-perëndim. Ndërsa nga njëra anë Gramshi ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim.

Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Devollit është mjaft i rëndësishëm për shkak të rëndësisë që ka lumi në zhvillimin e bashkisë. Meqenëse ujërat e këtij lumi përdoret edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e lumit të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujë e lumit gjatë kultivimit.




Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia dhe organet kompetente të manaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë; si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të ndotura urbane dhe industriale në lumë, të mbetjeve të ngurta dhe industriale, të parandalimit të ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit eficient të tyre etj. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që bashkia të planifikojë projekte me përparësi për rehabilitimin e lumit dhe përrrenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qëndror) që preken nga Devolli, për manaxhimin e integruar të këtij lumi.

4.3.2 Burimet ujore nëtokësore⁸¹

Bashkia Gramsh ka një rrjet të kufizuar burimesh ujore nëtokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike (Figura më poshtë). Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës.⁸² Akuiferët përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e Bashkisë së Gramshit.

Figura 46. Harta hidrogjeologjike, Bashkia Gramsh




Burimi: SHGJSH, 2014; Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Akuiferët kanë një shtrirje të vogël në territorin e Bashkisë, krahasuar kjo me sipërfaqen e saj. Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëtokësore bazoheshin në



sipërfaqen e Qarkut të Elbasanit sipas ndarjes administrative të territorit përpara Reformës së Re Administrative. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve për çdo bashki, por nëpërmjet dixhitalizimit të tyre kemi arritur të klasifikojmë akuiferët në Bashkinë e Gramshit⁸³.

Figura 47. Klasifikimi dhe sipërfaqja e Akuiferëve në Bashkinë Gramsh (në km²)



Burimi: SHGJSH, 2014; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Bashkia e Gramshit përfshin akuiferët e mëposhtëm:

- Akuiferë me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët)
- Akuiferë me porozitet poro-çarje
- Akuiferë me porozitet çarje-karst
- Akuiferë me porozitet çarje
- Jo-akuiferët, të cilët kanë porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësor në sasi të shfrytëzueshme

Akuiferët shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkisë, për ujitje, etj. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i akuiferëve që shtrihen në territorin e Bashkisë së Gramshit dhe shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë, dhe që janë i) akuiferë me porozitet ndërkokrrizor , ii) akuiferë me porozitet poro-çarje , iii) akuiferë me porozitet çarje-karst, iv) akuiferë me porozitet çarje.

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor të shkrifët: Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) është formuar nga grumbullimi i zhavorreve dhe materialeve të tjera nga Lumi Seman dhe Lumi Devoll⁸⁴. Në këtë akuifer dallohen disa zona të cilat ndahen ndërmjet tyre për nga kapaciteti përcjellës i ujit. Në Bashkinë e Gramshit bën pjesë zona me ujëpërcjellshmëri mesatare dhe të ulët (argjilë, rërë, suargjilë)⁸⁵. Kjo zonë shtrihet në pjesën e Luginës së Devollit, fillimisht shtrihet në zonën e Kodovjatit dhe shkon deri në Sult, për të kaluar më tej në territorin e Bashkisë Elbasan.



Ky akuifer ka lidhje hidraulike të mirë të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rezerva uji të konsiderueshme për shfrytëzim. Drejtimi kryesor i lëvizjes së ujërave nëntokësore përputhet me drejtimin kryesor të luginës së Devollit, paralel me lumin. Ujërat nëntokësore të luginës së Devollit ushqehen kryesisht nga lumi me të njëjtin emër. Sipas SHGJSH-së, ky akuifer ka ujëpërcjellshmëri mesatare dhe është në gjendje të furnizojë me ujë të pijshëm një komunitet të vogël.

Akuiferët me porozitet çarje-karst: Këto akuiferë lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë ku përfshihen kryesisht depozitimet gëlqerore. Dallohen ndërmjet tyre për përcjellshmërinë tepër të ndryshueshme. *Masivi karbonatik i Tervollit* është një akuifer i cili shtrihet nga Kishta në jug, deri në afërsi të Kabashit në veri⁸⁶. Këto akuiferë, për shkak të karstit kanë forma karstike shumë të zhvilluara (copëtime të theksuara, kreshta malore, pllaja të vogla, shpate të thepisura ose shpella, dhe forma akullnajore karstike). Në pjesën veriore të Masivit dalin një sërë burimesh si Burimet e Holtës dhe Burimi i Tervollit.

Depozitime gëlqerore ose siç njihen ndryshe depozitime të Krekut të sipërm dhe të poshtëm (Cr₁ dhe Cr₂) kemi gjithashtu dhe në pjesën lindore të Bashkisë Gramsh, në pjesën qendrore të NjA Kukuri⁸⁷.

I rëndësishëm për Bashkinë e Beratit është Akuiferi karstik i Tomorrit, i cili ndërtohet nga gëlqerorë të kretarkut dhe paleocenit. Burimet ujore, që dalin nga ky akuifer janë shumë të rëndësishëm sepse furnizojnë me ujë qytetin e Gramshit dhe zonat përreth. Të tillë janë burimi i Sotirës dhe ai i Kërpicës. Prurjet e tyre janë të mëdha duke variuar nga 1000-1500 l/sek⁸⁸.

Në zonën veri-lindore të Bashkisë Gramsh është i pozicionuar, në një sipërfaqe të vogël akuiferi me porozitet çarje-karst Luzajt. Nga ky akuifer në Bashkinë Gramsh del burimi i Sinecit i cili furnizon me ujë Bashkinë e Kuçovës.

Burimet ujore të cilat shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë të Bashkisë së Gramshit janë: Burimi i Kërpicës, Proshovës, Duzhës, Bulcarit, Komjanit, Shkozës, Shkuriqit, Sekës, Gurrës dhe Kroj Bardhë.

Burimet e lartpërmendura furnizojnë me ujë fshatrat, si : Pishaj, Shëmrizë, Cërunjë, Çekin, Qerret, Drizë, Galigat, Kotorr, Gjerovinë, Storë, Kodovjat, Bersnik, Mashan, Zamshe, Kushovë, Bregas, Gjeraqinë, Sotirë, Lenie, Proçan, Skënderbegas, Bletëz, Ermenj, Fushëz, Harunas, Kotkë, Nartë, Siman, Vidhas, Zenelas, Lubinjë dhe qyteti i Gramshit.

Akuifer me porozitet çarje: Lidhen ngushtë me shkëmbinjtë kompaktë dhe të çarë ultrabazikë. Dallohen për kapacitet ujëmbajtës të ulët me burime që rrjedhin kryesisht gjatë dimrit, në periudhën e reshjeve dhe që kanë prurje të vogla. Akuiferët me porozitet çarje shtrihen në Grabovë të sipërme dhe të poshtme, gjithashtu edhe në NjA Proçan. Burime të tilla janë burimet rrëzë malit të Valamarës me prurje 15 l/s⁸⁹. Këto burime dalin në kuota të të larta me ushqim kryesisht nga liqenet akullnajorë. Këto burime përbëjnë edhe pikënisjen e përrrenjëve dhe më tej të Lumit të Seman.

Jo-akuiferët: Sipërfaqja e jo-akuiferëve shtrihet në pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë Gramsh. Jo-akuiferët lidhen ngushtë me depozitimet argjilore, flishore dhe gipseve. Ato karakterizohen nga mungesa e porozitetit për të lejuar qarkullimin e ujërave nëntokësore, në sasi të tilla që të mund të shfrytëzohen. Këto zona nuk paraqiten me



porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizorë ose çarjesh. Në Bashkinë Gramsh gjenden depozitime të Oligocenit të mesëm dhe të Paleocenit-Eocenit⁹⁰.

o Problematikat e Pellgjeve Ujore Nëntokësore

Në 20 vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët⁹¹.

Për më tepër, Bashkia e Gramshit është zonë me veprimtari bujqësore dhe urbanizim të vazhdueshëm, që kanë çuar në ndotjen e lumenjve kryesorë (Devollit dhe degëve të tij). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet dëpërtimit të ujërave të lumenjve nëpër akuiferë. Ndotja e akuiferëve, që shërbëjnë për furnizimin me ujë të popullsisë, përbën rrezik për shëndetin e njeriut dhe banorëve. Më poshtë paraqiten problemet kryesore të ujërave nëntokësore të Bashkisë Devoll (ndotja dhe shfrytëzimi).

Mungesa e njohjes së kapacitet ujqor të shfrytëzuar: Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacitet të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi, në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme⁹². Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujqit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan manaxhimi, gjë që do të bënte të mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit furnizues. SHGJSH-ja⁹³ raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Elbasanit ka ardhur si rezultat i i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi sidomos në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale, ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose ilegale për shfrytëzimin e ujqit për bujqësi dhe industri, dhe iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Në Bashkinë e Gramshit, për plotësimin e nevojave të popullsisë së bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, nuk ka një studim ku të tregohet sasia që shfrytëzohet ose kërkesa aktuale për ujë.

Zonat pa lidhje me rrjetin janë kryesisht zonat rurale dhe përfshijnë⁹⁴:

- o *NjA Pishaj* (Ostenth, Gurrëz, Koçaj, Vinë, Fshat Gramsh, Cingar i Sipërm dhe i Poshtëm, Liras dhe Tërvol)
- o *NjA Sult* (Sult, Mazrek, Dushk, Kukuçovë, Kutërqar, Kodër Zgjupe, Zgjuj Fushë, Dufshan, Grekan)
- o *NjA Tunjë* (Tunjë, Duzh, Irmanj, Jançe Qendër dhe Mal, Ktërlis, Oban, Prrenjas, Pleas, Saraselë, Tunjë e Re)
- o *NjA Kushovë* (Dumberas, Bësnik, Ulovë, Kërpicë)
- o *NjA Skënderbegas* (Kullollas, Lemnushë)



- *NjA Kodovjak* (Bratilë, Bulçar, Kishtë, Kokel, Posnovishtë, Shelcan, Broshtan)
- *NjA Poroçan* (Kabash, Holtas, Lleshan, Gjerë)
- *NjA Kukur* (Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Snosëm, Sojnik)
- *NjA Lenie* (Bicaj, Grabovë e Sipërme dhe e Poshtme, Kuratë dhe Valth)

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje individuale, të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme. Këto burime apo pus-shpime, përveçse hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogeologjike, e bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve⁹⁵.

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të jashtligjshme⁹⁶. Shfrytëzimi i akuiferëve do të shtohet edhe më tej po të kihet parasysh se në vitet e ardhshme, kërkesa për ujë do të rritet.

Sasia e ujit, që shfrytëzohet për çdo akuifer nga industria, bujqësia dhe sektorët tjerë të ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferët (hyrje dhe dalje të ujit) me qëllim shfrytëzimin e ujit të akuiferit në mënyrë të qëndrueshme.

Ndotja e akuiferëve (Akuiferi i luginës së Devollit): Në Bashkinë e Gramshit, akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst shtrihen drejtpërdrejt nën vendbanimet urbane dhe zona industriale dhe bujqësore, janë shumë të ndjeshëm ndaj ndotjes mjedisore nga pus-shpimet për ujë, derdhja e ujërave të ndotura urbane, mbetjet e industrisë dhe ato urbane, si dhe aktiviteti bujqësor. Sipas SHGJSH-së⁹⁷, rreziku i ndotjes së Akuiferit të luginës së Devollit me shtrirje përgjatë lumit Devoll është i lartë si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse, sidomos në zonën e qytetit të Gramshit, si pasojë e popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare përgjatë lumit Devoll, dhe si pasojë e shkarkimeve industriale dhe urbane në këtë zonë. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe i ujërave sipërfaqësore si dhe mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Devoll nga ndotja, shkakton ndotjen e këtij akuiferi.

Prania e akuiferëve në territorin e Bashkisë realizon furnizimin me ujë të banorëve të qytetit të Gramshit dhe të njësisve të tjera administrative. Pus-shpimet përkatëse nga të cilat marrin ujë banorët e të gjithë territorit të Bashkisë së Gramshit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Figura 48. Ujësjellësit e Bashkisë Gramsh dhe burimet e furnizimit me ujë të tyre

N r	Ujësjellësi	Burimi nga furnizohet	Fshati që furnizohet	Numri i banorëve
NjA GRAMSH				
1	Ujësjellësi Kërpicës	Burimi i Kërpicës	Gramsh Qytet	14413
NjA PISHAJ				
		Burimi i Kërpicës	Pishaj, çekin, Qerret, Shemriz, Trashovicë	2976
1	Ujësjellësi Kërpicës	Stacioni i popmpave Shemrizë	Balloll, Llallë	525



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

2	Ujësjetllësi Kotorr	Stacioni i popmpave Holtë	Kotorr, Gjorgjovin	683
3	Ujësjetllësi Gjorgjovinë	Stacioni i pompave Gjergjovinë	Cerujë, Drizë	1158
4	Ujësjetllësi Galigat	Burimi Proshovës	Galigat	479
5	Ujësjetllësi Storr	Burimi Duzha	Storr	263
	NËNTOTALI			6084
NJA KODOVJAT				
1	Ujësjetllësi Kodovjat	Burimi Bulcar	Kodovjat, Bersnik	936
2	Ujësjetllësi Kërpicës	Burimi Kërpicë	Mashan	622
3	Ujësjetllësi Zamash	Burimi Kërpicë	Zmash	162
	NËNTOTALI			1720
NJA TUNJË				
1	Ujësjetllësi Kërpicës	Stacioni i pompave Shemrizë	Lubinjë	517
	NËNTOTALI			517
NJA KUSHOVË				
		Burimi Kërpicë	Sotirë, Paktos, Kushovë, Bregas	709
1	Ujësjetllësi Kërpicës	Stacioni i pompave Bregas	Gjeraqinë	88
	NËNTOTALI			797
NJA LENIE				
1	Ujësjetllësi Taragjin	Burimi Komjanit	Taragjin	57
2	Ujësjetllësi Lenie	Burimi Komjanit	Qendër Lenie	120
	NËNTOTALI			177
NJA POROÇAN				
1	Ujësjetllësi Poroçan	Burimi Caricaj	Poroçan Qendër	438
	NËNTOTALI			438
NJA SKËNDERBEGAS				
1	Ujësjetllësi Skënderbegas	Burimi Shkozës	Skënderbegas, Nartë, Harunas, Zenelas, Shima	1277
2	Ujësjetllësi Vidhan	Burimi Beges	Vidhan	141
		Burimi Vashës	Siman	138
3	Ujësjetllësi Siman	Burimi Kroi i Bardhë	Kotkë	220
4	Ujësjetllësi Ermenjë	Burimi Shkuriqit	Ermenjë	216
5	Ujësjetllësi Menkollare	Burimi Sekës	Fushëz	119
6	Ujësjetllësi Bletës	Burimi Gurres	Bletës	147
	NËNTOTALI			2258
	TOTALI			26404

Burimi: Bashkia Gramsh, Punoi: MetroPOLIS, 2017

Për shkak të rreziqeve që mund të paraqiten për jetën e banorëve nga përdorimi i ujit të akuiferëve në rast ndotjeje, rekomandohet monitorimi i tyre me qëllim mbrojtjen e jetës së banorëve nga ndotjet e mundshme.



o Burimet e ndotjes të Akuiferëve të Gramshit brenda Bashkisë

Burimet e ndotjes së Akuiferëve që shtrihen në territorin e Bashkisë janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

Mungesa e zonave higjiëno-sanitare: SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjiëno-sanitare përreth pus-shpimeve, si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë si përreth pus-shpimeve legale ashtu edhe përreth pus-shpimeve të jashtëligjshme. Pus-shpimet e ligjshme janë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të popullsisë dhe nga industria. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët, duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm ose nëpërmjet pus-shpimeve. Mbi akuiferin me porozitet ndërkokrrizor ndodhet edhe venddepozitimi i mbetjeve kimikate në qytetin e Gramshit dhe aktivitetet e tjera, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre shumë afër tij, të tilla si Uzina për çmontimin e predhave dhe kapsollave në Çekin apo venddepozitimi i mbetjeve përgjatë lumit Devoll.

Ky shfrytëzim i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale, si dhe të pakontrolluar si nga popullsia ashtu edhe nga industria rrezikon i) uljen e prurjeve në stacione, si dhe ii) prishjen e cilësisë së ujërave të këtij akuiferi duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi⁹⁸. Mungesa e zonave higjiëno-sanitare bën të mundur që e gjithë ndotja përreth pus-shpimeve të kalojë drejtpërdrejt në akuifer.

Ndotja e Akuiferit ndërkokrrizor nëpërmjet lumit Devoll: Një burim ndotjeje për Akuiferin ndërkokrrizor të Gramshit mbetet lumi Devoll. Ky i fundit ndotet nga shumë burime të ndryshme, ndër të cilat edhe nga derdhja e ujërave të ndotur në të. Sipas studimeve të kryera, sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të qytetit të Gramshit është i kombinuar. Kjo do të thotë se ky sistem grumbullon së bashku ujërat e reshjeve atmosferike dhe ujërat e përdorura nga qendrat e banimit. Sistemi shtrihet në të gjithë qytetin dhe të gjitha ujërat e përdorura shkarkohen në mjediset pritëse (në Lumin Devoll dhe përrenjtë e tij) pa asnjë trajtim paraprak.

Edhe ujërat e ndotura të zonave rurale të Bashkisë së Gramshit përfundojnë në Lumin Devoll në të gjitha zonat ku e lejon relievi. Nga analizat në terren është vënë re se zonat rurale nuk mbulohen nga sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane. Zakonisht, shtëpitë e banimit kanë gropa septike në oborret e shtëpiave, të cilat nuk janë ndërtuar sipas standardeve tekniko-sanitare. Në rastet kur është e mundur, ujërat e ndotura largohen në kanale të hapura kulluese pranë shtëpive, edhe kjo në mospërputhje me ligjin për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit. Për fat të keq, nuk dihet se cilat nga këto kanale kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lumin Devoll, dhe se në cilat zona ujërat e ndotura të zonave rurale ndikojnë në ndotjen e ujërave të akuiferëve.

Deri më sot, në mungesë të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale, Devolli ka shërbyer si kolektor ujërash të ndotur urbane, të bardha dhe industriale. Për këtë arsye, ka shumë mundësi që Devolli të ketë ndotur edhe akuiferin e luginës së së tij.

Duke qenë se ujërat e lumit Devoll shërbejnë si burim për akuiferin e luginës së Devollit, dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit ndërkokrrizor të Gramsh me shtrirje përgjatë lumit Devoll është i lartë, derdhja e ujërave të ndotura në Devoll përbën element ndotjeje të Akuiferit. Rreziku i ndotjes së Akuiferit ndërkokrrizor të Gramshit me shtrirje përgjatë



lumit Devoll është i lartë si pasojë e *mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse*, sidomos prej *popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare* dhe si pasojë e *shkarkimeve urbane dhe industriale në zonën e Gramshit*⁹⁹. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe i ujërave sipërfaqësore si dhe mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Devoll nga ndotja, shkakton ndotjen e këtij akuiferi.

Mungesa e monitorimit të akuiferëve në Bashkinë e Gramshit në mënyrë që të pasqyrohet gjëndja aktuale e tyre dhe si rrjedhojë të merren masat e nevojshme dhe domosdoshme për përmirësimin e tyre.

Ndotja e akuiferëve nga shfrytëzimi i inerteve lumore të Devollit: Lumi Devoll është një burim i rëndësishëm që ushqen me ujë akuiferin e ndërkokrrizor të Gramshit. Si rrjedhojë, përqendrimi i cilësisë së ujit të lumit ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ujërave të akuiferit. Sipas SHGJSH-së,¹⁰⁰ shfrytëzimi i zhavorreve të lumenjve dëmton rëndë burimet ujore, si nga ana sasiore, ashtu edhe cilësore sepse zvogëlon zonën e ushqimit të akuiferëve dhe prish regjimin e ujërave nëntokësore në zonat e gjerrmimeve.

Për fat të keq, në vendin tonë lumenjtë janë shfrytëzuar në të gjitha mënyrat e mundshme. Semani është shfrytëzuar dhe vazhdon të shfrytëzohet vazhdimisht në mënyrë të ligjshme ose jo për materialin e tij inert në rrjedhën e mesme dhe të poshtme.

Deri më sot, është vetëm 1 aktivitet i regjistruara që ushtron veprimtarinë e tij përgjatë lumit Devoll vetëm në territorin e Bashkisë Gramsh në Çerkez, me pasoja për akuiferin dhe bashkinë (përmbetje të zonave përreth lumit duke çuar në humbje të tokave bujqësore si dhe ndotje të ujërave të akuiferit për shkak të prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjikë.

Tabela 21. Vendndodhja e aktivitetetve të liçencuara për shfrytëzimin e inerteve lumore

Nr.	Vendi	Emërtimi i aktivitetit	x	y
1	Çekrez	Larje inertesh	431515	4522292

Burimi: SHGJSH; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016

o Përfundime dhe rekomandime

Bashkia e Gramshit është e pasur me burime ujore sipërfaqësore e nëntokësore, të cilat kanë problematikën e tyre. Një faktor që vlen të studiohet për Devollin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga barrierat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Devollin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Këto HEC-e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MË deri mbi 50MË. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Devollit që depërtojnë deri në burimet e tij në Bashkinë e Korçës (Kamenicë, Sul, Miras, Qytezë, etj.). HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si barrierë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e inerteve të transportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen.

Akuiferët e Bashkisë Devoll, sidomos Akuiferi Karstik i Tomorrit, ka një rëndësi të veçantë për shkak se shërben si burim furnizimi me ujë për qytetin e Gramshit dhe komunat përreth. Si i tillë, duhet treguar kujdes për çdo mundësi të ndotjes së tij, ndotje të cilat mund të



shkaktohen nga njerëzit ose industria. Ndaj për akuiferë të këtij niveli rëndësie duhet të tregohet një kujdes i veçantë, veçanërisht për monitorimin e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm do të jepte një pasqyrë të qartë për mënyrën e shfrytëzimit dhe cilësisë së akuiferit.

Duke parë keqmanaxhimin e burimeve ujore në 20 vitet e fundit, dhe rrezikshmërinë që paraqet ndotja e burimeve ujore nëntokësore për shëndetin e popullsisë, rivlerësimi i ndërtimit të HEC-eve, dhënies së lejeve për karriera lumore, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të ndotura urbane dhe mbetjeve industriale) dhe nga burimet ujore nëntokësore apo rehabilitimin e tyre, duhet të kenë përparësi për Bashkinë. Në këto projekte, Gramshi duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me Bashkitë e tjera që preken nga lumi i Devollit me qëllim manaxhimin e integruar të tij.

4.4 Ajrit

Ndotja e ajrit mbetet problem serioz në Shqipëri për shkak të rritjes së theksuar të numrit të makinave, numrit të mjeteve të vjetra të transportit, rritjes së trafikut në zonat urbane dhe ritmeve të shpejta të urbanizimit¹⁰¹. Ky i fundit ka çuar në një zhvillim me ritme tejet të shpejta edhe të sektorit të ndërtimeve dhe përkeqësimit të kushteve të rrugëve brenda zonave urbane.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Gramshitt dhe Bashkinë Gramsh në përgjithësi mungojnë. Megjithatë, për arsyet e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Marrë si reference të dhënat nga Raporti i Gjendjes në Mjedis për Shqipërinë dhe veçanërisht RGJM - 2015 të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industrinë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O₂ me rëndësi në cilësinë e ajrit në qendrat urbane.

Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë¹⁰², ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjendje të gaztë nga gjethet e tyre. Krahas filtrimit të ajrit të ndotur, hapsirat e gjelbra shërbejnë dhe janë faktor në mbrojtjen e tokës dhe shëndetit publik.

○ Burimet e ndotjes së ajrit

Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria, etj.). Megjithatë, në Bashkinë Gramsh, ndotja nga makinat mbetet burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Gramsh.

Ndotja nga mjetet e transportit: Sipas RGJM-së në Bashkinë Gramsh, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e transportit të




cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO₂ përkatësisht)
- substancat sulfurike (SO_x),
- lënda e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM₁₀ dhe PM_{2.5}, kryesisht),
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve)
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC),

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth **5 ton CO₂ në vit** (4.7 metric tons)¹⁰³. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si më poshtë.

Figura 49. Sasia e CO₂ që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë




Burimi: US EPA, 2016; Përpunoi: Bashkia Gramsh/Metropolis, 2017

Sasia e ndotësve që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobus urban, kamion etj.), moshja dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet atmosferike (shi apo diell etj.), gjendja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës, etj.¹⁰⁴ Në rast ndryshimesh të këtyre kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

Rritja e numrit të makinave: Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë.¹⁰⁵




Figura 50. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016¹⁰⁶

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike. Nga statistikat e viteve 2005-2013,¹⁰⁷ ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Figura 51. Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vend



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016¹⁰⁸

Me rritjen e makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO₂, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO₂ në vit/makinë, sasia e CO₂ e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) **në nivel bashkie është rreth 14,700 ton CO₂/vit** (2,940 automjete x 5 ton CO₂/automjet në vit = 14,700 ton/CO₂/vit). Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni etj.) po shtohen.

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të Shtetit Shqiptar kanë shkuar në infrastrukturë rrugore¹⁰⁹.

Ndërkohë, transporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asociimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-




së¹¹⁰. Megjithatë, fondet për zhvillimin e transportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse: Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qëndror Teknik.

Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të naftës¹¹¹, benzinës dhe solar-mazutit.

Mostrat e analizuar për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin.

Figura 52. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuar



Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik); Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017
112

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur më poshtë:¹¹³

Tabela 22. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numër)
11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
Totali	122			31

Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik)¹¹⁴

Për naftën, nga 122 mostrat e analizuar, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuar, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 129% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.




Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në naftë është *10 ppm*. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezulton se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër.

Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendencë në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë squfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e sulfurit, në rastin e naftës, arrin kufinj më të lartë se sa në rastin e benzinës.

Figura 53. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)



Burimi: AKM (IQT¹¹⁵), ; Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017¹¹⁶


Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin¹¹⁷. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë squfuri (mbi 3%). Në bazë të standardit S SH UNI 6579, për analizimin e lëndës diegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në gazoil është < 3%. Mostrat e analizuar rezultojnë se përmbajtja e squfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lënda djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.¹¹⁸ Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Së Automjeteve, pergatitur nga ECAT¹¹⁹, në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet se 87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën dhe 13% benzinën.

Ndotja nga vjetërsia e mjeteve të transportit: Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura¹²⁰. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.¹²¹ Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës diegëse.



Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara para vitit 1986 dhe 27% e atyre pas vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pavarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koeficientin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është K 2.5¹²².

Figura 54. % Makinave që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër..



Burimi: ECAT 2008¹²³; Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por, në motorat e vjetër, përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorrave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.¹²⁴

Ndotje nga burime të tjera: vend-depozitimet e mbetjeve, industria etj.: Venddepozitimi i mbetjeve është një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjieno-sanitare për depozitim të mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka aromë të keqe dhe, në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

Spektori i bujqësisë: gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

o Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj. shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O₃, CO, CO₂, SO_x (SO₂), PM (PM₁₀ dhe PM_{2.5}), Pb, VOC dhe O₃. Më poshtë sillet një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasoja akumulative/grumbulluese).

Monoksidi i karbonit (CO)¹²⁵: Ekspozimi ndaj përqëndrimeve të larta të monoksidit të karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve, të përziera dhe të



vjella. Probleme kritike ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e dëmtimit të fetusit, të lindjes së foshnjës nën peshë dhe të dëmtimit të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshëme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna, të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngshme.

Dioksidi i karbonit (CO₂)¹²⁶: Dioksidi i Karbonit në formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjedis me përqëndrim të CO₂ ≥ 10% mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjeshë, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqëndrimi të lartë të CO₂ mund të demtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO₂, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë probleme me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtim të sistemit nervor qendror, kontraktim të muskujve, ngritje të tensionit të gjakut. Gjithashtu, ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, probleme me lëkurën, djegie të syve dhe zhurma në veshë.

SO₂¹²⁷: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO₂ në ajër mund të jetë i rrezikshëm për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve më të ulta të SO₂ mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mbliqen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe të njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO₂

PM (PM₁₀ dhe PM_{2.5})¹²⁸: Është vërtetuar shkencërisht se përqëndrimet e larta të grimcave në ajër (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet, që përdorin lëndë djegëse diezel, janë vërtetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.



Pb¹²⁹: Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve, sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pavarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike, si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera, edhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

VOC¹³⁰: Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe të sistemit nervor qendror. Ndësa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojë probleme në sy, acarim të rugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

O₃: Ekspozimi ndaj përqëndrimit të lartë të Ozonit (O₃) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O₃ mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike, si dhe mund të rritë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, të zvogëlojë sistemin imunitar, të përkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simptomat fillestare të ndikimit të O₃ në shëndet fillojnë me irritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt dhe në gjoks. Futja e O₃ në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku, si dhe lodhje dhe të vjella.

4.5. Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti


4.5.1. Pyjet dhe kullotat

Në vitin 2016, fondi pyjor dhe kullosor kaloi në pronësi të Bashkisë Gramsh, me përjashtim të sipërfaqes pyjore e kullosor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 “Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë”).

Sot, Bashkia Gramsh ka në pronësi të saj 54,840.34 ha sipërfaqe fond pyjor, struktura e të cilit përbëhet nga rreth 35,731 ha pyje, 10,095 kullotë dhe 9,012 ha sipërfaqë djerr, inproduktive, ujore dhe bimë pyjore. Gjithashtu në territorin e Bashkisë rezultojnë të ketë një sipërfaqe prej 1,278 ha zona të mbrojtura, të cilat shtojnë sipërfaqen e pyjeve në territory, por që nuk i përkasin fondit pyjor dhe mbeten në pronësi të qeverisjes qëndrore.¹³¹



Figura 55. Struktura e fondit pyjor e kullësor, Bashkia Gramsh (ha)



Burimi: Bashkia Gramsh; Përgatiti: MetroPOLIS, 2017

Sipas të dhënave për shpërndarjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore në territorin e NjA-ve të Bashkisë Gramsh, dallohet qartë që NjA-ja me sipërfaqe më të madhe të fondit pyjor është Pishaj e cila ka sipërfaqen prej 9,693.4 ha, ndjekur nga NjA-të Kodovjat me 7,621.7ha, Kukur me 7,331 ha dhe Skënderbegas me 6,057 ha. Ndërsa NjA-të e tjera kanë sipërfaqe më të vogla të fondit pyjor. NjA-të të cilat kanë sipërfaqe më të madhe të kullotave përmendim NjA-në Poroçan me sipërfaqe kullësore 1,784 dhe Kukur me 902 ha. Ndërsa NjA-të me sipërfaqe më të vogël të fondit kullësor përmendim NjA-në Lenje, Tunjë dhe Skënderbegas. Duke analizuar me kujdes të dhënat vihet re që zona inproduktive me sipërfaqen më të madhe ndodhet në NjA-të Kukur dhe Skënderbegas, përkatësisht 1,295 ha dhe 1,134 ha. NjA-ja Skënderbegas ka edhe zona pyjore me status të mbrojtur me ligji (zona të mbrojtura) të cilat aktualisht menaxhohen nga AdZM Elbasan dhe Berat.

Tabela 23. Përdorimi i tokës sipas zonave, Bashkia Gramsh

Nr.	NJA	Kategoria	Sip. ha	Sip. Totale ha
1	Pishaj	djerrë	325.7	9,693.4
		inproduktive	85	
		kullotë	453.7	
		bujqësore	2,814.3	
		ujore	1.9	
		pyll	6,012.8	
2	Sult	djerrë	4,92.55	5,987.55
		inproduktive	174.2	
		kullotë	227.4	
		bujqësore	1,551.6	
		ujore	2.1	
		pyll	3,539.7	
3	Tunjë	djerrë	359.67	5,072.08
		inproduktive	407.12	
		kullotë	19.54	
		bujqësore	1,562.5	
		ujore	2.26	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

		pyll	2,720.99	
4	Skënderbegas	djerrë	70.74	6,057.9
		inproduktive	1,134.22	
		kullotë		
		bujqësore	1,760.99	
		ujore	1.64	
		pyll	3,090.31	
5	Lenie	djerrë		2,403.5
		inproduktive	663.4	
		kullotë	430	
		bujqësore	70.3	
		ujore		
		pyll	1,239.8	
6	Kodovjat	djerrë	318.06	7,621.7
		inproduktive	889.31	
		kullotë	868.89	
		bujqësore	1,946.24	
		ujore	15.01	
		pyll	3,584.19	
7	Kukur	djerrë	422.84	7,331.22
		inproduktive	1295.96	
		kullotë	902.62	
		bujqësore	1739.87	
		ujore		
		pyll	2969.93	
8	Poroçan	djerrë	459.28	5,589.57
		inproduktive	116.28	
		kullotë	1784.26	
		bujqësore	1279.44	
		ujore		
		pyll	1950.31	
9	Kushovë	djerrë	148.33	5,265.18
		inproduktive	602.69	
		kullotë	66.29	
		bujqësore	1395.44	
		ujore	0.29	
		pyll	3052.14	
Bashkia Gramsh sipërfaqe totale F. Pyjor			55,022.1	

Burimi: Bashkia Gramsh; Përgatiti: MetroPOLIS, 2017

Fondi pyjor në territoin e bashkisë Gramsh përbëhet nga specie të shumta drusor dhe shkurresh, ndër më të prashishmet përmendim Pishën e egër dhe detit (Pinus), Akacia,




Ahu, Makja, Shkoza, etj. Në vijim analizohet sipërfaqet dhe llojet e specieve drusorë për çdo NjA në territorin e bashkisë:

- **NjA Pishaj:** Fondi pyjor në këtë NjA përfaqësohet nga rreth 882 ha trungishte dhe 531 ha shkurre. Sipërfaqja e trungishtave përbëhet nga 481 ha pishë e egër dhe pishë deti, 8 ha akacie, 420 ha ahishte, shpardh dhe panjë, 1 ha arrë dhe rreth 34 ha qarri dhe shkozë. Ndërsa shkurretet përfaqsohen nga shkoza, dëllënja, mareja, ilqe, qarr, frash dhe dell¹³².
- **NjA Poroçan:** Në zonën e Poroçanit ndodhen rreth 1078 ha trungishte dhe 872 ha shkurre. Trungishtet përbëhen nga rreth 334 ha pyllë ah, 43 ha gështenjë, 13 ha pylla akacie, 551 Qarr dhe 136 ha poyllë më pisha. Ndërsa shkurret përfaqësohen nga Dëllënja, Shkoza, Lisi, Frashëri dhe Murrizi¹³³.
- **NjA Kukur:** Speciet floristike lehtësisht të identifikueshme në zonën e kukurit shkurret dhe trungishtet, ku përkatësisht formojnë një sipërfaqe prej 2113 ha shkurre dhe rreth 857 ha cungishte dhe trungishte¹³⁴. Shkurret përfaqsohen nga Shkoza, ndërsa cungishtet dhe trungishtet nga Pisha e egër, Pisha e zezë, Ahu dhe Akacia.
- **NjA Skënderbegas:** Në Skënderbegas ndër të tjera gjendet 1591 ha trungisht dhe 1310 shkurre. Trungishtet përfaqësohen nga Pisha e zezë e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 1339 ha, ndërsa shkurretat përfaqësohen nga makja, shkoza dhe lajthia¹³⁵.
- **NjA Kushovë:** Në zonën e Kushovës gjenden sipërfaqe të konsiderueshme më pyje, shkurre dhe bimë barishtore. Trungishtet zënë 671 hektarën, ndërsa shkurret 2830 ha¹³⁶. Trungishtet përfaqësohen nga pisha e zezë dhe shpardi, ndërsa shkurret nga makie dhe shkozë. Problemet kryesore në këtë zonë shkaktohen nga prerja e jashligjshme e pyjeve dhe mbi kullotja.
- **NjA Tunjë:** Në territorin administrativ të tunjës ndodhet 402 ha trungishte e cungishte dhe 2318 ha shkurre¹³⁷. Shkurret në Tunjë përfaqësohen nga Shkoz, Marea, Dëllënja dhe Cermedelli, ndërsa pyjet përfaqësohen nga pisha e egër, lisi, akacia dhe Arra.
- **NjA Sult:** Trungishtet dhe cungishtet zënë rreth 555 ha, të përfaqësuara nga pisha e Egër, Lisi dhe Akacia. Shkurrët zënë rreth 2984 ha, të cilat përfaqësohen nga Mare, Mrete, Dëllënja dhe Shkoza¹³⁸. Në këtë zonë ka edhe shumë specie barishtore dhe të kultivuara të cilat kanë kontribut të rëndësishëm në rritjen e diversitetit floristik të zonës.
- **NjA Kodovjat:** Trungishte dhe cungishte zënë 725¹³⁹ ha, të përfaqësuara nga Pisha e zezë, pisha e egër, Shpardi dhe Qarri. Ndërsa shkurret zënë një sipërfaqë prej 2859 ha, e cila përfaqësohet nga Shkoza, Dëllënja, Mareja, Frashëri, etj. .



Figura 56. Harta e fondit pyjor 1984 dhe 2015



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Gramsh; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

o Problematikat kryesore të fondit pyjor

Mungesa e inventarizimit periodik i fondit pyjor e kullosor: të dhënat rreth sipërfaqeve pyjore e kullosore në vendin tonë dhe në Bashkinë Gramsh bazohen në inventarin e fundit të këtij fondi i cili i përket viteve 1984-1985. Që nga regjistrimi i fundit, nuk ka patur përpjekje të reja për një inventar të përditësuar edhe pse me ligj parashikohet inventarizimi çdo dhjetëvjeçar. Si rrjedhojë, në vendin tonë dhe në Bashkinë Gramsh, të dhënat e inventarëve shpesh janë kontradiktore.

Humbja e sipërfaqes pyjore: Një ndër problematikat kryesore të pyjeve në Bashki është humbja e sipërfaqes pyjore në dy dhjetëvjeçarët e fundit me rreth 10,000 ha.

Prerja e pyjeve: Në territorin e Bashkisë janë vërejtur prerje të vazhdueshme të pyjeve për lëndë djegëse dhe për tregëtim të lëndës drusore. Aktualisht, prerja e pyjeve është e ndaluar (Moratoriumi 10 vjeçar i pyjeve), ndaj zbatimi i moratoriumit është jetik për mbarështimin e pyjeve.

Djegia e pyjeve: Ashtu si në të gjithë vendin, edhe në Bashkinë Gramsh janë vënë re raste të djegies së pyjeve. Duke qënë një terren i thyer, kontrolli dhe ndërhyrja në raste zjarri është jetik i vështirë.

Tjetërsimi i sipërfaqeve të fondit pyjor: Tjetërsimi i fondit pyjor në kullotë është një fenomen i cili praktikohet gjërësisht në vend, në rastet më të shumta ndodh fenomeni i zjarr-vënies e më pas, kthimi në kullotë për bagëtinë.




4.5.2 Peizazhi

Peizazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe dejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon atë estetik. Në territorin e Bashkisë Gramsh peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: *urbane, industriale, rurale, natyrore* dhe *ujore*.

Krijimi i fashave peizazhistike në territorin e Bashkisë lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet *fasha natyrore*, e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu, shumë e dallueshme në territor është *fasha rurale*, e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë “informale”, grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rrjesht, të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (Liqene, lumenj, kanale, rezervuare, etj.)

Figura 57. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017.

Tipologji tjetër peizazh-krijuese në Bashkinë Gramsh është *fasha urbane* ku peizazhi shpalolet në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter *formal*. Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zburuese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial shfaqet i pandashëm nga fasha urbane, specifikisht në NjA-në Gramsh dhe Pishaj. Ky peizazh ka po ashtu karakter “*formal*”, ndonëse bimësia është më e rallë.



Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e *sipërfaqeve ujore*, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumi Devoll dhe degët e tij, liqeni i Banjës dhe gjithë liqenet dhe rezervuarët e shpërndar në gjithë territorin e bashkisë.

Ndonëse pjesë kryesore dhe e pandashme e peizazhit urban, *rrugët* ashtu si edhe sipërfaqet ujore, shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar “çarje” të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojnë edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën e peizazhit, rrugët shfaqen si “kanale” lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra, në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike, ato karakterizohen vetëm nëpërmjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

Elementet përbërëse të peizazhit

Elementët e peizazhit natyror: Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Gramsh, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh, si *zonat ripariane, korridoret, kopshtet ujëmbajtëse* etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat *ripariane*, të cilat natyrshëm shtrihen përgjatë trupave ujore si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare parandalojnë erozionin ujor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë këtë mjedis, krijojnë mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për mbarështimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepricë), që rezultojnë nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në tokë bujqësore.

Figura 58. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë



Burimi: Google Imagery, 2017



Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës¹⁴⁰ marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke lidhur parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe vendkalime për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë barrierë natyrore për erën. Në territorin e Bashkisë Gramsh rripat e gjelbër, parcelat e lidhura dhe ato të ndara mbizotërojnë në peizazhin natyror. Ato ndahen në dy kategori; natyrore dhe ato të mbjella nga fermerët me bimë si robinja (*Robinia Pseudoacacia*), rrapit (*Platanus*), shëlgë (*Salix*) dhe plepi i bardhë (*Populus Alba*), të cilët në pjesën më të madhe shtrihen përgjatë tokave bujqësore si elemente ndarës pronësie por edhe si pasojë e kushteve të krijuara për rritjen dhe zhvillimin natyror të këtyre bimëve në këto rripa të gjelbër dhe koridore.

Figura 59. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës



Burimi: Google Imagery, 2017

Korridorët, krahas rëndësisë peizazhistike që mbartin, karakterizohen nga shërbime të shumta ekologjike në përgjithësi të përherëshme i strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimit për jetën e egër, por edhe ato të përkohëshme si vendkalimet dhe ushqimi sezonal, ndërsa korridoret lidhës të cilët janë në shkallë më të vogël ofrojnë shërbime ekologjike të përkohëshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën. Korridoret (të mëdhenj dhe të vegjël, lidhës) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastre.

Elementët e Peizazhit Urban dhe Industrial: karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Elementet urbane dhe industriale të forta/mbizotëruese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruara ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë.

Elementët e peizazhit ujqor në tërësi dhe në veçanti ai liqenor shfaqet i “qëndëruar” mes peizazhit urban dhe atij natyror. Bimësia “ripariane” mungon dhe t’kurret dukshëm kur trupi ujqor ndodhet fashën rurale, ndërkohë gjatë fashës natyrore sërisht humb një pjesë të vogël të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujqor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.



Rreziku ndaj elementëve peizazhistik

Peizazhi në territorin e Bashkisë Gramsh paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku mbizotëron aktiviteti njerëzor. Problematikat kryesore që has peizazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëzimin e peizazhit natyror, dhe mos-futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për t'u theksuar prania e problemeve me peizazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historike, të cilët së bashku do të krijojnë një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh, praktikatat e mira të peizazhit nuk ndiqen, apo përcaktohen si dytësore. Këto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh në formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet më të shpeshta, duke ndjekur konturet e infrastrukturës. Kjo është një mënyrë sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit apo përdorimit të elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë.

Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë përbërësit e tij (planifikimi, arkitektonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimësia lokale, e deri tek përbërësit më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë stinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të ndërthuren me njera-tjetrën për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional. Ndër rreziqet kryesore ndaj elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë Gramsh përmendim:

- *Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore* në tërësi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujorë ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujërave rrjedhëse, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumi Devoll e shfaq dukshëm këtë fenomen. Bimësia lokale në to karakterizohet me bimësi si robinja (*Robinia Pseudoacacia*), rrapi (*Platanus*), shelgu (*Salix*), plepi i bardhë (*Populus Alba*) dhe shkurrja autoktone. Në sipërfaqet ku ka mbijetuar zona ripariane, shtresat përbërëse të saj si ajo e sipërme, e mesme dhe e mbulimit të tendës, rrallë gjenden të pandikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbje të shtresës së mbulimit të terrenit në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqësore dhe herë të shtresës së mesme të tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë, nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e, nga ana tjetër, erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmbytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi tokë.
- *Përbërësit peizazh-formues* si ai **urban, industrial, rural, natyror** dhe **ujor** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit. Por, problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre. Në këtë kontekst vërehet një



mospërputhje e elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë, duke mos u përdorur elementët peizazhistik në funksion të përmirësimit të tij.

- *Fragmentimi i zonave natyrore* ka cënuar peizazhin natyror, duke e cunuar dhe ndaluar vijshmërinë natyrore. Kjo shfaq probleme krahas fragmentimit të habitateve dhe fragmentit pamor.
- *Zonat e ndotura (hotspot)* të cilat janë të pranishme në territorin e bashkisë luajnë një rol të rëndësishëm në përkeqësimin e cilësisë peizazhistike të territorit.

Përfundime dhe rekomandime

Territori i Bashkisë Gramsh rezulton të ketë një larmshmëri peizazhistike, natyrore, ubrane, rurale, ujore, etj., duke u përkthyer kjo në një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit. Larmshmëria e peizazhit është kushtëzuar nga territori dhe përdorimi i tokës. Kryesisht në pjesën e NjA-ve dy skajet e bashkisë mbizotëron peizazhi natyror, ndërsa në pjesë qendrore të Bashkisë Gramsh mbizotëron peizazhi me tipologji rurale e bujqësore. Qendra e territorit, gjithashtu është i përqëndruar tipologjia urbane dhe industriale e peizazhit.

Në territorin e bashkisë mbetet problematik fragmentimi i peizazhit natyror, i cili është dëmtuar nga zhvillimi urban, industrial e kryesisht ai bujqësor. Zonat e ndotura, kryesisht nga mbetjet urbane dhe shkarkimi i ujrave të ndotura, apo dhe zonat industriale, ndikojnë në përkeqësimin e peizazhit dhe natyrës. Ndërthurja e tipologjive të ndryshme të peizazhit në territor haset me vështirësi të mëdha, pasi gjatë zhvillimeve të ndryshme në territor nuk janë marrë parasysh elementët peizazhistikë dhe rëndësia e tyre. Kjo vazhdon të jetë një pengesë për përmirësimin e peizazhit.

Me qëllim përmirësimin e peizazhit dhe ndërthurjen e tipologjive të tij, duke përmirësuar aspektin pamor dhe ruajtur funksionalitetin, nevojitet të merren masa të cilat lidhen me:

- futjen e përbërësve natyrorë në brëndësi të zonave urbane dhe industriale,
- mbjelljen e pemëve të larta për të fshehur objektet industriale të padëshirueshme nga pikpamja vizuale/pamore,
- ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjithave tipologjive të peizazhit në territorin e Bashkisë,
- krijimin e zonave ripariane dhe korridoreve përgjatë tokave bujqësore dhe
- gjatë hartimit dhe zbatimit të planeve sektoriale, rekomandohet futja e elementit peizazhistik.

○ **Biodiversiteti në Shqipëri**

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitet”, me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë¹⁴¹. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike¹⁴², duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikpamja e biodiversitetit dhe larmshmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e



deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit, të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km.¹⁴³ Zona veriore e vendit ka një reliev malor, i cilikarakterizohet nga diversiteti i formacioneve shkëmborë që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.¹⁴⁴

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth **7,233 taksonë bimore**¹⁴⁵ (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe **5,438 lloje kafshësh**¹⁴⁶ (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.¹⁴⁷ Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratore. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.¹⁴⁸ Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratore dhe insektet.¹⁴⁹

o Speciet e rrezikuara në Shqipëri

Në territorin e vendit gjenden rreth *91 lloje të kërcënuara speciesth në nivel global*. Në këtë listë përfshihen Pelikani kaçurrel (*Crispus crispus*), Breshka Shqiptare e Ujit (*Pelophylax shqipericus*) dhe Blini (*Acipenser sturio*), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.¹⁵⁰ Sipas IUCN-it,¹⁵¹ 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuar.


Tabela 24. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX – Të zhdukura	0	5
CR – Të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN –Të rrezikuara	123	56
VU – Të pambrojtura	120	154
LR – Rrezik i ulët	59	238
DD – Mungojnë të dhëna	30	72
NE – Të pavlerësuar	3	7

Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016¹⁵²; Përgatitip: Co-PLAN, 2016



Figura 60. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016¹⁵³; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Lista e Kuqe e faunës dhe florës së egër është miratuar në dhjetor 2013, me Urdhër të Ministrit Nr. 1280, datë 20.11.2013. Llojet e mbrojtura të florës janë 402 nga 361 që ishin në Listën e Kuqe paraprake të vitit 2007. Llojet e mbrojtura të faunës janë 575, i njëjti numër me listën e vitit 2007.

o Biodiversiteti në Bashkinë Gramsh

Bashkia Gramsh bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare kodrinore, nënzona jug-perëndimore që shtrihet deri në 800-1000 mnd dhe në atë mesdhetare malore, nënzona juglindore, pjesa që arrinë lartësinë 2,373 mnd. Territori i Bashkisë është i larmishëm, me terren fushor, kodrinor e malor dhe me lumenj e përrenj të shumtë. Gramshi përshkohet nga rrjedha e lumit Devoll dhe degët e tij. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja gjeografike e kësaj nënzona ndikojnë në regjimin e elementëve klimatike dhe në biodiversitetin e pasur të zonës.

Bashkia Gramsh ka një sipërfaqë natyrore rreth 5,909.6 ha. Në bashki gjenden edhe shumë monumente natyrore (20 Monumente Natyre ku 11 Gjeo Monument dhe 9 Bio Monumente), si dhe zona të mbrojtura si Parku Kombëtar i Tomorrit (zonat e mbrojtura janë trajtuar në një seksion më vete). Në territorin e Gramshit dhe rrethinat, haset një numër i konsiderueshëm i llojeve të kafshëve dhe shpendëve, kryesisht gjitarët e medhenj dhe familja e rosave dhe thëllëza edhe pse numri total i specieve floristike dhe faunistike në bashki nuk njihet. Gjithashtu, territori i bashkisë shquhet për pasuri floristike, kryesisht në drurë të lartë, shkurre dhe bimë të kultivuara. Në brendësi të territorit hasen një sërë llojesh, duke filluar nga shkurret shqopa, shkoza, dhe deri tek dushqet, ahishtat, dhe kullotat alpine.

Numri i specieve floristike dhe faunistike, që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre, nuk njihet mirë. Megjithatë, njihet numri i specieve të rrezikuara (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 100 specie (rreth 15% e specieve të rrezikuara në vend). Këto i përkasin kryesisht specieve të florës, insekteve dhe shpendëve.



Tabela 25. Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Gramsh

Flora dhe Fauna e Rrezikuar në Shqipëri dhe Bashkinë Gramsh ¹⁵⁴				
Kategoritë Taksonomike	Nr. Total i Specieeve në vend	Nr. Specieeve të rrezikuara në vend	Nr. Specieeve të Rrezikuara në B. Gramsh	% Specieeve të Rrezikuara në B. Gramsh
Kërpudha	800	16	2	12
Bimësi	3,228	363	42	11
Insekte	680	108	15	14
Zvarranikë	37	37	4	11
Shpendë	330	120	31	29
Gjitarë	91	46	6	13
Totali	5,166	690	100	14.5

Burimi: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqipëtare; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

o Fauna në Bashkinë Gramsh

Territori i Bashkisë Gramsh karakterizohet nga një faunë e pasur ujore dhe kafshë e shpendë të ndryshme. Ndër vite, në territorin e bashkisë është ushtruar presion i vazhdueshëm mbi faunën, kryesisht në formën e gjuetisë së pa kontrolluar dhe dëmtimit të habitatit nga aktivitetet e ndryshme njerëzore, si rrjedhojë është ulur ndjeshëm numri i specieve faunistike dhe disa prej tyre rezultojnë të rrezikuara.

Nuk ka një numër të saktë mbi speciet që mund të gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh. Nga të dhëna të siguruar nga studime pjesore, vëzhgime në terren, diskutime me banorët e zonës dhe specialistët pranë zyrave të Bashkisë mund të thuhet se në brendësi të territorit ka një numër të lartë specimesh faunistrike.

Ne territorin e Gramshit janë të pranishëm rreth 23 lloje gjitarësh të vegjël dhe lakuriqë nate, 11 lloje mishëngrënësish, ndër të cilët përmendet Ariu i murrmë, Ujku, Çakalli, Macia e egër, Baldosa, etj. Rreth 63 lloje shpendësh strehohen kryesisht në zonat pyjore dhe shkurreta, 48 lloje të tjerë ndodhen në habitatin që ofrojnë kullotat alpine dhe zonat e hapura. Në sipërfaqet shkëmbore strehohen rreth 14 lloje shpendësh kryesisht rrëmbenjës, ndërsa pranë zonave të banuara vërehet prania e 7 lloje shpendësh. Disa nga shpendët tipikë të cilët gjenden në zonë janë: Thëllëza e malit, Thëllëza e fushës, Shkurta, Shapka, Turtulli, Lauresha, Mëllenja, Cërloi, Harabeli i shtëpisë, etj.¹⁵⁵

Në rrjedhat ujore në territorin e bashkisë janë identifikuar 10 lloje peshqish¹⁵⁶ dhe një llojë ngjale e cila nuk është hasur më pas ndërtimit të digës së hidrocentralit të Bënjës. Gjithashtu përgjatë gjithë Lumit Devoll dhe degëve kryesore të tij është e pranishme Lundërza, ndërsa gjendja e makrozoobentik (kryesisht larva insektesh ujore) ndryshon në të cilësisë së ujit të lumit.¹⁵⁷

Zonat ripariane të lumit Devoll (kryesisht ato të pa dëmtuara) strehojnë rreth 24 llojë insektesh, 6 prej të cilëve janë më status mbrojtës, specie të rrezikuara cilësohen *Flutura e hershme*, *Fshikendësja filodesmë*, *Antenagjati cerdo*, *Osmoderme eremitë* dhe *Rosalia*.



Gjithashtu, territori i Gramshit strehon një numër të konsiderueshmë reptilësh, dy prej të cilëve janë të rrezikuar sipas Librit të Kuq të Faunës Shqiptare, këto specie janë Bullari (*Ophisarurus apodus*) dhe Bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*).

Nga takimet e shpeshta me banorë të zonës dhe specialistë pranë Bashkisë theksohet që fauna ka pësuar ulje të numrit të specieve në territorin e bashkisë, pasi disa lloje nuk janë vëzhguar prej disa vitesh, ndër të tjera përmbenden Rriqebulli (*Linx linx*) dhe Ujku i bardhë, ky i fundit mendohet se është parë një individ kohet e fundit në NJA-në Tunjë, pranë zonës së quajtur “Varri i Djalit”

Shkaqet kryesore, që rrezikojnë zhdukjen e specieve të faunës në territorin e Bashkisë Gramsh, janë tregëtimi i specieve të ndryshme, koleksionimi i disa lloje speciesh, kryesisht fluturave, prishja e habitatit, ndotja e habitatit, zhvillimi i bujqësisë dhe përdorimi i plehrave dhe kimikateve në masë të madhe, zhvillimi i turizmit, shqetësimi i habitatit, zgjerimi i zonave urbane, gjuetia e paligjshme, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendit të folezimit, trafikimi i specieve të rralla, fragmentimi i habitateve, degradimi i pyjeve etj. Në vijim, shkaqet do të trajtohen më gjerësisht duke i analizuar specifikisht.

o Flora në Bashkinë Gramsh

Territori i Bashkisë Gramsh dhe zonat përreth shquhen për larmishmëri floristike. Teritori i bashkisë shquhet për pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen trupat ujorë, kodrat dhe malet e larta, shkurretat mesdhetare, pyjet gjethe gjerë dhe halorë, kullotat dhe shumë bimë të tjera barishtore. Në zonën e Gramshit numërohen rreth 9 monumente natyrore dhe një pjesë e parkut Kombëtar të Tomorrit, këto elementë përforcojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurive natyrore në territorin e bashkisë. Në brendësi të territorit të bashkisë (sipas Librit të Kuq të Florës Shqiptare) gjenden rreth 44 specie të rrezikuara, kryesisht bime barishtore dhe me pak shkurre dhe pemë. Ndër të tjera specie të rrezikuara përmendim Tisi (*Taxus bacata*), Zonja e bukur (*Atropa bella-donna*), Lot zoje (*Convallaria majalis*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Arra (*Juglans regia*), Dëllënja e zezë (*Juniperus communis*), Ilqe (*Quercus ilex*), etj. Ndarja e bimësisë dhe gjendja e florës në territorin e bashkisë do të analizohet sipas NjA-ve në vijim:

NjA Pishaj: Bimësia përfaqësohet nga rreth 882 ha trungishte dhe 531 ha shkurre. Sipërfaqja e trungishtave përbëhet nga 481 ha pishë e egër dhe pishë deti, 8 ha akacie, 420 ha ahishte, shpardh dhe panjë, 1 ha arrë dhe rreth 34 ha qarri dhe shkozë. Ndërsa shkurretet përfaqësohen nga shkoza, dëllënja, mareja, ilqe, qarr, frash dhe dell¹⁵⁸. Gjithashtu në zonë janë të pranishme një sërë bimësh barishtore dhe bimë të kultivuara, të cilat pasurojnë edhe më tepër diversitetin floristik të zonës. Gjendja e pyjeve dhe shkurreve në këtë zonë paraqitet në gjendje relativisht të mirë, duke theksuar që vitet e fundit sipërfaqet kanë njohur zvogëlimë të konsiderueshme.

NjA Poroçan: Krahas të tjerave, në zonën e Poroçanit ndodhen rreth 1078 ha trungishte dhe 872 ha shkurre. Trungishtet përbëhen nga rreth 334 ha pyllë ahu, 43 ha gështenjë, 13 ha pylla akacie, 551 Qarr dhe 136 ha poyllë më pisha. Ndërsa shkurret përfaqësohen nga Dëllënja, Shkoza, Lisi, Frashëri dhe Murrizi¹⁵⁹. Krahas specieve të përmendura, në Poroçan ka një numër të lartë të bimëve barishtore dhe atyre të kultivuara, të cilat shtojnë larmishmërinë floristike të zonës. Problematike në këtë zonë mbetet dëmtimi i pyjeve dhe bimëve si pasojë e prerjeve dhe kullotjes.



NJA Kukur: Speciet floristike lehtësisht të identifikueshme në zonën e kukurit shkurret dhe trungishtet, ku përkatësisht formojnë një sipërfaqe prej 2113 ha shkurre dhe rreth 857 ha cungishte dhe trungishte¹⁶⁰. Shkurret përfaqsohen nga Shkoza, ndërsa cungishtet dhe trungishtet nga Pisha e egër, Pisha e zezë, Ahu dhe Akacia. Në këtë zonë gjenden dhe shumë bimë të tjera barishtore dhe të kultivuara, të cilat kanë një kontribut të rëndësishëm në diversitetin floristik të zonës. Ndër problematikat kryesore në këtë zonë paraqitet mbikullotja dhe prerja e pyjeve.

NJA Skënderbegas: Në zonën e Skënderbegasit dallohen lehtë speciet floristike, kryesit të shkurreve dhe drurëve, pa lënë mbas dhe speciet barishtore dhe të kultivuara. Në Skënderbegas ndër të tjera gjendet 1591 ha trungisht dhe 1310 shkurre. Trungishtet përfaqësohen nga Pisha e zezë e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 1339 ha, ndërsa shkurretat përfaqësohen nga makja, shkoza dhe lajthia¹⁶¹. Në këtë zonë ka një numër të lartë specimesh barishtore dhe të kultivuara, të cilat pasurojnë më tepër diversitetin floristik të zonës.

NJA Lenie: Në zonën e Lenies ka një sipërfaqe të konsiderueshme natyrore, e cila dominohet nga pyje dhe shkurre e ndjekur nga bimësi barishtore dhe ajo e kultivuar. Ndër speciet më tipike të zonës veçojme pishën e egër dhe atë të zezë, Lisin, Dëllënjën, Shkozën, Frashërin, Mareja, Shkoza, etj¹⁶². Në këtë zonë ka një tendecë të dëmtimit të sipërfaqeve pyjore dhe dëmtimin e pyjeve dhe shkurretave e cila vjen nga prerjet abuzive dhe mbikullotja.

NJA Kushovë: Në zonën e Kushovës gjenden sipërfaqe të konsiderueshme më pyje, shkurre dhe bimë barishtore. Trungishtet zënë 671 hektarën, ndërsa shkurret 2830 ha¹⁶³. Trungishtet përfaqësohen nga pisha e zezë dhe shpardihi, ndërsa shkurret nga makie dhe shkozë. Problemet kryesore në këtë zonë shkaktohen nga prerja e jashligjshme e pyjeve dhe mbi kullotja.

NJA Tunjë: Në Tunjë ka larmishmëri të lartë të specieve floristike, ku haset një numër i madh i specieve pyjore, shkurre dhe barishtore e ato të kultivuara. Në territorin administrativ të tunjës ndodhet 402 ha trungishte e cungishte dhe 2318 ha shkurre¹⁶⁴. Shkurret në Tunjë përfaqësohen nga Shkoz, Marea, Dëllënja dhe Cermedelli, ndërsa pyjet përfaqësohen nga pisha e egër, lisi, akacia dhe Arra. Kohët e fundit ka një dëmtim të ndjeshëm të sipërfaqeve pyjore dhe bimeve të tjera, kjo si pasojë e mbi shfrytëzimit dhe mbi kullotjes.

NJA Sulti: Sulti ka një sipërfaqe të konsiderueshme natyrore, ku pjesa dominuese është e mbuluar nga pyje dhe shkurre. Trungishtet dhe cungishtet zënë rreth 555 ha, të përfaqësuara nga pisha e Egër, Lisi dhe Akacia. Shkurrët zënë rreth 2984 ha, të cilat përfaqësohen nga Mare, Mrete, Dëllënja dhe Shkoza¹⁶⁵. Në këtë zonë ka edhe shumë specie barishtore dhe të kultivuara të cilat kanë kontribut të rëndësishëm në rritjen e diversitetit floristik të zonës. Kohët e fundit ka pasur jo pak probleme në këtë zonë, kryesisht prerje të paligjshme të pyjeve dhe mbikullotje.

NJA Kodovjat: Në këtë zonë ka një sipërfaqe të konsiderueshme më pyje dhe shkurre, të pasuara me bimësi të ulët dhe barishtore. Trungishte dhe cungishte zënë 725¹⁶⁶ ha, të përfaqësuara nga Pisha e zezë, pisha e egër, Shpardihi dhe Qarri. Ndërsa shkurret zënë një sipërfaqe prej 2859 ha, e cila përfaqësohet nga Shkoza, Dëllënja, Mareja, Frashëri, etj.



Kohet e fundit është venë re një ulje e sipërfaqeve pyjore dhe shkurretave, e cila mendohet që rrjedh si pasoje e prerjeve të paligjshme dhe mbikullotjen.

Sipas Librit të Kuq të Florës së Shqipërisë, në territorin e bashkisë gjenden 44 lloje të rezikuara floristike, ku pjesa më e madhe e tyre u përkasin llojeve barishtore, të ndjekura nga shkurre dhe më llojet e pemëve. Ndër speciet e rezikuara që takohen në territorin e Gramshit, ndër të tjera janë: Çaji i malit (*Sideritis raeseri*), Rigoni i rëndomtë (*Origanum vulgare*), Foje (*Juniperus excelsa*), Lepushtera (*Caltha palustris*), Asteri shqiptar (*Aster albanicus*), Vidhi malit (*Ulmus glabra*), Ilqe (*Quercus ilex*), Arne (*Pinus peuce*), Dëllënja e zezë (*Juniperus communis*), etj.

o Problematikat kryesore të biodiversitetit në Bashki:

Gjendja e florës dhe faunës në zonën e Gramshit paraqet problematika të ndryshme, kryesisht për shkak të zhvillimit të aktivitetit njerëzor në territorin e Bashkisë. Ndërhyrjet kryesor dhe ato të cilat kanë ndikim më të theksuar në biodiversitetin e zonës janë të renditura në vijim:

- Zhvillimi industrial dhe pasojat e ish-aktiviteteve industriale, kanë qënë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe ujit. Aktualisht, gjendja paraqitet më e stabilizuar, pasi industrinë në territorin e bashkisë kanë ulur ndjeshëm kapacitetin e tyre prodhues.
- Urbanizimi: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje, duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore, kryesisht përreth qytetit të Gramshit.
- Fragmentimi i habitateve nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjedhojë e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore, pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit. Kjo vihet re edhe nga një analizë e thjeshtë e përdorimit të tokës në Territorin e Bashkisë. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme.
- Gjuetia e paligjshmeka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- HEC-et: Prodhimi i energjisë në territorin e Gramshit nga HEC-et ka një ndikim jo të vogël në ndryshimin e rrjedhave të përenjëve të vegjël dhe krijimin e rezervuarëve të mëdhenj (HEC-i i Banjës).
- Zhvillimi i bujqësisë së shkallës: Zhvillimi i bujqësisë, ka qënë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar, edhe pse disa nga tokat bujqësore të përfutuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90, të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore, po rikthehen në gjendjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit të pesticideve dhe



plehrave kimike në mënyrë të pakontrolluar, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore.

- **Shpyllëzimi** ka qënë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e shkuara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzime masive ndodhnin për hapjen e tokave bujqësore. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10-vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend.
- **Kullotja** e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta, të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Gramshit nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë.
- **Zhvillimi i turizmit**, kryesisht në formën e vizitave ditore, në zonat natyrore të territorit të Gramshit, ka një ndikim jo të vogël në ndotjen e këtyre zonave dhe shqetësimin e kafshëve apo shpendëve. Kjo ndodh kryesisht në ato zona ku guidat nuk zbatojnë standardet e mbrojtjes së natyrës dhe nuk kanë informacion për zonat e caktuara, të cilat nuk duhen shqetësuar
- **Peshkimi i pakontrolluar**, kryesisht përgjatë lumit Devoll, ka ndikuar në uljen e numrit të popullatës së peshqve pa lënë pas edhe peshkimin në liqene apo rezervuarë, të cilët kanë tashmë një jetë natyrore të zhvilluar.

Në territorin e Bashkisë Gramsh mund të ketë edhe aktivitete të tjera, të cilat kanë ndikime më të vogla në biodiversitetin ndër të cilat mund të përmendim mbledhjen e nënprodukteve të pyllit siç janë bimët mjekësore etj.








Shpallja e moratoriumit 5-vjeçar të gjuetisë dhe moratoriumit 10-vjeçar të pyjeve mendohet se do të mbrojë biodiversitetin në përgjithësi dhe do të shtojë numrin e specieve floristike dhe faunistike në territorin e Bashkisë.

Tabela 26. Specie të faunës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Gramsh

Emërtimi Latinisht	në	Emërtimi Shqip	në	Shkaqet rrezikimit	e	Foto
Helix lucorum		Kërrmidhi shkurreve	i	Grumbullimi kriter	pa	
Helix secernenda		Kërrmidhi gëlqeror		Grumbullimi kriter	pa	










DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Carcharodus flocciferus	Flociferja	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Pyrgus sidea	Kafeportokallja	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Palaeochrysophanus hippothoe	Flakëroshja e vogël e lëpjetës	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Cupido minimus	Vogëlushja blu	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Iolana iolas	Kaltëroshja e madhe	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Coenonympha tullia	Tulia	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Eredia melas	Zijoshja melas	Kufizim i habitatit	










DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Erebia medusa	Zijoshja e pyllit	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Melanargia russiae	Laramanja lartësive	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Arethusana arethusa	Aretusa	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Charaxes Jasius	Dybishtakja Jasius	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Hemaris croatica	Sfingidi kroat	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Callimorpha dominula	Mermerja kuqe	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Lucanus cervus	Kacadrei	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	











DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Pseudorasbora parva	Skort lumi me vizë	Ndotja kimike-organike e ujrave dhe peshkimi	
Ophisarurus apodus	Bullari	Shqetësimet, dëmtimet fizike	
Elaphe quatuorlineata	Bolla me katër vija	Dëmtimi dhe prishja e habitatit	
Pernis apivorus	Huta grenxangrënëse	Gjuetia dhe shqetësimi	
Milvus migrans	Huta e zezë bishtgërshtë	Gjuetia dhe shqetësimi	
Accipiter gentilis	Gjeraqina	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe gjuetia	
Accipiter nisus	Gjeraqina shkurtes	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe gjuetia	










DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Buteo buteo	Huta	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe gjuetia	
Buteo rufinus	Huta bishtbardhë	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe gjuetia	
Aquila pomarina	Shqiponja e vogël e rosave	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe gjuetia	
Aquila chysaetos	Shqiponja e malit	Gjuetia, trafikimi prishja e habitatit	
Hieraaetus fasciatus	Shqiponja bishtvijëzuar	Gjuetia jashtligjshme dhe shqetësimi i habitatit të folezimit	
Falco tinnunculus	Skifteri kthetrazi	Gjuetia paligjshme dhe shqetësimi i habitatit	
Falco biarmicus	Skifteri i mesdheut	Gjuetia jashtligjshme dhe shqetësimi i habitatit	
Falco cherrug	Skifteri i gjuetisë	Gjuetia jashtligjshme dhe shqetësimi i habitatit të folezimit	










DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Falko peregrinus	Krahëthati	Gjuetia dhe shqetësimi i habitatit	
Tetrao urogallus	Gjeli i egër	Gjuetia jashtligjshme dhe shqetësimi i habitatit të folezimit	
Bubo bubo	Bufi	Shqetësimi dhe gjuetia	
Strix aluco	Kukuvajka e pyjeve	Shqetësimi dhe dëmtimi i foleve	
Upupa epops	Pupëza	Shqetësimet humane	
Jynix troquilla	Qafëdredhësi	Shqetësimet humane në vend folezim	
Picus viridis	Qukapiku i gjelbër	Gjuetia dhe shqetësimet humane	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Drycopus martius	Qikapiku i zi	Shqetësimet humane	
Dendrocopos leucotos	Qikapiku larosh kurrizbardhe	Shqetësimi human dhe gjuetia	
Anthus trivialis	Drenja e pyllit	Shqetësimet humane dhe prishje e habitatit	
Bombycilla garrulous	Çafkëlore	Shqetësime dhe dëmtim i habitatit	
Prunella collaris	Dredhuesi i alpeve	Shqetësimet dhe mosnjohja	
Parus palustris	Trishtili i vogël i murmë	Dëmtimi dhe shqetësimi i habitatit	
Sitta europaea	Zvarritësi i zakonshëm	Shqetësimi human	






DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Tichodroma muraria	Zvarritësi krahëkuq	Shqetësimet humane	
Petronia petronia	Harabeli i gurëve	Shqetësimet humane	
Loxia curvirostra	Sqepkryqi	Shqetësimet humane	
Pyrrhula pyrrhula	Kuqalashi Çafkëzi	Shqetësimet humane	
Emberiza hortulana	Cerla e kopshtit	Shqetësimet humane	
Ursus arctos	Ariu i murrmë	Humbje dhe fragmentim i habitatit	
Meles meles	Baldosa	Gjuetia dhe dëmtimi i habitatit	
Felis silvestris	Macja e egër	Dëmtimi dhe degradimi i habitatit	






**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Lynx lynx	Rreqebulli	Humbja dh edëmtim i habitatit	
Sus scrofa	Derri i egër	Dëmtim i pyjeve, dushkajave	
Rupicapra rupicapra	Dhia e egër	Gjuetia jashtligjshme e	
Numri total i specieve të rrezikuara		56	







Burimi: Libri i Kuq i Faunës Shqipëtare, 2007; Përpunoi: MetroPOLIS, 2017

Tabela 27. Specie të florës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Gramsh

Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në Shqip	Shkaqet e rrezikimit	Foto
Taxus bacata	Tis	Shpyllëzimi i ahishtave	
Agrimonia eupatoria	Eupatoria	Grumbullimi pa kriter	
Atropa bella-donna	Zonjë e bukur	Dëmtim i habitatit	






DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Campanula tymphaea	Lulekambanë Timfeut	e	Kullotja intensive	
Convallaria majalis	Lot zoje		Dëmtim i habitatit	
Digitalis lanata	Luletogëzi leshtak		Veprimtaria njërëzore në zonën e dushkut	
Dryopteris filix-mas	Fier mashkull		Grumbullimi pa kriter	
Gentiana lutea	Sazë		Grumbullimi pa kriter	
Hypericum perforatum	Lulebasani		Grumbullimi pa kriter	










DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Juglans regia	Arrë	Shfrytëzim i gjithanshëm	
Juniperus communis	Dëllënja e zezë	Grumbullimi dhe shfrytëzimi pa kriter	
Juniperus excelsa	Foje	Individ i radhe dhe areal i kufizuar	
Juniperus oxycedrus	Dëllënja e kuqe	Grumbullimi dhe zjarrvënja	
Origanum vulgare	Rigoni i rëndomtë	Grumbullimi pa kriter dhe shpyllëzimi	
Pinus peuce	Arne	Areali i kufizuar dhe prerjet abuzive	
Quercus ilex	Ilqe	Veprimtaria e pakontrolluar njerëzore dhe zjarret	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Sambucus nigra	Shtog i zi	Grumbullimi dhe veprimtarite ndryshme njerëzore	
Sideritis raeseri	Çaj mali	Grumbullimi pa kriter dhe abuziv, shkulja gjatë grumbullimit	
Tilia platyphyllos	Bli gjethegjerë	Rrallësia e individëve dhe prerja gjatë mbledhjes së luleve për qëllime mjeksore	
Caltha palustris	Lepushter	Areal i copëzuar	
Nuphar lutea	Lëkue i verdhë	Dëmtim i vendbanimeve specifike të këtij individi	
Alyssum bertolonii	Sericë e Bertolonit	Veprimtaria antropike ne arealin e përhapjes së kësaj specie	
Arabis bryoides	Arabëz mushknjgashëm	Individë të rrallë	









DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Arenaria serpentini	Arenare serpentinës	e	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Aster albanicus	Aster shqiptar		Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Athamantha macedonica	Atamantë Maqedonisë	e	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Athamantha turbith	Atamantë turbith		Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Biscutella laveigata	Biskutelë		Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Bornmuellera baldaccii	Bornmuelerë Baldacit	e	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Botrychium lunaria	Sefir		Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	









DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH


Centaurea graeca	Kokëçel i Greqisë	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Centaurea pindicola	Kokçel i Pindit	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Chamaecytisus tommasinii	Kamecitizë Tomazinit	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Crepis geracioides	Shmangë kamaroshe	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Pedicularis graeca	Pedikulare greke	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Ptilotrichum cyclocarpum	Ptilotrik frytrotullar	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Ramonda serbica	Ramondë e Serbisë	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Sedum serpentini	Rrushqyqe serpentinit	e Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Trifolium pilczii	Trifil i pilcit	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar dhe mbikullotje	
Trollius europaenus	Troll europian	Individë të rrallë dhe areal i kufizuar	
Calvatia utriformis	Kërpudhë ujku	Dëmtim i habitateve dhe kullotja	
Sarcodon imbricatus	Dhëmbëza	Dëmtimi i habitatit	
Tulipa sylvestris	Tulipan pyjesh	Individë të rrallë dhe mblidhet si bime dekoruese	



Ulmus glabra	Vidh mali	-	
Numri total i specieve të rrezikuara		44	

Burimi: Libri i Kuq i Florës Shqipëtare, 2007; Përpunoi: MetroPOLIS, 2017

4.5.4. Zonat e Mbrojtura

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore¹⁶⁷.

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj¹⁶⁸ dhe zënë rreth 16%¹⁶⁹ të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:¹⁷⁰ i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 28. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralese ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror ¹⁷¹ .



Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluar dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të manaxhuara.

Burimi: Ligji Nr 81/.2017 Për Zonat e Mbrojtura

Manaxhimi i zonave të mbrojtura në vend

Kohët e fundit, Shteti Shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm përpara për zhvillimin e zonave të mbrojtura. Qeveria ka plotësuar më tej kudrin ligjor dhe institucional për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 81, dt. 2017, Për Zonat e Mbrojtura, i cili ka si qëllim kryesor shpalljen, ruajtjen, manaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në vend është edhe miratimi i VKM-së Nr. 102 i datës 12.02.2015 i cili krijoi dhe përcaktoi funksionet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM). AKZM-ja dhe AdZM-ja kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend, mbështetjen që i japin e Ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave për zonat e mbrojtura, hartimin dhe zbatimin e planeve të manaxhimit dhe të veprimit, monitorimin, mbledhjen e informacionit dhe lajmërimin e organeve kompetente kur vërehen shkelje në zonat e mbrojtura.¹⁷² Pas përpjekjeve të shtetit shqiptar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, mund të themi që manaxhimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura është qartësuar në kontekstin e përgjegjësive institucionale.

Në këtë fazë, AKZM-ja¹⁷³ ka hartuar Programin Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i manaxhimit të ZM-ve sipas standardeve të BE-së, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore. Për më tepër, Qeveria ka marrë masa konkrete për zbatimin e ligjeve mbi zonat e mbrojtura dhe manaxhimin e tyre. AKZM-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka hartuar planet e manaxhimit për disa zona të mbrojtura (Plani i manaxhimit të Parkut kombëtar të Malit të Tomorrit, Divjakë- Karavasta etj.) dhe është drejt përfundimit të hartimit të planeve të manaxhimit¹⁷⁴ për zona të tjera. AKZM-ja e shtrin aktivitetin e saj në çdo qark nëpërmjet degës së saj rajonale (AdZM-të e qarqeve). AdZM-të kanë në fokus të tyre zbatimin e planeve dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në territorin e tyre të kompetencës (të qarkut përkatës) dhe bashkëpunimi më AdZM-të e tjera përkatëse kur zona e mbrojtur i kalon kufinj të qarkut. AdZM-të kanë një staf të caktuar në varësi të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që ndodhen në territorin e






administruar prej tyre (disa punonjës në rastet e manaxhimit të një parku komëtar, që llogaritet të ketë një sipërfaqe të madhe kupërfshihen kryesisht specialistë monitorimi dhe disa roje).¹⁷⁵

Me gjithë punën e mirë të bërë nga AKZM, zbatueshmëria e ligjit për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura ende hasvështirësi. Mungesa e planeve të manaxhimit dhe mungesa e kapaciteteve për zbatimin e planeve të menaxhimit për disa zona mbetet ndër vështirësitë kryesore. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, momentalisht AKZM-ja është duke bërë një punë të mirë në drejtim të rritjes së kapaciteteve lokale dhe plotësimit të stafit të nevojshëm për menaxhimin sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.

o Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh

Në territorin e Bashkisë së re të Gramshit gjenden pasuri të shumta natyrore. Format e larmishme të relievit dhe luhatjet e lartësive kanë ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme të cilat ofrojnë mundësinë për zhvillimin e florës dhe faunës në territor. Në territorin e bashkisë gjendet një pjesë e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit (Pjesa veriore e parkut), i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 21 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zone. Monumentet e Natyrës ndahen në 7 gjeo-monumente dhe 14 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjendje të mirë biologjike dhe estetike. Në tabelën më poshtë gjenden të listuara Zonat e Mbrojtura në territorin e Bashkisë Gramsh dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Tabela 29. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh

Emërtimi i ZM-së	Kategoria	Përshkrim shkurtër	Rëndësia	Foto
Kategoria II – Park Kombëtar				
Mali i Tomorrit	II	Biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma	Shkencore, biologjike, ekologjike, ekonomik, kulturore, didaktike dhe turistike	
Kategoria III – Monument Natyre dhe Gjeo - Monumente				
Shpella e Kabashit	III	Lartësia mnd: 900 m Gjatësia: 120 m Mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Karsti i Tërvolit	III	Peizazh i mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	






**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Gurrët e Krushqëve	III	Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çudiçme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria gërryrrese e erës	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Kanioni Sinecit Saraselit	III	Gjatësia: 1,500m Thellësia: 300m Gjerësia: 20-30 m Shpate të thepisura dhe një ekosistem interesant krasti	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Ahishtia e Rovjes	III	Lartësia mnd 1,400 m Sipërfaqja: 50 ha Lartësia e drurëve: 15-35m Diametri i trungut: 50-70cm Moshë: 80 vjeçar Gjendja: shumë e mirë	Biologjike, didaktike, estetike e turistike	
Dushkaja e Katër Lisave	III	Lartësia mnd: 850m Sipërfaqja: 1ha Lartësia: 15-18m Diametri i trungut: 30-40cm Perimetri i trungut: 120cm Moshë: 80 - 100 vjeçar Gjendja: Dëmtim të pjesshëm të drurëve	Biologjike, didaktike, estetiko-turistike dhe klimaterike	
Tarraca Ballores (Qytezës)	III	Gjatësi: 800m Gjerësi: 200m Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepisur, 15 m të lartë, ka mbetje arkeologjike, pra përbën një vendbanim prehistorik.	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Dushku Bulçarit	III	Lartësia mnd: 1100 m Sipërfaqja: 2 ha Lartësia e Drurëve: 15 – 25 m Diametri: 15 – 35 cm	Shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike dhe turistike	



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

		Perimetri: 50 – 110 cm Mosha: 150 vjeçare Gjendja: E mirë		
Liqeni Dushkut	i III	Lartësia mnd: 1105 m Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m	Shkencore, didaktike, turistike.	
Rrobulli Grabovës	i III	Lartësia mnd: 1500 m Sipërfaqja: 8 ha Mosha 100 vjeçare Lartësia e pemëve: 25 – 30 m Diametri i trungut: 25 – 35 cm Perimetri i trungut: 60 – 100 cm Gjendja: Shumë e mirë	biologjike, didaktike, estetiko-turistike dhe klimaterike	
Shkëmbi (kanioni) Kopaçit	i III	formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit homonym, rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1,5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike	
Liqenet Valamarës	e III	Lartësia mnd: 2,200 m Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, ekologjike dhe kulturore	
Robulli Valamarës	i III	Lartësia mnd: 1,500 m Lartësia e drurëve: 30 m Diametri i trungjeve: >35cm Perimetri i tyre: 70 – 100 cm Mosha: 150 vjeçare	Shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike turistike	



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Liçeni i Zi – Lenie	III	Lartësia mnd: 1634 m Forma e liçenit është e përzgatur, rreth 1000 – 1200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m	Shkencore (hidrogeologjike), didaktike, turistike e kurative	
Moçalet e Grabovës	III	Lartësia mnd: 1550 m Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1000 m,	Shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike	
Burimet e Kërpicës	III	Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flihit të luginës së Tomorricës	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Ujëvara e Sotirës	III	Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Kanioni i Holtës	III		Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Ahishtja e Rovjes	III	-	-	-
Gështenja dhe pisha në Teqenë e Skënderbegasit	III	-	-	-

Burimi: AKZM 2016; Përpunoi: MetroPOLIS, 2017



o **Park Kombëtar (kategoria II)**

Parku kombëtar përfaqëson territore të gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe educative.¹⁷⁶

Parku Kombëtar (PK) “Mali i Tomorrit (K. 2): Në pjesën jugore të territorit të Bashkisë Gramsh ndodhet një pjesë prej 1,278.9ha e PK Mali i Tomorrit. Parku Kombëtar mali i Tomorrit shtrihet në dy Qarqe të vendit, Elbasan dhe Berat, ka një sipërfaqe të përgjithshme rreth 24,723 ha¹⁷⁷. Parku shquhet për biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Specie dominuese në floristike përmendim ahun, pishën e zezë, robullin dhe kullotat subalpine e alpine. Gjithashtu parku është një habitat i rëndësishëm për një gamë të gjerë të specieve faunistike, ndër të tjera përmendim gjitarët e mëdhënj ariu – *Ursus arctos*, ujku – *Canis lupus*, ndërsa shpendët përfaqësohen nga rrëmbenjësit e ditës dhe të natës, harabelat, etj.¹⁷⁸

Krahas vlerave shkencore dhe ekonomisë natyrore, parku i Tomorrit ofron një gamë të gjerë vlerash peizazhi, çlodhëse dhe historiko-kulturore, të cilat mundësojnë zhvillimin e turizmit në natyrë dhe atij historiko-kulturor në këtë zonë. Në të gjenden habitatet pyjore (pyje të larta dhe të ulëta) me mbulesë bimore të larmishme si pasojë e ndryshimit të lartësisë, e dukshme në largësi të vogël, lagështi e përshtatshme në stinën e verës dhe dhera të pasura e prodhuese. Pyjet e larta mbizotërohen nga kombinimi i ahishtave dhe pishës. Në lartësinë 1,100-1,700m gjenden pyjet e ahut, të cilat rrallëherë përzihen me pyjet e pishës. Në lartësinë 1,500-1,800m mbi nivelin e detit gjendet rrobulli (*Pinus Heldreichii*), mjaft i rëndësishëm në ato pjesë ku thatësira është e lartë. Ndërsa mbi kuotën 1,800m mbi nivelin e detit takohen livadhe dhe kullota alpine. Pyjet e pastra të ahut (*Fagus sylvatica*) gjenden në lartësitë 1,100-1,400m mbi nivelin e detit. Në rajon gjenden edhe pemë të tjera gjetherënëse përveç panjës (*Acer sp.*). Në brezin 1,400-1,800m mbi nivelin e detin mbizotëron pisha e zezë (*Pinus nigra*) dhe rrobulli (*P. Hedldreichii*), në përzierje më dëllinjën (*Juniperus spp.*), si dhe zona të hapura kullotash. Mbi 1,800m hasen lëndinat dhe kullotat alpine.

Pyjet e ulëta vendosen kryesisht në pjesën lindore të parkut, pasi shpatet në këtë pjesë janë më të thata. Në lartësinë deri në 800m mbi nivelin e detit rriten shkurret me përzierje shkozë e zezë (*Carpinus orientalis*) dhe dëllinjë (*Juniperus spp.*) dhe nga 800-1,100m rritet lajthia (*Corylus sp.*), shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), arra e butë (*Juglans regia*), frashëri (*Fraxinus excelsior*) dhe panja (*Acer sp.*) me pak bungëbutë (*Quercus pubescens*) të shpërndarë. Në zonat me kushte shumë të thata bimësia është shumë e ulët, ku gjenden kryesisht kullotat e hapura dhe dëllinja e kuqe (*J. oxycedrus*).

Shkurret dhe pemët përfaqësohen nga *Pholmis sp.*, dhe në masë relativisht të ulët nga molla e egër (*Malus sylvestris*). Në këtë zonë kullotat ndikojnë intensivisht. Në pjesën e poshtme të shpateve, nën 500m, gjenden shkurreta mesdhetare, si: shqopa (*Erica arborea*), *Phillyrea media*, *P. angustifolia*, mareja (*Arbutus unedo*), xina (*Pistacia lentiscus*) dhe pak pemët e dushkut (*Quercus ilex*, dhe *Q. trojana*). Ndërsa niveli i florës barishtore në zonën e parkut përbëhet nga barëra të ndryshme, shumë prej të cilave shquhen për vlerat e tyre kuruese. Për këtë arsye ato kanë gjetur përdorim të gjerë në popullsi. Në këtë zonë ndodhen edhe bimë barishtore si iriqëza gjetherrotullare (*Saxifraga rotundifolia*), luleshtrydhja



(*Fragaria vesca*) dhe sherebela veshtullore (*Salvia glutinosa*). Çaji i malit (*Sideritis raeseri*), krahas përdorimit të tij në masë për vlerat kuruese që ai mbart, është një lloj endemik për zonën. Parku kombëtar i malit të Tomorrit strehon edhe një numër llojesh endemike dhe subendemike si: *Aubrieta intermedia*, *Astragalus austraci*, *Cupris baldacii* ose *Nepeta spursesi*.

Fauna në parkun kombëtar të malit të Tomorrit është shumë e rëndësishme, pasi përfshin edhe vertebrorët e mëdhenj. Habitatet e shumëllojshme brenda parkut shërbejnë si strehëza për faunën e kësaj zone. Disa lloje jovertebrorësh që jetojnë në Parkun e Tomorrit janë *coleopteran*, brisqari (*Cerambyx cerdo*) etj., të cilët kanë rëndësi të madhe në ruajtjen e ekuilibrit biologjik të zonës. Edhe komunitetet e amfibëve janë një pjesë e rëndësishme e faunës në Parkun e Tomorrit. Ato përfaqësohen nga thithlopa barkverdhë, (*Bombina variegata*), thithlopa (*Bifidobufo*) dhe tritoni me kreshtë (*Triturus cristatus*). Për sa i përket zvarranikëve, ata përfaqësohen nga bolla laramane (*Elaphe situla*), bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata-CR*), breshka (*Testudo hermanni* dhe *Emys orbicularis*) etj. Në këtë zonë është e pranishme edhe një shumëllojshmëri shpendësh, përfshirë lloje të rralla apo të kërcënuara. Llojet rezidente janë bufi (*Bubo bubo*), shqipja e maleve (*Aquila chrysaetos*) dhe krahëthati (*Falco peregrinus*). Gjithashtu, pyjet strehojnë edhe gjelin e egër (*Tetrao urogallus*), qukapikun e zi (*Dryocopus martius*) dhe shqiponjën e vogël të rosave (*Aquila pomarina*). Lloje që riprodhohen në zonën e parkut janë gjeraqina e shkurtës (*Accipiter nisus - EN*), gjeraqina (*Accipiter gentilis*) (*Circaetus gallicus*) dhe huta grenxa ngrënëse (*Pernis apivorus*). Në masë relativisht të madhe gjendet thëllëza e malit (*Alectoris graeca*). Gjitarët e mëdhenj ose mishngrënësit e zakonshëm janë ariu i murrmë (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*). Thundrakët, nga ana tjetër, përfaqësohen në numër të vogël nga derri i egër (*Sus scrofa*) dhe dhia e egër (*Rupicapra rupicapra balcanica*). Gjitarë të tjerë të shumtë në numër brenda parkut janë: dhelpra (*Vulpes vulpes*), kunadhja (*Martes foina*), baldosa (*Meles meles*), lepuri i egër (*Lepus europea*), ketri (*Sciurus vulgaris*), iriqi (*Erinaceus concolor*) dhe nuselalja (*Mustela nivalis*). Ndërsa lakuriqët e natës të cilët janë të pranishëm në territorin e parkut përfaqësohen nga *Rhinolophus hipposideros*, *Miniopterus schreibersi* dhe *Myotis capaccini*.

Parku kombëtar “Mali i Tomorrit” menaxhohet nga AKZM-ja. Parku ka një projektplan menaxhimi që është hartuar në vitin 2014 nga Ministria e Mjedisit.¹⁷⁹ Aktualisht nuk ka informacion nëse ky plan menaxhimi është miratuar. Sipas AKZM-së, parku kombëtar “Mali i Tomorrit” ka vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve lokale, AdZM-ve Elbasan dhe Berat, të cilat mbrojnë parkun dhe kontrollojnë veprimtaritë brenda tij. AdZM –ja Elbasan ka përcaktuar një punonjës për mbikqyrjen e pjesës së parkut brenda territorit të parkut Elbasan, ndërsa AdZM-ja Berat ka aktivizuar 5 punonjës për mbikqyrjen e parkut kombëtar “Mali i Tomorrit” dhe 4 specialistë për monumentet e natyrës.¹⁸⁰

o Monumente Natyre (Kategoria III)

Monument Natyre përfaqëson një formacion natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacion i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat të një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike.¹⁸¹ Në territorin e Bashkisë Gramsh ndodhe 21 te tilla, të cilat do të trajtohen në vijim:



Shpella e kabashit:¹⁸² Ndodhet në afërsi të fshatit Kabash, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. E formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretës së sipërme, është e gjatë rreth 120 m. Ende nuk është eksploruar. Pjesa e njohur formon një labirinth të vërtetë dhe është e mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin Gramsh ose Elbasan – Kabash.

Karsti i Tërvolit:¹⁸³ Ndodhet në malin e Tërvolit, i cili është i përbërë nga gëlqerorët e kretës së sipërme. Në kreshtën e tij të sheshtë është i zhvilluar fuqimisht procesi i karstit, i cili ka formuar një peizazh të mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin – Gramsh – Tërvol – Monumenti.

Gurrët e Krushqëve¹⁸⁴: Ndodhen në afërsi të fshatit Lisec të bashkisë të Gramshit. Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çudiçme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria gërryrrëse e erës. Legjenda i lidh ata me "ngrirjen e krushqëve, që kishin shkuar për të marrë nusen". Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin Gramsh – Lisec.

Kanioni i Sinecit ose Saraselit¹⁸⁵: Ndodhet pranë fshatit të Saraselit të NJA-së së Sultit, bashkia Gramsh. Përfaqëson një kanion të madh të formuar në gëlqerorët e kretës së sipërme nga veprimtaria karstike dhe erozive e përroit të Seraselit. Është i gjatë rreth 1,5 km, i thellë rreth 300 m dhe i gjerë rreth 20-30 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin Gramsh - Sinec.

Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit¹⁸⁶: Ndodhet në afërsi të Grabovës së Sipërme dhe është i formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit homonim, degë e Devollit. Është rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1,5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin Gramsh – Lenie – Grabovë e Sipërme.

Tarraca e Ballores (Qytezës)¹⁸⁷: Ndodhet në krahun e majtë të lumit të Devollit, në afërsi të fshatit të Ballores. Përfaqëson një fragment të nivelit të parë të tarracës lumore të formuar nga lumi i Devollit dhe lumi i Tomorricës, degë e tij. Është e gjatë rreth 800 m dhe e gjerë rreth 200 m. Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepisur, 15 m të lartë. Në shpinën e saj ka mbetje arkeologjike, pra përbën një vendbanim prehistorik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkelogjike), didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur intinerarin Gramsh – Skënderbegas.

Liqeni i Dushkut:¹⁸⁸ Ndodhet në afërsi të fshatit Lenie, në rrëzën veriperëndomore të malit të Komianit, në lartësinë 1105 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m. Ka botë të pasur të gjallë, në të cilën dallohen sidomos zambakët e mbëdhenj të ujit. Rrethohet nga një pyll i dendur pishash me sipërfaqe



rreth 12 ha. Së bashku me pyllin rrethues formon një ekosistem tepër interesant liqenor e pyjor. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas intinerarit Gramsh – Kodovjat – liqeni i Dushkut.

Liqenet e Valamarës:¹⁸⁹ Nodohen në malin e Valamarës, të vendosura në një cirk të madh kompleks akullnajor, në lartësinë rreth 2200 m mbi nivelin e detit, prane fshatit Lenie të rrethit të Gramshit. Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m, të veçuara nga njeri tjetri prej depozitimesh morenike. Liqeni më i madh ka permasa mesatare 600 m gjatësi dhe 200 m gjerësi. Kanë ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Janë të pasura me një botë të gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpinë. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Vizitohen sipas intinerarit Gramsh – Lenie dhe prej ketej vazhdohet rruga kembesore drejt qafes së Mushkes për shpatin lindor të malit të Valamars.

Liqeni i Zi – Lenie:¹⁹⁰ Gjendet në lartësinë 1634 m, në afërsi të fshatit Lenie, NJA-ja me të njëjtin emër të bashkisë së Gramshit. Përfaqëson një liqen me origjinë akullnajore. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe. Forma e liqenit është e përzgatur, rreth 1000 – 1200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m. Drurët e pyllit kanë lartësi 25 – 30 m, trashësi të trungut 20 – 35 cm e perimetër të tij 60 – 100 cm. Janë drurë me moshë shekullore. Ujërat e liqenit përdoren edhe për kurim sëmundjesh si reumatizma, por ende nuk ka studime të këtij lloji. Monumenti ka vlera shkencore (hidrogjeologjike), didaktike, turistike e kurative. Vizitohet duke ndjekur intinerarin: Gramsh – fshati Lenie – Biaj, e më pas në Liqenin e Zi.

Moçalet e Grabovës:¹⁹¹ Gjendet në shpatin e malit të Valamarës, në lartësinë 1550 m mbi nivelin e detit. Nga ana administrative i përket fshatit Grabovë e Sipërme, NJA Lenie e bashkisë të Gramshit. Njihet edhe me emrat Moçalet, Gropa e Kryqit dhe Prishtakoll. Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1000 m, gjerësi 400 – 450 m e sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungut 25 – 35 cm, perimetri trungjeve 80 – 100 cm, ndërsa mosha është 150 vjeçare. Pylli është përreth një livadhi, ku derdhen mjaft burime nga ana lindore e tij. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike. Gjëndja e tij është e mirë. Vizitohet sipas intinerarit Gramsh – Kodovjat – Grabovë e Sipërme – Moçalet.

Burimet e Kërpicës:¹⁹² Nodohet në afërsi të fshatit Kërpicë të bashkisë Gramsh. Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flihit të luginës së Tomoricës. Dallohen për regjim të rregullt të prurjes, ujët e pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një pamje me bukuri mahnitëse. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas intinerarit Gramsh – Kërpicë – monumenti.

Ujëvara e Sotirës:¹⁹³ Nodohet në shpatin lindor të malit të Tomorrit, në afërsi të fshatit të Sotirës. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distancë mjaft të madhe. Krijon një pamje me bukuri mahnitëse. Ka vlera shkencore (gjeologjike,



gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas intinerarit Gramsh – Sotirë – Monumenti.

Robulli i Valamarës¹⁹⁴: Gjëndet në malin e Valamarës, 1500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 10 ha. Lartësia është. Lartësia e drurëve është rreth 30 m, diametri i trungjeve është mbi 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 70 – 100 cm. Moshja e tyre është 150 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike e turistike. Për ta vizituar duhet ndjekur intinerari: fshati Grabovë e Sipërme – përroi i Sharrës – Valamarë.

Rrobulli i Grabovës:¹⁹⁵ Gjëndet në afërsi të malit të Valamarës, ndaj nga banorët njihet edhe me emrin Valamara e Vogël. I përket fshatit Grabovë e Sipërme, NjA Lenie e Bashkisë Gramsh. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 8 ha. Pylli i rrobullit ka formë drejtkëndëshe me gjatësi 400 – 500 m, e gjerësi 150 – 200. Lartësia mbi nivelin e detit është 1500 m. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungjeve është 25 – 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 60 – 100 cm. Moshja e tyre është 100 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike e turistike. Për ta vizituar duhet ndjekur intinerari: fshati Grabovë e Sipërme – përroi i Sharrës – Vërtoq.

Dushku i Bulçarit:¹⁹⁶ Ndodhet në fshatin Sojnik, NjA Kukër e Bashkisë Gramsh, në lartësinë 1100 mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grupe drurësh dushku. Ka formë të përzgatur me gjatësi 2000 – 3000 m, gjerësi 200 – 300 m. Drurët përfaqësohen nga pisha e zezë dhe dushk, përreth liqenit të Dushkut rreth 12 ha. Në afërsi të liqenit ka livadhe me bimësi barishtore, bimësi ujore e gjallesa të tjera. Lartësia e drurëve është 15 – 25 m, diametri trungjeve është 15 – 35 cm, perimetri tyre është 50 – 110 cm. Moshja e drurëve të pishës është 150 vjeçare. Janë të ruajtur mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike. Vizitohet sipas intinerarit: Gramsh – Kodovjat – Bulçar – liqeni i Dushkut.

Dushkaja e Katër Lisave:¹⁹⁷ Gjëndet në fshatin Katërlis, NjA Tunjë të Bashkisë Gramsh, në lartësinë 850 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll dushku, me sipërfaqe rreth 1 ha. Grupi i drurëve ka formë drejtkëndëshi me gjatësi 200 – 250 m e gjerësi 40 – 50 cm. Lartësia e drurëve është 15 – 18 m, diametri i trungjeve është 30 – 40 cm, ndërsa perimetri i tyre arrin deri 120 cm. Moshja e drurëve është 80 – 100 vjeçare. Pas vitit 1990 ka patur dëmtim të pjesshëm të drurëve. Është në pronësi shtetërore. Kanë vlera shkencore (biologjike), estetike e turistike. Vizitohen sipas intinerarit; Gramsh – fshati Tunjë – mali Katërlisës.

Ahishtia e Rovjes:¹⁹⁸ Gjëndet në afërsi të fshatit Kukër (Rovë) të NjA-së me të njëjtin emër të Bashkisë Gramsh, 1400 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll ahu. Pylli ka formën e një amfiteatri në shpatin malor me sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 15 – 35 m, diametri i trungut është 50 – 70 cm, perimetri trungjeve është 100 – 200 cm, ndërsa mosha e tyre është 80 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas intinerarit: Gramsh – fshati Kukër – Rovje.



○ Problematikat kryesore të ZM-ve Gramsh

AKZM-ja dhe AdZM-ja janë duke bërë përpjekje serioze në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në Bashkinë e Gramsh. Megjithatë, problematikat mbeten ende të shumta, ndër të cilat përmendim:

Rreziku i përhapjes së zjarreve është i pranishëm pothuajse gjatë gjithë sezonit të nxehtë, kryesisht në zonën e Malit të Tomorrit, apo dhe në zona të largëta, të cilat paraqesin vështirësi për t'u kontrolluar.¹⁹⁹ Kryesisht, zjarret kanë qenë të qëllimshme nga praktika të gabuara që përdoren për hapjen e kullotave dhe tokave bujqësore.

Gjuetia e paligjshme është një problem aktual në territorin e bashkisë dhe në afërsi të PK Mali i Tomorrit dhe në zona të tjera të thella që është vështirë të kontrollohen. Gjuetia ndikon direkt në uljen e numrit të shpendëve dhe kafshëve, dhe shqetësimin e tyre.

Manaxhimi joefektiv i aktiviteteve turistike që kryhen në të gjitha zonat e mbrojtura, edhe pse në nivele të ulëta, lënë pas mbetje të ngurta, të cilat shpërndahen, theksi duhet vendosur tek Ujevara e Sotirës dhe tek Kanioni i Holtës, aty ku fluksi i vizitorëve është më i madh.

Ndërtimi i HEC-eve, të cilët shfrytëzojnë ujin, duke e devijuar atë, ka sjellë probleme të shumta në habitatet e zonave të mbrojtura. Disa zona janë prekur nga ndërtimi i HEC-eve të vegjël, duke sjellë reduktimet e ndryshme në sasinë e ujit që rrjedh në gjendje të lirë dhe furnizon ekosistemet natyrore në këto zona. Shembull konkret i devijimit të ujit nga HEC-et është ai i Tervolit, në hyrje të Kanionit të Holtës

Kullotja është prezente pothuaj në të gjithë Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Gramsh. Ende nuk ka një studim se sa është kapaciteti i lejuar i këtyre zonave, kështuqë është një problem i pastudiuar dhe i pazgjidhur.

Erozioni është një fenomen i pranishëm në zonat kodrinore malore, kryesisht erozioni i shpateve të zhveshura, apo në brigjet e përrenjve apo lumenjve, që kalojnë në zonat e mbrojtura.

Ndikimi që kanë patur, si prishja e rregjimit të ujërave në lumenj, gjithashtu edhe shpyllëzimet intensive, kanë rezultuar në një rritje të ndryshme të aktivitetit erodiv kudo në Shqipëri, dhe ende nuk ka një adresim të saktë të këtij problemi ndaj edhe zgjidhja e këtij fenomeni mbetet të realizohet në një të ardhme ndofta të largët.

○ Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Gramsh është e pasur me rezervate natyrore dhe monumente natyre të shumëllojshme, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Për më tepër, në Bashki gjenden edhe ujëra termale apo me veti kuruese (ujrat termal në hyrje të kanionit të Holtës dhe Ujrat me veti kuruese të Liqenit të Zi), të cilat nëse ruhen dhe mirëmbahen, mund të shndërrohen në motorrin kryesor të zhvillimit ekonomik të zonave përreth. Megjithatë, këto zona kanë pësuar dëmtime të ndryshme në vitet e shkuara, si prerje abuzive të pyjeve në territorin e tyre, zjarre, ndërtime të ndryshme, mbikullotja dhe fenomene të tjera natyrore si erozioni dhe shembjet e ndryshme të dherave.

Duke patur parasysh që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme, jo vetëm sepse shërbejnë si habitate të një biodiversiteti të larmishëm, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë, përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe



peizazhistikeqë mbartin. Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Gramsh me AdZM-në Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura dhe zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera, që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre.


4.6 Toka

4.6.1 Përdorimi i tokës

Sipërfaqja totale e Bashkisë Gramsh është 739.98 km². Sipas analizës territoriale, sistemi natyror zë rreth 79.87% të territorit (591.05 km²). **Sistemi natyror** është i përqëndruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe malore. **Sistemi bujqësor** renditet i dyti, duke zënë afërsisht 13.7% të territorit (101.39 km²) dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Devoll, në pjesën më të ulët të qytetit të Gramshit, zonë në të cilën janë përqëndruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën qendrore të territorit, **sistemi urban** ndërthuret me sistemin natyror dhe me sistemin infrastrukturor. Sistemi urban, i cili zë 6.05%, është përqëndruar kryesisht në qytetin e Gramshit. Ky sistem shtrihet edhe përgjatë akseve kryesore rrugore, siç është segmenti Gramsh-Cërrik-Elbasan dhe segmentet rrugore që lidhin qendrën e bashkisë me njësitë administrative, që kanë distancë të vogël me qytetin e Gramshit. Në pjesën tjetër të Bashkisë Gramsh, sistemi urban është pikësor dhe ndërthuret me sistemin natyror dhe sistemin bujqësor. Në territorin e Gramshit ka edhe sipërfaqe të konsiderueshme **ujore** që në total zënë një sipërfaqe prej 36.59 km². Kategoria e përdorimit **banim**, zë një sipërfaqe totale 5.14 km² dhe është e përqëndruar kryesisht në pjesën e qytetit ndërsa në fshatra zë më pak sipërfaqe dhe ka shpërhapje më të madhe, ndërsa kategoria **industri** dhe **ekonomi** zë 0.45 km² të gjithë sipërfaqes së Gramshit.



Figura 61. Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 30. Sistemet territoriale, Bashkia Gramsh

Nr	Sistemet territoriale	Sipërfaqja në km ²	Sipërfaqja në %
1	Bujqësor	101,39	13,70%
2	Infrastrukturor	4,90	0,66%
3	Natyror	591,05	79,87%
4	Ujor	36,59	4,94%
5	Urban	6,05	0,82%
	TOTAL	739,98	100,00%

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 31. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës (km²)

Nr	Kategoritë bazë	Sipërfaqja (km ²)	Sipërfaqja (%)
1	Aktivitete Shoqërore dhe Argëtim	0,053	0,007%
2	Arsim	0,106	0,014%
3	Banim	5,136	0,694%
4	Bujqësi	101,453	13,710%
5	Industri Ekonomi	0,447	0,060%
6	Infrastrukturë Bujqësore	0,062	0,008%
7	Infrastrukturë Energjitike	0,018	0,002%
8	Infrastrukturë Telekomunikacioni	0,002	0,000%
9	Infrastrukturë Transporti	4,751	0,642%
10	Infrastrukturë Ujësjellës-Kanalizime	0,013	0,002%
11	Institucione	0,026	0,004%



12	Monumente Kulture	0,001	0,000%
13	Shëndetësi	0,028	0,004%
14	Shërbime	0,141	0,019%
15	Tokë Natyrore	591,054	79,874%
16	Ujëra	36,575	4,943%
17	Varreza	0,084	0,011%
18	Zonë ushtarake	0,03	0,004%
	TOTAL	739,98	100,000%

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

4.6.2 Toka Bujqësore

Sipas klasifikimit të *Census* 2011, Bashkia e Gramshit ka 2 njësi vendore bujqësore mikse malore (Pishaj e Kukur) dhe 7 njësi vendore bujqësore malore (Kodovjat, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult e Tunjë). Sipas tipologjisë së qendrave urbane Gramshi është klasifikuar si një qendër lokale.

Tabela 32. Tipologjitë sipas NJA-ve

Ko di	Bashkia	Tipologjia	Sip. km ²	Bano rë
14	Gramsh	Qendër lokale	2.48	14413
42	Pishaj, Kukur	Njësi vendore bujqësore mikse malore	192.6	5439
44	Kodovjat, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult, Tunjë	Njësi vendore bujqësore malore	544.14	8325
Totali			739.22	24231

Burimi: CENSUS, 2011; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Sipas tabelës së mësipërme, të paktën 30.8% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë mikse malore, ndërsa rreth 34.4 % e popullsisë së bashkisë merret me bujqësi malore. Shifrat mund të jenë edhe më të larta, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit, e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Bashkia e Gramshit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore, që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, Bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e *drithërave* (grurit, misrit, tagjirës), pemtarisë, vreshtave, primeve dhe blegtorisë (ritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për *drurët frutorët*. Sipërfaqet bujqësore në Bashkinë e Gramshit janë të vendosura në tokat përgjatë lumit të Devollit dhe përrrenjëve që përshkojnë bashkinë.

- Problematikat e tokave në Gramsh

Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembjet: Bashkia e Gramshit shtrihet në një zonë me reliev të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor, ku zonat fushore janë të kufizuara përgjatë luginës së lumit Devoll dhe përgjatë përrrenjëve. Si rrjedhojë, duke qenë se një pjesë e mirë e tokave bujqësore shtrihen në reliev jofushor, ato janë të prirura ndaj erozionit, shkarjeve dhe shembjeve. Për sa i përket *erozionit* në tokat bujqësore, ndërsa në vendin



tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në zonën e Gramshit ky potencial është vlerësuar si *i lartë*.²⁰⁰

Tabela 33. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

Rrethet	Sip (Ha)	Indeksi i erodibilitetit		Indeksi i erozionit tokës	Indeksi i pjerrësisë	Indeksi rrezikut potencial të tokës		Vlerësimi
		Abso l.	Rel.			Absol .	Rel.	
Korçë	58973	6.3	3	2	1.68	10.1	2	Mesatar
Gramsh	7518	7.3	3	2	2.37	14.2	3	I lartë
Elbasan	40450	6.9	3	2	2.25	13.5	3	I lartë

Burimi: AKM 2013; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e NjA-ve Kukur, Skënderbegas, Tunjë, Gramsh dhe Pishaj të cilat janë të ndjeshme ndaj erozionit. Shkaqet e erozionit në tokat bujqësore të kultivuara në Bashkinë e Gramshit janë natyrore dhe të shkaktuara nga ndërhyrjet e njeriut me mënyra të papërshtatshme gjatë përdorimit të saj (keq-manaxhimi). Disa nga ndërhyrjet mund të lidhen kryesisht me: i) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene atmosferike; ii) mënyra e kultivimit të tokës bujqësore kodrinore në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës gjatë plugimit; iii) djegia e mbetjeve të bimëve të kultivuara në sezonin e mëparshëm, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tërësisht tokën nga bimësia që shërben si mbrojtëse ; iv) tarracimi i papërshtatshëm i zonave kodrinore-malore me zhveshje të tokës etj. Në fakt, gjatë gjithë zonës fushore dhe kodrinore brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra toke të punuar thellë dhe të zhveshura tërësisht nga bimësia. Kjo sepse në tokat bujqësore në Bashkinë Gramsh dhe pothuajse në gjithë vendin tonë, bujqërit ose fermerët vazhdojnë të përdorin praktika bujqësore të papërshtatshme si zhveshja e tokës nga bimësia e stinëve të mëparshme gjatë plugimit, pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit, në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës.

Tokat e rajonit të Gramshit janë të rrezikuara edhe nga mundësitë e *shkarjeve* dhe *shembjeve*²⁰¹, një formë e rrezikut gjeologjik. Disa nga shkaqet e shkarjes së tokës që indentifikon AKM-ja në Bashki janë relievi i thyer, sasi të mëdha të reshjeve, dëmtimi i bimësisë natyrore, mbikullotja në zonat me bimësi livadhore, braktisja e tokave bujqësore, etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë²⁰².

Fatkeqësisht, ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika të përshtatshme kultivimi për të shmangur ose zvogëluar rrezikun e erozionit në tokat bujqësore (si punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimi i mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjellja e foragjereve apo e bimësisë që ushqen dhe forcon tokën ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pentaria, vreshtaria ose ullishtet etj.), në vendin tonë mbetemi ende mbrapa. Si rrjedhojë, për shkak të arsyeve të ndryshme në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës, kjo si pasojë e erozionit, mungesës së njohurisë së thelluar për tokën dhe praktikave




të keqmanaxhimit, apo braktisjes. Shifrat lokale në lidhje me erozionin lokal mungojnë por në rang vendi degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014²⁰³.

Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve: Gjatë viteve të fundit, në Gramsh rreziku i gërryerjes së tokës në lumin Devoll mbetet i lartë, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta²⁰⁴. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit dhe mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Nga studimet e kryera në nivel kombëtar është konstatuar një gjendje serioze e shtretërve të lumenjve duke humbur një nivel të lartë të tokave në brigjet e lumenjve, si pasojë e një mungese menaxhimi dhe mirëmbajtjeje të lumenjve²⁰⁵.

Përdorimi konfliktual i tokës: Duke i'u referuar hartës së mësipërme, në Bashkinë e Gramshit përdorimi i tokës është i llojeve të ndryshme. Karakteristikat e të gjitha bashkive por që e gjejmë edhe në Bashkinë e Gramshit është fakti që përdorimi i tokës nuk është i zonuar sipas parimit të përdorimit të lejuar, ndaluar dhe kushtëzuar. Kjo vihet re dukshëm në rastet kur tokat bujqësore nuk kanë asnjë ndasi apo brez mbrojtës ndaj zonave që përdoren për banim apo ndaj aktiviteteve të tjera ndotëse, pa marr parasysh asnjë masë mbrojtëse.

Figura 62. Mbivendosje e përdorimit të tokës



Punoi : Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Siç shihet dhe nga harta e mësipërme, në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh gjejmë mbivendosje të përdorimit të tokës²⁰⁶. Mbivendosjet më të shpeshta janë ndërmjet kategorive *bujqësi-ujëra*, *banim-ujëra* dhe *industri-bujqësi*, përdorime të veçanta (zona e varrezave) me banim. Mbivendosja e banimit me ujërat dhe e banimit me ujërat është e pranishme përgjatë lumit Devoll. Në NjA-të Tunjë, Kushovë, Lenie dhe Poroçan ka kryesisht mbivendosje të zonave të banimit me atë të varreza. Njësitë administrative përgjatë lumit Devoll shtrihen në terren fushor dhe kanë sipërfaqe me toka bujqësore. Në këto njësi mbivendosen banimet me tokat bujqësore. Zonat industriale dhe ekonomike mbivendosen



me ato të banimit. Ish Uzina mekanike dhe ajo e prodhimit të baterive në qytetin e Gramshit është e vendosur pranë banimit dhe pranë trupi uJOR (lumi Dvöll). Zona që ka pasur presion më të madh zhvillimi është përgjatë lumit Devöll, për arsye të karakterit fushor që ka kjo zonë. Pranë Lumit Devöll janë vendosur zona me karakter ekonomik duke krijuar mbivendosje të zonave industriale me bujqësore dhe atyre bujqësore me zonat ujore.

Ulja e rendimentit të tokave bujqësore për shkak të përdorimit intensiv të saj: Sot, bujqësia në vendin tonë përballet me ndryshime të mëdha, gjë e cila nënkupton: kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inpuveve bujqësore të panjohura më parë, shtimin e kulturave bujqësore të reja si dhe përdorimin e plehrave të ndryshëm kimik.

Në vend është vënë re shtimi i sasisë së plehrave kimike të përdorur, ndërkohë që një fenomen i ri që vihet re vitet e fundit është edhe ndryshimi i llojit të plehrave kimike të përdorura (kalimi nga plehu organik në diamond superfosfat), për të cilin nuk njihet arsyeja.

Tabela 34. Sasia e plehrave kimik të përdorur në Bashkinë Gramsh, 2016

Nr	Kultura bujqësore	DAP	Nitrat	Ure	Pleh organik
		Sasia përdorur (ton)	Sasia përdorur (ton)	Sasia përdorur (ton)	Sasia përdorur (ton)
1	Misër	249	172,5	301	18540
2	Grurë	290	208,5	371	
3	Tagji	76,1	81,5	70,5	2590
4	Perime	55	104,5	13,9	7670
5	Patate	43	75,4	7,3	4420
6	Fasule	38,9	77,9	2,7	600
7	Foragjerë	369,9	424,9	225,9	16950
8	Pemë frutore	47,1	5	51,4	1760
9	Ullishte	22,9	4,8	25,8	880
10	Vreshta	34,1	5	36,7	1260
TOTALI		1226	1160	1106,2	54670

Burimi: Bashkia Gramsh, Përpunoi: MetroPOLIS, 2017

Zhvillimi i bujqësisë ka ardhur për shkak se në këtë mënyrë garantohet rritja e prodhimtarisë dhe e përfitimeve ekonomike. Megjithatë, duhet theksuar se bujqësia intensive kërkon njohje të vetive fiziko-kimike të tokës të cilat ndihmojnë në përdorimin eficient të saj (përdorimin e inpuveve bujqësore, llogaritjen e përmbajtjes së metaleve të rënda, depërtimit të ndotjes nga toka në shtresat ujore nëntokësore, llogaritjes së sasisë së ujit të përdorur për ujitje, kohën e përdorimit etj.). Mungesa e njohjeve të tilla me kalimin e viteve çon në degradimin e tokës dhe në ndotjen e mjedisit, e sigurisht në rënien e prodhimit bujqësor dhe të zhvillimit ekonomik nga bujqësisë.

Ndotja e tokës: Në Bashkinë e Gramshit ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zonat bujqësore, industriale, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera. Si zona të ndotura, në Bashkinë Gramshit dallohet ish-Uzina e



prodhimit të baterive, ish-Uzina e mekanike/ushtarake e Çekinit, venddepozitimi i mbetjeve pranë qytetit të Gramshit, në pjesën jugore të qytetit, si dhe venddepozitimet e mbetjeve në të gjitha NjA-të, pranë përrenjve, jashtë kushteve teknike dhe higjeno-sanitare.

o Përfundime e rekomandime

Bashkia e Gramshit ka një larmi të gjerë tokash, si: fushore, kodrinore dhe malore, të cilat përdoren për prodhimin e *drithërave* (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët dhe dhentë). Megjithatë, bashkia përballë çdo ditë e më tepër me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës**, që në Gramsh është fenomen i zakonshëm për shkak të shkëmbinjëve me fortësi mesatare dhe pjerrësisë të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi, duke e thelluar dhe më shumë fenomenet, si: erozioni, shkarjet dhe shembjet e tokës. Për shkak të shirave dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë²⁰⁷. Gjatë viteve të fundit, në Gramsh mbetet i lartë edhe rreziku i erozionit të tokës, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë periudhave me shi²⁰⁸. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë bregut të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndëkohë që mirëmbajtja e lumit lë për të dëshiruar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme²⁰⁹. Njëkohësisht, në zona të caktuara, në të cilën ka qenë e zhvilluar industria, si zona përreth Ish-Uzinës mekanike të Çekinit, nuk mungon ndotja.

Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore, duke u ofruar informacionin e duhur bujqve. Ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Gramshit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së²¹⁰.

Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

4.7. Shërbimet Publike

4.7.1. Furnizimi me ujë

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gramsh, e cila ofron shërbimin e



grumbullimit dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe gjithashtu siguron largimin e ujërave të ndotura.

Bashkia e Gramsh siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik në pjesën më të madhe nga burimi i kërpicës në malin e Tomorrit rreth në jug-lindje të qytetit të Gramshit në një lartësi prej 390m mbi nivelin e detit. Prurja maksimale e këtij burimi $1m^3/s$, me një regjim të qëndrueshëm.

Klorinimi ndodh në depon kryesore në vend burim, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit. Burimi i kërpicës i plotëson kërkesa e qytetit të Gramshit për furnizimin me ujë të pijshëm.

Cilësia e ujit nga burimi Kërpicës që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft e mirë, kjo sepse burimi del në shkëmbinjtë dhe nga akuiferi me porozitet çarje-karst.

Këto ujëra janë të një cilësie të mirë si rrjedhojë e një sërë faktorëve, ndër më të rëndësishmit mund të përmendim i) mungesën e infiltrimeve të ujërave të ndotura në akuiferin nga i cili furnizohet ky burim dhe ii) respektimin e zonave higjeno-sanitare.

Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e Bashkisë Gramsh përfaqësohet nga 35 rezervuarë, të mëdhënj e të vegjel, që u shërbejnë komuniteteve në territor, volumi i përgjithshëm prej $1670 m^3$ paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Tabela 35. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm

N r	NJESIA ADMINISTRATIVE	Ujesjellesi	Burim nga funizohet	Fshati qe funizohet	Banoret	Depo Uji	
1	B A S H K I A G R A M S H	Ujes.Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	Qyteti	14396	400 m3	
2	P I S H A J	Ujesjellesi Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Pishaj</i>	905	Nga qyteti	
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Cekin</i>	855	200 m3	
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Qerret Fshati</i>	286	20 m3	
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Shemriz Fshati</i>	563	50 m3	
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Trashovic Fshati</i>	367	50 m3	
			<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Balloll</i>	279	nga Llalla	
			<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Fshati Llalle</i>	246	50 m3	
			Ujesjellesi	<i>St.pompave Holte</i>	<i>Kotorr Fshati</i>	435	20 m3
			Kotorr	<i>St.pompave Holte</i>	<i>Gjorgjovin Fshati</i>	248	20 m3
			Ujesjellesi Gjorgjovin	<i>St.pomp. Gjorgjovine.</i>	<i>Ceruje</i>	650	80 m3
			Ujesjellesi	<i>St.pomp. Gjorgjovine.</i>	<i>Fshati Drize</i>	508	30 m3
			Ujes.Galigat	<i>Burimi Proshoves</i>	<i>Fshati Galigat</i>	479	40 m3
Ujes.Stror	<i>Burimi Duzha</i>	<i>Fshati Stror</i>	263	30 m3			



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

					6084	
3	K O D O V J A T	Ujesjellesi	<i>Burimi Bulcar</i>	<i>Fshati Kodovjat</i>	423	30 m3
		Kodovjat	<i>Burimi Bulcar</i>	<i>Fshati Bersnik</i>	513	20 m3
		Ujes.Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Mashan</i>	622	50 m3
		Ujes.Zamsh	<i>Burimi =</i>	<i>Fshati Zamsh</i>	162	20 m3
					1720	
4	T U N J E	Ujes.Kerpice	<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Fshati Lubinje</i>	517	30 m3
					517	
5	K U S H O V E	Ujesjellesi Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Sotire</i>	238	50 m3
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Paktos</i>	53	20 m3
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Kushov</i>	276	30 m3
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Bregas</i>	142	50 m3
			<i>St.pompave Bregas</i>	<i>Fshati Gjeraqine</i>	88	20 m3
					797	
6	L E N I E	Ujes.Taragjin	<i>Burimi Komjanit</i>	<i>Fshati Taragjin</i>	57	20 m3
		Ujes.Lenie	<i>Burimi Komjanit</i>	<i>Fshati Q.Lenie</i>	120	15 m3
					177	
7	P O R O C A N	Ujes.Porocan	<i>Burimi Carciaj</i>	<i>F. Porocan Qender</i>	lokale	12 m3
S K E N E		Ujesjellesi Skenderbegas	<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Skenderbegas</i>	440	50 m3
			<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Narte</i>	323	30 m3
			<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Harunas</i>	153	20 m3
			<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Zenalas</i>	140	10 m3
			<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Shima</i>	221	20 m3



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

8	R	Ujes.Vidhan	Burimi Beges	Fshati Vidhan	141	20 m3
	B	Ujes.Siman	Burimi Vashes	Fshati Siman	138	20 m3
	E	Ujes.Siman	Burimi Kroi Bardhe	Fshati Kotke	220	20 m3
	G	Ujes.Ermenje	Burimi Shkuriqit	Fshati Ermenje	216	20 m3
	A	Ujes.Menkollare	Burimi Sekes	Fshati Fushez	119	20 m3
	S	Ujes.Bletes	Burimi Gurres	Fshati Bletes	147	20 m3
					2258	

Burimi: Ujësjetllës-Kanalizime Gramsh; Përgatiti: MetroPolis, 2016

Duke qënë gjithnjë në gjendje pune, rezervuarët, , klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk iu janë nënshtruar rregullisht proceseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim.

Gjithashtu agjentët atmosferikë si edhe në disa raste vegetacioni kanë ndikuar negativisht në higjenën e këtyre elementëve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri duke marrë parasysh faktin se në këto elementë mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.


VKM-ja nr. 102, datë 16.03.1992, “Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat” përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 150 litra ujë në ditë për frymë.

Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (Banesa, Institucione, Biznese).

Gjatë kësaj llogaritjeje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat për qytetin e Gramshit përllorariet të jenë në masën deri në 30-40%. Disa prej NjA-ve në Bashkinë Gramsh nuk kanë infrastrukturën minimale ndaj zgjidhja e tyre është me puse në oborret e shtëpive, apo marrja nga burime sipërfaqësore.



Tabela 36. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Gramsh



Burimi : Ujësjiellës-Kanalizime, Bashkia Gramsh; Punoi: MetroPOLIS, 2017

o Pus-shpimet

Popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar, ose individuale iniciativën për të realizuar pus-shpime, për të përmbushur nevojat e përditshme, për ujë të pijshëm dhe konsum sekundar.

Bashkia Gramsh dhe ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve, mbështetet kryesisht tek prurjet që vijnë nga burimi Kërpicës Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA-të e tjera të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pus-shpime apo burime sipërfaqësore brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.

Masa që duhen ndërmarrë për rritjen e efikasitetit të këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Masa të tjera që mund të parashikohen që të ketë rehabilitim të sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë dhe të lidhjeve me shtëpitë janë : i) rehabilitim i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë, ii) instalimi i sahatëve matës në shkallë të gjerë si edhe pajisje të tjera.

Në vlerësimin tonë nevojitet që për të qënë sa më miqësorë me mjedisin, të kontrollohen në mënyrë dinamike sasi të ujit të prodhuar nga pus-shpimet në varësi të kërkesës për konsum. Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA²¹¹ i cili në mënyrë automatike do të monitorojë nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e më pas po në mënyrë automatike do të udhëzojë pompat në lidhje me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujërave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave, pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar për t'u mbyllur.



Gjithashtu, një masë tjetër ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale si edhe nivelet kryesore e dytësore të rrjetit të shpërndarjes për konstatimin dhe shpërndarjen e të gjitha lidhjeve të paligjshme.

Kjo masë do të ndikonte duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmojë që sasia e faturuar e ujit të jetë sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve të llogaritura në projektim.

- Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm.

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Mungesa e shtrirje të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh.
- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacione të vjetëruara, ose të bllokuara.
- Humbjet në sistem: aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 30-40%. Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.

4.7.2. Ujërat e ndotura


Shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Gramshit dhe pjesërisht në Kodovjat dhe Çekin nëpërmjet sistemit të kanalizimeve. Sa i përket qytetit të Gramshit shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij. Vitet e fundit janë bërë ndërhyrje duke rikonstruktuar vetëm problematikat kryesore të sistemit të kanalizimeve në Gramsh.

Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe ujërat shiut. Ujrat e përdorura trajtohen në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura, i cili u ndërtua në vitin 2016.

Në të gjithë fshatrat e NjA-se përdoren gropa septike jashtë kushteve higjieno-sanitare për largimin e ujërave të ndotura urbane nga shtëpitë, shpesh hasen raste ku ujrat e ndotura derdhen direkt në trupat ujorë sipërfaqësor, përrenj dhe lumenj.



Figura 63. Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Gramsh



Punoi: MetroPOLIS, 2016

Aktualisht janë të identifikuar disa pika të shkarkimeve të ujrave të ndotura urbane në lumin e Devollit, kryesisht të zonave rurale, të cilët bëjnë shkarkimin direkt në ujrat sipërfaqësor. .

Diametri i tubave variojnë nga 200 deri në 800mm. Kanalet janë kryesisht tuba betoni pa bazament dhe me bashkime me llaç. Pothuaj 70-80% e rrjetit është shtrire para vitit 1980.

Zonat Urbane: Sot, Bashkia Gramsh mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura rreth 80-90% të popullsisë së NjA-së të Gramsh. Aktualisht ujrata e përdorura trajtohen në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura në pjesën veri-perëndimore të qytetit.

Zonat Rurale: Në zonën rurale të Bashkisë Gramsh nuk ekziston asnjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura (pjesërisht Kodovjat dhe Çekin, por që nuk janë plotësisht funksional). Ujërat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive, të cilat nuk respektojnë standardet higjeno-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i ujërave të ndotura nga këto gropa bëhet në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë shtëpive të tyre dhe janë në kundërshtim me kushtet teknike e sanitare të largimit të tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i ujërave urbane dhe industriale është një ndër problemet kryesore që haset sot në zonat rurale të bashkisë Gramsh. Përzierja e lëndëve ndotëse organike dhe inorganike (ujërat e ndotur urban e ato industrial) si edhe largimi i tyre deri në grykëderdhje përbën një shqetësim të madh mjedisor e shoqëror për të gjithë banorët e e zonave rurale.

o Problematikat

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në Bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efikasitet funksionin bazë. Përveç Qytetit të Gramshit, pjesa tjetër e Bashkisë



nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat ku ky rrjet shtrihet, hasen shumë probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është i vjetëruar, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe kanaleve kullues e vaditës, si pasojë e derdhjes së ujërave të ndotura të patrajuara në mjedis.

Si përfundim mund të thuhet se në Bashkinë Gramsh:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm dhe ofrohet vetëm në zonën urbane.
- Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar.
- Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndosin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore si pasojë e shkarkimit të patrajuar të tyre drejtpërdrejtë trupat ujore (kryesisht zonat rurale).
- Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujërave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare).
- Nevojitet që sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura të projekohet i ndarë nga sistemi i cili pret ujërat e larta, kjo për arsye të shmangies së mbingarkesës e cila shpesh rezulton në përmytje dhe daljen në sipërfaqe të ujërave të ndotura.
- Nevojiten të gjenden zgjidhje për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave në zonat rurale, për të eliminuar përdorimin e gropave septikë jashtë kushteve higjieno-sanitare. Vazhdimisht praktikohen mënyra të ndryshme të cilat janë mjaft efektive sa i përket eliminimit të ndotjes duke minimizuar kështu ndotjen që shkarkohet nga gropat septike.

4.7.3. Menaxhimi i mbetjeve

2.1. Politika dhe Strategjia Kombëtare mbi mbetjet

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për manaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2025, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;



Edukimi: Partnerët/bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;

Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbetjeve dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave, duke marrë në konsideratë periudhat e para dhe pas pranimit. Në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbetjeve, është llogaritur që një kosto investimesh prej 150-200 Milion EURO do të kërkohen në nivel vendi dhe më pas një fond shtesë prej 52 Milion EURO në vit si kosto operacionale.


Në mënyrë që të mirëmanaxhohen mbetjet, vendi është ndarë në nivel strategjik në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë sipas qarqeve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë, por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës. Në vazhdim, çështjet e këtyre zonave të mbetjeve do të manaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbetjeve që përbëhet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë. Plani Kombëtar i Mbetjeve ka përmbledhur dhe sugjeruar disa masa dhe veprime për mirëmanaxhimin e mbetjeve urbane dhe jo urbane, nga teknologjitë e trajtimit të mbetjeve deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

○ Principet e Manaxhimit të mbetjeve

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

Hierarkia e mbetjeve: Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.

Figura 64 Hierarkia e mbetjeve



Burimi: PKMIMU



Parimi reduktues: Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;

Parimi parandalues: Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet;

Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë: Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të manaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.

Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit: Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e manaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu kostot mjedisore dhe kostoja e manaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

- **Kuadri ligjor dhe detyra ligjore te bashkisë**

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2008-2017, legjislacioni Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit. Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Manaxhimit të mbetjeve:

Tabela 37. Kuadri Ligjor për Manaxhimin e Mbetjeve

Ligjet	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
VKM-të	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane”
	VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura "
	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "
	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
	VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
	VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

	VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
	VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
	VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
	VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
	VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
	VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
	VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
Udhëzime	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS 2017

Tabela 38. Detyrimet Kryesore që rrjedhin nga ligji për menaxhimin e mbetjeve

Mbetjet		
Ligji Nr.8094, datë 21.03.1996 "Për Largimin Publik të Mbeturinave"	Neni 7	Bashkia/NjA-të vendosin pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave në kosha, kazanë e stacione betoni.
	Neni 9	Bashkia/NjA-të, në bashkëpunim me organet kompetente, përcaktojnë metodat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave.
	Neni 14	Bashkia e qytetit dhe NjA-të kontrollojnë dhe mbikëqyrin largimin e mbeturinave, në përputhje me kushtet tekniko-higjienike, në zbatim të kontratës, nga personat e autorizuar prej saj.
	Neni 20	Bashkia organizon largimin publik të mbeturinave.
VKM Nr.333, datë 26.01.2001 "Për Administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane"	Pika 2	Bashkia bashkëpunon me bashkitë e tjera në nivel qarku për harmonizimin e politikave rajonale për ushtrimin e funksioneve të përbashkëta.
	Pika 5	Bashkia bashkëpunon me Këshillin e Qarkut i cili planifikon sipërfaqe të caktuara për t'u përdorur për administrimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, si dhe përcakton vend-depozitimet për mbetjet e ndërtimit.



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve, 19 gusht 2010	4.3.7	Bashkia, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, <i>koordinon planifikimin dhe ngritjen e qendrave të pritjes për mbetjet e rrezikshme shtëpiake, shërbimet dhe industrinë e vogël.</i>
VKM Nr. 798 , datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”	Pika 4	Bashkia <i>miraton vendndodhjen e impianteve të përpunimit të mbetjeve spitalore dhe vend-depozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme.</i> Bashkia <i>monitoron administrimin e mbetjeve spitalore sipas kompetencave.</i>
Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve”	Neni 12	Bashkia: <i>- harton Planin Vendor të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion;</i> <i>-përcakton rregulloren për kontrollin e manaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve.</i>
	Neni 62	Bashkia <i>sanksionohet me gjobë në rast se nuk respektohen standardet e manaxhimit të mbetjeve brenda territorit të saj.</i>
Vendim (Projekt) Nr. 418 , datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim	Neni 4	<i>-Bashkia merr masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara në këtë ligj.</i>
	Neni 9	Bashkia <i>merr masat mbi arritjen e objektivave dhe afateve të përcaktuar në këtë vendim.</i>
VKM Nr. 608 , datë 17.09.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”	Pika 4	Bashkia <i>grumbullon mbetjet bio në mënyrë të diferencuar deri në vitin 2018</i>
	Pika 9	Bashkia ka për detyrë: <i>-uljen në masën 50% të peshës totale të mbetjeve bio, të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;</i> <i>- uljen në masën 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 12 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.</i>
	Pika 11	Në Planin Vendor të Manaxhimit të Mbetjeve, <i>Bashkia duhet të përcaktojë masat, kriteret dhe rregullat për grumbullimin dhe manaxhimin e mbetjeve bio, në përputhje me Planin Rajonal dhe Planin Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve.</i>
	Pika 13	Bashkia <i>siguron kontienierë individualë për zonat me shtëpi private.</i>
	Pika 14	Bashkia, në zonat rurale <i>përcakton mënyrat, vendet dhe afatet kohore për trajtimin e mbetjeve bio në shtëpi ose lagje.</i>
	Pika 15	Bashkia <i>duhet të bashkëpunojë me bashki (NJQV) të tjera për sisteme të përbashkëta të grumbullimit të mbetjeve bio si dhe për ngritjen e skemës së ndarjes së mbetjeve bio.</i>
	Pika 16	Bashkia <i>krijon një bazë me të dhëna rreth peshës së mbetjeve bio të grumbulluara.</i>
	Pika 17	NjQV <i>raporton</i> çdo fundviti në Këshillin e Qarkut të dhënat mbi grumbullimin e mbetjeve bio dhe objektivat e trajtimit.
VKM Nr. 575 , datë 24.06.2015 “Për miratimin e Kërkesave për Manaxhimin e Mbetjeve Inerte”	Pika 13	Bashkia, në Planin e Përgjithshëm Vendor si dhe Planin Vendor të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve, <i>duhet të parashikojnë vende për</i>



		<i>depozitimim e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe vend-depozitim për mbetjet inerte.</i>
	Pika 19	Bashkia bashkëpunon me bashki të tjera për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet vend-depozitimi rajonal dhe për mënyrën e funksionimit të tij.
	Pika 21	Bashkia duhet të përcaktojnë vendin e depozitimit të mbetjeve inerte.
Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 23	Bashkia mbledh, largon dhe trajton mbetjet e ngurta dhe shtëpiake.

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS 2017

- **Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Gramsh**

Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, shpërndarë në funksion të dëndësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi dhe trajtimi i tyre, si edhe depozitimi i tyre përfundimtar.

Bashkia Gramsh aktualisht mbulon me shërbim të menaxhimit të mbetjeve urbane NjA-në e Gramshit dhe NjA-në Pishaj dhe Kodovjat, dy të fundit në masën 30%. Në NjA-në Gramsh grumbullimi dhe largimi i mbetjeve kryet nëpërmjet sipërmarjes private “Kurora” Shpk, ndërsa NjA Pishaj dhe Kodovjat bashkia e kryen vetë këtë shërbim. Përveç NjA-së Gramsh dhe pjesërisht Pishaj dhe Kodovjat, në të gjitha NjA-të e tjera nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane. Menaxhimi i mbetjeve në NjA-në Gramsh, Pishaj dhe Kodovjat bëhet me skemë tepër bazike, ku proceset e mbetjeve kalojnë nga gjeneruesi në pika grumbullimi, mbledhja dhe depozitimi në fushën e depozitimit të mbetjeve, e cila nuk plotëson standartet e një landfilli sanitar. .

Sot, Bashkia Gramsh mbulon me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta urbane (MNU) 50% të popullsisë, e cila është e përafërt me numrin e popullsisë të NjA-së Gramsh dhe të fshatrave Pishaj dhe Kodovjat. NjA-të në të cilat nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të MNU-së, janë gjetur zgjidhje individuale nga banorët, të cilët i depozitojnë ato në pika të pa autorizuar dhe shpesh herë përgjat rrjedhave të përrrenjëve dhe lumenjëve.

Si në të gjitha qendrat urbane të vendit, edhe në Bashkinë Gramsh, mbledhja e mbetjeve urbane bëhet me metodat tradicionale. Nga zyra e urbanistikës është përcaktuar skema e shpërndarjes në terren të pikave mbledhëse të mbetjeve të ngurta urbane. Në qytetin e Gramshit funksionojnë 101 pika të tilla, 90 prej të cilave janë vendosur kazanë prej llamarine me vëllim 1100L, ndërsa 11 pika të tjera janë platforma prej betoni. Personeli përkatës i subjektit “KURORA” shpk evadon çdo ditë, mbetjet urbane, duke i dërguar ato në fushën e depozitimit të përkohshëm të tyre. Transporti i mbetjeve urbane bëhet nga makina teknologjike me kapacitet 7 ton. Distanca mesatare e transportit nga vëndet e mbledhjes së mbetjeve urbane, në fushën e re të depozitimit të përkohshëm të tyre është rreth 5 km.

Gjëndja e rrugëve ku lëviz mjeti i transportit të mbetjeve urbane është e përgjithësisht e mire. Trafiku në rrugën që shkon në venddepozimin e mbetjeve mund të vlerësohet disi



intensiv sepse ky është një aks rrugor që lidh qytetin e Gramshit me Njësitë Administrative Kodovjat dhe Kukur dhe më tej deri në Qytetin e Korçës.

- **Gjenerimi i mbetjeve të ngurta urbane**

Gjat viti të shkuar Bashkia Gramsh ka gjeneruar rreth 8,810t/vit²¹², thënë ndryshe, afërsisht 24.1 t/ditë (gjenerim për të gjithë territorin e bashkisë). Norma mesata e prodhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë është 0.7 kg/ditë/banor. Norma e gjenerimit për bizneset është 10 kg/ditë, kjo për bizneset e vogla dhe të mëdha, ndërsa për institucionet është 12 kg/ditë. NjA-ja Burrel prodhon rreth 9.5 t/ditë mbetje urbane, ose rreth 39.4% të mbetjeve të gjeneruara në territorin e bashkisë.

Sasia më e madhe e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë vijnë nga sektori familjar, e ndjekur nga biznesi i vogël, biznesi i madh dhe me sasinë më të vogël të gjeneruar renditen institucionet. Nga sasia totale e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë rreth 72% e tyre prodhohet nga sektori familjar, rreth 22% nga biznesi i vogel dhe i madh, rreth 6% nga institucionet.

Tabela 39. Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Gramsh,

Bashkia Gramsh						
Nr.	Emertimi	Njesia	Nr.	Norma kg	kg/dite	Ton/vit
1	Nr. Banore	fryme	24,484	0.7	17,138	6,255
2	Biznes i vogel	cop	493	10	4,930	1,799
3	Biznes i madh	cop	57	10	570	208
4	Institucione	cop	125	12	1,500	547
	Shuma				24,138	8,810

Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

Mbetjet e prodhuara nga NjA-të varet kryesisht nga numri i popullsisë në to, pasi sasia më e madhe e prodhuar e mbetjeve vjen nga prodhimet familjare, që do të thotë, që sektori i biznesit, apo sektorë të tjera kanë sasi më të ulët prodhimi mbetjesh sesa sektori familjar. Siç edhe është përmendur më lar, NjA Gramsh ka sasinë më të madhe të gjenerimit të mbetjeve.

- **Vend-Depozitimi i mbetjeve urbane**

Vend depozitimi i mbetjeve ndodhet rreth 5 km larg nga qendra e qytetit të Gramshit, në Fshatin Çkrezë. Vend depozitimi ndodhet shumë pranë nga Lumi Devoll. Ky vend-depozitim është vënë në funksion në vitin 2016. Në një moment të mëvonshëm, mendohet të bëhet seleksionimi i mbetjeve dhe në landfillin rajonal të depozitohen vetëm mbetjet e pariciklueshme. Deri atëherë, rekomandohet që Bashkia të marrë masa parandaluese që sigurojnë se elementët ndotës në përbërjen e shllamit të mos përfundojnë në ujërat sipërfaqësore të Devollit, dhe më tej në ujërat nëntokëse, që përkon me rrjedhën e Devollit në zonën e akuiferit me porozitet ndërkokrrizor.



NjA-të e tjera të Bashkisë Gramsh, nuk kanë vend-depozitime të përcaktuara duke rritur hapsirat e shpërndarjes së mbetjeve në pika më të vogla dhe vështirësuar mbledhjen dhe pastrimin e tyre.

Metodat e depozitimit.

Njihen dy metoda kryesore të depozitimit të mbetjeve urbane që janë:

- a) Depozitim i thjeshtë
- b) Depozitim i kontrolluar (Bashkia Gramsh ka përpjekje në këtë drejtim)

Depozitim i thjeshtë konsiston në shkarkimin/grumbullimin e metjeve urbane në terrene apo gropa të ndryshme, pa marrë masa të veçanta. Në shumicën e rasteve këto depozitime bëhen vatra të grumbullimit të insekteve, kafshëve dhe shpendëve parazitar që tërhiqen dhe ushqehen nga lëndët organike që përmbajnë këto mbetje. Kjo lloj metode sjell impakte serioze negative mbi mjedis, prishin pejsazhin, përhapin erëra të këqia, emetojnë gaze dhe lëngje që ndotin mjedisin dhe sjellin pasoja të vlerësueshme në shëndetin e popullatës në përgjithësi.

Depozitimi i kontrolluar konsiston në sistemimin e mbetjeve urbane në teritore të përpunuar dhe ndërtuara paraprakisht, duke i përshtatur ato për mbajtjen e mbetjeve urbane për kohë relativisht të gjata. Përgatitja konsiston në vendosjen e shtresave natyrore apo artificiale të cilat nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve që dalin nga dekompozimi i mbetjeve në shteresat e tokës dhe kështu eliminohet ndotja e tokës dhe e ujrave nëntoksore. Gjithashtu mënyra e sistemimit të mbetjeve në këto terrene bëhet e tillë që mund të mbledhet dhe administrohet biogazi që del gjatë dekompozimit të mbetjeve dhe, të përdoret ai për qëllime komunale.

Figura 65. Venddepozitimi i mbetjeve urbane B. Gramsh



Burimi: GgoogleImagery

○ **Mbetjet Inerte**

Në territorin e Bashkisë së Gramshit nuk dihet sasia e gjeneruar e mbetjeve inerte. Gjatë vizitave në terren dhe sipas informacioneve pranë zyrave të bashkisë rezultojnë që mbetjet




inerte janë të pa trajtuara, gjenden të depozituara përgjatë brigjeve të lumjnjëve dhe anës rrugëve automobilistike. Aktualisht bashkia nuk ka një plan për menaxhimin e kësaj rryme mbetjesh dhe nuk disponon një vend depozitim për mbetjet inerte. Pra shihet emergjente hartimi dhe mirë menaxhimi i kësaj rryme të mbetjeve dhe gjetja e mundësive për ripërdorim dhe riciklim të tyre.

Aktualisht Bashkia ka ngritur një propozim në Planin e Përgjithshëm Vendor, nisur edhe nga sygjerimet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për të ndërtuar vend-depozitim të mbetjeve inerte pranë venddepozitimit aktual të mbetjeve urbane. Kjo zonë vlerësohet paraprakisht si terren i përshtshëm për të instaluar vend-depozitim të mbetjeve inerte, por sygjerohet që të studiohet më hollësisht gjatë implementimit të projektit, në mënyrë që të merren masa tekni për parandalimin e dëmëve specifike në mjedis. Zona e propozuar ndodhet në afërsi të aksit automobilistik Gramsh – korçë, rreth 5 km nga qyteti i Gramshit, aty ku aktualisht është vend-depozitimi I mbetjeve urbane. Kjo zonë do të rehabilitohet dhe më pas do të mendohet për zbatimin e projektit për ndërtimin e vend-depozitimit të mbetjeve inerte.

Theksohet që bashkia duhet të ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkiake, hartimi i së cilit buron si detyrim nga Ligji për Menaxhimin e integruar të Mbetjeve, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, Ligji Për Vetëqeverisjen Vendore (seksioni i detyrimeve ligjore).

Figura 66. Propozimi për vend-depozitim të mbetjeve Inerte



Burimi; GoogleImagery dhe MetroPOLIS, 2017

- **Mbetjet spitalore**

Mbetjet spitalore manaxhohen nga subjekti privat Medi-Tel, i cili i tërheq mbetjet periodikisht sipas kontratës së lidhur me subjektetpërkatese. Kompania MediTele ofron shërbimin e sterilizimit dhe grirjes së mbetjeve spitalore. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre



mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjetet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Mbetjet spitalore të gjeneruara në spitalin e Gramshit arrijnë në rreth 400 kg/muaj, ndërsa mbetje të tjera që mund të gjenerohen nga qëndrat shëndetësore dhe nga subjekte të tjera nuk njihet.

Problematike mbeten edhe mbetjet farmaceutike. Rezulton se asnjëra nga farmacitë nuk ka marrëdhënie kontraktuale me ndonjë nga subjektet e licensuara në fushën e trajtimit të mbetjeve spitalore. Farmacitë i manaxhojnë vetë mbetjet, thjesht duke i depozituar në kazanët e mbetjeve urbane ose drejtpërdrejt në vend-depozitim kryesor të mbetjeve. Siç mund të shihet, për sa i takon manaxhimin të mbetjeve, farmacitë e kryejnë aktivitetin e tyre jashtë të gjithave kushteve ligjore.

○ **Mbetjet Elektronike**

Rregullat për trajtimin dhe kasifikimin e mbetjeve elektronike nuk e parashikojnë depozitim e tyre në landfill. Pra aktualisht Bashkisë Gramsh, duke qënë se të gjitha objektet apo materialet e klasifikuara si mbetje i manaxhon duke i transportuar dhe depozituar në Vend-depozitim e Gramshit apo pikave të tjera, i lind nevoja që të ndërtojë një qendër për trajtimin e diferencur të kësaj rryme.

Gjenerues të këtyre mbetjeve janë si familjarët ashtu edhe bizneset private, që operojnë në Bashkinë Gramsh. E vetmja mënyrë për të arritur manaxhimin e mbetjeve tek ata dhe jo mbetja tek konteineri është nëpërmjet realizimit të një plani specifik të manaxhimit për këtë rrymë dhe aktivizimi i fushatave sensibilizuese.

○ **Mbetje të tjera**

Ndër mbetjet e tjera mund të klasifikojmë:

- Mbetjet nga gommat e përdorura,
- Mbetjet nga karkasat e makinave
- Mbetjet nga vajrat e përdorur. etj

Edhe këto rryma të identifikuar, siç ndodh me mbetjet EE, nuk diferencohen apo të trajtohen por grumbullohen sëbashku me mbetjet urbane dhe derdhen në vend-depozitim e përcaktuara.

Diferencimi në burim si edhe trajtimi i seleksionuar sipas parimit Redukto – Ripërdor – Riciklo është sfida më e madhe, që parashtrohet në Bashkinë Gramsh, sfidë e cila vjen paralelisht me rehabilitimin e zonave të ndotura nga depozitimi jashtë kushteve teknike të mbetjeve deri më sot.

Në funksion të gjeneruesëve të identifikuar, si edhe atyre potencialë, nevojitet që të merren masa për trajtimin e mbetjeve me origjinë industriale, pra mbetjeve me potencial rreziku të lartë. Duke qënë detyrim ligjor i adresuar nga vetë prodhuesit, qoftë nga Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006, qoftë edhe nga leja Mjedisore që ata posedojnë, Bashkia Gramsh mund të asistojë në përcaktimin e një pozicioni ku këto mbetje do të depozitohen dhe trajtohen të diferencuara.

○ **Riciklimi dhe kompostimi**



Për sa i përket riciklimit të mbetjeve, në Bashkinë Gramsh nuk dihet sasia e saktë e ricikluar. Bashkia Gramsh raporton se riciklimi kryhet në rrugë jo formale për grumbullimin e mbetjeve të plastikës dhe metalit. Mbetjet e ricikluara janë zakonisht alumini dhe hekuri dhe vitet e fundit është rritur interesimi mbi plastikën.

Tabela 40. Përbërja merceologjike e mbetjeve²¹³

Loji	Pëmbajtja në %	Kg/ditë	Ton / vit
Organike	47.36	1.106	4172
Druri	1.43	33.0	125
Letër	5.37	125.0	473
Karton	8.13	190.0	716
LD Plastike	8.46	198	745
HD Plastike	4.75	111	418
Qelq	5.75	134	506
Tekstil	5.27	123	464
Metale ferroze	0.56	13	49
Metale me ngjyrë	0.57	13	50
Mbetje Spitalore	0.17	4	14.9
Produkte Kauçuku	0.20	5	17.6
Mbetje inerte	7.20	168	634
Mbetje sanitare	3.25	76	286
MPEE	0.31	7	27
Bateri	0.02	1	1.7
Prodhime të mbetjeve nga kafshët	1.08	25	95

Burimi: Bashkia Gramsh dhe metroPOLIS 2017

Megjithëse një proces kryesisht informal, riciklimi mbetet i domosdoshëm, synimi i bashkisë duhet të jetë formalizimi dhe kontraktimi i procesit të riciklimit në të gjithë Bashkinë Gramsh si edhe të synojë riciklimin në masën 60% kundrejt totalit të mbetjeve të riciklueshme, duke reduktuar gjithnjë e më tepër sasinë e mbetjeve të riciklueshme, të cilat zënë volume të mëdha në landfill-e.

Bashkia Gramsh do të marrë të gjithë masat e nevojshme për të reduktuar sasinë e mbetjeve të prodhuara, dhe të rikuperojë një vlerë maksimale nga mbetjet që prodhohen. Strategjia Kombëtare e Mbetjeve e adopton hierarkinë e mbetjeve si një nga parimet themelore të saj.

Në zbatim të detyrime të përcaktuara në V.K.M. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Bashkia Gramsh duhet të realizojë grumbullimin e diferencuar për rrymat e mbetjeve, të pasqyruara në tabelën në vijim:

Tabela 41. Përbërja merceologjike e mbetjeve²¹⁴



Lënda	Sasia e Riciklimit në %		Sasia e rikuperuar	
	Ndaj Totalit	Ndaj kësaj rryme	Ton/ditë	Ton/vit
Letër	5.37	15.98	1.3	473
Karton	8.13	24.20	1.9	716.2
Metale ferroze	0.56	1.66	0.13	49.3
Metale me ngjyrë	0.57	1.69	0.14	50.2
LD plastike	8.46	25.18	2	745.3
HD Plastike	4.75	14.00	1.15	418.5
Qelq	5.75	17.11	1.38	506
Total	33.59		8	~2,958.

Burimi: Bashkia Gramsh dhe metroPOLIS 2017

Këto rryma mbetjesh përbëjnë rreth 33.58 % të totalit të mbetjeve ose 2,958 ton në vit duke e zbritur në këtë mënyrë sasinë e mbetjeve për t'i dërguar në fushën e depozitimit të mbetjeve nga 8,810 ton në vit në 5,852 ton në vit. Nga të dhënat e paraqitura në formë analitike, në tabelën më lart, rezulton se kemi një rrymë mbetjesh në sasisë prej 8 ton/ditë të cilat nuk do depozitohen por do të riciklohen. Kështu rryma ditore e mbetjeve që do shkojnë në landill do të jetë 16 ton/ditë, nga rreth 24.5 ton – ditë që është gjenerimi aktual i mbetjeve.

Mbetjet e thata, ligji i përkufizon si një grup mbetjesh ku përfshihen rrymat e mbetjeve të tilla si: letër/karton, metal, plastikë, qelq, materialet e të cilave, nëpërmjet çdo operacioni rikuperimi, ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, material apo substance për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera.

Në zbatim të VENDIM Nr. 608, datë 17.9.2014 PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË NEVOJSHME PËR GRUMBULLIMIN DHE TRAJTIMIN E MBETJEVE BIO SI DHE KRITERET DHE AFATET PËR PAKËSIMIN E TYRE, Bashkia Gramsh duhet të arrijë objektivat:

- Jo më vonë se pesë (5) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në lëndfill pakësohen në (janë sa) 75% të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme, të gjeneruara në vitin 2010.
- Jo më vonë se 8 (tetë) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në lëndfill pakësohen në (janë sa) 50% të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme, të gjeneruara në vitin 2010.
- Jo më vonë se 13 (trembëdhjetë) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në lëndfill pakësohen në (janë sa) 35% të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme, të gjeneruara në vitin 2010. Mbetjet bio janë 47.36% e mbetjeve ose rreth 4,172 ton në vit.

Sipas Ligjit “Për menaxhimin e interuar të mbetjeve” Nr 10 463 datë 22.09.2011 “Mbetje bio” janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet



ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, katering dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelat e mësipërme rezultojnë:

- 47.36% janë mbetje organike të riciklueshme të cilat mund të kompostohen për të prodhuar plehun organik;
- $5.37\% + 8.13\% = 13.5\%$ letër, karton, mbetje që mund të ripërdoret si lëndë e parë për industrinë e letrës. Në Shqipëri funksionon subjekte private që i mbledhin ato.
- $8.46+4.75=13.21\%$ plastikë e lehtë + plastikë e rëndë mbetje që mund të ripërdoret si lëndë e parë për industrinë e plastikës. Në Qarkun Elbasan ekzistojnë disa linja përpunimi të mbetjeve plastike.
- 1.13 % metale, të cilët mund të përdoren gjithashtu si lëndë e parë në industrinë e prodhimit të çelikut (KURUM International shpk po në Elbasan. Kjo shifër flet qartë që kjo mbejtje mblidhet).
- Rreth 90 % e sasisë së mbetjeve që prodhohet në Qytetin e Gramshit, mund të kompostohet, ripërdoret apo të riciklohet. Nëse arrihet të realizohet praktikisht një gjë e tillë, do të kemi jo vetëm gjenerim të të ardhurave por, ajo që është më e rëndësishmja, mbrojtjen e burimeve natyrore.


• Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Gramsh aktualisht nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane. Situata aktuale e mbetjeve është problematike, kryesisht në vend-depozitim, i cili nuk është në kushtet e kërkuara dhe në disa zona vërehen mbetje të hedhura rishtaz. Mbetjet inerte dhe ato industriale nuk menaxhohen dhe nuk kanë një vend të përcaktuar për depozitim dhe tyre. Sot, territori i bashkisë nuk mbullohet i gjithi me shërbimin e mbledhjes dhe terheqjes së mbetjeve urbane.

Në këtë kontekst bashkia e Gramshit duhet të ndërmarrë nisma konkrete, fillimisht për të hartuar Planin Lokal të menaxhimit të mbetjeve dhe të ndërtojë një skemë afatgjatë për menaxhimin e mbetjeve në territorin e saj. Reduktimi, Ripërdorimi dhe Riciklimu duhet të jenë konceptet bazë mbi të cilin duhet të udhëhiqet skema e menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë. Bashkia duhet të ndërmarrë gjithashtu veprime konkrete për të ndërtuar të paktën një stacion transferimi të mbetjeve dhe një pikë kompostimi, ndërsa trajtimi final i mbetjeve duhet të parashikohet për të dërguar në landfill-in e Elbasanit apo të trajtohen me djegie në inceneratorin e mbetjeve në Elbasan.



Figura 67. skema e propozuar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS 2017


Skema e sygjeruar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë qëndron në futjen e instrumentave për reduktimin dhe ripërdorimin e mbetjeve, mbledhjen në pika grumbullimi publike dhe diferencimi i tyre në stacion transferimi (mbetjet organi të kompostohen) dhe asgjësimi përfundimtar i tyre të bëhet në landfill-in e Elbasanit apo të trajtohen me djeie në inceneratorin e Elbasanit.

Specifikisht për menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë rekomandohet:

Vend-depozitimi aktual duhet ti nënshtrohet rehabilitimit mjedisor dhe të mendohet për ndërtimin e stacionit të transferimit po në të njëjtin vend. Stacioni i transferimit të jetë në standartet dhe parametrat teknik të pranueshëm dhe të mundësojë diferencimin e mbetjeve në të.

Në të njëjtën vendodhje të ndërtohet edhe pika e kompostimit, gjithashtu të mendohet edhe për skema individuale apo kolektive të vogla në disa zona ku shihet e arsyeshme që të mundësohet kompostimi i mbetjeve me orgjinë bio.

Figura 68. Propozim për St. Transferimi, Pikë Kompostimi dhe Venddepozitim inertesh



Burimi: GoogleImagery dhe MetroPOLIS, 2017



Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë kopetencë e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në zonat ish industriale të Bativerive në Gramsh. Zona ka nevojë urgjente për rehabilitim mjedisor dhe kthimi në një zonë të sigurt.

Formalizimi i riciklimit të mbetjeve në teritorin e bashkisë është një tjetër sfidë, e cila kërkon ngritjen e skemave të grumbullimit të mbetjeve të paktën me dy kosha, fillimisht në zonat me densitet të lartë të popullsisë.

Mbetjet inerte duhet të menaxhohen dhe depozitohen me standartet e kërkuara, fillimisht duhet të ndërtohet vend depozitimi për këtë rrymë mbetjesh, vend i sigjeruar mbetet në krah të stacionit të transferimit (i propozuar), në zonën ku aktualisht ndodhet vend-depozitimi i mbetjeve urbane. Gjatë ndërtimit të këtij vend-depozitimi duhen zbatuar të gjitha kërkesat teknike që të parandalohet

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë teritorin e Bashkisë Gramsh.

4.8. Ndryshimet klimatike dhe rreziqet

o Ndryshimet klimatike në Rajon

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- Një rritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- Një ulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshim të regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)²¹⁵.

Këto fenomene parashikohet të kenë pasojat të theksuara në zhvillimin e rajonit, sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësim të ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshime në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshim të habitateve, pakësim në numër dhe lloj të specieve, shtim të llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.²¹⁶

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat. Të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm, që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës e cila është zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë:²¹⁷

- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperaturës do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëborës parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin nga kjo.



- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.
 - o Ndryshimet klimatike në Shqipëri

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të këtë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë²¹⁸:

- Rritja e temperaturave
- Ulja e sasisë së reshjeve,
- Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit
- Rritja e nivelit të detit²¹⁹.

Rritja e temperaturave: Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990 (Tabela 67)

Tabela 42. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperaturës (Referuar Tem. Mes. 1990)


Stinët	Vitet			
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016²²⁰; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe skenari maksimal 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080, temperatura mund të rritet me 2.8°C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar arrin shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1°C.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8°C në vitin 2050, dhe një rritje me 4.6-6.0°C në vitin 2100, referuar temperaturavetë vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25°C në vitet 2050, dhe në 30°C në vitin 2100.

Figura 69. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016²²¹; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017



Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë $>35^{\circ}\text{C}$ pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 43. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 1961-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Nr. ditëve me $T_{\text{maks}} > 35^{\circ}\text{C}$	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperaturë të ftohtë	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016²²²; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme (Tabel 94), përgjatë gjithë viteve të ardhshme deri në vitin 2100 do të kemi një rritje të ditëve me temperatura maksimale mbi 35°C , ku ng 1.7-5.8 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arrijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, nërsa në pjesën qendrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, ditët me valë të nxehta do të rriten përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990, në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qendrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë aspak të pranishme në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valët të ftohtë nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 44. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me $T_{\text{min}} < 0^{\circ}\text{C}$	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390



Ditë me valë të ngrohta	Jug	1168	1130	1110	1090	10702
-------------------------	-----	------	------	------	------	-------

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016²²³; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Si pasojë e rritjes së temperaturës, dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësi të konsiderueshme dhe mot të nxehtë. Ndikim të menjëhershëm do të ketë në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; nëkërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm, që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit (Tabela 69).

Tabela 45. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3 to 10.75)	-14.26 (-45.1 to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016²²⁴; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080, dhe deri në mbi 18% në vitin 2100. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësisë të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore, vihet re që stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhe të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Gramsh do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitetet. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet më kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje, dhe nga ana tjetër, një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazitë, mikrobe, insekte), do të jetë një problem i qenësishëm rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve, të cilët dëmtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për përshtatjen bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.



Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve, fenomenet ekstreme të motit si përmbytjet, valët e të nxehtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve, i ndihmuar nga shirat intensive, që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara, duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të territorit të Bashkisë Gramsh janë bërë pre e përmbytjeve të vazhdueshme nga Lumi Devoll, kryesisht tokat bujqësore pranë brigjeve. Në vitet e fundit, ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave intensivë, të cilët janë tepër problematike në fryrjen e menjëhershme të lumenjve, dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përbalimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

- Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike

Bujqësia²²⁵: Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndryshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve) etj. Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjetë kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me rritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësisë dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet klimatike, pasi rritja e temperaturës shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarinë ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Gramsh do të hasen jo pak ndryshime. Ndryshimet kryesore në lidhje me zhvillimin bujqësor janë rritja e temperaturës, shtimi i kohës së kultivimit, valët e të nxehtit, zgjatja e periudhës së thatë, shtimi i dëmtuesve të bujqësisë dhe mundësia e mungesës së ujit vaditës në disa zona. Rritja e temperaturës mesatare vjetore ka ndikim direkt në zhvillimin e bujqësisë, pasi kulturat aktuale, të cilat përdoren në tokat bujqësore, nuk do të përshtaten maksimalisht me temperaturat në rritje, apo disa prej tyre do ta kenë të pamundur të përshtaten, e për pasojë do të kemi të korra më të ulëta nga bujqësia. Intensifikimi i valëve të tënxehtit dhe ulja e reshjeve në periudhën e kultivimit të bujqësisë pritet të ketë një ndikim të madh në zhvillimin e bujqësisë, pasi do të kërkojë sasi të mëdha uji për vaditje, ndërsa zona të cilat nuk kanë akses në kanalet vaditës do të reduktojnë maksimalisht sasinë e të korrave. Rritja e temperaturës dhe zvogëlimi i valëve të ftohta në



dimër do të këtë një ndikim direkt në shtimin e dëmtuesve të tëmbjellave bujqësore, pasi shume prej këtyre dëmtuesve (duke mos pasur temperature të ulta në dimër) do të mund të shtohen duke rritur periudhën e riprodhimit të tyre. Kjo situatë do të çojë në rritjen e kostos së prodhimit, në sajë të përdorimit të pesticideve, nëulje të cilësisë së prodhimit dhe nërënie të rendimentit.

Burimet ujore (Energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)²²⁶: Përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtësia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujqor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave intensive parashikohen të jenë më të shpeshta duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend tëplotësohet nga HEC-et, rritja e temperaturës do ta shtojë mungesën e ujit, i cili do të duhet për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji dhe bujqësinë. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrija e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi etj. Prodhimi i energjisë pritet të ketë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qënë së ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq, diferenca midis prodhimit dhe nevojës për ujë mund të zbutet me çështje teknike dhe të politikave.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimit në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimit.

Popullsia: Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizmi dhe bujqësia. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikrobeve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peizazhit).

Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasishumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuencës së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturë sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte etj.²²⁷

- Përfundime dhe rekomandime



Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.²²⁸ Në këtë kontekst, shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtja ndaj erozionit të tokësetj.

Edhe për Bashkinë Gramsh, sektorët që do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike janë bujqësia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore²²⁹. Në territorin e Bashkisë Gramsh kalojnë ujërat e lumit Devol, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye, duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekuar edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

4.9. Zonat e nxehta mjedisore

Gjatë kohës së sistemit komunist në Republikën e Shqipërisë ndotjet më të mëdha janë trashëguar nga aktiviteti industrial. Të gjitha industritë të cilat funksionuan gjatë asaj periudhe prodhuan mjaftueshëm mbetje, të cilat në vitet që pasuan u magazinuan pa asnjë masë minimale të sigurisë teknike. Në vitin 1990, industria kontribuonte në më shumë se 37% të GDP-së në vend. Ky tregues u ul në 12% në vitet 1999 ku edhe sot karakterizohet nga ulje-ngritje, të cilat janë kryesisht produkt i politikave të paqëndrueshme miratuar e shfuqizuar në vendin tonë.

Problematikat lidhur me këto zona filluan të dilnin në pah dhe e vështirësuan më tepër situatën si pasojë e mbylljes së industrive dhe lënien në mënyrë të pakontrolluar të depozitave me kimikate dhe elementëve ndotës në mjedis, zhvillimi i zonave urbane pranë zonave industriale, si dhe papërgjegjshmëria e individit.

Sot, numurohen të paktën 9-10 vatra të nxehta mjedisore (*prioritare*) në të gjithë vendin, por lista mund të zgjatet nëse tregohemi të matur dhe realistë kur marrim në konsideratë ndotjet e vazhdueshme të prodhuara nga ujërat e ndotura të zonave urbane dhe industriale si dhe vlerësojmë gjendjen e venddepozitimeve në të gjithë vendin e veçanërisht në venddepozitimet që ndodhen në brigjet e lumenjve apo në zona totalisht të papërshtatshme nga ana mjedisore.

Në Bashkinë Gramsh, industria ka qenë sektori kryesor i zhvillimit të kësaj Bashkie, e fokusuar në sektorin e prodhimit të baterive dhe prodhimin e armëve për kombëtorinë.

Referuar raportit të UNECE-s mbi hotspotet në vendin tonë, të hartuar në vitin 2012²³⁰, Bashkia e Gramshit nuk ka asnjë veprimtari ose ish-veprimtari të cilësuar si vatër e nxehtë mjedisore, por në territorin e Bashkisë së Gramshit shtrihen zona të ndotura nga: veprimtaria industriale, mbetjet urbane, ujërat e ndotura etj, veprimtari të cilat kanë shkaktuar një ndotje të akumuluar në territor.



Uzina e prodhimit të baterive (jug-lindje te qytetit) në Gramsh nuk është identifikuar si zonë e nxehtë mjedisore, por mendohet se mbetet dhe ndotja që ka shkaktuar gjatë kohës që ka funksionuar është e madhe. Në zonën industriale, e cila është jashtë funksionit, mendohet se vazhdojnë të jenë të depozituara sasi të mëdha të cianurit të pluhurit të zhivës²³¹.

Në këtë sipërfaqe janë të depozituara ndër vite sasi të mëdha baterish. Bateritë kanë në ndërtimin e tyre element ndotës, si: plumbi dhe zhiva, të cilat njihen për efektin e tyre shkatërrues për mjedisin, por sidomos dhe për jetën e njerëzve.

Plumbi mund të hyjë në trupin tonë nëpërmjet ushqimit ose ujit që përmban këtë element, i cili mund të shkaktojë shumë probleme shëndetësore. Plumbi mund të ndikojë pothuajse në çdo organ dhe sistem në trupin tuaj. Tek të rriturit, plumbi mund të rrisë presionin e gjakut dhe të shkaktojë fertilitet, çrregullime nervore dhe të muskujve, etj. Prani e plumbit mund të shkaktojë nervozizëm dhe mund të ndikojë në aftësinë për t'u përqëndruar²³².

Plumbi është veçanërisht i rrezikshme për fëmijët sepse mund të shkaktojë anemi, dhimbje stomaku, dobësi të muskujve dhe dëmtim të trurit. Edhe në nivele të ulëta, plumbi mund të ndikojë në rritjen mendore dhe fizike të fëmijës²³³.

Në rastet kur njerëzit kanë kontakt me mërkurin shkaktohen probleme me fjetjen, anoreksinë, ankthin, probleme me dëgjimin e shikimin²³⁴. Gjithashtu, nën efektin e shkurtër të mërkurit shkaktohet probleme në frymëmarrje, irritim i syve, dhimbje koke, shije metalike në gjuhë, etj²³⁵.

Gjendja duhet parë si problematike sepse godinat e Uzinës janë kthyer në apartamente për të jetuar familjet.

Uzina mekanike Gramsh (Çekin), siguron prodhimin e makinerive me precision të lartë, trajtime në të nxehtë dhe riparime për industrinë e mbrojtjes²³⁶. Që prej vitit 2009, nëpërmjet Urdhrit Nr.997, datë 07.07.2008, në Uzinë bëhet dhe demontimi i armatimeve të tepërta dhe riparimi i armëve ekzistuese.

Për prodhimin e armëve ushtarake përdoren element me potencial të lartë rrezikshmërie. Përbërësit metalor, që përdoren zakonisht në prodhimin e municioneve dhe të armëve përfshijnë plumbin (Pb), bakrin (Cu), mërkurin (Hg), etj, për shembull plumbi (Pb) përbën 95-97 % të komponentëve metalike të municioneve ushtarake²³⁷.

Mbetjet e ngurta industriale: Bashkia e Gramshit është ndeshur edhe me problemin e depozitimit të mbetjeve të ngurta industriale gjatë kohës që Uzina mekanike dhe ajo e prodhimit të baterive kanë ushtruar aktivitetin e tyre në bashki. Si pasojë e aktivitetit të tyre ndër vite, sot në Bashki nuk ka një plan se ku të depozitohen këto mbetje, ndaj dhe nuk dihet ku përfundojnë ato. Ndotja ë shkaktohet nga këto mbetje nuk mund të përcaktohet, për aq kohë sa nuk dihet se sa është sasia e prodhuar²³⁸.

Ndikimi i ndotjes me metale të rënda nga burimi ndotës (zona industriale) shtrihet deri në zonën e lumit Devoll, sepse afërsia me të është afërsisht 400-450m. Kjo veprimtari industriale ka ndikuar edhe në ndotjen e tokave bujqësore përreth.

Shkarkimet e lëngshme industriale: Gjatë gjithë kohës së funksionimit të zonës industriale, ndotjet e lëngshme janë shkarkuar dhe shkarkohen në lumin Devoll. Krahas aktiviteteve madhore industriale, në territorin e Bashkisë Gramsh janë identifikuar disa aktivitete më të kufizuara, të cilat ndotjen dhe mbetjet e gjeneruar i shkarkojnë në ujërat e lumit Devoll apo përrrenjve më të afërt. Ndër to mund të përmëndim mbetjet nga furra e



gëlqereve, mbetjet nga aktiviteti i përpunimit të inerteve, mbetje urbane dhe inerte të depozituara në brigje dhe shtratin e trupit uJOR.

o Zona/aktivitete potenciale me ndotje të pavlerësuar:

Në këtë seksion, krahas zonave të nxehta mjedisore, të cilat janë të identifikuar dhe ndotja e tyre është adresuar dhe monitoruar, po pasqyrojmë edhe disa zona të cilat nevojitet të monitorohen me qëllim identifikimin e ndotjes së tyre në mjedis.

Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve: Së pari, vend-depozitimi i vjetër i mbetjeve në Bashkinë e Gramshit ka qënë i vendosur në dalje të qytetit. Ai ka qënë i vendosur thuajse në trupin e lumit Devoll, pranë fshatit Cërrujë. Por me ndërtimin e digës së hidrocentralit të Banjës kërkohet zhvendosja e këtij venddepozitimi, sepse paraqiste probleme për krijimin e liqenit. Për ndotjen e shkaktuar nga vend-depozitimi i vjetër nuk është identifikuar sasia e shllameve të depozituara në shtresat nëntokësore. Njëkohësisht nuk është vlerësuar sasia e gazeve metan CH₄ i grumbulluar ndër vite, në formë jastikësh, në nënshtresat e këtij vend-depozitimi dhe gazi i formuar nga procesi i kompostimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Gramsh.

Afërsia me shtratin e Devoll dhe pozicionimi i tij mbi akuiferin ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare nën lumin Deoll dhe përbën një problem me shkarkimet dhe infiltrimet e shllamve të çliruara nga dekompozimi i mbetjeve.

Figura xFigura 70. Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve, Cërrujë, Bashkia Gramsh



Burimi: Ministria e Zhvillimit Urban, Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Venddepozitimi i ri i mbetjeve: Përveç vend-depozitimit të vjetër, në Gramsh është ndërtuar vend-depozitimi i ri i mbetjeve në Çkrezë, i cili ndodhet afërsisht 3.4 km²³⁹ larg nga qendresë e qytetit dhe vetëm 300 m nga Lumi Devoll. Ky vend-depozitim është vënë në funksion në vitin 2016. Në një moment të mëvonshëm, mendohet të bëhet seleksionimi i mbetjeve dhe në landfillin rajonal të depozitohen vetëm mbetjet e pariciklueshme.

Deri atëherë, rekomandohet që Bashkia të marrë masa parandaluese që sigurojnë se elementët ndotës në përbërjen e shllamit të mos përfundojnë në ujërat sipërfaqësore të



Devollit, dhe më tej në ujërat nëntokëse, që përkon me rrjedhën e Devollit në zonën e akuiferit me porozitet ndërkokrrizor.

Figura 71. Vend-depozitimi i ri i mbetjeve urbane, Bashkia Gramsh



Burimi: Google Earth, Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Venddepozitimi i ri dhe ai i vjetër i mbetjeve grumbullon mbetjet urbane vetëm për qytetin e Gramshit. Sa i përket mbetjeve urbane, për Njësitë e tjera Administrative të bashkisë, përrrenjtë dhe proskat janë vend depozitimi final i mbetjeve.

Venddepozitimet e mbetjeve, duke u kufizuar nga rrjedha sipërfaqësore, pranë lumit Devoll, kombinuar kjo edhe me elementët e sigurisë të cilët mungojnë në këtë sit, përbënë pikërisht një vatër të nxehtë mjedisore për Bashkinë Gramsh.

Problematikë emergjente paraqitet situata mbi: shkarkimet e gazrave CH₄ në atmosferë, NO, NH₄ si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme, shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore, infiltrimin e shllameve nga dekompozimi i mbetjeve në ujërat nëntokësore.

○ Përfundime dhe rekomandime

Duke patur parasysh rreziqet që i kanosen shëndetit të njeriut dhe mjedisit, rekomandohet që Bashkia të marr masa për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura dhe kontrollin e ndotjes nga industria, venddepozitimit të vjetër dhe të ri të mbetjeve dhe shkarkimet e ujërave të ndotura.



Monitorimi i shkarkimeve dhe trajtimit të ujrave të ndotura industriale dhe urbane duhet të përfshihet në axhendën e Inspektoriatit Mjedisor Rajonal, duke referuar kështu në mënyrë dinamike cilësinë e ujërave sipërfaqësor të Bashkisë Gramsh, si dhe të adresohet secili shkelës nëpërmjet parimit ndotësi-paguan.

4.10. Trashëgimia historike dhe kulturore

Trashëgimia që fshihet në historinë e hershme të trevave që sot njihen si Bashkia Gramsh identifikohet thjesht duke vëzhguar përmes shtresave të ndryshme të historisë dhe fakteve fizike ende sot mbi sipërfaqe, prej nga kupton se vazhdimësia e civilizimit në Gramsh ka qënë dhe mbetet ende aktive.

Fillimisht vlen të përmenden se gjetjet arkeologjike në sitet e shumta dhe në varret (tumulat) e zonës i përkasin jo vetëm kësaj krahine por edhe qytetërimeve dhe fiseve të tjera Ilire. Një indikator se në këtë zonë ka pasur zhvillim qoftë të mardhënieve me mbretëri të zonës por edhe lidhje tregtare të forta me to. Në vazhdim gjatë periudhës së mesjetës kjo zonë ishte nën administrimin e Pricipatës së Arianitit (Gjergj Arianitit) ndërsa gjatë sundimit Otoman kjo krahinë ishte e ndarë mes Sanxhakut të Elbasanit dhe Vilajetit të Manastirit. Gramshi u shpall zyrtarisht qytet i Republikës së Shqipërisë në *10.Korrik.1960* ku prej vitit '65 njihet si Bashki.

Faktet më të forta fizike për qytetërimin e hershëm në Gramsh gjenden fillimisht në Kalanë e Irmajit e cila është e pozicionuar rreth 18km nga qyteti pranë fshatit Tunje e Lubinjë (ndryshe e njohur edhe si krahina e Sulovës). Pozicionuar në majën e kodrës që mban të njëjtin emër rreth 979.5m. mbi nivelin e detit dhe me sipërfaqe rreth 5.5ha.

Kjo kala ndryshe njihet me emrin Kalaja Kodrionit, e vërtetuar nga arkeologë vendas e të huaj se themelimi i saj daton rreth shekullit të IV p.e.s!

Figura 72. Mur i brëndshëm nga kalaja Kodrionit (Irmanaj).



Burimi: Arkiva Co-Plan

E fortifikuar në vazhdimësi dhe zgjeruar në skajet e saj, provohet në këtë mënyrë se kemi patur një rritje progresive të civilizimit në këtë zonë. Nga skajet e saj gjithashtu shihen qartazi zona të tjera arkeologjike në Malin e Tomorrit, Shpiragut e Tërvolit. Element i cili mbështet teorinë se kemi patur prezencën e komunikimit direkt të këtij siti me vendbanime të tjera. Gjithashtu një mundësi tjetër është që seksione të veçanta të këtij siti të madh (5.5ha) mendohet të jetë kompozuar nga gurë masiv të cilët janë karakteristik të siteve pellazgjike (*Dodonë*).



Kjo krahinë ilire është vlerësuar na arkeologët vëndas dhe të huaj se ka njohur lulëzimin e saj në periudhën midis shekullit V-IV p.e.s! Zbulimet arkeologjike si fibulat, varëset, veglat e punës, bronxaturat, monedhat dhe qeramika e përpunuar tregon se jo vetëm kjo krahinë ka njohur mirqënie por edhe lidhjet e saj tregtare me krahina të tjera kanë qënë mjaft të forta.

Në territorin e Bashkisë së sotme të Gramshit, janë identifikuar mbi 27 site arkeologjike prej të cilave vlen të përmenden:

- a. 4 vendbanime të njohura Ilire (Driza, Tunja, Kushova dhe Bulçari)
- b. 2 Tumule (Varrezat e Cërujës dhe Çekinit)
- c. 2 Kala Ilire – Irmanaj
- d. Fortifikimi antik i Tërvolit
- e. 12 Kala Mesjetare (Galigati, Kerkeza, Holta, Lubinjë, Kabashi, Mendraka, Prrenjasi, Vidhani, Bresniku, Grabova, Griba, Grozhdani,)
- f. Urbanizimi mesjetar i Prenjasit (Ujësjellësi dhe Kalldrëmet Mesjetare)

Në këtë zonë gjëndet gjithashtu edhe Kulla e Kamunaut, qyteti antik i Kodrionit, nëndega jugore e rrugës Egnatia, Kalaja e Qafës, Bazilika dhe vendbanimi mesjetar i Klosit etj. Në rrjedhën e përzier të shekujve një pjesë e tyre deri në ditët e sotme janë shkatërruar, ose janë duke u zhdukur plotësisht. Kjo mjegull e bën të vështirë qartësinë e ndërtimeve dhe rëndësinë e tyre, por që përbëjnë një material me mjaft interes njohës për historinë tonë antike.

Të dhënat historike janë baza kryesore, sepse pa to historia nuk ekziston. Kjo kullë është e kohës antike, por emri i saj i hershëm endet në heshtjen e harruar të shekujve.

Figura 73. Gjetje arkeologjike ne territorin e bashkise



Burimi: Muzeu Gramsh

Kuptimin e sotëm të emrit të Kullës së Kamunaut disa studiues e nxjerrin nga bullgarishtja: Kulla e gurit; Kulla e Shkëmbit, dhe në disa raste e quajnë Kulla e Petras. Në përgjithësi toponimia e kësaj krahine, si gjithë krahinat rrotull saj, kërkon shpjegime më të studiuara,



sepse dyndjet shekullore kombinuar me forcën e vendimeve zyrtare të pushtetit ushtarak e administrative vendosën emërtimet e tyre.

Kodra ku ndodhet Kulla e Kamuaut shfaqet si piramidë, tipike zotëruese dhe majë të sheshtë, si një kështjellë natyrore e përshtatshme për t'u mbrojtur nga çdo rrezik, ndonëse lartësia e saj nuk i kalon të 500 m.

Shpellat të afrojnë interes njohës për tregimet mitologjike fatlëna të mjekëve apo priftërinjve, që i shfrytëzonin për peligrinët, të cilët vinin për të kërkuar zgjidhje për ëndrrat e shqetësimet e njerëzve të tyre. Ishin priftërinjtë e Dodonës që quheshin Selloi, të cilët janë përshkruar nga Homeri si njerëz që jetonin shpellave e flinin shtrirë në tokë, dhe që vepronin sipas një riti të lashtë pagan, duke lexuar kraharorin e shpendëve e shpatullat e kafshëve.

Tek qasja në brendësi të shpellave ke një ndjesi të frikshme nga historitë e treguara. Aty nuk shquan shenja jete, se ndoshta koha mund t'i ketë zhdukur, por legjendat e thurura me mistikën e tyre tregojnë për gjurmë të Dodonës pellazgjike. Për këto shpella nuk është bërë asnjë studim, e që duhet një shtysë e studiuesve spelologë të hulumtojnë, për të vërtetuar rreth legjendave të lashta. Shpalosja interesante e natyrës së kësaj krahine e kanë bërë që të preferohet në periudhat më të lashta për të ndërtuar kala të fortifikuara.

Nisur nga këto fakte të pakundërshtueshme, pozicionin e përzgjedhur, mënyrën e ndërtimit, ku duhen hedhur gjykime mbi teknikën e ndërtimit, (gjurmët që ruan sot nuk janë të mjaftueshme për të gjykuar rreth arkitekturës).

Sipas hulumtimeve të arkeologëve e studiuesëve të historisë, koha dhe roli që ka patur ky objekt arkeologjik në këtë pozitë gjeografike, i përket një kulle vrojtimi të fortifikuar, të ndërtuar në shekullin e IV (para erës sonë). Është me vend që t'i referohemi atyre se kjo kala antike është shfaqur në burimet antike si kullë dominuese, e cila kontrollonte një degë jugore të rrugës Egnatia, që vinte nga Ultësira bregdetare, Apollonia. Ajo zinte një vend kyç në këtë rrugëkalim, dhe “është ndërtuar në vitet 1000-400, të mijë vjeçarit të dytë para erës sonë.”²⁴⁰

Natyrisht vendbanime të tilla të fortifikuara janë ngritur në një hap më të zhvilluar të shoqërisë prehistorike. Dëshmitë gjuhësore dhe historike dëshmojnë se në antikitet me vendosjen e marrëdhënieve skllavopronare dhe me lindjen e qyteteve hapsira gjeografike e këtij territori është banuar nga fisi ilir i Dasaretëve.

“Dasaretët fis i madh ilir, banorë të krahinës Dasaretia, që shtrihej nga pjesa perëndimore e liqenit të Ohrit, në fushën e Korçës, krahinën e Kolonjës, Devoll në Gorë, Opar, Mokërr, e deri në Berat”.²⁴¹

Mendohet sipas arkeologëve se ajo mund të jetë shkatërruar në vitin 168 para krishtit me rënien e shtetit Ilir kur romakët u bënë zotër të vendit (si pasojë e luftimeve iliro-romake). Në ndihmë na vijnë autorët e lashtësisë.

Në të njëjtën linjë por duke u kthyer më herët në periudhën historike të kësaj krahine, përmëdim këtu fortifikimin ose siç quhet ndryshe Kalaja Tërvolit rreth 493m mbi nivelin e detit. E pozicionuar mbi kanionet e Holtës (e cila dikur mendohej se ishte një udhë e shkrutër drejt zonës së Mokërs – Ohrit / në lindje. Ndërkohë që në Perëndim ka passur një fushpamje mahnitëse mbi pllajën e Holtës, Devollit der në kodrat përreth Elbasanit.)



Figura xx. Pamje e kalasë së Tërvolit nga shpati Kabashit (Fërricës)

E vendosur midis fshatit Kabash dhe për më tepër mbi një formacion të thepisur shkëmbor i cili përbëhet nga labirinte masive shpelalsh. Mendohet se datimi i saj i takon periudhës mesjetare por nuk kemi gjurmime specifike në këtë sit.

Figura 74. Dëmtimi i themeleit të murit perimetral të kalasë së Tërvolit.



Duhet theksuar, vetëm si pasojë e gojëdhënave dhe historisë së pasur të kësaj krahine, janë kryer gjurmime të paligjshme për gjetjen e ndonjë thesari të mundshëm. Shumë nga sitet arkeologjike janë dëmtuar ndërkohë që nuk kanë mbetur pa u dëmtuar edhe monumente natyrore.

Ndërhyrje më vandale vlerësohet të jetë kryer në themelin perëndimor të murit perimetral të kalasës së Tërvolit, ku në kërkim të thesareve të mundshme janë dëmtuar rënde shtresat shkëmbore mbatjeëse si edhe themelet e këtij muri ku 30% është rrëzuar nga këto ndërhyrje. Gjthasthu janë konstatuar gjurmime parciale ku kemi dëmtim të qeramikave dhe pitos-ëve.

Periudha Mesjetare në këtë territor mund të identifikohet nga të dhënat e arkivave tek të cilat mbizotëron epoka e sundimit të Haxhi Sali Bej Përrenjasit nga krahina e Sulovës. Gjatë sundimit të tij mendohet që e gjithë krahina të ketë njohur zhvillim të madh në urbanistikë ku shpesh rrënojat apo edhe struktura të veçanta (Gurra e Dufshanit, Ura e Haxhi Sali Bej Përrenjasit, fragmente kalldrëmi si zgjatim i degezimit jugor të rrugës egnatia etj) këto mbeten ende si fakte fizike.

Zhvillimi i civilizimit të kësaj krahine njeh një vazhdimësi që prej periudhës Ilire deri në Mesjetë e më pas dokumentimi gjatë periudhës Otomane deri në luftën e parë botërore e më tej me themelimin e qytetit dhe Bashkisë së sotme.

Në vlerësimin tonë, duke marrë parasysh që potenciali që ofron kjo krahinë për zhvillimin e jetës si edhe karakteristika e saj gjeografike, mund të ekzistojë mundësia që shtrirja e historisë së kësaj krahine të shkojë më thellë në histori. Nëse do të kishim hulumtime të mirfillta arkeologjike dhe historike mund të gjëndjen linja të cilat të çojnë deri në periudhën e hershme pellazgjike e ndofta prehistorike. Kjo, megjithëse vetëm një hamendësim, bazohet në faktin se kjo krahinë e pasur me ujë dhe toka pjellore, e pozicionuar gjeografikisht midis qytetërimeve të lashta ilire si edhe fakti që numurohen mbi 89 shpella të identifikuar me kapacitet për të strehuar familje ndofta dhe fise.



Figura 75. Kalorësi Dardan (object zbukurimi I shek. IV-III p.e.s) dhe Heshta nga tumula të luftëtarëve



Burimi: Muzeu Gramsh

Ky hamëndësim vjen si rrjedhojë i gjetjeve interesante në terren si edhe nga komunikimi intensiv me banorë vëndas të cilët ndër vite kanë transmetuar gojdhënat dhe histori të ndryshme të kësaj krahine kaq të mrekullueshme.

Tabela 46. Të dhëna mbi heshtat e gjetura

GIATËSIA	cm	TEHU PRERËS	cm	BISHTI	cm	DIAMETRI I VRIMËS BISHTIT	cm
	35		3,5		7		1,3
31	4	7,5	1,3				
28	3,5	7	1,2				
26	2,8	3,5	0,7				
16	3,5	2	Demtuar				
7	2,5	12	1,8				

Burimi: Muzeu Gramsh

Tabela 47. Lista e monumenteve kulturore dhe historike sipas IKMT

Çezma e Gramshit	Tipologjia: Çezem me çardak Fusha: Arkitekture dhe Infrastruktura	Vendi: Skënderbegas Bashkia: Gramsh
Fortifikim mesjetar (Gramsh)	Tipologjia: Fortifikim Fusha: Arkitekture	Vendi: Pprenjas Bashkia: Gramsh
Gradishta e Bresnikut	Kategoria: I	Vendi: Bresnik Bashkia: Gramsh
Kalaja e Tervolit	Tipologjia: Kala fortifikuese Fusha: Arkitekture	Vendi: Tervol Bashkia: Gramsh
Kalaja e Galigatit	Kategoria: I	Vendi: Galigat Bashkia: Gramsh
Kalaja e Grabovës së Poshtme	Tipologjia: Fortifikim Fusha: Arkitekture dhe Urbanistike	Vendi: Grabovë e poshtme Bashkia: Gramsh
Kalaja e Gradishtës (Bresnik)	Kategoria: I	Vendi: Bresnik Bashkia: Gramsh
Kalaja e Irmajt	Tipologjia: Kala fortifikuese Fusha: Arkitekture	Vendi: Tunje Bashkia: Gramsh



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Kalaja e Prenjasit	Tipologjia: Kala fortese garnizoni Fusha: Arkitekture	Vendi: Prenjas Bashkia: Gramsh
Kisha e Shën Kollit (Grabovë e Sipërme)	Tipologjia: Objekt kulti Fusha: Arkitekture	Vendi: Grabovë e sipërme Bashkia: Gramsh
Rrënojat e Urës Antike (Grabovë e Sipërme)	Tipologjia: Ure me nje hark Fusha: Arkitekture	Vendi: Grabovë e sipërme Bashkia: Gramsh
Tuma pranë lumit Nolt (Cerunje)	Kategoria: I	Vendi: Cerruje Bashkia: Gramsh
Ujesjellesi ne përroin e Ranxës (Sult dhe Grakan)	Tipologjia: Akuadukt/sistem ujësjellësi Fusha: Arkitekture	Vendi: Sult dhe grekan Bashkia: Gramsh
Ura mesjetare e gurtë (Grabovë e Sipërme)	Tipologjia: Ure me nje hark Fusha: Arkitekture	Vendi: Grabovë e sipërme Bashkia: Gramsh

Burimi: Muzeu Gramsh



5. Vlerësimi mjedisor i ndikimit të PPV-së

5.1 Detyrimet ligjore e institucionale

Tabela 48. Detyrimet ligjore dhe institucionale Ligji Neni Detyrimet
Ligjore/Institucionale për Bashkitë

Vetëqeverisja Vendore		
Ligj nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 26 Pika 1	Bashkia <i>siguron, në nivel vendor, masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.</i>
Ajri		
Ligj nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”	Neni 4 Pika 3	Bashkia (njësia e qeverisjes vendore) <i>merr masat për ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.</i>
	Neni 7 Pika 8	Bashkia përgatit (dhe miratohet nga këshilli Bashkiak) <i>Planin e Aglomeratit dhe Planin e Zonës.</i>
	Neni 7 Pika 12	Bashkia përgatit, ndryshon ose rishikon një <i>Plan të Cilësisë së Ajrit.</i> (në bashkëpunim me ministrinë e linjës, AKM-në, ARM-të dhe ISHMPU-në. Ministrinë e linjës, AKM-ja, ARM-të dhe ISHMPU-ja sigurojnë të gjithë informacionin përkatës që disponojnë).
	Neni 8 Pika 3	Bashkia përgatit dhe zbaton/zbatojnë një <i>Plan Veprimi Afatshkurtër</i> për një zonë apo aglomerat kur ka rrezik të kapërcehet pragu i alarmit <i>për Ozonin</i> . Në këto raste planet afatshkurtra mbajnë parasysh edhe kërkesat që lidhen me <i>arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin.</i>
	Neni 8 Pika 4	Bashkia përgatit dhe zbaton/zbatojnë një <i>Plan Veprimi Afatshkurtër</i> , kur ekziston rreziku që të kapërcehen një ose më shumë vlera kufi apo vlera të synuara.
Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore		
Ligji Nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore	Neni 23	Bashkia ngarkohet me detyrën për <i>prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.</i>
Ligj Nr. 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 111/2012 “Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”	Neni 7	Këshillat e Baseneve Ujore dhe Agjencitë e Baseneve Ujore janë organet vendore për manaxhimin e integruar të burimeve ujore.
	Neni 31	Njësia e qeverisjes vendore (Bashkia) dhe çdo institucion tjetër që ka sistemin e tij të furnizimit me ujë, detyrohet të <i>marrë masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të furnizuar.</i>
	Neni 61	Bashkia, gjatë hartimit të planeve dhe studimeve të rregullimit të territorit, <i>merr në konsideratë planet e manaxhimit të burimeve ujore.</i>
	Neni 72	Organet e qeverisjes vendore (Bashkia) <i>mbikqyr e detyron subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private.</i>
Ligji Nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”	Neni 6	Pushteti vendor (Bashkia) <i>mban bazën e të dhënave të bilancës së rezervave ujore nëntokësore</i> (dhe gjeologjinë, bilancën e rezervave të mineraleve të dobishme dhe rreziqet



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

		gjeologjike) e cila i vihet në dispozicion nga SHGJSH-ja.
	Neni 8	Për kryerjen e shpimeve për ujëra nëntokësore me thellësi mbi 15m nga sipërfaqja e tokës <i>merret miratim nga SHGJSH-ja përpara se të dorëzohet projekti hidrogeologjik tek Këshilli i Basenit.</i>
VKM Nr. 342, datë 04.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”		<i>Drejtues të Bashkisë janë anëtarë të strukturës së Këshillit të Basenit Ujor për zbatimin e manaxhimit të integruar të burimeve ujore (të Basenit përkatës).</i>
VKM Nr. 177 datë 31.03.2005 “Për Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”	Pika 7	<i>Këshilli i Basenit Ujor (në bashkëpunim me ARM-në, çdo dy vjet) përgatit dhe publikon programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjediseve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta.</i>
Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”	Neni 2	<i>Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura. (në përputhje me llojin e natyrën e tyre, hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, përsosjen e kuadrit ligjor, sigurimin e përdorimit të frytshëm të burimeve finaciare dhe kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave).</i>
Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, 2013-2020	Kapitulli 2	Kërkohet: <i>-zvogëlimi i lejeve të shfrytëzimit me 100% deri më 31.5.2014</i> <i>-lejimi i shfrytëzimit të inerteve lumore vetëm për nevojat e ndërtimit të rrugëve kombëtare deri në vitin 2020.</i>
VKM Nr. 1, datë 21.06.2006 “Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”	Pika 2	<i>Shfrytëzimi i zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve lejohet vetëm kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara.</i>
	Pika 3	<i>Periudha e shfrytëzimit të inerteve lumore është 1 qershor-31 tetor.</i>
	Pika 4	<i>Thellësia e shfrytëzimit të inerteve lejohet deri në 0.5m mbi nivelin minimal të pasqyrës së ujërave nëntokësore.</i>
	Pika 5	<i>Sasia e materialit që merret nga çdo subjekt nuk duhet të jetë më shumë se 50% e prurjeve të ngurta vjetore të zonës e miratuar për shfrytëzim.</i>
	Pika 8	<i>Brenda 2006 në argjinaturat dhe në shtretërit e lumenjve duhet të hiqen të gjitha impiantet e përpunimit të inerteve dhe materialet e grumbulluara.</i>
Pyjet & Kullotat		



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Ligji Nr 48/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar”	Neni 4	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për hartimin dhe përpunimin e Programit të Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve.
	Neni 5	Këshilli i Bashkisë, në bashkëpunim me shërbimin pyjor, miraton Planet e mbarështimit të pyjeve Bashkiake dhe private.
	Neni 7	<p>Bashkia ngre strukturën për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor.</p> <p>Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashki ka aftësi teknike, manaxhuese e këshillimore, e cila (Neni 11) kryen shërbime teknike e publike në fondin pyjor vendor dhe ka këto detyra:</p> <ul style="list-style-type: none">-qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;-mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;-ruan ekuilibrin biologjik në fondin pyjor vendor;-mban e administron të gjitha dokumentet për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat;-mban të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë;-përgatit projekte për investimet në pyje e kullota;-drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;-ndjek, bashkëpunon, harmonizon dhe kryen veprimtari kërkimore;-mbikëqyr zhvillimin e florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;-siguron mbështetje teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;-organizon trajnime e shërbime këshillimore për pronarët privatë;-kontrollon marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota;- mirëmban infrastrukturës në fondin pyjor Bashkiak;-harton zbatimin e një programi për trajnimin e punonjësve të shërbimit pyjor dhe aftësimin e tyre profesional;-mbështet zhvillimin e agropylltarisë.
	Neni 23	<p>-Bashkia:</p> <ul style="list-style-type: none">-administron dhe zhvillon pyjet vendore apo pjesë të tyre sipas planeve të mbarështimit;- krijohen njësitë tekniko-administrative për një administrim të qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor, për rregullimin e përdorimit e të shfrytëzimit të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera pyjore e jopyjore, për mbrojtjen nga zjarri dhe dëmtuesit;-merr masa dhe planifikon fonde për investimet në pyjet brenda territorit, për përmirësimin dhe



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

		<p>planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe krijon sektorin e agropylltarisë;</p> <p>- planifikon fonde për ruajtjen, mirëmbajtjen, kryerjen e punimeve silvikulturore dhe përgjigjet për trajtimin shkencor të tyre;</p> <p>- merr nisma për shtimin e sipërfaqeve pyjore, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre.</p> <p>-Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Pyjor ndihmojnë, kontrollojnë, këshillojnë dhe sigurojnë mbështetjen teknike për njësitë tekniko-administrative dhe për shoqatat e përdoruesve të pyjeve.</p>
Ligji Nr 49/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9693 , datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar	Neni 7	Bashkia dhe pronarët privatë të kullotave e livadheve i japin ministrisë përgjegjëse të dhëna për inventarizimin e kullotave që zotërojnë.
	Neni 14	<p>- Strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave në njësitë e qeverisjes vendore (Bashki) hartojnë Planet e Mbarështimit.</p> <p>-Bashkia merr pjesë në komisionin teknik që shqyrton Planet e Mbarështimit të Kullotave para se të miratohet (Planet e Mbarështimit të Kullotave, para se të miratohen, shqyrtohen nga një komision teknik, në përbërje të të cilit është edhe një përfaqësues i Bashkisë).</p>
	Neni 26	<p>Bashkia (dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe):</p> <p>- ruan, administron dhe përdor kullotat dhe livadhet;</p> <p>-harton Planet e Mbarështimit;</p> <p>-merr masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre;</p> <p>-raporton në ministrinë përgjegjëse të dhënat për inventarizimin dhe regjistrimin e fondit kullor;</p> <p>-njofton ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit që shfaqen në kullota e livadhe.</p>
VKM Nr.436, datë 8.6.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 1374 , datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”	Pika 2	Bashkia paraqet në Ministrinë e Mjedisit kërkesën për heqjen e sipërfaqes nga fondi kullor.
Ligji nr. 5/2016 , “Për shpalljen e memorandumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”	Neni 7	Bashkia zbaton moratoriumin 10 vjeçar të pyjeve.
Udhëzim Nr. 1 , datë 09.06.2016 “Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor Publik”	Pika 1	Bashkia jep në përdorim me kontratë qiraje nëpërmjet procedurës së konkurimit publik sipërfaqe të fondit pyjor/kullor në pronësi.



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Zonat e mbrojtura			
Ligji Nr 81 / 2017 “Për Zonat e Mbrojtura”	Neni 13	Bashkia merr pjesë në vendosjen e statusit të një zone si zonë e mbrojtur (Ministria shpall zonat e mbrojtura pas konsultimit me organet e qeverisjes vendore. Zonat e mbrojtura shpallen ato territore që janë prone publike, Bashkiake, komunale dhe në raste të veçanta pronë private).	
	Neni 15	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit dhe organet e tjera shtetërore dhe ose me të tretët, për hartimin e Planene të Manaxhimit për secilën zonë të mbrojtur.	
	Neni 19	Bashkia, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe atë ndërtimore, ndalon zbatimin e projekteve që bien ndesh me planin e manaxhimit të zonës.	
	Neni 22	Bashkia merr pjesë në heqjen e statusit të një zone të mbrojtur.	
	Neni 25	Bashkia nxit dhe përkrah nisma, projekte, programe e veprimtari, që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjike e natyrorë të një zone të mbrojtur.	
Biodiversiteti			
Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 27	Bashkia mbron natyrën dhe biodiversitetin.	
Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9587, Datë 20.07.2006, “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, i ndryshuar	Neni 7	Bashkia (dhe organet shtetërore, qëndrore) administron burime natyrore përbërëse të biodiversitetit dhe e mbron atë.	
	Neni 8	Bashkia merr pjesë në hartimin dhe rinovimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Biodiversitetit. (ky plan hartohet nga Ministria e Mjedisit me pjesëmarrjen e organeve shtetërore, qëndrore dhe vendore, komunitetit shkencor dhe shoqërisë civile).	
	Neni 19	Bashkia përfshin ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të llojeve dhe habitateve të specieve tokësore, ujore dhe detare në politikat, planet, programet dhe në vendimmarrje.	
	Neni 26	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për hartimin e Planit të Veprimit për Ruajtjen e Llojeve Veçanërisht të Mbrojtura. Bashkia përfshin Planin e Veprimit për Ruajtjen e Llojeve Veçanërisht të Mbrojtura në strategjitë, planet, programet dhe në vendimmarrjet shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.	
	Neni 29	Bashkia përfshin ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet në nivel vendor.	
	Neni 46	Bashkia: -siguron mbështetjen e publikut për të ruajtur diversitetin biologjik dhe për t'i përdorur përbërësit e tij në mënyrë të qëndrueshme	



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

		- <i>boton të dhëna dhe programe ndërgjegjësimi dhe edukimi për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij</i>
Ligji Nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë”	Neni 8	<i>Administron (drejton) muzetë vendorë.</i>
	Neni 12	<i>Miraton strukturën dhe organikën e muzeve tipologjike dhe vendore.</i>
Ligji Nr 41/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.10006, datë 23.10.2008 “Për Mbrojtjen e Faunës së Egër”, i ndryshuar	Neni 40	-Bashkia <i>mbron faunën e egër</i> , brenda hapësirës në pronësi të Bashkisë. -Bashkia, Policia Pyjore dhe Inspektorati i Peshkimit bashkëpunojnë me veterinerin zyrtar dhe inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për të bërë më të efektshëm kontrollat.
VKM Nr.84, datë 27.01.2009 “Për Caktimin e Kriteve Për Ngritjen e Rrjetit Të Inventarizimit dhe Të Monitorimit Të Biodiversitetit”	Pika 3	Bashkia <i>bën pjesë në Rrjetin e Informatizimit dhe Monitorimit të Biodiversitetit</i> i cili ngrihet nga AKM-ja. Rrjeti ka këto detyra: -monitorim afatgjatë; -të sigurojë zbatimin e legjislacionit shqipëtar për mbrojtjen e biodiversitetit; -të mundësojë sistemimin e të dhënave të përdorshme për vendimmarrësit; -të informojë për biodiversitetin dhe për ndërgjegjësimin e publikut për ruajtjen e tij; -të ndërtojë një sistem inventarizimi dhe monitorimi; -të krijojë një sistem informacioni për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave.
	Pika 5	Bashkia <i>bashkëpunon</i> me Ministrinë e Mjedisit <i>për hartimin e Projektprogramit të Monitorimit të Biodiversitetin për vitin pasardhës</i>
Ligji Nr 43/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”	Neni 12	Bashkia <i>merr pjesë aktive në propozimin e zonave të gjuetisë</i> , kur zona ndodhet brenda territorit të saj.
	Neni 56	Bashkia <i>ndihmon në monitorimin dhe kontrollin e zonave të gjuetisë</i> për zbatimin e ligjit.
Toka dhe Bujqësia		
Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 26	Bashkia <i>merr masa për mbrojtjen e cilësisë së tokës</i> nga ndotja.
	Neni 27	Bashkia <i>administron shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.</i>
Ligji Nr 131/2014 Për ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”	Neni 8	Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT) në përbërje të të cilit është kryetari i Bashkisë dhe kryetarët e dhe NjA-ve, <i>kontrollon dhe studion çështje të veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore.</i>
	Neni 10	Këshilli Bashkiak <i>merr vendime në funksion të ruajtjes së tokës</i> , bashkërendimit të veprimtarive për mbrojtjen e tokës me bashkitë e tjera dhe shqyrtimit të ankesave që vijnë nga qytetarët apo institucionet e tjera.
Ligji Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar	Neni 21	Bashkia <i>ndalon çdo zënie ose përdorim të paligjshëm të tokës.</i>
VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “Për Mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga	Kapitulli 4	ZMMT-ja:



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

DAMT-i në qarqe dhe ZMMT-ja në komuna dhe/ose Bashki		-manaxhon dhe mbron tokën bujqësore shtetërore dhe private, si dhe kategori të tjera të burimeve; -grumbullon dhe sistemon dokumentacionin e ri kadastral për tokën bujqësore; -evidenton tokat bujqësore të pakultivuara.
	Kapitulli 5	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) dhe ZMMT-ja kanë për detyrë ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore vetëm kur mbi të kanë vepruar fenomene natyrore të mëdha si tërmetet, vullkanet, rrëshqitjet e tokës, përmbytje, zjarre masive etj.
VKM Nr. 410, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”	Kapitulli 2	Komisioni i ndryshimit të kategorive të burimeve, i Bashkisë ose NJA-ve shqyrton kërkesën për ndryshimin e tokës nga burim pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh në kategorinë e burimit tokë bujqësore brenda afateve të përcaktuara dhe merr vendimin përkatës.
Udhëzim Nr. 1, datë 18.7.2012 “Për Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”	Pika 5	Kryetari i Bashkisë : -shqyrton kërkesat dhe merr vendimet për marrjen me qira të tokës sipas kërkesave të paraqitura; -organizon procedurën e garës kur për të njëjtën tokë bujqësore është paraqitur më shumë se një kërkesë për qiramarrje; - lidh kontratën tip me subjektin e përzgjedhur; -verifikon dhe respekton kushtet e përcaktuara në kontratën tip gjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj.
	Kapitulli V	Bashkia ose komuna (NJA-të) mbledh qeranë për dhënien me qera të tokave bujqësore të pandara. (Pavarësisht se cili është autoriteti qiradhënës, pagesa e qirasë bëhet për llogari të komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën, objekt i qirasë.
VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”	Kapitulli III	Bashkia (Njësia e qeverisjes vendore) jep leje ndërtimi për ndërtimin e objekteve me qëllime bujqësore në tokë bujqësore, në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.
Vendim Nr.956, datë 25.11.2015 Për një ndryshim në vendimin Nr. 127, datë 11.02.2015 “Për Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”	Kreu IV	Bashkia merr informacion nga përdoruesi i llumrave për vendndodhjen e tokës ku do të përdoren llumrat.
Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë, 2010-2025	Kapitulli IV	Sensibilizimi i autoriteteve lokale për shmangien e ndërtive në zonat qëku ndikohen nga aktiviteti minerar
Zhurmat		
	Neni 8	Bashkia:



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

<p>Ligji Nr 39/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”</p>		<p><i>-harton dhe zbaton Planin Vendor të Veprimit për Zhurmën një vit pas miratimit të planit kombëtar të veprimit, (miratohet nga këshillat e bashkive/komunave);</i></p> <p><i>-kryen hartëzimin e zhurmës, në përputhje me Planin Vendor të Veprimit, sipas udhëzimeve të ministrit (Neni 21);</i></p> <p><i>-shpall zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendos kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me Planin Vendor të Veprimit;</i></p> <p><i>-kërkon marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë;</i></p> <p><i>-u kërkon organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.</i></p>
	Neni 15/1	<p><i>-Verifikon zbatimin e kërkesave për zbatimin e nivelit të zhurmave brenda nivelit kufi në rastet e shfrytëzimit të banesave, me përjashtim të banesave vetjake.</i></p>
	Neni 17	<p><i>Miraton zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime, me kohë të kufizuar, në mjedise të jashtme apo të mbyllura, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët.</i></p>
	Neni 29 dhe neni 30	<p>Bashkia, në rast shkelje të Ligjit:</p> <p><i>-cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes,</i></p> <p><i>-ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit,</i></p> <p><i>-vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë,</i></p> <p><i>-merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin, sipas nevojave të rastit.</i></p>
<p>VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”</p>	Pikat 3 dhe 5	<p>Bashkia jep leje për lokalet e ndryshme sipas këtij përcaktimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Për ambientet e hapura:</u> <ul style="list-style-type: none"> ➤ për ditën e premte dhe të shtunë, orari i lejimit të aktivitetit do jetë nga ora 19.00 deri në orën 24.00, ➤ për ditët e tjera të javës, orari i lejimit të aktivitetit do të jetë nga ora 19.00 deri në orën 23.00 në përputhje me normat e lejuara të zhurmës. - <u>Për ambientet e mbyllura,</u> aktiviteti do lejohet pa kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës. <p>Bashkia, së bashku me Strukturat Vendore të Policisë së Shtetit, ndjek zbatimin e vendimit të marrë nga ana e Inspektoriatit të Mjedisit pa praninë e tyre, në subjektet që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin.</p>



Ndryshimet klimatike		
Draft-Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, 2015-2020	Kapitulli 1	Bashkia duhet: -të forcojë kapacitetet në institucionet përkatëse dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike, -të përfshijë ndryshimet klimatike gjatë planifikimit në strategjitë sektoriale, -të mbështesë strategjitë që përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse të shëndetit, pronës dhe funksioneve prodhuese të ekosistemeve nga ndryshimet e klimës, -të rritë ndërgjegjësimin publik për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, -të krijojë partneritet rajonal për të përmirësuar teknologjinë, politikat dhe strategjitë e zbutjes së gazrave serrë në të gjithë sektorët.
	Kapitulli 2	Bashkia duhet: -të zbatojë Planin e Veprimit për Eficiencën e Energjisë, -të përfshijë objektivat e përshtatjes dhe uljes së gazrave serrë në planifikimin urban, manaxhimin e ujërave dhe tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet dhe ruajtjen e natyrës, -të ulë me 8% shkarkimin e gazrave serrë krahasuar me skenarin bazë dhe uljen e sasisë së HCFCve me 40%.
Shërbimet publike		
Ligj Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 3	Bashkia bën zgjedhjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore dhe realizimin e shërbimeve.
	Neni 23	Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Bashkia është përgjegjëse për: - prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; -mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; -mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut; -mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara; -mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; -planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit; -ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore; -ndriçimin e mjediseve publike; -transportin publik vendor; -ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit; -shërbimin e dekorit publik; -parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
	Neni 12	Bashkia ka përgjegjësi ligjore: - të hartojë Planin e Integruar të Manaxhimit të Mbetjeve;
Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar	Neni 12	Bashkia ka përgjegjësi ligjore: - të hartojë Planin e Integruar të Manaxhimit të Mbetjeve;



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

		-të përcaktojë rregullore për manaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve; -t'i raportojë Këshillit të Qarkut mbi ecurinë e zbatimit të planit të menaxhimit të mbetjeve.
VKM Nr. 379 , datë 25.05.2016 “Për Miratimin e Rregullores Cilësia e Ujit të Pijshëm”	Neni 5	Bashkia ka përgjegjësi: -të sigurojë ujin e përshtatshëm për përdorim në pikën e ofrimit të tij; -të parashikojë masat për sigurimin e furnizimit në rast emergjence me ujë të pijshëm për sasinë dhe periudhën minimale të nevojshme për të përballuar nevojat lokale; -të përshtasë planet e ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në bashkëpunim me Agjencinë e Ujit të Basenit (AUB) përkatës.
Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave Të Ndotura”	Neni 4	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për: -përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura; -hartimin e Planit për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura në mënyrë të integruar; -krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura; -kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre.
Ligji Nr 10/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8308 , datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”	Neni 14	Këshilli Bashkiak përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për transportin qytetas.
	Neni 21/1	Këshilli Bashkiak përcakton vendin e terminalit të autobusëve.
	Neni 22	Këshilli Bashkiak përcakton vendet e nisjes dhe mbërritjes së autobusëve dhe të agjencive të transportit të udhëtarëve.
Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për shëndetin publik dhe inspektoriatin sanitar shtetëror” i ndryshuar	Neni 19	Bashkia ushtron kontrolle për zbatimin e ligjit brenda juridiksionit të saj dhe në bashkërendim me institucionet përkatëse.
Ligji Nr.9915, datë 12.5.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8102 /1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”	Neni 23	Bashkitë, pronare të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, kontrollojnë subjektet e licencuara për zbatimin e këtij ligji, për respektimin prej tyre të kushteve të licensës dhe përdorimin e tarifave të ujit për konsum publik, të vendosura nga gullator.
VKM Nr. 145 datë 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin		Bashkia ka të drejtë të kontrakttojë një kompani private për ofrimin e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve.



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”		<p>Bashkia dhe ndërmarrja e UK-së <i>shpall zonat e mbrojtura sanitare</i> të burimit sipërfaqësor ose nëntokësor të ujit.</p> <p><i>-Brezi i rreptësisë</i>, i cili rrethohet në <i>distancë 20 m</i>, rreptësisht i pakalueshëm, përfshin pusët e ujit, depot e ujit dhe stacionin e pompimit. Në këtë zonë ndalohet çdo ndërtim, përveç atyre të domosdoshëm për nevojat e ujësjellësit.</p> <p><u>Zona e mbrojtur Nr.1</u> përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një distancë 200m. Në këtë zonë lejohen vetëm aktivitetet me baze organike dhe duhet të eliminohet çdo aktivitet industrial ose aktivitetet bujqësore të cilat përdorin <u>pesticide apo plehra të tjera kimike</u>.</p> <p><u>Zona e mbrojtur Nr. 2</u> rrethon pellgun ujëmbajtës në një distancë 1,500 m. Në këtë zonë nuk lejohet të ketë zona të ndotura nga ujërat e ndotura apo nga depozitime mbeturinash të ndryshme duke përfshirë këtu dhe ato kimike. Impianti i trajtimit të ujit të ndotur urban duhet të parashikohet jashtë kësaj zone. Gjithashtu nuk lejohet ndërtimi i banesave në këtë sipërfaqe/zonë të mbrojtur.</p> <p><u>Zona e mbrojtur Nr. 3</u> zhvillohet në biefin e sipërm të burimit. Rregullat e përmendura për zonën Nr.2 duhet të zbatohen edhe për këtë zonë.</p> <p><u>Zona e mbrojtur Nr. 4.</u> Çdo ndërtim që do të bëhet brenda në këtë zonë duhet të kërkojë detyrimisht leje nga Bashkia ose nga Organe të tjera të autorizuar duke përfshirë këtu dhe mendimin e një hidrogeologu.</p> <p>-Çdo burim që shfrytëzohet për qëllime pirje nga shoqëri të licencuara publike ose private duhet të jetë i pajisur me një leje nga autoriteti i basenit ujqor në nivel vendor.</p>
Mbetjet		
Ligji Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”	Neni 7	Bashkia/NjA-të <i>vendosin pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave</i> në kosha, kazanë e stacione betoni.
	Neni 9	Bashkia/NjA-të, në bashkëpunim me organet kompetente, <i>përcaktojnë metodat dhe teknologjitë që përdoren</i> ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave.
	Neni 14	Bashkia e qytetit dhe NjA-të <i>kontrollojnë dhe mbikëqyrin largimin e mbeturinave</i> , në përputhje me kushtet tekniko-higjienike, në zbatim të kontratës, nga personat e autorizuar prej saj.
	Neni 20	Bashkia <i>organizon largimin publik të mbeturinave</i> .
VKM Nr.333, datë 26.01.2001 “Për Administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”	Pika 2	Bashkia <i>bashkëpunon me bashkitë e tjera në nivel qarku për harmonizimin e politikave rajonale</i> për ushtrimin e funksioneve të përbashkëta.
	Pika 5	Bashkia bashkëpunon me Këshillin e Qarkut i cili planifikon sipërfaqe të caktuara për t’u përdorur për administrimin e automjeteve të dala jashtë



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

		përdorimit, si dhe përcakton vend-depozitimet për mbetjet e ndërtimit.
Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve, 19 gusht 2010	4.3.7	Bashkia, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, <i>koordinon planifikimin dhe ngritjen e qendrave të pritjes për mbetjet e rrezikshme shtëpiake, shërbimet dhe industrinë e vogël.</i>
VKM Nr.798, datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”	Pika 4	Bashkia <i>miraton vendndodhjen e impianteve të përpunimit të mbetjeve spitalore dhe vend-depozitimt të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme.</i> Bashkia <i>monitoron administrimin e mbetjeve spitalore sipas kompetencave.</i>
Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve”	Neni 12	Bashkia: <i>- harton Planin Vendor të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion;</i> <i>-përcakton rregulloren për kontrollin e manaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve.</i>
	Neni 62	Bashkia <i>sanksionohet me gjobë në rast se nuk respektohen standardet e manaxhimit të mbetjeve brenda territorit të saj.</i>
Vendim (Projekt) Nr.418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim	Neni 4	<i>-Bashkia merr masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara në këtë ligj.</i>
	Neni 9	Bashkia <i>merr masat mbi arritjen e objektivave dhe afateve të përcaktuar në këtë vendim.</i>
VKM Nr. 608 , datë 17.09.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”	Pika 4	Bashkia <i>grumbullon mbetjet bio në mënyrë të diferencuar deri në vitin 2018</i>
	Pika 9	Bashkia ka për detyrë: <i>-uljen në masën 50% të peshës totale të mbetjeve bio, të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;</i> <i>- uljen në masën 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 12 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.</i>
	Pika 11	Në Planin Vendor të Manaxhimit të Mbetjeve, <i>Bashkia duhet të përcaktojë masat, kriteret dhe rregullat për grumbullimin dhe manaxhimin e mbetjeve bio, në përputhje më Planin Rajonal dhe Planin Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve.</i>
	Pika 13	Bashkia <i>siguron kontenerë individualë për zonat me shtëpi private.</i>
	Pika 14	Bashkia, në zonat rurale <i>përcakton mënyrat, vendet dhe afatet kohore për trajtimin e mbetjeve bio në shtëpi ose lagje.</i>
	Pika 15	Bashkia <i>duhet të bashkëpunojë me bashki (NJQV) të tjera për sisteme të përbashkëta të grumbullimit të mbetjeve bio si dhe për ngritjen e skemës së ndarjes së mbetjeve bio.</i>
	Pika 16	Bashkia <i>krijon një bazë me të dhëna rreth peshës së mbetjeve bio të grumbulluara.</i>
	Pika 17	NjQV <i>raporton</i> çdo fundviti në Këshillin e Qarkut të dhënat mbi grumbullimin e mbetjeve bio dhe objektivat e trajtimit.
	Pika 13	Bashkia, në Planin e Përgjithshëm Vendor si dhe Planin Vendor të Manaxhimit të Integruar të



VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e Kërkesave për Manaxhimin e Mbetjeve Inerte”		Mbetjeve, duhet të parashikojnë vende për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe vend-depozitim për mbetjet inerte.
	Pika 19	Bashkia bashkëpunon me bashki të tjera për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet vend-depozitimi rajonal dhe për mënyrën e funksionimit të tij.
	Pika 21	Bashkia duhet të përcaktojë vendin e depozitimit të mbetjeve inerte.
Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”	Neni 23	Bashkia mbledh, largon dhe trajton mbetjet e ngurta dhe shtëpiake.

Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

5.2 Vlerësimi i planit të zhvillimit të territorit

5.2.1 Procesi i vlerësimit

Vlerësimi i ndikimit të projekteve kalon në dy faza, të cilat janë përshkruar më poshtë:

Faza 1: Vlerësimi i ndikimit:

Kjo është faza kur vlerësohet ndikimi që çdo projekt i Planit ka në elementët përbërës të mjedisit. Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, “ndikimi” në vetvete është zërthyer në **6 elementë** (kriteret, përbërës) të tij, të cilët janë:

1. Shfaqja (e ndikimit): element i cili shqyrton mundësinë e shfaqjes së ndikimit mjedisor të një projekti specifik në një objektiv mjedisor,
2. Kohëzgjatja (e ndikimit): vlerëson shtrirjen kohore të ndërhyrjes në mjedis që është parashikuar për një projekt,
3. Ndikimi (i projektit): shpreh me vlerë numerike shkallën e ndikimit të një projekti të Planit për çdo objektiv mjedisor (ujë, ajër, tokë, etj.),
4. Rikthimi (i ndikimit): ky tregues shpreh mundësinë e rikthimit të ndikimit në mjedis të një projekti pas zbatimit të tij,
5. Kumulativ (ndikim): potenciali që mbart ndërhyrja në mjedis gjatë realizimit të projektit për të shtuar dhe prodhuar ndotje të akumuluar në fazën e operimit dhe shfrytëzimit,
6. Shtrirja (e ndikimit): tregon hapësirën fizike (sipërfaqen) në të cilën shtrihet ndikimi në mjedis i një projekti.

Për sa i përket mjedisit, në kontekstin e vlerësimit mjedisor të PPV-së, ai është zërthyer në **10 elementë** që supozohet se janë pësuesit e pasojave që vijnë nga ndërhyrjet në mjedis gjatë zbatimit të projekteve. Këto 10 elementë janë *uji, toka, biodiversiteti, pyjet, peizazhi, klima, kultura, shëndeti dhe socio-ekonomia* të cilët gjatë gjithë procesit të vlerësimit në mjedis janë quajtur objektiva mjedisorë ose OM (Tabela 57). Pra, çdo element i mjedisit që është marrë për bazë në vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedis, përbën një objektiv mjedisor më vete. Për shembull, ajri është objektivi mjedisor numër 1, uji është objektivi mjedisor numër 2 e kështu me rradhë. Numri i objektivit mjedisor ka thjesht funksion renditës dhe nuk ndikon në vlerësimin e projektit.



Tabela 49. Objektivat mjedisorë

Objektivat Mjedisorë	Kodifikimi i tyre
Ajri	OM 1
Uji	OM 2
Toka	OM 3
Biodiversiteti	OM 4
Pyjet	OM 5
Peizazhi	OM 6
Klima	OM 7
Kultura	OM 8
Cilësia e jetës (Shëndeti Socio-ekonomia)	OM 9

Burimi: MetroPOLIS, 2017

Objektivat mjedisore të marrë si bazë për vlerësimin mjedisor të projekteve të PPV-së janë përcaktuar në Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani i Përgjithshëm Vendor për të arritur objektivat e tij. Për vlerësimin e ndikimit të çdo elementi (kriter) të *ndikimit* në një OM janë përdorur vlerat numerike ndërmjet [0-10] ku është ndjekur llogjika e mëposhtme:

- Vlera numerike 0: është përdorur për të shënuar projekte dhe objektiva ndikimi i të cilëve në mjedis nuk është i matshëm dhe i vlerësueshëm,
- Vlerat numerike 0.1-10: janë vlerat numerike që i jepen projekteve në varësi të ndikimit të tyre specifik në objektivat e mjedisit. Në parim, madhësia e ndikimit të një projekti në mjedis dhe vlerësimi numerik lidhen ndërmjet tyre në përpjestim të zhdrejtë. Sa më i lartë që të jetë numri i pikëve që merren në vlerësim, aq më i ulët është ndikimi i një projekti në mjedis dhe anasjelltas. Për shembull, vlera “1” tregon ndikim të lartë të projektit në mjedis ndërsa vlera numerike “10” tregon mungesë ndikimi ose ndikim të papërfillshëm. *Kjo vlen si në nivel elementi të ndikimit (kriteri), ashtu edhe në nivel projekti.*

Për vlerësimin e ndikimit ndiqet procesi i mëposhtëm:

1 *Vlerësimi me vlera numerike i ndikimit në një OM:*

Fillimisht kryhet *vlerësimi në pikë* i ndikimit të çdo elementi/kriteri të ndikimit në një OM (Tabela 58).

2 *Llogaritja e peshës specifike të një kriteri të vlerësimin në raport me totalin:*

<i>Pr.2: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi sipas standarteve të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta.</i>	1	1	1	1	2	1	2	3	3	1.67
<i>Pr.3: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike si dhe ndërtimi i pikës së kompostimit të mbetjeve organike.</i>	1	1	1	1	1	2	1	3	3	1.56
O3P2: Programi për krijimin e parqeve rajonale në zonat mjedisore që cilësohen si zona me biodiversitet të lartë duke mbrojtur dhe konservuar faunën dhe florën si dhe elementet e fortë natyror, peizazhistik, e historiko-kulturor.	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
<i>Pr.4: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit.</i>	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
<i>Pr.5: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit.</i>	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
O3P3: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve përrrenjve dhe zonave me rrezik natyror.	2.20	2.20	2.80	2.00	2.80	2.20	2.80	3.00	3.00	2.56
<i>Pr.6: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll.</i>	2	2	2	2	2	1	2	3	3	2.11
<i>Pr.7: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore</i>	2	2	3	2	3	3	3	3	3	2.67



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

<i>përgjatë përroit të Tomorricës, Vërçës dhe Holtës.</i>										
<i>Pr.8: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumi Devoll dhe liqeni i Hidrocentralit të Banjës..</i>	2	2	3	2	3	2	3	3	3	2.56
<i>Pr.10: Ndërtimi i pritave malore dhe ndërmarrja e fushatave të mbjelljes së bimësisë për zbutjen e veprimtarisë së erozionit në zonat e zhveshura malore.</i>	3	2	3	2	3	2	3	3	3	2.67
<i>Pr.11: Projekti për pyllëzimin e kodrave në afërsi të lagjes Llapushaj në qytetin e Gramshit si dhe në zonën e Liqenit të Dushkut.</i>	2	3	3	2	3	3	3	3	3	2.78
O4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.	1.65	1.94	1.75	1.75	2.75	2.81	2.25	3.00	2.94	2.32
O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet.	2.00	2.00	2.00	2.00	3.00	3.00	2.00	3.00	3.00	2.44
<i>Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Grabovë, Nartë, Mashan, Holtas, Gjerë dhe shkollës Asllan Shahini qytet Gramsh.</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.2: Ndërtimi i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Kukuçovë, zgjupë, Kabash dhe Lleshaj.</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.3: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.</i>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
<i>Pr.4: Rikonstruksioni i plotë i shkollës së mesme në Tunjë</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.5: Rikonstruksioni i ndërtesave publike të njëjve administrative Kushovë dhe Sult</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.6: Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore në fshatrat Siman dhe Ermenjë si dhe ndërtimi i qendrës shëndetësore në fshatrat Bratille dhe Kokël.</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

<i>Pr.7: Rikonstruksioni i Spitalit të Qytetit të Gramshit</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
Strategjik O4P2: Rikonstruksioni ndërtimi dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësisve administrative dhe fshatrave	1.00	2.00	1.50	1.50	3.00	3.00	2.50	3.00	3.00	2.28
<i>Pr.8: Ndërtimi i sheshit në afërsi të kishës në zgjatimin e bulevardit të ri të qytetit.</i>	1	2	1	2	3	3	2	3	3	2.22
<i>Pr.9: Rikonstruksioni i shesheve të qendrave të njësisve administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë</i>	1	2	2	1	3	3	3	3	3	2.33
O4P3: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.	1.60	2.00	2.00	2.00	3.00	3.00	2.00	3.00	3.00	2.40
<i>Pr.10: Projekti për rikonstruksionin i godinës së Komisarariatit Policor dhe kthimi në zyrë për shërbime administrative të institucionit të Bashkisë Gramsh.</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.11: Projekti për rikonstruksionin e bibliotekës së qytetit</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.12: Projekti për rikonstruksionin e muzeut të qytetit</i>	2	2	2	2	3	3	2	3	3	2.44
<i>Pr.13: Projekti për rikonstruksionin i Stadiumit dhe Pallatit të Sportit në qytet .</i>	1	2	2	2	3	3	2	3	3	2.33
<i>Pr.14: Projekti për rikonstruksionin Pallatit të Kulturës në qytet.</i>	1	2	2	2	3	3	2	3	3	2.33
O4P4: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Gramsh, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.	2.00	1.75	1.50	1.50	2.00	2.25	2.50	3.00	2.75	2.14
<i>Pr.15: Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës</i>	2	2	2	2	2	2	2	3	3	2.22
<i>Pr.16: Projekti për ndërtimin e zonës rekreacionale të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll</i>	2	2	1	1	2	2	3	3	3	2.11
<i>Pr. 17: Projekti për ndërtimin e parkut tërthor të qytetit i cili lidh parkun e bregut të lumit me zonën</i>	2	2	2	2	2	3	3	3	3	2.44



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

<i>e kodrave në pjesën lindore të qytetit.</i>										
<i>Pr.18: Projekti për ndërtimi varrezave të reja të qytetit</i>	2	1	1	1	2	2	2	3	2	1.78

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si me poshtë:

Objektivat Mjedisorë të PPV-së për Bashkinë Gramsh paraqiten:

- me përputhshmëri të lartë mjedisore në masën **37.1%** dhe
- me përputhshmëri të pjesshme në masën **30.6%**
- me përputhshmëri të zbehtë në masën **14.6%**
- me përputhshmëri neutrale në masën **13.0%**
- me ndikim të theksuar në mjedis: **4.7%** e ndërhyrjeve të parashikuara

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një përputhshmërisë e pjesshme e parë në kontekstin e përgjithshëm ku sipas fushave përkatëse mjedisore, intensitetin më të madh të ndikimeve në mjedis e marrin ndërhyrjet e forta në terren siç janë ato të zhvillimit të infrastrukturës urbane dhe rurale.

Duke qënë se mesatarja e përgjithshme e përputhshmërisë vlerësohet me 2.03, mund të themi se Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të.

Pra, në tërësi, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Gramsh mund të zbatohet plotësisht në terren dhe të jetë miqësor me mjedisin vetëm duke rrespektuar standardet, kushtet dhe masat specifike mjedisore që do të rrjedhin nga vlerësimi specifik i secilit projekt.

Në tabelat e mëposhtme, përputhshmëria është sjellë në nivel objektivash e planesh të Programit.

Sipas të dhënave të kësaj tabele, vërehet se shkalla më e ulët e përputhshmërisë vihet re tek objektivi mjedisor i ajrit, tokës, ujit, biodiversitetit të cilat janë edhe elementët mjedisor më të ndjeshëm nga projektet zhvillimore të parashikuara në PPV.



Tabela 62. Përputhshmëria e objektivave dhe progameve të planit me OM-të

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	Vlerësimi mesatar
O1:Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.	1.25	1.25	1.44	1.38	2.46	2.21	1.88	2.81	2.75	1.94
O2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.	0.92	0.99	0.21	0.54	1.51	0.94	2.37	3.00	3.00	1.50
O3:Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.	2.07	2.07	2.27	2.00	2.43	2.23	2.43	3.00	3.00	2.39
O4:Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.	1.65	1.94	1.75	1.75	2.75	2.81	2.25	3.00	2.94	2.32

Përgatitit: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Përputhshmëria është sjellë edhe në nivel Plani e shprehur me përqindje (%) e cila na ndihmon të kuptojmë shpërndarjen e saj në nivel objektiv të Planit.



Tabela 63. Përputhshmëria e objektivave (në %)

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore	% e OM me Perputh. e Larte / Projekt	% e OM me Perputh.e Pjesshme / Projekt	% e OM me Perputh.te zbehte / Projekt	% e OM me Perputh. Neutrale / Projekt	% e OM pa Përputhje / Projekt
O1:Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.	20.8%	27.9%	12.2%	37.5%	1.5%
O2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.	30.1%	31.0%	21.7%	0.0%	17.2%
O3:Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.	57.5%	17.0%	14.3%	11.1%	0.0%
O4:Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.	40.1%	46.2%	10.1%	3.6%	0.0%

Përgatitit: DLDP/MetroPOLIS, 2016

Si përfundim, duke u bazuar në tabelën e mësipërme, Objektivat I, II, III dhe IV të PPV-së për Bashkinë Gramsh paraqiten me përputhshmëri të lartë mjedisore në masën 37.1% dhe me përputhshmëri të pjesshme në masën 30.6%, ndërsa me përputhshmeri të zbehtë dhe neutrale vlerësohen 27.6%. Vetëm 4.7% e ndërhyrjeve të parashikuara rezulton të ketë ndikim të theksuar në mjedis.



5.2.4 Vlerësimi i projekteve të veçanta të PPV-së

Në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh janë përcaktuar projekte specifike për çdo objektiv. Të gjitha projekte janë të ndryshme për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis. Në tërësinë e projekteve të propozuar në PPV është bërë përzgjedhja e 2 projekteve për t'u trajtuar në mënyrë të veçantë. Përzgjedhja është bërë në bazë të 4 kriterëve: i) shkalla e ndikimit në mjedis gjatë zbatimit, ii) shkalla e ndërhyrjes në territor, iii) niveli i përputhshmërisë me objektivat mjedisore dhe iv) shkalla e ndikimit afatgjatë (gjatë operimit). Projektet e përzgjedhura dhe të konsideruar si të veçantë janë:

1. *Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*
2. *Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh*

Në vazhdim trajtohet në mënyrë të veçantë çdo projekt, duke analizuar kryesisht ndikimet negative në mjedis dhe duke dhënë rekomandime për marrjen e disa masave specifike për uljen e ndikimit dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë me objektivat mjedisore (OM).

Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë

Sipas legjislacionit për mbrojtjen e burimeve ujore në vend, është detyrë e Bashkisë për të prodhuar, trajtuar, transmetuar dhe furnizuar me ujë të pijshëm, në mënyrë që të sigurojë që çdo banorët i bashkisë të konsumojnë ujë të sigurt nga ndotja kimike, fizike dhe mikrobiologjike. Prandaj, ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm është propozuar si një zgjidhje efektive për sigurimin e ujërave të pastra për t'u përdorur brenda territorit të Bashkisë Gramsh.

Nga vlerësimi i ndikimit në mjedis, ka rezultuar se projekti për “*Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*” do të ketë ndikim mesatar në OM-n e ajrit, ujit, tokës, pyjeve dhe biodiversitetit, ndërsa në klimës do të ketë ndikim të ulët. Kulturës dhe shëndetit, në rast se merren të gjitha masat mjedisore do të ketë ndikim të papërfillshëm.

Tabela 64. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit

Bashkia GRAMSH: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshket kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.										
<i>Pr.31: Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë</i>	⇒ 5.7	⇒ 5	4.1 ⇒	4.2 ⇒	4.8 ⇒	3.6 ⇒	7.4 ⇒	8.8 ⇒	8.74 ⇒	9.05

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Siç shohim dhe nga tabela e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, projekti “*Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*” ka ndikim të papërfillshëm në aspektin social-ekonomik.



Nga analiza e përputhshmërisë midis projektit “*Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*” dhe objektivave mjedisore, rezulton se vlerësimi mesatar i përputhshmërisë së projekteve me OM-të vlerësohet të jetë i pjesshëm.

Tabela 65. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e	
<i>Pr.31: Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë</i>	2	2	1	1	3	3	3	3	3	2.33

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Projekti i “*Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjjë, Cigna, Nartë, Skenderbegas, Harunas, Duzhë, Silar, Mashan. Lenie, Taragjin dhe Kuratë*” ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisore (OM). Për objektivat mjedisore të tokës, biodiversitetit përputhshmëria është e zbehtë me objektivat e projektit të PPV-s. Ndërsa projekti përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore të ajrit dhe ujit dhe përputhet plotësisht me objektivin mjedisor të pyjeve, peizazhit, klimës, kulturës dhe cilësisë së jetës.

Duke ndërhyrë në tokë e punime për hapjen e kanaleve për kalimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm apo me punime për rehabilitimin e tij, parashikohen problematika të ndryshme si erozion i tokës, zhurma të shkaktuara nga makineritë gjatë punimeve që kryhen për gërmimin e tokës, humbje e biodiversitetit si pasojë e shqetësimeve të habitatit, presioni i ushtruar në tokë nga makineritë ose ngjeshje të tokës, shkarkime të lëndëve të ngurta në ajër si pasojë e pluhurave që shkaktohen nga punimet në tokë, etj. Në plan afatgjatë, projekti do të ketë ndikim pozitiv në transportin e sigurt të ujit të pijshëm, mbrojtjen e ujërave nga ndotja bujqësore dhe industriale.

Duke qënë që projekti ka ndikim në biodiversitet, këshillohet që zbatimi i tij të ndiqet, krahas inxhinierëve teknikë edhe nga një specialist mjedisi, në mënyrë që të parandalohen ndikimet e mundshme negative, pasi biodiversitetit është mjaft i ndjeshëm ndaj ndryshimeve që ndodhin në habitatin e tij.

Veprat e marrjes së ujit të mos planifikohen në burime që janë në monumentet e natyrës. Nëse marrja e këtyre burimeve ujore është me domosdoshmëri jetike dhe për nevoja të komunitetit të zonës, uji të merret 200 m larg perimetrit të monumentave të natyrës.

Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh



Projekti i rehabilitimit dhe pastrimit të kanaleve vaditëse dhe kulluese konsiston në pastrimin e kanaleve nga dheu i akumuluar gjatë viteve, sistemimin e shtratit të kanaleve pasi pjesa më e madhe e tyre është në gjendje dheu, e cila ka funksion të shumfishtë në mbrojtjen e cilësisë së ujit që përdoret për vaditje, përmirësimin e shërbimit të grumbullimit të ujërave të përdorura në vaditje dhe mbrojtjen e tokës e ujërave nëntokësorë nga ujërat e ndotura me pesticide dhe kimikate që përdoren në bujqësi.

Nga vlerësimi i ndikimit në mjedis, rezulton se projekti ka ndikim të papërfillshëm në kulturë, shëndet dhe socio-ekonomi, ndërsa në ujë dhe ndikimi është vlerësuar mesatar dhe ndikimi është vlerësuar i ulët në pyje dhe klimë, ndërsa në biodiversitë është cilësuar si ndikim i lartë.

Tabela 66. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit

Bashkia GRAMSH: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Socio-ekonomik
01: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim ujin e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.										
<i>Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh</i>	⇒ 4.4	⇒ 3.1	⇒ 3.4	↓ 2.7	⇒ 8.4	⇒ 5.4	⇒ 6.6	⇒ 9.4	⇒ 9.3	⇒ 7.7

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Projekti për “Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh” ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisore (OM). Për objektivat mjedisore të tokës, peizazhit dhe klimës përputhshmëria është e pjesshme me objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor. Ndërsa objektivat e Planit përputhen plotësisht me objektivat mjedisore të ajrit, pyjeve, kulturës dhe cilësisë së jetës, ndërsa përputhshmëria është e zbehtë për objektivat mjedisore të ujit dhe biodiversitetit.

Tabela 67. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetesës	
<i>Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh</i>	1	1	2	-1	3	2	2	3	3	1.78

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Duke ndërhyrë në shtretërit e kanaleve me punime për rehabilitimin e tyre, parashikohen problematika të ndryshme si erozion i tokës, sedimentimi të dherave duke shkaktuar kështu turbullira në ujërat e kanaleve, zhurma të shkaktuara nga makineritë gjatë punimeve që kryhen për pastrimin e shtratit të lumit, presion i ushtruar në tokë nga makineritë ose ngjeshje të tokës, etj.



Projekte të tilla gjenerojnë sasi të mëdha llumërash ose sasi balte, si rrjedhojë e depozitimit të grimcave të dherave, pasojë e punimit të sipërfaqeve të tokës bujqësore.

Në plan afatgjatë, projekti do të ketë ndikim pozitiv sa i përket sipërfaqes së mbulimit të tokës bujqësore me sistemin e vaditjes dhe kullues. Në rastin e rehabilitimit dhe pastrimit të kanaleve sasia e sipërfaqes që do të shpërndahet do të jetë më e madhe krahasuar me atë aktuale, sepse dhe sasia e ujit që transporton kanali do të rritet. I njëjti fenomen do të ndodhë dhe sa i përket kanaleve vaditëse. Pra, sdo shkaktohen më përmbytje të kanaleve dhe tokave përreth por ato do të jenë në gjendje të presin volume më të mëdhenj ujërash.

5.2.5 Ndikimi i përgjithshëm i Planit sipas OM-ve

Ndikimet më të mëdha në mjedis vijnë si pasojë e ndërhyrjeve në territor. Projektet e propozuara për përmirësimin e infrastrukturës publike janë ato që shkaktojnë ndryshimet më të mëdha mjedisore, ndikime që janë pasqyruar edhe në tabelën ku janë vlerësuar projektet sipas objektivave mjedisore. Më poshtë do të paraqitet vlerësimi i treguesve mjedisor nën ndikimin e projekteve të parashikuara në PPV-në e Bashkisë Gramsh.

- Ndikimi i përgjithshëm i Planit në tokë

Gjatë fazës së ndërtimit për zhvillimin e infrastrukturës, ndikimi në mjedis parashikohet të jetë i lartë. Zbatimi i projekteve në ato sipërfaqe toke ku do të ndërtohet do të ketë kthim të sipërfaqes natyrore/bujqësore në infrastrukturë/betonizuar. Kjo do të reflektohet në ndryshimin e përdorimit të tokës dhe do të çojë në zvogëlimin e sipërfaqes së tokës natyrore ose bujqësore dhe betonizimin e saj duke shkaktuar dhe fragmentarizim të habitatit natyror.

Gjatë fazës së ndërtimit, në zbatimin e projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh të cilat kanë punime për ndërtime të reja, ka ndikime të kthyeshme sidomos në zonën e ndërtimit. Këto ndërtime shkaktojnë dëmtimin e tokës duke shkaktuar fenomene të tilla si erozioni, shqetësime të faunës, rritje të prurjeve të sedimenteve në rast shirash të rrëmbyeshëm, rritje të sasisë së grimcave pezull në ajër si rezultat i veprimit të erës, në sipërfaqen ku do të ndërtohet.

Ndërtimet e reja ose rindërtimet e infrastrukturës janë burim i prodhimit të volumeve të mëdha të mbetjeve. Ato gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet krijohen si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe gjatë fazës së funksionimit. Ndikimi nga depozitimi i mbetjeve llogaritet të jetë i përhershëm dhe i pakthyesëm. Ndaj mendohet se duhet të merren masa për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që ndikimi në mjedisit të jetë sa më i ulët.

Sasitë e mbetjeve të krijuara nga infrastruktura në veçanti, konsiderohen të volumeve të mëdha. Ndërtimi i veprave lokale ka si rezultat sasi të vogla mbetjesh. Këto mbetje të krijuara mund të ripërdoren në infrastruktura të ngjashme si material mbushës. Zakonisht, përzierjet e materialeve të dala nga ndërtimet shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale. Në mënyrë që të arrihet një administrim ekonomik i burimeve natyrore, përveç masave specifike që jepen në PPV-në e Bashkisë Gramsh, nevojitet edhe marrja e masave të përgjithshme shtesë me qëllim uljen e ndotjes në tokë, si përdorimi i materialeve të riciklueshme në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës për çdo sektor.

Projektet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e projekteve në mënyrë institucionale dhe organizative nuk kanë ndikim në mjedis.



- Ndikimi i përgjithshëm i Planit në ajër

Ndikimi kryesor në ajër në lidhje me zbatimin e projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh do të vijë si rrjedhojë e zhvillimit të transportit. Shkarkimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit do të kenë ndikim afatshkurtër ose të kthyeshëm. Ndotja në ajër si pasojë e shkarkimeve do të shfaqet si pasojë e një numri të lartë aktiviteteve.

Ndikimet pozitive për shkarkimet në ajër priten edhe nga marrja e masave nga sektorë të tjerë ekonomikë që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda Bashkisë Gramsh duke marrë në konsideratë kontrollin e shkarkimeve në ajër, marrjen e masave për pakësimin e ndotjes së shkarkuar në ajër dhe përdorimin e energjive të gjelbra (për shembull, energjia diellore).

Nivelet e shkarkimeve të grimcave pezull në ajër do të rriten në zonat ku do të ketë ndërtime dhe rindërtime të infrastrukturës. Këto grimca janë shkaktare të një sërë sëmundjesh tek njeriu, të tilla si astma, arteroskleroza, sëmundje që kanë lidhje me sistemin e frymëmarrjes deri në kancer. Njerëzit, që punojnë dhe jetojnë në zonat e zbatimit të projekteve (në zonat e ndërtimit) janë të ekspozuar ndaj grimcave pezull dhe rrezikojnë të preken nga sëmundje të ndryshme. Ndaj, gjatë zhvillimit të projekteve nevojitet të zbatohen masat e parashikuara në mënyrë që të pakësohet shkarkimi i grimcave në gjendje pezull nga sheshet e ndërtimit.

- Ndikimi i përgjithshëm i Planit në ujë

Ndikimi në ujë (sipërfaqësor dhe nëntokësor) nga zbatimi i projekteve do të ndihet gjatë zbatimit të projekteve madhore, kryesisht ato infrastrukture, të cilat kanë edhe ndikimin më të lartë në mjedis. Gjatë periudhës së ndërtimit/rindërtimit dhe funksionimit të infrastrukturës, ndikimi në ujëra pritet të jetë i lartë. Në shumicën e rasteve ndikimi është i kthyeshëm. Ndikimi në ujë do të ndihet më tepër në trupat ujorë që do të presin shkarkimet e ujit të përdorur gjatë aktiviteteve.

Gjatë fazës së ndërtimit, në rast se nuk merren masat mbrojtëse të parashikuara, ndikimet mund të jenë të pakthyeshme si pasojë e ndikimit në morfologjinë e ujërave natyrore, në cilësinë e tyre, mosrespektimin e zonave mbrojtëse duke shkaktuar ndryshim të cilësive biologjike, fizike dhe kimike.

Në legjislacionin shqiptar në fuqi përcaktohet se në tokat pranë burimeve ujore dhe në brigjet ose sipërfaqet e trupave ujorë mund të kryhen vetëm ato veprimtari, të cilat bazohen në planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa prodhuar kosto të lartë disproporcionale. Pozicionimi i tyre mund të ndikojë thellësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore që përshkojnë Bashkinë e Gramshit.

- Ndikimi i përgjithshëm i Planit në biodiversitet

Ndikimi më i madh në biodiversitet ndodh gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit të veprave ndërtimore, ndikime të cilat konsiderohen afatshkurtër për Bashkinë e Gramshit. Ndikime të tilla shkaktohen nga zhurmat në sheshndërtime apo nga prishja a zvogëlimi i habitatit natyror. Ndikimet afatgjate dhe të pakthyeshme gjatë fazës së ndërtimit shkaktohen si rezultat i ndryshimit të përdorimit të tokës dhe ndërprerjes së rrugëve të migrimit të kafshëve. Ky ndikim mbartet dhe në vazhdim, mbas fazës së zbatimit gjatë fazës së funksionimit.



Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi i infrastruktures ekzistuese mund të rezultojë në humbje të florës dhe faunës, fragmentim të habitatit dhe ndërprerjen e rrugëve migruese të llojeve të veçanta ose jo. Dëmtime të biodiversitetit shkaktohen si rrjedhojë e mungesës së mosmarrjes së masave për të mos ndërprerë vazhdimësinë e habitateve (për shembull, ndërtimi i urave të gjelbërta), konfliktualitetin midis ndërtimeve dhe rindërtimeve me faunën, krijimit të zhurmës duke krijuar shqetësim tek shpendët dhe gjitarët. Edhe ndriçimi i strukturave të ndryshme të infrastrukturave mund të krijojë shqetësim të drejtpërdrejtë tek kafshët që kryejnë aktivitetin e tyre jetësor në mbrëmje dhe natën, pozicioni që kanë aktivitetet në ujë ose në tokën pranë vijave ujore.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në peizazh*

Peizazhi në Bashkinë Gramsh do të ndikohet më tepër nga zbatimi i projekteve që kanë shtrirje të gjerë në hapësirë. Ndikimi i projekteve të tilla evidentohet lehtësisht për shkak të shtrirjes në zonë të hapur. Ndikimet në peizazh përcaktohen nga ndryshimi i veçorive pamore të zonës dhe i elementëve karakteristike të hapësirës ku shtrihet hapësira e peizazhit të prekur. Ndikimi konsiderohet i lartë në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, zona të mbrojtura ose në zona me tipare simbolike.

Ndikimet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si të drejtpërdrejta, kumulative, jo të drejtpërdrejta dhe të dobëta. Ndërhyrjet që parashikohen të bëhen në PPV-në e Bashkisë Gramsh synojnë që të realizojnë përmirësimin e peizazhit, krahas fragmentarizimit të peizazhit dhe ndryshimit përfundimtar të përdorimit të tokës. Projekte të tilla janë ndërhyrjet që do të kryhen për ndërtimin e rrugëve peizazhistike, hartimi i paketave turistike, krijimi i intenerareve të gjelbra si dhe rehabilitimi i pyjeve të dëmtuara dhe gjelbërimi dekorativ në zonat urbane.

Rehabilitimi i zonave të nxehta që janë të pozicionuara në Bashkinë Gramsh paraqet interes jo vetëm për faktin që zbut ndotjen por dhe për përmirësimin e peizazhit, krahas përfitimeve shëndetësore që mund të kenë banorët e zonave përreth.

Ndërtimet e reja infrastrukturore të cilësdo ekonomi bëhen pjesë e peizazhit. Për këtë arsye nevojitet kujdes i veçantë në sistemimin e strukturave në fjalë në mënyrë që vendosja e tyre të bëhet në përputhje me tipologjinë e peizazhit ekzistues. Duke marrë parasysh elementin e tipologjisë natyrore të zonës gjatë zbatimit të projekteve, do të ulet fragmentimi/copëzimi i peizazhit.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në klimë*

Projektet e propozuara në PPV-në e Bashkisë Gramsh do të kenë ndikime të kthyeshme pavarësisht se do të ndikojnë në çlirimin e gazrave të efektit serë dhe rritjen e sasisë së grimcave në gjendje pezull në ajër duke shkaktuar kështu krijimin e një mikroklimë në zonën ku do të aplikohen. Zbatimi i projekteve me ndikime të kthyeshme por shkaktarë të krijimit të mikroklimës, kanë të bëjnë më përmirësimin infrastrukturor.

Ndër shkaqet kryesore të ndryshimeve klimatike renditet edhe përdorimi i mjeteve të transportit, si pasojë e cilësisë së ulët të karburantit që përdoret në vendin tonë. Karburantet çlirojnë gazra të efektit serë gjatë djegies. Për këtë arsye, transporti klasifikohet si një ndër sektorët më problematikë lidhur me gazrat serë. Transporti ngelet sektori kyç në arritjen e objektivave kombëtare mbi masat për ndryshimet klimatike duke u ndjekur nga bujqësia dhe përdorimi i tokës.



Objektivi kryesor i vendimit 406/2009/EC për vendet anëtare të EU është ulja e shkarkimeve të gazrave serë për periudhën nga 2013 në 2020. Republika e Shqipërisë ka planifikuar që deri në vitin 2018 të përshtasë dhe të zbatojë objektivat e këtij vendimi. Me qëllim përmbushjen e objektivave të këtij vendimi parashikohet që me zbatimin e SKZHI të arrihet ulja me 8% të sasisë së GHG së shkarkuar dhe ulja me 40% e sasisë së HCFC-ve.

Transporti, bujqësia dhe sektori i prodhimit të energjisë mbeten sektorët kryesorë të ekonomisë që ndikojnë ndjeshëm në prodhimin e gazrave serë dhe HCFC-ve. Për eliminimin e këtyre ndikimeve duhet të merren masa specifike. Arritja e objektivave realizohet duke stimuluar zhvillimin dhe përmirësimin e transportit publik, duke ulur ndotjen industriale, duke informuar bujqërit rreth metodave të reja bujqësore të punimit të tokës dhe duke nxitur përdorimin e energjive të rinovueshme për prodhim energjie.

5.3 Përmbledhje e vlerësimit të propozimeve të PPV-së

Projektet e propozuara në Planin e Bashkisë Gramsh janë hartuar duke patur parasysh njëkohësisht gjendjen e mjedisit në territorin e Bashkisë dhe problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me shërbimet që Bashkia i ofron qytetarëve të saj. Projektet synojnë arritjen e pesë objektivave specifike të Planit që janë:

- **O1:**Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.
- **O2:** Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.
- **O3:**Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.
- **O4:**Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.

Zbatimi i projekteve së bashku me projektet që parashikohen në Planin e Detajuar Vendore pritet të ketë ndikim konkret në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe gjendjes së mjedisit. Ndërkohë, ndikimi i tyre gjatë fazës së zbatimit mund të shkaktojë përkeqësimin e përkohshëm të gjendjes mjedisore të Bashkisë Gramsh.

Duke qenë se projektet mbulojnë fusha të ndryshme, ata janë të ndryshëm për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis. Me qëllimin përcaktimin e ndikimeve të mundshme të projekteve në mjedis gjatë fazës së zbatimit dhe në një periudhë kohore afatgjatë, si dhe përcaktimin e natyrës së ndikimeve dhe masave zbutëse, u bë vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik dhe Plani.

Në bazë të analizës së ndikimit, rezultoi se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Konkretisht, në nivel objektivi të planit, rezultatet paraqiten si më poshtë:



- e. Projektet e O.1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët. : nga 15 projektet e O.1, rezulton se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim mesatar në ajër ujë dhe tokë, biodiversitet, ndërkohë në, pyje, peizazh dhe klimë ndikimi do të jetë i ulët, ndërsa përbërësit e kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë do të kenë një ndikim të papërfillshëm.
- f. Projektet e O.2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.: nga 37 projektet e O.2, rezulton se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim mesatar në përbërësit ajër, ujë, tokë, biodiversitet, pyje, peizazh dhe ndikim të ulët në klimë, ndërsa në kulturë e socio-ekonomi kanë ndikim të papërfillshëm.
- g. Projektet e O.3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.: ky përmbledh në vetëvete 22 projekte, rezulton se projektet do të kenë ndikim të ulët në përbërësit e mjedisit si ajër, ujë, tokë, biodiversitet, pyje, klimë dhe peizazh, ndërsa në përbërësit e tjerë (kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë) do të ketë një ndikim të papërfillshëm.
- h. Projektet e O.4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.: nga 10 projektet e O.4, rezulton se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit mjedisorë: pyje, ajër, klimë, kulturë, shëndet dhe socio ekonomi, ndërkohë që në ujë, tokë, peizazh dhe biodiversitet ndikimi rezulton mesatar.

Vlerësimi numerik (sasi) i ndikimit në mjedis është bërë duke patur parasysh se gjatë zbatimit të projekteve do të merren masat teknike për zbutjen e ndikimit, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të ndikimit, është vlerësuar edhe përputhshmëria ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit të Bashkisë Gramsh dhe objektivave të VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi është kryer fillimisht në nivel projekti dhe ka përfunduar në nivel objektivash. Për vlerësimin e përputhshmërisë janë paraqitur 5 nivele të cilat janë:

11. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të: Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm,
12. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të: Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.



13. Lidhja/përputhshmëria është e zbehtë: Përputhshmëria është e dobët edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
14. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale): Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM-së.
15. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të: janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Rezultatet e analizës së përputhshmërisë në nivel Planit të Bashkisë gramsh janë paraqitur më poshtë:

Tabela 68. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Përputhshmëria Totale	1.47	1.56	1.41	1.42	2.29	2.05	2.23	2.95	2.92	2.03

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Bashkia Gramsh, nga procesi i vlerësimit të Përputhshmërisë, ka rezultuar se Planit ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisorë. Ky tregues mund të interpretohet në mënyrë të përmblendhur duke theksuar se ndikimet në mjedis nga zbatimi i programeve dhe projekteve të PPV-së do të jenë konkrete dhe të matshme. Këto ndikime janë referuar në seksionin e mësipërm (5.2.1) dhe në bazë të tyre janë hartuar masa shoqëruese (referuar në seksionin 6) të cilat nëse respektohen nga zbatuesit dhe monitorohen me përpikmëri nga institucionet përgjegjëse (të referuara në seksionin 5.1), mund të zbutin ndikimin në mjedis në nivele më të ulta edhe pse nuk mund ta eliminojnë fenomenin plotësisht.

Duke iu referuar tabelës përmblendhëse të Përputhshmërisë në nivel PPV-je, është vlerësuar se Objektivat Mjedisorë Ajër, Tokë dhe Biodiversitet janë në kufinjtë e kategorizimit me përputhshmëri të zbehtë, afër mesatares . Për këtë arsye masat e referuara për këto elementë nevojitet që të trajtohen me rreptësi.

Lidhur me ujin, pyjet, peizazhin, dhe klimën janë vlerësuar se këto objektiva janë në përputhshëmi të pjesshme. Duke qëndruar nën presionin e ndikimit të fortë njerëzor, këto elementë të mjedisit janë përballur me sfida të forta ndër vite për të cilat vetëm kohët e fundit janë hartuar politika dhe ndërhyrje konkrete të cilat synojnë parandalimin e përkeqësimit të gjendjes dhe përmirësimin e saj në rang Republike dhe jo vetëm në Bashkinë e Gramshit.

Kultura dhe cilësia e jetës janë dy përbërës mbi të cilët është punuar veçanërisht për të krijuar një harmoni natyrore dhe përmirësim të vlerave qoftë natyrore, të shëndetit publik



dhe trashëgimisë kulturore e historike duke identifikuar vlerat thebësore dhe identitetin e kësaj Bashkia.

Në tabelën e mëposhtme reflektohen Projektet e Planit të PPV-së të shpërndara në % në bazë të niveleve të përputhshmërisë që ato kanë ndaj Objektivave Mjedisore.

Tabela 69. Përputhshmëria totale e Planit me Objektivat Mjedisorë

Bashkia GRAMSH: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore	% e OM me Perputh. e Larte / Projekt	% e OM me Perputh.e Pjesshme / Projekt	% e OM me Perputh.te zbehte / Projekt	% e OM me Perputh. Neutrale / Projekt	% e OM pa Përputhje / Projekt
Përputhshmëria Totale	37.1%	30.6%	14.6%	13.0%	4.7%

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Përgjithësisht, shumica e përputhshmërive në nivel mesatar dhe të ulët lidhet më tepër me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet e infrastrukturës, veçanërisht nga projektet me shtrirje të gjere sipërfaqësore dhe sektorë të ndryshëm si energji, ujë, etj.

Nga rezultatet e mësipërme rezulton se:

- Në total, nga 80 projekte të PPV-së, 37.1% e tyre kanë përputhshmëri të lartë me objektivat mjedisore. Pra ndikimi që projektet do të kenë në mjedis do të jetë i papërfillshëm dhe, në disa raste, ato janë hartuar si një domosdoshmëri e rehabilitimit të gjendjes mjedisore për Bashkinë Mat.
- Rreth 30.6 % e fondit të projeteve kanë përputhshmëri mesatare, çka nënkupton se ndikimi i tyre do të jetë i ulët dhe mund të zbutet ndjeshëm me marrjen e masave të parashikuara në legjislacionin shqiptar (masat përcaktohen gjatë hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) gjatë fazës së zbatimit. Monitorimi i këtyre masave është element kyç në ruajtjen e nivelit të përputhshmërisë edhe gjatë fazës së operimit të këtyre projekteve.
- Vetëm 14.6 % e projekteve nga 80 që janë propozuar në Planin e Bashkisë Gramsh kanë përputhshmëri të zbehtë. Në këtë rast qoftë respektimi qoftë monitorimi i përpiktë i masave shtrënguese mjedisore nuk do të sillte neutralizim të plotë të ndikimeve, por thjesht do të kufizohej me zbutjen e ndikimit të projekteve tek objektivat mjedisore.
- Projektet e vlerësuara me përputhshmëri neutrale kanë të bëjnë kryesisht me hartime planesh, studimesh, investimesh dhe ngritjesh kapacitetesh njerëzore. Pra projekte dhe ndërhyrje të cilat bartin një ndikim mjedisor me peshë fare të vogël (13 %) krahasuar me ndërhyrjet fizik është faktorizuar si neutral.
- Vetëm 4.7 % e projekteve nuk përputhen me objektivat mjedisore (OM-t), kjo është një përqindje fare e vogël, pasi kjo është gjeneruar në totalin e elementeve të vlerësuar, ndaj nuk do të thotë që një projekt i caktuar do të jetë plotësisht pa përputhshmëri me OM-të.



Ndikimet që rrejdhin nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor janë vlerësuar kryesisht të kenë karakter me intensitet të ulët dhe në disa raste rehabilitues e të domosdoshëm për të sistemuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit në Bashkinë Gramsh.

Ndikimet pozitive afatgjatë identifikohen kryesisht në përmirësimin e cilësisës së jetës dhe nivelit kulturor të shoqërisë, kjo si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të parashikuara në këtë PPV.

Ndikimet pozitive në popullatë dhe pasuri materiale do të vijnë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës rrugore dhe të shërbimeve në përgjithësi gjë që do të çojë në përmirësimin e lëvizjes së banorëve brenda dhe jashtë Bashkisë duke shkurtuar kohën e udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.



6. Masat mbrojtëse për mjedisin

6.1 Masa për parandalimin / zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së

Në Kapitullin 5 është vlerësuar ndikimi i projekteve të PPV-së gjatë fazës së zbatimit dhe afatgjatë. Siç është shtjelluar në këtë kapitull, në bazë të analizës së ndikimit, ka rezultuar se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Ndikimi, edhe pse në shkallë të ndryshme, do të jetë kryesisht në tokë, burime ujore, pyje, ajër, biodiversitet, etj. Ndikimi parashikohet të jetë specifik për çdo projekt më vete.

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti, dhe në rastin tonë të projekteve të PPV-së së bashkisë është kompetencë e një numri të caktuar institutesh publike dhe e zhvilluesit të projektit. Institutet publike sigurohen që për çdo projekt, zhvilluesit e projekteve parashikojnë dëmtimet e mundshme të mjedisit gjatë fazës së zbatimit dhe përpara fillimit të zbatimit të projektit, marrin masat teknike të nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në respekt me mjedisin.

Sipas Ligjit nr. 10440, projektet, përpara zbatimit do t’i nënshtrohen “procedurës paraprake të vlerësimin të ndikimit në mjedis” ose “procedurës së thelluar të vlerësimin të ndikimit në mjedis” sipas Ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011. Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Sipas nenit 4 të të njëjtit ligji, vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. *Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit gjatë fazës së zbatimit dhe gjithashtu edhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, edhe propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.*

Autoriteti vendimmarrës për hartimin e VSM-së është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila vendos nëse një projekt i nënshtrohet VNM-së paraprake ose duhet t’i nënshtrohet edhe procedurës së thelluar të VNM-së. Hartimi i vlerësimin të ndikimit në mjedis (VNM-së) të një projekti mbetet detyrë e zhvilluesit të projektit (neni 11 i Ligjit nr. 10 440). Hartimi i VSM-së është proces që përfshin institucionet shtetërore (Ministrinë e Mjedisit dhe AKM-në), zhvilluesin e projektit, pushtetin lokal ku zhvillohet projekti dhe palët e tjera të interesuara si publiku dhe organizatat jo-fitimprurëse, etj. Zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij (Neni 14 i Ligjit nr. 10 440).



Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti luan edhe autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive (zbatimin e projekteve). Ligji nr. 10 440 i kërkon autoriteteve në fjalë që, përpara vendimit për dhënien e lejes së zhvillimit apo licencës përkatëse për një projekt të propozuar, të sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin (Neni 20 i Ligjit nr. 10 440).

Mbas marrjes së lejes për zbatimin e projektit, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë (Neni 20 i Ligjit nr. 10 440).

Një vëmendje të veçantë si objekt mbrojtjeje i kushtohet zonave të mbrojtura ose zonave veçanërisht të mbrojtura (neni 21 i Ligjit nr. 10 440). Në këtë rast, dispozitat e ligjit nr. 10 440 zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zonë veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij. Bëjnë përjashtim vetëm rastet kur i) nuk ka zgjidhje tjetër alternative; ii) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ato me natyrë shoqërore apo ekonomike (arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin); iii) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të “Natyra 2000”.

Si përfundim, mund të thuhet se masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së përcaktohen në VNM-të përkatëse të çdo projekti. Rolin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në këtë rast e luajnë Ministria e Mjedisit me institucionet vartëse që miratojnë VNM-të e projekteve, autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive të cilat kërkojnë që projekti të jetë pajisur me vendim apo deklaratë mjedisore, zhvilluesit e projekteve të cilët përcaktojnë masat që merren gjatë fazës së zbatimit dhe autoritetet inspektuese gjatë fazës së zbatimit. Një rol tejet të veçantë dhe të rëndësishëm pritet që të luhet nga publiku në fazën e hartimit të VSM-ve dhe për ndërgjegjësimin e qeverisë lokale (bashkisë) për rëndësinë e respektimit të ligjit nr. 10440 gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së dhe në të ardhmen.



6.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore

6.2.1 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë e cili rrjedh kryesisht nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për ruajtjen e mjedisit dhe ofrimin e një mjedisi cilësor për qytetarët në territorin e saj si dhe Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”. Krahas tyre, detyrimet rrjedhin edhe nga ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo të përbërësve specifikë të tij.

Lumi i Devollit e degët e tij kanë pësuar dëmtime të shumta brenda territorit të Bashkisë së Gramsh dhe jasht saj, në 20 vitet e fundit. Nga vëzhgime të vazhdueshme në territorin e Bashkisë së Gramshit ka rezultuar se presionet kryesore të lumit janë mbetjet urbane, shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe ato nga industria, kryesisht të trashguara nga ish-industrit. Problematikat kryesore nga burimet ndotës shfaqen në segmentin pranë qytetit të Gramshit, ku derdhen ujërat e ndotur urban (pasi jo të gjitha janë të lidhura me impiantin e trajtimit të ujrave) të patrajtuar, gjithashtu në këtë segment të lumit bashkohen ujërat të cilët janë të ndotura nga shllami që shkarkohet nga vend-depozitimi i mbetjeve urbane në afërsi të Gramshit.

Me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore, në Planin e Përgjithshëm Vendor, i cili është në fazë miratimi, Bashkia Gramsh ka hartuar disa projekte specifike të cilat përqendrohen në *përmirësimin e hidro-morfologjisë të lumenjve të Basenit të Devollit* dhe degëve të tij, *mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën. Projektet janë kryesisht me fokus i) rehabilitimin mjedisor të zonave ripariante të Lumit Devoll e degëve të tij, ii) hartimin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sipas ligjit Nr. 10 463, datë 229.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Neni 12. Në plan përfshihen edhe propozime për *gjetjen e zgjidhjes për ujrën e ndotura urbane në të gjithë territorin e bashkisë* dhe krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe ripërdorimin e ujërave të bardha. Krahas projekteve të propozuara në PPV, VSM-ja përcakton edhe disa masa të tjera, të nevojshme për realizimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, si më poshtë:

Monitorimi i menjëhershëm i Lumit Devoll: gjatë monitorimit të ujërave të lumit Devoll²⁴², ka rezultuar se ujërat janë të ndotur me metale të rënda si Pb, Cd, Ni, Mn, Fe, Cu, Cr. Duke patur parasysh se ujërat e lumenjve në përgjithësi përdoren për ujitje të kulturave bujqësore dhe herë herë për peshkim. Metalet e pranishme në lumin Devoll, si Pb e Cd janë kancerogjene, ndaj është e rëndësishme që të merren masa për monitorimin e thellë të lumenjve për një kohë prej të paktën dy-vjeçare në mënyrë që të përcaktohet nëse:

- Ujërat e lumit Devoll mund të përdoren për ujitje pa cënuar shëndetin e banorëve dhe konsumatorëve,
- Banorët e zonave në afërsi të lumit mund të peshkojnë dhe të konsumojnë peshkun e zënë në ujërat e lumit Devoll pa cënuar shëndetin e tyre

Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Devoll: Lumenjtë e Basenit të Semanit janë (ben pjesë edhe Devolli) shfrytëzuar për inerte në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e



cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit:

- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore, kryesisht në fillimin e hyrjes së lumit Devoll në territorin e Bashkisë dhe në degët e tij, ku është vënë rë shfrytëzim i inerteve lumore (në bashkëpunim me ABU Seman, ARM Elbasan dhe Ministrinë e Mjedisit). Bazuar në VKM Nr.1, datë 21.6.2006 “Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”, Bashkisë së Gramsh i rekomandohet që *për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve të japë leje vetëm në rastet kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*. Pra, Marrja e inerteve, në rastet kur është e pashmangshme për arsye ekonomike, *të shoqërohet me studime specifike të posaçme për çdo rast me qëllim shmangien e dëmtimit të trupit lumor*. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka kryer studime të hollësishme rreth shfrytëzimit të inerteve të lumenjve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Për këtë arsye, rekomandohet *bashkëpunimi me SHGJSH për shqyrtimin e çdo lejeje*,
- Të rehabilitojë shtratin e lumit në zonat e dëmtuara përgjatë lumit të Devoll dhe degëve të tij, kryesisht në NjA-në Skëndërbegas e deri në Gramsh. (Ndërtimin e pritave anësore e tërthore me qëllim shmangien e erozionit të brigjeve, mbrojtjen e urave, pastrimin e brigjeve të lumit të mbushura me inerte, krijimin e pyjeve artificiale në terracën e shtratit apo në terracën e parë me qëllim shmangien ose uljen e veprimtarisë gërryese të rrjedhës).²⁴³

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikën e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikën bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e kimikateve.

Hartimi dhe zbatimi i programeve e planeve vendore/ndërbashkiake për menaxhimin e Basenit të lumit Seman (Devollit pjesë e këtij baseni): Semani është lumë që përshkon territorin e bashkive të ndryshme. Si rrjedhojë, mbrojtja e tij kërkon bashkërendimin e përpjekjeve të të gjitha bashkive përkatëse në bashkëpunim me Agjencinë e Basenit Ujor (ABU) të Semanit. Bashkëpunimi mund të kryhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve e planeve ndërbashkiake/vendore ose për hartimin e Planit të Menaxhimit të Basenit të Semanit. Ky plan duhet të përcaktojë angazhimet përkatëse për çdo bashki në fushat e mëposhtme:

- përdorimin e qëndrueshëm të ujërave të lumit Seman nga të gjitha bashkitë (bashkëpunim në dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit për qëllime të ndryshme si për pije, bujqësi, industri, etj.) pa penalizuar bashkitë në rrjedhën e mesme e të poshtme të lumit,
- koordinim për ruajtjen e mirëmbajtjen e lumit (pastrimin e shtratit të lumenjve, krijimin e fashës së gjelbër, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumë),
- parandalimin e ndotjes së lumenjve në këto bashki (ndalimin e hedhjes së mbetjeve në lumë/burime ujore sipërfaqësore) në mënyrë që bashkitë në rrjedhën e poshtme të mos marrin të gjitha ujërat e ndotura të bashkive në rrjedhën e sipërme dhe të mesme;



- përcaktimin e pasojave dhe masave për zbutjen e tyre që ka ndërtimi i HEC-eve në degët e Semanit në cilësinë e ujit të lumenjve, në prurje, biodiversitet, dhe deri në plazhe.
- pyllëzimin e pellgut ujëmbledhës të lumit Semanit me qëllim shmangien e përmytjeve dhe erozionit;
- monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të basenit të Semanit dhe degëve të tij dhe të ujërave të Akuiferëve që përdoren për ujë të pishëm.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit ujor: rekomandohet që Bashkia të ndërtojë një program ndërgjegjësimi të popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore ku të vihet theksi tek mospërdorimi i lumenjve si vende të depozitimit të mbetjeve, etj.

Zgjerimi i rrjetit të monitorimit dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike (industriale, bujqësore, etj.) të pranishme në territor: lumi Devoll përshkon territore të gjera me aktivitetet të ndryshme bujqësore dhe industriale. Për fat të keq, Devolli monitorohet nga një numër i kufizuar stacionesh monitorimi²⁴⁴. Duke parë rëndësinë që ujërat e Devollit kanë për bujqësinë dhe peshkimin, rekomandohet:

- Monitorimi mujor ose mundësisht ditor i cilësisë së ujërave të Devollit nga ARM Elbasan gjatë gjithë vitit. Monitorimi i lumenjve deri më tani kryhet nga AKM. Është e udhës që monitorime të kryhen edhe nga ARM Elbasan. Duke qenë e pranishme në territor, ARM Elbasan arrin të monitorojë ujërat e lumit Devoll në kohën e duhur edhe në rastet kur ka derdhje të rastësishme abuzive të lëndëve të ndryshme në lumë.
- Shtimin e stacioneve të reja të monitorimit të lumenjve në zonat më problematike (në qendër të zonave më të banuara, në zonën ku zhvillohet industria, etj.).

Për këtë nevojitet bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale Elbasan.

6.2.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore

Qarku i Elbasanit, ku bën pjesë edhe Bashkia Gramsh është i pasur me burime ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshme ujëmbajtës²⁴⁵. Akuiferët përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitete të tjera ekonomike në territorin e Bashkisë së Gramshit dhe të bashkive përreth. Duke u mbështetur në studimet e kryera nga SHGJSH rreth problematikave të ndryshme të akuiferëve në Qarkun e Elbasanit²⁴⁶, lind nevoja të merren disa masa të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Disa nga këto masa renditen më poshtë:

Monitorimi në mënyrë urgjente i Akuiferëve në territorin e Bashkisë Gramsh dhe më gjerë për ndotje nga industria / bujqësia që zhvillohet brenda zonës. Monitorimi duhet të ketë si qëllim të përcaktojë llojin e përdorimit të ujërave të akuiferëve. (nëse ujërat e këtyre Akuiferëve mund të përdoren për furnizim me ujë të popullsisë). Prej vitesh në zonë kryhen aktivitete të ndryshme, ku mendohet që një sasi ndotje të ketë deportuar në ujërat e akuiferëve, aktualisht nuk ka monitorime të kryera për akuiferët në territorin e Gramshit.



Zbatimi dhe mbrojtja e zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve dhe burimeve që shfrytëzohen nga popullata për qëllim pirje apo bujqësinë (legale/ilegale): Në Bashkinë e Gramshit, kryesisht uji për pirje merret nga burime, pjesa më e madhe e bashkisë furnizohet nga Burimi i Kërpicës. Në territorin e bashkisë, Disa NjA nuk kanë sistem të furnizimit me ujë të pishëm, kështu që lind nevoja për marrjen e ujit në mënyrë individuale, kryesisht në afërsi të shtëpive të tyre, në këtë mënyrë është më së e nevojshme monitorimi i këtyre ujërave dhe përcaktimi i zonave higjeno-sanitare përreth tyre.

Të krijojë një regjistër ku të regjistrohen pus-shpimet/veprat e marrjes legale dhe ilegale në territor dhe vendndodhja e tyre me qëllim përcaktimin e cilësisë së këtyre ujërave dhe gjetjen e mundësisë për shmangien e konflikteve me veprimtaritë e tjera (industria, bujqësia, urbanizimi) që shkaktojnë ndotje në to. Pus-shimet duhen klasifikuar sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore. Kjo ndihmon për inspektimin e tyre të herë pas hershëm.

- Të krijojë dhe mbrojë zonat higjeno-sanitare përreth të gjitha pus-shpimeve / veprave të marrjes në zbatim të Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 “ Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm
- të zonohet territori sipas ndjeshmërisë së akuiferëve ndaj ndotjes sipërfaqësore në rast shpimesh. Kjo ndihmon për të përcaktuar se në cilat zona lejohen shpimet sepse nuk përbëjnë rrezik ndotjeje për akuiferët dhe në cilat zona ndodh e kundërta
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura industriale në lumin Devoll dhe në degët e tij në mënyrë të menjëhershme.

Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike në zonë: AKM në bashkëpunim me SHGJSH monitoron gjendjen e burimeve ujore nëntokësore rregullisht me bazë vjetore²⁴⁷. Megjithatë, vihet re se numri i pikave të monitorimit për përcaktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në çdo basen e akuifer është i ulët, ndërkohë që zonat me ndjeshmëri të lartë ndotjeje janë të shumta. Në Bashkinë Gramsh rekomandohet monitorimi i parametrave që tregojnë edhe ndotjen nga ish-industria dhe aktivitetet e ndryshme që zhvillohet aty.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikën e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikën bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

- o *Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore të akuiferëve*

Pajisja me një pasqyrë të rezervave vjetore të ujërave nëntokësore në akuiferë. Pasqyra të kihet parasysh gjatë dhënies së lejeve për shfrytëzimin e ujërave të akuiferëve me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre²⁴⁸. Në periudhën me reshje të pakta në verë (qershor-shtator), kërkesa për ujë rritet edhe më tej nga sektori i turizmit e bujqësisë. Në këtë periudhë, akuiferët kanë nivelin më të ulët të ujit në krahasim me periudhat e tjera të vitit për shkak të mungesës së shirave. Rol kryesor në menaxhimin e akuiferëve kanë SHGJSH-ja, Agjencia e Menaxhimit të Basenit të Seman (ABU Seman) së bashku me Bashkinë e Gramshit dhe bashkitë e tjera përkatëse që shfrytëzojnë akuiferët. Menaxhimi



i qëndrueshëm i burimeve ujorë rrjedh si pasojë e zbatimit të ligjit nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”.

Monitorimi i sasisë së ujit që shfrytëzohet nga akuiferët në Qarkun e Elbasanit e Bashkitë e tij: Sipas ligjit Nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, Bashkisë së Gramshit në bashkëpunim me AKM, ARM dhe Këshillin dhe Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit i del për detyrë të mbikqyrin, të detyrojnë subjektet dhe individët të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private për të eliminuar lidhjet e paligjshme dhe shfrytëzimin e pakontrolluar të akuiferit ujëmbajtës. Kjo do të sillte një mirëmenaxhim të burimeve ujore dhe Bashkia do të kishte informacion më të saktë për përdorimin e tij.

Ndalimi i shkarkimit të ujërave të ndotura urbane e industriale dhe të bardha në Devoll: Shpesh herë burim ndotës për ujërat nëntokësor janë lumenjtë, pasi disa pjesë të lumenjëve shërbejnë si dritare hidreologjike për ujërat nëntokësor, kryesisht zonat të cilat janë me ujëpërçellshmëri të lartë. Në këtë mënyrë ujërat e ndotura të lumenjëve e transportojnë ndotjen në ujërat e akuiferëve. Lumi i Devollit ka presion të vazhdueshëm mjedisor nga shkarkimi i ujërave të ndotura urbane, dujqesore dhe ato industriale, të shpërndara në disa pjesë të territorit

Për këtë arsye rekomandohet që Bashkia:

- të marrë masa të menjëhershme për ndalimin e derdhjes direkt në lumë i ujërave të ndotura urbane dhe industriale të patrajuara fillimisht si dhe
- të ndërtojë sa më shpejt rrjetin e ganalizimeve dhe gropave higjeno-sanitare të ujërave të ndotura urbane të parashikuar në PPV,
- të ndërtojë sistemin e kullimit që bën të mundur kontrollin e ujërave të bardha me qëllim shmangien e ndotjes së lumit Devoll dhe degëve të tij që shërbejnë si burim ushqimor për ujërat nëntokësor.
- Për menaxhimin e Basenit të Semanit, të bashkëpunojë me ABU Seman dhe bashkitë e tjera përkatëse për mbrojtjen e lumit Devoll e në tërësi Basenin e Semanit nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.

Mbyllja dhe rehabilitimi i gropave septike: Në zonat rurale të bashkisë sistemi i kanalizimeve nuk e mbulon të gjithë popullsinë e vendosur në këto zona. Për largimin e ujërave të ndotura nga shtëpitë e tyre popullsia ka ndërtuar gropa septike jashtë çdo standardi tekniko-sanitar duke krijuar kështu probleme në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ujërat e vendosura në këto gropa largohen nga aty nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese duke kryer shkelje të legjislacionit në fuqi. Bashkisë i del për detyrë të :

- lokalizojë vendosjen e gropave septike jashtë standardeve tekniko-sanitare dhe të vendosë mbylljen dhe rehabilitimin e gropave ekzistuese
- hartojë një plan informimi për mënyrën e ndërtimit të gropave septike.

6.3. Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura

6.3.1 Masa për mbrojtjen e peizazhit

Peizazhi në territorin e Bashkisë Gramsh paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku dominon aktiviteti njerëzor (Shih seksionin e Peizazhit). Problematikat kryesore që has peizazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëtimin



e peizazhit natyror dhe mos futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për tu theksuar problemet me peizazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historik, të cilët sëbashku do të krijojnë një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh praktikat e mira të peizazhit nuk ndiqen, apo përcaktohen si dytësore, këto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qenë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet dominuese duke ndjekur konturet e infrastrukturës, kjo është një mënyrë bazike, sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit, apo përdorimit elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë komponentët që e formojnë atë (planifikimi, arkitektonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimët lokale, e deri tek komponentet më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë stinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të kombinohen me njeri-tjetrin për të krijuar një Peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional.

Me qëllim mbrojtjen e përbërësve të mjedisit e peizazhit, në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i cili është në fazë miratimi, Bashkia Gramsh ka parashikuar marrjen e disa masave të cilat përqëndrohen në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Gramshit dhe në zonat industriale, krijimin e zonave ripariane përgjatë lumit Devoll dhe degëve të tij. Konkretisht për përmirësimin e peizazhit, në PPV Bashkia ka propozuar mbjelljen e pemëve në zonat urbane, ri-pyllëzim të sipërfaqeve të degraduara, rehabilitimin e zonave të ndotura, etj. Krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Gramsh rekomandohen keto masa:

Peizazhi Urban: Futja dhe ndërthurja e përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane (sipërfaqe të gjelbra, peme, shkurre, sipërfaqe ujore). Kjo kërkon studime të hollësishme për zona specifike, apo dhe në shkallë qyteti (Qyteti i Gramshit), në mënyrë që Peizazhi urban të ndërthuret me atë natyror dhe ky i fundit të mund të shërbejë, krahas të mirave mjedisore, si dekor urban. Masa specifike për përmirësimin e Peizazhit urban në territorin e bashkisë janë:

- Ruajtja e struktues së **pemëve përgjatë rrugëve**, pra nëse aksi rrugor karakterizohet nga pemë kumbulle të kuqe, që i kanë rezistuar kohës dhe i janë përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe mundësisht të së njëjtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur “*formalitetin*” që karakterizon këtë peizazh. Zgavrat e bordurat ku pema qëndron duhet të jenë të së njëjtës madhësi, ngjyre dhe materiali mbulues. Kjo e fundit duhet të ketë çarje të mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit në rrënjë, por të mos pengojë ecjen mbi to. Gjithashtu duhet të jetë e lëvizshme për qëllime mirëmbajtjeje. Rekomandohet që të përdoren mbulesat dhe zgavrat të mos lihen të çara e me bordurë sepse, veçanërisht në rrugët me trotuare të ngushta (1-2 m) pemët kthehen në pengesë serioze për ecjen e kalimtarëve.



- **Përzgjedhja e bimëve** përgjatë akseve rrugorë urban duhet të jetë ose të të njëjtit lloj, ose me një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur, që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, diversiteti në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qëndrojnë të pandryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.
- Në zona park e hapësira të tjera publike ku do të mbillen pemë karakteri formal i këtij peizazhi mund të thyhet nga pemë të mbjella rresht e të të njëjtit lloj, në pemë të së njëjtës familje (gjethore, halore, shkurre), por të mbjella në grupime, pra grupe me nga 3 apo 5 pemë në varësi të hapësirës. Gjithsesi, në zonat park, projektuesit e peizazhit kanë liri në përzgjedhjen e formacioneve, për sa kohë që: zgjedhin bimë vendase apo të përshtatura për një kohë shumë të gjatë në territorin e qytetit të Gramshit/Bashkisë së Gramshit; i vendosin në mënyrë të tillë që të garantojnë hije në verë dhe depërtim të dritës së diellit në dimër; bëjnë të mundur krijimin e zonave me bar dhe jo vetëm lule ose tokë nën hije ku nuk mund të rriten bimët; krijojnë mikroklima të ndryshme brenda parkut; sjellin shumëllojshmëri bimësh që ofron informacion shkencor bazik edhe për përdoruesit e parkut; garantojnë që bimësia e përzgjedhur përmirëson cilësinë e tokës dhe rrit aftësinë filtruese e infiltruese të saj.
- Ti kushtohet vëmendje “*Xhepave Urban*”, ose thënë ndryshe hapësirave boshe, të pa trajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit të cilat fshehin një potencial të madh në trajtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standarde dhe se është vetë elementi i përdorur në të, i cili nëpërmjet funksionit që ka në një hapësirë relativisht të vogël, sërisht ofron një shumëllojshmëri aktiviteteve e mjedisesh. Po si hapësirat e tjera park, edhe këto xhepa ofrojnë tipologji të ndryshme sipas vendodhjes. Pra, këto xhepa mund të trajtohen sipas nevojave të komunitetit.
- Bimët e rekomanduara për t’u përdorur në territorin e Bashkisë Gramsh(jo të vetmet) janë: **Bliri** (*Tilia argentea*), **Lagestromia** (*Lagerstroemia indica*), **Kumbulla e Kuqe** (*Prunus cerasifera*), **Rrapi** (*Platanus occidentalis*), **Pisha e Butë** (*Pinus Pinea*), **Dafina** (*Laurus Nobilis*) dhe **Ginko** (*Ginkgo Biloba*) të cilat janë bimë (pemë) me tipare terheqëse, rezistente ndaj ndotjes, të përshtatshme me zonën dhe kanë sjellin të mira mjedisore (filtojnë ajrin, neutralizojnë temperaturën, etj.)

Peizazhi industrial: Të merren masa në drejtim të uljes së ndikimit negativ vizual të zonave industriale. Kjo kërkon studime specifike në mënyrë që futja e elementëve të gjelbërimit me pemë dhe shkurre të shërbejë si përmirësues i peizazhit dhe në fshehjen e zonave/objekteve të cilat nuk janë të përshtatshëm nga pikëpamja vizuale. Gjatë hartimit të këtyre projekteve dhe zbatimit të tyre duhet pasur parasysh që funksionet industriale dhe gjelbërimi, apo përbërësit e Peizazhit të balancohen dhe të plotësojnë njeri-tjetrin duke krijuar një dizajn të pëlqyeshëm dhe njëkohësisht duke garantuar ruajtjen e funksionalitetit. Masa specifike për përmirësimin e peizazhit industrial janë:

- *Të shtohen sipërfaqet e pyllëzuara në zonat industriale*, kryesisht në zonën e Çekinit, aty ku ndodhet dhe Uzina e Demontimit të armëve dhe zona ish- industriale të tjera. Pyllëzimi i këtyre zonave do të përmirësonte pamjen vizuale të zonës



industriale dhe do të sillte një sërë përfitimesh mjedisore, si mbrojtja e tokës, shtimi i oksigjenit në ajër dhe zbutjen e klimës, etj.

- *Të mbillen pemë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të zhvillohen në mjedise relativisht të ndotura. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: **Akacia** (*Acacia*), **Plepi** (*Populus alba*), **Shelgu** (*Salix species*), **Eukalipti** (*Eucalyptus*) dhe **Lofata** (*Cercis siliquastrum*).*

Peizazhi natyror: Të synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrore. Masat specifike për përmirësimin dhe mbrojtjen e peizazhit natyror mund të jenë:

- *Të ruhen ose të ndërtohen aty ku mungojnë, zonat ripariane të lumit Devoll dhe degëve të tij, të cilat janë një përbërës i rëndësishëm i plotësimit të peizazhit të territorit të Bashkisë Gramsh. Ruajtja dhe përmirësimi i zonave ripariane luajnë rol të shumëfishtë, ato kanë funksion mbrojtës të tokës nga gërryerja, njëkohësisht luajnë rolin e brezit buferik (zbutës) të ndalimit të ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit, kanë një rol të rëndësishëm si korridor lidhës për habitatet dhe për strehimin dhe lëvizjen e specieve të ndryshme, gjithashtu dhe ndikimet pozitive në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e klimës, etj.*
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme të zonave pyjore të *Porocanit, Lenië etj.* do të sillte një ndikim pozitiv në ruajtjen e njëtrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm. Ndaj gjatë kësaj ndërhyrje duhet treguar kujdes i veçantë, që pemët e përzgjedhura duhet të jenë të ngjashme me ato që kanë qënë të mbjella më parë ose të përshtaten pemë të tjera, gjithmonë duke përdorur pemë të cilat janë karakteristikë për zonën dhe që e kanë territorin habitatin e tyre.
- Të mbillen pemë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga gërryerja dhe që nuk përbëjnë rrezik për të prishur balancat me bimët e tjera (nuk janë invazive), ndër të tjera rekomandohen: **Shelgu** (*Salix species*), **Plepi** (*Populus alba*), **Akacia** (*Acacia*), **Eukalipti** (*Eucalyptus*).

Peizazhi rural: Mbrojtja e Peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij, duke e konsideruar si pjesë të pandashme të peizazhit natyror. Kjo do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave specifike për rregullimin e elementëve të caktuar, disa prej këtyra masave mund të jenë:

- Gjatë hartimeve të planeve të zhvillimit të bujqësisë të kihen parasysh elementët e peizazhit, në mënyrë që, aty ku është e mundur sektori i bujqësisë të përshtatet me përbërësit e tjerë të Peizazhit, apo të krijojë një peizazh i cili nuk fragmenton vijshmërinë pamore (edhe fizike aty ku është e mundur) të peizazhit.
- Ruajtja dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditës-kullues dhe mbjellja e brigjeve të tyre me gjelbërim, duke krijuar “damar” të gjelbër përgjatë parcelave bujqësore (kryesisht bimësi e ulët, barishtore dhe shkurre të vogla).
- Të krijohen breza buferik (zbutës) me pemë të larta dhe të ulta në pjesët fundore të tokave bujqësore, me qëllim krijimin e një zonë të gjelbër dhe parandalimin e shpërdarjes së ndotësve në sipërfaqe të gjera (nëqoftëse në pjesën fundore të



parcelave bujqësore ndodhet një lum, ky brez i gjelbër do të ulë ndjeshëm depërtimin e ndotësve si pasojë e shpëlarjes së tokës bujqësore nga vaditja).

- Të mbillen pemë/bimë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund krijojnë konflikt me zhvillimin bujqësor. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: **Plepi** (*Populus alba*), **Shelgu** (*Salix species*), **Eukalpti** (*Eucalyptus*) dhe **Akacia** (*Acacia*).

Masa të përgjithshme për peizazhin, për mbrojtjen e peizazhit dhe ndërthurjen e tij me të gjithë komponentët e peizazhit në harmoni të plotë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndjeshmërisë emocionale të qytetarëve mund të jenë:

- **Të ruhet dhe konservohet Peizazhi natyror dhe ai artificial:** Kjo merr një rëndësi të veçantë për banorët që jetojnë, apo që kthehen në vendin e orgjinës, nga pikëpamja emocionale dhe e qetësisë që i ofron identiteti i vendlindjes/banimit të tyre.
- **Përfitime të tjera nga ruajtja e peizazhit:** Ruajtja dhe konservimi i peizazhit natyror gjithashtu ka një sërë përfitimesh mjedisore, kryesisht në mbrojtjen e tokës, uljen e ndotjes, habitatit për specie e deri tek përfitimet ekonomike të drejtpërdrejta. Bashkia Gramsh në PPV e hartuar në 2017, ka hartuar një sërë projektesh të ndryshëm infrastrukturorë në territorin e bashkisë duke marrë në konsideratë të gjithë komponentët e Peizazhit dhe mbrojtjes dhe përmirësimit të tyre aty ku është e mundur. Ndaj rekomandohet që gjatë zbatimit të projekteve nga PPV të merren në konsideratë të gjithë masat që janë dhënë për të ruajtur Peizazhin dhe të sigurohet përmirësimi i tij.

6.3.2 Masa për mbrojtjen e biodiversitetit

Territori i Bashkisë Gramsh ka një biodiversitet relativisht të pasur dhe të larmishëm (shih seksionin e biodiversitetit), si nga pikëpamja faunistike ashtu edhe floristike. Megjithatë, qëndrueshmëria e biodiversitetit përballet me një sërë vështirësish, të cilat lidhen kryesisht më problemet e shkaktuara nga aktiviteti njerëzor në territor. Zhvillimi bujqësor, industrial, urban dhe ai infrastrukturor janë problemet të cilët kanë pasur ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Hapja e tokave bujqësore (vitet e shkuara) ka çuar në tkurrje dhe fragmentimin e habitateve natyrore, zhvillimi industrial kryesisht ka patur ndikim negativ në prishjen e cilësisë së tokës dhe të ujërave duke dëmtonuar biodiversitetin, zhvillimi urban dhe ai infrastrukturor ka copëtuar gjithashtu habitatet, kryesisht ai infrastrukturor (rrugë) i cili ka copëtuar konsiderueshëm habitatet, duke vështirësuar, apo penguar plotësisht vijueshmërinë e tyre. Si pasojë, shumë specie mbeten të izoluara në habitate të vogla të copëzuara.

Në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mëtejshëm të biodiversitetit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Gramsh rekomandohet:

Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij në brëndësi të territorit të bashkisë, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qendrore (AKM, ARM, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të ligjit Nr.587, datë 20.7.2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”.



Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qendrore, AKM, ARM, AKZM, ADZM). Inventarizimi dhe njohja e llojeve në territorin e Bashkisë do të shërbente në qartësimin e përcaktimit të masave efektive për mbrojtjen e tyre, si dhe propozimin për të dhënë status mbrojtjeje zonave të cilat spikaten për larmishmëri dhe strehojnë specie të rrezikuara. Realizimi i këtyre masave do të shërbejë Bashkisë që të ruajë dhe të mbrojë biodiversitetin nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga elementët natyrorë, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 “Për Caktimin e kriterëve për ngriten e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit”.

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të dihet kapaciteti i territorit për kullotje dhe të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes aty ku vlerësohet e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Medicinale dhe Aromatike, në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qendrore, Ministria e Mjedisit, Ministrinë e linjës, ARM, AKM, etj.).

Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).

Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrollin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë bashkisë i lind detyrim nga ligji Nr.10 006, datë 23.10.2009 “Për Mbrojtjen e faunës së egër” dhe ligji Nr.9587, datë 20.7.2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”) është masa kryesore që do të përmirësonte gjendjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Kontrolli i zbatimit të moratoriumeve, gjuetisë dhe pyjeve, kërkon:

- Bashkëpunim me institucionet lokale dhe qendrore për të koordinuar punën dhe për të kryer veprimtari të përbashkëta të cilat cilësohen më efikase në bashkëpunim ndërinstitutional (institucionet që duhet të lidhin ura bashkëpunimi janë Bashkitë fqinje, Ministria e Mjedisit, ARM, AKM, Policia e shtetit, etj.)
- Ngritjen e sistemeve të informimit në terren, në mënyrë që të raportohen në kohë dëmet dhe të dalin para përgjegjësisë shkelësit (sistemi duhet të jetë formal, krahas punonjëve të lidhen marrdhënie të mira me banorët e zonës dhe kryesisht me barinjët).
- Hartimin e planeve të kontrollit dhe inspektimeve, në mënyrë që të gjitha kontrollet të jenë të koordinuara dhe të kenë efikasitet në veprimtarinë e tyre.
- Organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë që ka ndalimi i gjuetisë dhe prerjes së pyjeve për një afat të paracaktuar, përkatësisht 5 vjet për ndalimin e gjuetisë dhe 10 vjet për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve.



Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore (kryesisht rrugët lidhëse të fshatrave 6-8m gjerësi). Në pikat ku vlerësohet që ndarja e habitateve krijon probleme në biodiversitetin e zonës, të ndërtohen ura/nënkalime ekologjike për të lidhur habitate. Rrugët lidhëse ekzistuese dhe të propozuara dhe në të gjitha zonat natyrore të bashkisë duhet të kenë parasysh ndërtimin e urave ekologjike pasi këto rrugë kanë ndikim të konsiderueshëm në habitate (copëtojnë habitatet).

Rehabilitimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbetjeve aktuale, e cila është jashtë standardeve të kërkuara. Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane shkakton një sërë problemesh në mjedis, duke ulur cilësinë e elementeve përbërëse të tij, si toka, ajri, uji dhe si pasojë ndikime negative në biodiversitetin e zonës. Ky venddepozitim, duke qënë fare pranë shtratit të përroit të Stanës, ku me pas bashkohet në lumin Mat, vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit të tij e, si rrjedhojë, në florën e faunën ujore.

6.3.3 Masa për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura

Në territorin e bashkisë gjenden pjesë të Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit, i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden një numër i lartë Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente (Shiko seksionin e Zonave të Mbrojtura), të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zonë. Më qëllim mbrojtjen e zonave të mbrojtura, Bashkisë i propozohet (pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM) :

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe materiale të AdZM Elbasan në funksion të menaxhimit të ZM Mat,
- Bashkëpunimi i Bashkisë Gramsh me AdZM Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, në mënyrë të veçantë monumentet në pjesën e Kabashit dhe Sotirës,
- Hartimi i planit të emergjencave në rast zjarri dhe rreziqesh gjeologjike në Zonat e Mbrojtura dhe MN në të gjithë territorin (në bashkëpunim me AdZM),
- Promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura me qëllim zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për menaxhimin e tyre,
- Marrja e masave ndaj prerjes së pyjeve brenda zonave të mbrojtura, në pjesën e Tmalit të Tomorrit edhe në përgjithësi, duke zbatuar kështu dhe Moratoriumin e prerjes së pyjeve,
- Kontrrolli i vazhdueshëm i zbatimit të lejes për HEC-et të cilët kanë ulur ndjeshëm sasinë e ujit që duhet të rrjedhë në gjendje të lirë,
- Marrja e masave për mbrojtjen e erozionit për brigjet e lumenjve apo përrenjëve që kalojnë në ZM,
- Studime për kapacitetin kullotës që kanë ZM-të. Nuk ka një studim të mirëfilltë për këtë fenomen i cili është i pranishëm në çdo zonë të mbrojtur.



- Të zbatohet shkalla e mbrojtjes të zonave të mbrojtura sipas ligjit në fuqi (Të gjitha shkallët e mbrojtjes së ZM-ve në Gramsh paraqiten në tabelën në vijim).
- Në rastet e furnizimit me ujë të popullatës: Veprat e marrjes së ujit të mos planifikohen në burime që janë në monumentet e natyrës. Nëse marrja e këtyre burimeve ujore është me domosdoshmëri jetike dhe për nevoja të komunitetit të zonës, uji të merret 200 m larg perimetrit të monumentave të natyrës.

Rekomandim i rëndësishëm, në kuadër të zgjerimit të zonave të mbrojtura në territorin e Bashkisë do të ishte krijimi i dy parqeve bashkiake në Lenie dhe në pjesën e Grabovës. Këto zona, kryesisht përgjatë mbartin vlera të larta natyrore, kryesisht në shumëllojshmëri biologjike dhe në format e relievit, të cilat krijojnë peizazh të vecantë. Për statusin që do ti jepet kësaj zone është e nevojshme të studiohet hollësisht për vlerat e sajë dhe të përcaktohen kufinj të terren. Paraprakisht mund të themi që kjo zonë mbart larmishmëri të lartë në drurë dhe shkurre.

Tabela 70. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara)

Kategoria	Emërtimi	Zona buferike (m)	Shkalla e mbrojtjes	Veprimtaritë e ndaluara
II	Mali i Tomorrit	50	II	<p><u>Aktivitetet që ndalohen me ligj në këto zona:</u></p> <p>a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;</p> <p>b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar;</p> <p>c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;</p> <p>ç) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;</p> <p>d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;</p> <p>dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;</p> <p>e) mbjellja e pyjeve monokulturë;</p> <p>ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;</p> <p>f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;</p> <p>g) gjuetia me ushqime të helmuara;</p> <p>gj) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;</p> <p>i) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;</p>



				<p>j) organizimi i garave me automjete e motoçikleta.</p> <p><i>Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:</i></p> <p>a) ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;</p>
III	Te gjithë Monumentet e Natyrës në territorin e bashkisë Gramsh	-	I	<p>Aktivitetet që janë të ndaluara:</p> <p>a) prerja e drurëve dhe e shkurreve;</p> <p>b) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;</p> <p>c) ndërtime të çdo lloji;</p> <p>ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; gjuetia dhe peshkimi;</p> <p>dh) ndezja e zjarreve; .</p> <p>e) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre;</p> <p>ë) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive;</p> <p>f) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;</p> <p>g) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;</p> <p>gj) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;</p> <p>h) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.</p>

Burimi: Ligji nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”

6.4. Masa për mbrojtjen e cilësisë së ajrit

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është detyrim ligjor për bashkinë, detyrim i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj. Ligji 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” është ligji kryesor që ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë specifike të përmirësimit të cilësisë së ajrit së bashku me ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Gramshit dhe Bashkinë Gramsh mungojnë. Megjithatë, për arsytet e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Me qëllim përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Gramsh ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për uljen e ndotësve të shkarkuar në mjedis nga transporti përfshijnë i) uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të



transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, ii) shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet, dhe iii) planifikimin eficient të territorit. Krahas masave të mësipërme të propozuara në PPV, rekomandohet edhe marrja e masave shtesë të cilat përfshijnë:

- **Hartimin i Projekteve** duke bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik dhe transport alternativ (këmbësor, biçikleta, etj.). Kjo kërkon hartimin e politikave që synojnë fuqizimin e transportit publik, favorizimin e këmbësorëve dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të transportit alternativ (biçikleta ose motorrë, të paktën në zonat urbane). Kjo gjithashtu kërkon zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, kufizimin e numrit të makinave në qarkullim në qendra urbane, shtimin dhe zgjerimin e trotuarve në rrugët më të rrahura nga qytetarët, fuqizimin e mëtejshëm të transportit publik dhe shtimin e korsive të biçikletave përgjatë akseve të rrugëve në qendra dhe nëpërmjet rrugëve që lidhin NjA-të e afërta në largësi, etj. Kjo nënkupton edhe zhvillimin territorial të qendrave të NjA-ve ose urbane në parimin e përdorimit të tokës/trullait në mënyrë eficiente dhe të përqendruar dhe jo të shpërhapur (përdorime mikse të zonave që nënkuptojnë biznese, banime, dhe shërbime në të njëjtën zonë), me qëllim uljen e kilometrave që qytetarët nevojitet të përshkojnë me makinë për plotësimin e nevojave të tyre (blerjet, udhëtime për në institute, shkolla, qendra spitalore) në jetën e përditshme.
- **Përfshirjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Planet Sektoriale** të transportit publik, transportit rrugor, zhvillimit urban, industrial, të tokës, pyjeve, etj.
- **Menaxhimi i mbetjeve sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit** (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazeve që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre jashtë dhe brenda venddepozitimit të mbetjeve. Rekomandohet që venddepozitimet të pajisen me sistemin e kapjes së gazrave që çlirohen nga degradimi i mbetjeve, në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë.

Për më tepër, duke patur parasysh që burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit në Bashkinë Gramsh shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, industria e rëndë së bashku me sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimet, rekomandohet:

- **Bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit** për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë, i ndërtimeve, etj.
- **Ndërmarrjen e nismave të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore** (të tipit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi si dhe pjesëmarrja aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve.

Monitorimi i cilësisë së ajrit:

- Krijimi i stacioneve të përhershme të monitorimit të ajrit me qëllim monitorimin ditor dhe mundësisht orar (24/7) të cilësisë së ajrit në zonat me aktivitet industrial dhe në zonat ku fluksi i automjeteve është shumë i lartë. Monitorimi orar shërben për njoftimin e qytetarëve në përgjithësi dhe pjesën më të ndjeshme të popullsisë (fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzanë, etj.) që të qëndrojnë brenda shtëpisë sa herë



që cilësia e ajrit nuk është e mirë. Në këtë mënyrë shmangen rreziqet që i kanosen shëndetit të popullsisë nga ndotja e ajrit. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM, ARM Elbasan dhe Instituti i Shëndetit Publik).

- Monitorimi i ndotjes së ajrit nga pluhurat gjatë ndërtimeve në qytet (pallateve në veçanti).

6.5 Masa për mbrojtjen e tokës

6.5.1 Masat për mbrojtjen e tokës/territorit

Mbrojtja e cilësisë së tokës është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj. Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor dhe tokës, u vu re se problematikat kryesore të tokës janë erozioni dhe shkarjet e shëmbjet, të shpërndara në zonat kodrinore dhe malore, si në pjesën malore të NjA-së Porocan, pjesën qendrore të Skënderbegasit dhe në pjesën qendrore të NjA-së Lenie.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së tokës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Gramsh ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për uljen e ndotësve dhe shkallës së degradimit të tokës përfshijnë rehabilitimin e sistemit ujitës-kullues, luftën kundër erozionit.

Me qëllim mbrojtjen e tokës nga fenomene të rrezikut gjeologjik (erozion, shkarje, etj.) dhe nga ndërhyrjet e njeriut, rekomandohen masat e mëposhtme për Bashkinë.

Studime të mirëfillta mbi erozionin duke përdorur modele bashkëkohore për parashikimin e erozionit të shkaktuar nga shiu ose era (përdorimi i ekuacionit universal për humbjen e dherave-USLE ose parashikimi i erozionit nga shiu-ËEPP²⁴⁹) në të gjithë sipërfaqen e bashkisë me qëllim përcaktimin e shkallës/shtrirjes së erozionit në të gjithë territorin. Kjo ndihmon i) në planifikimin më të mirë të menaxhimit të tokës, ii) për një vlerësim të pasojave që vijnë nga mënyrat e ndryshme të punimit të tokës (me përmbyesje të dheut në 100% të sipërfaqes së tokës, pa shkulje të bimësisë së kultivuar në stinët e mëparshme me qëllim mbrojtjen e tokës, etj.), iii) për përcaktimin e standardeve për mbrojtjen e tokës e mjedisit, iv) për zhvillimin e planeve për kontrollin e sedimentit në projekte ndërtimi si rezervuare, si dhe v) për llogaritjen e kohës (viteve) që nevojiten për mbushjen e kanaleve dhe digave me sediment.

Kufizimi i sipërfaqeve që kalojnë nga tokë pyjore në tokë bujqësore / urbane, fenomen ky që krijon rrëshqitje të dheut duke tjetërsuar kështu morfologjinë e tokës në të cilën ndodh. Rekomandohet që Bashkia të mos miratojë kërkesa për kalimin e tokës pyjore në tokë bujqësore në zonat ku shihet dukshëm krijimi i fenomenit të erozionit e rrëshqitjeve, kryesisht në zonat kodrinore e malore.

Për përmirësimin e sipërfaqeve të tokave të gërryera, të braktisura, të zhveshura dhe të shpyllëzuara Hartimi dhe zbatimi i Planit për Shtimin e Sipërfaqeve Pyjore. Bashkisë Gramsh i del si detyrë hartimi dhe zbatimi i këtij plani në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar” Neni 7, nëpërmjet të cilit synohet shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve në zonat e braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera. Struktura pranë Bashkisë ndjek dhe mbikqyr



punën për përmirësimin e zonave tek të cilat ka ndodhur procesi i rrëshqitjes, detyrim ligjor i cili i vjen nga ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor.

Hartimi i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve: Për fenomenin e erozionit dhe rrëshqitjes së dheut në Bashki rekomandohet Hartimi i Planit të Mbarështrimit të Zonave Pyjore. Zonat më problemtike ndaj këtij fenomeni shfaqen në pothuajse në të gjithë pjesën kodrinore malire të bashkisë. Plani duhet të parashikojë:

- pyllëzim dhe, aty ku vlerësohet e nevojshme, ndërhyrje me vepra inxhinierike për mbrojtjen e tokës nga erozioni,
- Merrjen e masave mbrojtëse për rrëshqitjet e dheut nëpërmjet ndërtimit të instrumentave inxhinierikë *kryesisht në pjesën malore*. Për mbrojtjen nga rrëshqitja ndërtohen mure mbrojtëse me materiale gabioni, betoni, betoni të armuar dhe prej materiali miks (gjeotekstil me dhe, beton me ankerim),
- Sistemimin e shtratit të lumit Devollit, ndërtimit të veprave inxhinierike me karakter mbrojtës të brigjeve anësore dhe krijimin e zonave ripariane përgjatë lumit Të Devollit dhe degëve kryesore të tij,
- Ripërtëritje të bimësisë së ulët (nënpyllit) në zonat e dëmtuara,
- Ngritja e një sistemi për parandalimin e prerjes së drurëve në mënyrë të paligjshme,
- Ruajtja e gjerësisë bimore në kanalet e ujërave në zonat pyjore (zakonisht gjerësia duhet të jetë rreth 1.5 herë më e madhe se gjatësia e pemës më të lartë të pyllit²⁵⁰). Kjo bimësi përveç se mbron tokën nga erozioni, mbron edhe burimin ujqor nga ngrohja e panevojshme nga dielli.
- Disiplinimin e rrjedhës së ujërave (përrenjëve të vegjël) në pyje: stabilizimi i zonave pyjore nën ndikimin e erozionit në të cilat ka patur gërryerje të sipërfaqes të cilat kanë çuar në krijimin e kanaleve ujqore të parregullta dhe të pakontrolluara,
- Menaxhim dhe ndërtim rrugësh duke patur parasysh ndikimin e madh që këto kanë në shtimin e erozionit. Kjo nënkupton ushtrimin e kontrollit të duhur në rastet kur ndërtohen rrugë të reja me qëllim që të respektohen standardet për mbrojtjen e tokës (gjatë ndërtimit të rrugëve për shfrytëzimin e lëndës drusore, për rekreacion, etj., për aktivitetet e minierave që zakonisht ndodhen në zona pyjore),
- Përkujdesje gjatë ndërtimit të rrugëve për shfrytëzimin e materialit drusor për ngrohje,
- Ruajtja e prodhimtarisë së tokave në menaxhimin e agro-bujqësisë ose bujqësisë.

Hartimi i Planit për Menaxhimin e zonave kullosore (në zonat kodrinore-malore):

Kullotat (bimësia barishtore) garantojnë nivel më të lartë mbrojtjeje se vetë shkurret. Për këtë arsye, në rast dëmtimi të kullotave që vjen shpesh nga mbikullotja, ndodh përkeqësimi i gjendjes së barit ose rrallimi i barit/bimësisë nëpër zonat kullosore, duke e lënë kështu tokën të zhveshur e si rrjedhojë, të ndjeshme ndaj erozionit. *Duke parë se erozioni është i lartë në bashki, edhe në zona malore*, është e rëndësishme që bashkia të marrë masa eë menjëhershme për rregullimin e përdorimit të kullotave. Kjo nënkupton:

- Disiplinimin e kullotave në bashki nëpërmjet rregullave që garantojnë përdorimin e tyre të qëndrueshëm. Rekomandohet që rregullat të kenë parasysh i) sigurimin e ushqimit të gjësë së gjallë ose bagëtisë dhe njëkohësisht ii) mbrojtjen e kullotave nga



erozioni. Pra, mbrojtja e kullotave është një ndër masat kryesore për mbrojtjen e tokës nga erozioni,

- Parandalimin e zjarreve nëpër kullota,
- Mbjelljen e bimëve kullimore në zonat e dëmtuara,
- Mirëmbajtjen e tokës dhe ruajtjen e stabilitetit të tokës në ekonomitë kullimore,
- Kontrollimin e rrugëve që ndërtohen në zona kullimore dhe të aktivitetiteve të ndryshme si minierat apo guroret,
- Ndërtimin e strukturave fizike që kanë si qëllim drejtimin dhe ngadalësimin e shpejtësisë së rrjedhës së ujërave. Kjo nevojitet në zona me pjerrësi të theksuar ose me pjerrësi të vazhdueshme për një largësi të theksuar.

Përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullues: Në zonat fushore, në pjesën e luginës, anës lumit të Devollit, bashkisë Gramsh i rekomandohet:

- Mirëmbajtja e sistemit ujitës dhe kullues duke pastruar vazhdimisht kanalet.
- Përmirësimi i zonave riparane përgjatë lumit Devoll e degëve të tij me qëllim parandalimin e përmbytjes së tokave përreth lumenjve e kanaleve.

Përmbytjet: Bashkia Gramsh nuk rrezikon përmbytje të llojit me rikthim në 100vjet siç ndodh në Fier, Lushnje etj. (seksioni i përmbytjeve). Megjithatë, rekomandohet marrja e masave për parandalimin e përmbytjeve të shkaktuara nga degët e Devollit në disa zona, ndaj rekomandohet që:

- të hartohet një plan menaxhimi në rast përmbytjesh. Fillimisht rekomandohet të bëhen studime për të përditësuar përmbytjet në Bashki.
- të krijohet brezi i gjelbër mbrojtës përgjatë të gjitha burimeve ujore në Bashki. Kryesorë janë *Lumi i Devollit dhe degëve kryesore si Tomorrëca*. Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar veshjes së brigjeve të këtyre lumenjve dhe përrenjve në zonat kodrinore-malore ku erozioni është edhe më i lartë për shkak të karakterit malor të përrenjëve/lumenjëve.
- të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e lumit Devoll, Tomorrëca dhe Holtës, veçanarisht në zonat më problematike, me ndërtimin e shuarësve të energjisë përgjatë tupit të lumit/përroit dhe ndërtimin e anëve të lumenjve/përrenjëve.

Investime në bujqësi: Mbështetje financiare për fermerët që të përdorin parcelat e tyre të tokës për foragjerë dhe pyll duke e mbrojtur atë nga erozioni. Kjo është tejet e rëndësishme në tokat kodrinore ose malore me pjerrësi të theksuar, që në vendin tonë kultivohen si toka bujqësore duke shkaktuar erozion.

Trajnimi i fermerëve për futjen e praktikave të mira bujqësore për mbrojtjen e saj nga erozioni (sipas Ligjit Nr.9 244 datë 17.6.2004 “Per Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”) dhe zbatimin e masave erozive. Kjo është tejet e rëndësishme në fshatrat me njësi bujqësore malore ose mikse malore si *Grabovë, porocan, Tunjë etj.* Disa nga këto mënyra përfshijnë tarracimin e kodrave sipas specificitetit të zonës, kullimin e kodrave me drejtim përreth kodrës dhe jo nga lart-poshtë e anasjelltas.



Përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullues: në zonat fushore të Bashkisë Gramsh, kryesisht në zonat fundore të luginës, përgjatë lumit, rekomandohet që:

- të merren masa për përmirësimin e sistemit ujitës dhe kullues duke i pastruar dhe duke i përmirësuar si dhe duke i rehabilituar ato.
- të merren masa të menjëhershme për përmirësimi e zonave riparane në mënyrë që të minimizohet rreziku i përmytjes së këtyre tokave me qëllim parandalimin e përmytjes së tokave përreth lumenjëve veçanërisht në *Lumin Gramsh, Përroin e Tomorricës dhe ai i Holtës*.

6.5.2. Masa për mbrojtjen e tokës bujqësore

Duke parë rëndësinë e veçantë që ka sektori i bujqësisë në ekonominë e Bashkisë, është e rëndësishme që Bashkia të investojë në mbrojtjen e tokën bujqësore në përgjithësi dhe tokës bujqësore në veçanti. Në këtë rast, krahas masave të propozuara në PPV-në e Bashkisë Gramsh, bashkia rekomandohet të marrë një sërë masash të tjera të cilat janë renditur më poshtë:

Ruajtja ose mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet: Bashkia e Gramshit është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Veprimtari të tilla si ndërtimi mbi tokën bujqësore ndalohen me ligj (Nenet 10 dhe 14 i Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”).

Ndalimin e çdo zënie ose përdorimi të paligjshëm të tokës në territorin e bashkisë në zbatim të Ligjit nr. 7501 “Për Tokën” i ndryshuar, Neni 21. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Gramshit të marrë masa për kontrollin e vazhdueshëm për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në toka bujqësore.

Studime të mirëfillta mbi erozionin duke përdorur modele bashkëkohore për parashikimin e erozionit të shkaktuar nga uji (përdorimi i ekuacionit universal për humbjen e dherave-USLE ose parashikimi i erozionit nga shiu-ĒEPP²⁵¹) ose nga era në të gjithë sipërfaqen e bashkisë me qëllim përcaktimin e shkallës/shtrirjes së erozionit në të gjithë territorin.

Kjo ndihmon i) për të planifikuar më mirë menaxhimin e tokës, ii) për të vlerësuar më mirë pasojat që vijnë nga mënyrat e ndryshme të punimit të tokës (me përmytje të dheut në 100% të sipërfaqes së tokës, pa shkulje të bimësisë së kultivuar në stinët e mëparshme me qëllim mbrojtjen e tokës, etj.), iii) për të përcaktuar respektimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit, iv) për të zhvilluar plane për kontrollin e sedimentit në projekte ndërtimi, v) si dhe për të llogaritur vitet që nevojiten për mbushjen e kanaleve dhe digave me sediment.

Hartimin e një Plani Veprimi për Informimin e Bujqve për praktikën e mira bujqësore me qëllim uljen e erozionit në tokat bujqësore dhe rritjen e prodhueshmërisë së tokave. Praktika të tilla synojnë:

Punimin e tokës, duke e trazuar sa më pak atë (ku gjatë punimit të tokës më shumë se gjysma e mbetjeve bimore të kultivimeve të mëparshme lihen të paprekura në vend që të kalben).

Shmangien e lënies së tokës të zhveshur ose pa bimësi ndërmjet të mbjellave ose gjatë stinës së kultivimit. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mbjelljes së bimëve me funksion



veshjen/mbulimin e sipërfaqes së tokës. Një shembull është mbjellja e bimëve foragjere / legumeve (ose bimë të tjera me funksion mbulimin e tokës) ndërmjet rreshtave të vreshtave, pemëve, ulishtave, etj. ose të gjitha atyre kulturave ku bimët mbillen në rresht si kultura e misrit, etj. Këto bimë mund të mbillen jo vetëm ndërmjet rreshtave gjatë stinës së kultivimit por edhe ndërmjet stinëve të kultivimit. Në të dyja rastet, këto bimë garantojnë mbulimin e tokës e, si rrjedhojë, shmangien e erozionit.

Mbulimin e sipërfaqes së tokës me një shtresë të hollë copash të grimcuara bimësh ose druri në rast se nuk kultivohet. Kjo ndodh në rastet kur mbjellja e dy ose më shumë kulturave njëkohësisht nuk është mënyrë e përshtatshme. Shtresa mbuluese, duke qenë me bazë bimore, shërben jo vetëm për ruajtjen e tokës nga erozioni por edhe për rritjen e prodhimit të tokës, përmirësimin e shëndetit dhe ndalimin e rritjes së bimëve të egra në të.

Mbështetjen e fermerëve për mbjelljen e kulturave që shërbejnë edhe për mbrojtjen e tokës (kalimi nga kultura bujqësore në foragjere/bar ose lënia e tokës në pyll) sa herë që paraqitet nevoja, kryesisht në zonat kodrinore e malore me rrezikshmëri të lartë erozioni. Sigurisht që ky ndryshim përdorimi i tokës kërkon investime nga shteti për kompensimin e fermerëve.

Stabilizimin e zonave nën ndikimin e erozionit në sipërfaqe të sheshta dhe të erozionit të shkaktuar nga shiu të cilat kanë krijuar kanalizime të parregullta për ujin në tokat e punuara
Në zonat kodrinore: Trajnimin e fermerëve për futjen e mënyrave të kultivimit të tokës që e mbrojnë atë nga erozioni dhe që në të njëjtën kohë, ruajnë lagështinë e tokës. Disa nga këto mënyra përfshijnë terracimin e kodrave, kultimin e zonave kodrinore me drejtim përreth kodrës dhe jo nga lart-poshtë e anasjelltas dhe krijimin e kanaleve të veshura me bar²⁵².

Figura 76. Kultivimi i kodrave me drejtim përreth kodrave



Source: FAO²⁵³

Investime në bujqësi që synojnë mbrojtjen e mjedisit, sipas standardeve të BE-së. Investimet në bujqësi duhet të synojnë edhe mbrojtjen e tokave të brishta /të pjerrëta ndaj erozionit, gërryerjes, etj. Në shumë fshatra ose zona kodrinore, popullsia është e detyruar



të kultivojë tokat e brishta në pronësi të saj për arsye ekonomike. Kultivimi kryhet edhe në rastet kur tokat janë tejet të ndjeshme ndaj erozionit e gërryerjes (për shkak të shiut e erës). Me qëllim shmangien e degradimit të këtyre tokave nga kultivimi, rekomandohet që Bashkia të investojë në bujqësi, dhe në veçanti, të nxitë pronarët e tokave të ndjeshme që të mos i punojnë ato në këmbim të kompensimit të tyre.

Mbikqyrja e punës për përmirësimin e zonave të gërryera në tokat bujqësore: Për problemet me erozionin në toka bujqësore, rekomandohet që Bashkia të drejtojë dhe të mbikqyrë punën për përmirësimin e zonave të gërryera në tokat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar” Neni 7.

6.6 Masa për mbrojtjen e pyjeve e kullotave

Mirëadministrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Gramsh, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejtë suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor.

Me qëllim marështimin dhe përmirësimin e zonave pyjore e kullosore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Gramsh ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për mbarështimin e pyjeve në territorin e Bashkisë përfshijnë krijimin e parqeve urbane dhe rehabilitimin e zonave riparianë përgjatë gjatësive të lumenjëve në territorin e Bashkisë.

Në funksion të mbarështimit e qëndrueshmërisë së sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Gramsh rekomandohet:

- **Inventarizimi i fondit pyjor e kullosor** në mënyrë që të dihet sipërfaqja aktuale. Siç është theksuar më parë, të dhënat zyrtare rreth fondit pyjor e kullosor janë të vitit 1984-85 kur është kryer dhe inventari i fundit.
- **Hartimi i Planit të Mbarshtimit të Pyjeve e kullotave** i cili është detyrim ligjor për Bashkinë, që buron nga ligji nr. 9385/2005”Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Duke qenë se në territorin e Bashkisë Gramsh nuk njihet mirë kapacitetet që kanë kullotat për t’u shfrytëzuar, lind nevoja edhe për hartimin e Planit të Mbarshtimit të Kullotave, i cili do të mundësojë njohjen e kapaciteteve të kullotjes në territorin e bashkisë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.
- **Hartimi i Planit të monitorimit dhe kontrollit** të pyjeve dhe kullotave me qëllim zbatimin e ligjit dhe shmangien e dëmtimeve në territor.
- **Përmirësimin e infrastrukturës rrugore** të pyjeve dhe kullotave (rrugë aksesi), të cilat janë jetike për ndërhyrje në rastet e rënies së zjarrit në pyje, kryesisht në zonat malore.
- **Zgjidhje e konfliktit pyje-bujqësi.** Ky konflikt është theksuar vitet e fundit për shkak se pentaria është shndërruar në sektor fitimprurës për banorët. Në këtë rast rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me popullsinë, të përcaktojë se deri në cilën shkallë lejohet zhvillimi i pentarisë në dëm të sipërfaqeve pyjore.
- **Monitorimi dhe zbatimi i moratoriumit** të shfrytëzimit të pyjeve.



6.7 Masa për trajtimin e zonave të nxehta mjedisore

Në Bashkinë e Gramshit gjendet ish Uzina e prodhimit të baterive e cila është klasifikuar si një Hotspot mjedisor dhe shtrihet në NjA Gramsh. Gjithashtu në territorin e bashkisë mund të konsiderohen si vatra të nxehta edhe vend depozitimet aktuale të mbetjeve të cilat janë të pa menaxhuara dhe jashtë çdo standardi higjeno-sanitar të përcaktuar me ligj.

Me qëllim përmirësimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Gramsh ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Këto masa përfshijnë rehabilitimin e të gjithë vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve urbane dhe gjetjen e mundësisë për minimizimin e ndotjes që shkaktohet nga aktiviteti industrial në territor.

Në funksion të uljes së ndikimit negativ mjedisor të vatrave të nxehta mjedisore dhe rehabilitimin e tyre, krahas masave të propozuara në PPV rekomandohen edhe masa të tjera të menjëhershme drejtë rehabilitimit të zonave të nxehta mjedisore, si :

- **Rehabilitimi i menjëhershëm i vend-depozitimit** me qëllim shmangien e ndotjes së tokës e ujërave nëntokësorë nëpërmjet shllamit që krijohet nga shpërbërja e mbetjeve.
- **Hartimi i një plani për menaxhimin e mbetjeve industrial:** kjo arrihet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me institucionet qendrore të linjës në mëyrë që të sigurohet menaxhimi i mbetjeve minerare në përputhje me direktivat e BE-së.
- **Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit gjatë rehabilitimit të zonave të ndotura.** Më konkretisht, rekomandohet transportimi i dheut të hequr pa u depozituar fillimisht në zonat përreth duke shmangur kështu ndotjen e zonës, përdorimin e makinerive të përshtatshme, shmangien e incidenteve që mund të ndodhin nga grumbullimi i mundshëm i gazit në shtresat e poshtme të mbetjeve të depozituara, etj.


6.8. Masa për menaxhimin e mbetjeve

Bashkia Gramsh aktualisht nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane. Situata aktuale e mbetjeve është problematike, kryesisht në vend-depozitim, i cili nuk është në kushtet e kërkuara dhe në disa zona vërehen mbetje të hedhura rishtaz. Mbetjet inerte dhe ato industriale nuk menaxhohen dhe nuk kanë një vend të përcaktuar për depozitim e tyre. Sot, territori i bashkisë nuk mbullohet i gjithi me shërbimin e mbledhjes dhe terheqjes së mbetjeve urbane.

Në këtë kontekst bashkia e Gramshit duhet të ndërmarrë nisma konkrete, fillimisht për të hartuar Planin Lokal të menaxhimit të mbetjeve dhe të ndërtojë një skemë afatgjatë për menaxhimin e mbetjeve në territorin e saj. Reduktimi, Ripërdorimi dhe Riciklimu duhet të jenë konceptet bazë mbi të cilin duhet të udhëhiqet skema e menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë. Bashkia duhet të ndërmarrë gjithashtu veprime konkrete për të ndërtuar të paktën një stacion transferimi të mbetjeve dhe një pikë kompostimi, ndërsa trajtimi final i mbetjeve duhet të parashikohet për ti dërguar në landfill-in e Elbasanit apo të trajtohen me djegie në inceneratorin e mbetjeve në Elbasan.



Figura 67. skema e propozuar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS 2017


Skema e sygjeruar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë qëndron në futjen e instrumentave për reduktimin dhe ripërdorimin e mbetjeve, mbledhjen në pika grumbullimi publike dhe diferencimi i tyre në stacion transferimi (mbetjet organi të kompostohen) dhe asgjësimi përfundimtar i tyre të bëhet në landfill-in e Elbasanit apo të trajtohen me djegie në inceneratorin e Elbasanit.

Specifikisht për menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë rekomandohet:

Vend-depozitimi aktual duhet ti nënshtrohet rehabilitimit mjedisor dhe të mendohet për ndërtimin e stacionit të transferimit po në të njëjtin vend. Stacioni i transferimit të jetë në standartet dhe parametrat teknik të pranueshëm dhe të mundësojë diferencimin e mbetjeve në të.

Në të njëjtën vendodhje të ndërtohet edhe pika e kompostimit, gjithashtu të mendohet edhe për skema individuale apo kolektive të vogla në disa zona ku shihet e arsyeshme që të mundësohet kompostimi i mbetjeve me orgjinë bio.

Figura 68. Propozim për St. Transferimi, Pikë Kompostimi dhe Venddepozitim inertesh



Burimi: GoogleImagery dhe MetroPOLIS, 2017



Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë kopetencë e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në zonat ish industriale të Baterive në Gramsh. Zona ka nevojë urgjente për rehabilitim mjedisor dhe kthimi në një zonë të sigurt.

Formalizimi i riciklimit të mbetjeve në teritorin e bashkisë është një tjetër sfidë, e cila kërkon ngritjen e skemave të grumbullimit të mbetjeve të paktën me dy kosha, fillimisht në zonat me densitet të lartë të popullsisë (shiko seksionin e mbetjeve).

Mbetjet inerte duhet të menaxhohen dhe depozitohen me standartet e kërkuara, fillimisht duhet të ndërtohet vend depozitimi për këtë rrymë mbetjesh, vend i sygjyeruar mbetet në krah të stacionit të transferimit (i propozuar), në zonën ku aktualisht ndodhet vend-depozitimi i mbetjeve urbane. Gjatë ndërtimit të këtij vend-depozitimi duhen zbatuar të gjitha kërkesat teknike që të parandalohet

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë teritorin e Bashkisë Gramsh.



7. Plani i veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore

7.1 Plani i veprimit: monitorimi, treguesit e vlerësimit e institucionet e monitorimit

Plani i Përgjithshëm Vendor përbëhet nga projekte specifike nëpërmjet të cilave synohet disiplinimi i tipologjisë së funksionimit hapsinor dhe plotësimi i nevojave të Bashkisë Gramsh me të gjithë përbërësit fizikë, infrastrukturorë dhe natyrorë. Duke iu referuar Ligjit nr. 10431 të datës 09/06/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", në rastet kur janë parashikuar ndërhyrje fizike në territor, PPV-ja shoqërohet edhe me Planin e Monitorimit të Mjedisit i cili siguron respektimin dhe realizimin e Objektivave të Mbrojtjes së Mjedisit që janë kryesisht:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes në ujë, ajër, tokë dhe e ndotjeve të tjera të çdo lloji,
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe biodiversitetit,
- Planifikimi i përdorimit të pasurive natyrore me synim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar,
- Përdorimi i qëndrueshëm dhe i zgjuar i burimeve natyrore,
- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore, estetike, peizazhiste dhe natyrore,
- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit publik.

Me **Monitorim Mjedisor** nënkuptohet "Programi i matjeve sistematike, vëzhgimit dhe raportimit të treguesëve mjedisorë". Plani i monitorimit të mjedisit hartohet si dokument themelor i bazuar në detyrimet ligjore që kanë për synim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në një nivel të lartë, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut e sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Monitorimi i mjedisit në vendin tonë bazohet në Ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 19 "Mbrojtja e natyrës"; neni 41 "Monitorimi i gjendjes së mjedisit"; neni 45 "Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe, neni 60 mbi "Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Proçedurat dhe rregullat e monitorimit përcaktohen në VKM nr.1189 të datës 18/11/2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" dhe në Planin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, 2015. Monitorimi kryhet edhe në kuadër të detyrimeve që i lindin vendit tonë si rrjedhojë e marrjes së statusit të vendit kandidat në Bashkimin Europian, konkretisht zbatimit të nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) për "Zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër degradimit mjedisor" në zbatim të të cilit, Ministria e Mjedisit ka krijuar Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit (SIMM). Mbështetur në elementë të këtij sistemi është hartuar edhe Plani Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së përcakton treguesit mjedisor mbi të cilët do të bazohet monitorimi, shpeshësinë e monitorimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe institutet përgjegjëse për monitorimin e gjendjes në mjedis. Sipas legjislacionit në fuqi, **treguesit mjedisorë** janë "ndryshorja që jep në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë, të dhëna për një dukuri mjedisore duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet vlerësimit



numerik nga matjet përkatëse". Dukuritë mjedisore lidhen me cilësinë e mjedisit, konkretisht të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen aktive, shkallën e dëmtimit dhe ruajtjes e masave të marra. Monitorimi/Matja e treguesve të mjedisit është proces shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të patur një pasqyrë të qartë të gjendjes së mjedisit me qëllim përcaktimin e shkaqeve/origjinës së problematikave dhe zgjidhjen e tyre. Monitorimi i treguesve të mjedisit kryhet veçanërisht gjatë zbatimit të projekteve të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së ka përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse, të cilat do të duhet të monitorojnë treguesit mjedisorë për vlerësimin dhe zbatimin e masave të parashikuara në VSM sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse. ***Institucionet përgjegjëse*** përfshijnë "institutet, laboratorët e qendrat kërkimore-shkencore private e publik të kontraktuar nga Ministria e Mjedisit për të kryer monitorimin e treguesëve konkretë të dukurive natyrore të cilësisë". Insitucionet shtetërore, qoftë në nivel kombëtar apo edhe rajonal si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Inspektoritati Mjedisor, Drejtoria e Mjedisit në Bashkinë Gramsh do të nevojitet të bashkërendojnë punën në mënyrë që të realizojnë inspektimet në terren për mbarëvajtjen dhe respektimin e kushteve të pëlqimeve apo lejeve mjedisore të projekteve.

Më poshtë është paraqitur Plani i veprimit, monitorimi dhe treguesit e vlerësimit për PPV-në e Bashkisë Gramsh.



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

Tabela 71. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së

Nr.	Objektivi Mjedisor	Treguesi Mjedisor	Autoriteti Monitorues	Parametrat Fizik	Frekuenca e Monitorimit
1.	Toka	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pjelloria (ushqyesit e tokës) ▪ Ndotja (metalet e rënda dhe përbërësit organikë). ▪ Sip. bujqësore/natyrore/kullosore e humbur nga fondi bujqësor, për shkak të ndryshimit të përdorimit të saj (për ndërtime, infrastrukturë, etj. ▪ Sipërfaqja e tokës së trazuar/degraduar (gërryer, rrëshqitur). ▪ Sasia mujore e tokës së humbur nga erozioni. ▪ Sipërfaqja e tokës e përdorur si venddepozitim i përkohshëm gjatë punimeve. <p>Lloji dhe kohëzgjatja e teknologjisë së përdorur për mbrojtjen e dheut të depozituar në venddepozitimin e përkohshëm nga erozioni i shkaktuar nga era dhe shiu.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkarkimet nga tubacionet e naftës ▪ Gjatësia e burimeve ujore që preken drejtpërsëdrejti nga erozioni i tokës ku zbatohet një projekt. ▪ Lloji i teknologjisë që përdoret për parandalimin e erozionit në burime ujore. ▪ Shkarkimet industriale në tokë nga mjetet e rënda. ▪ Rivitalizimi tokave djerr. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ SHGJSH ▪ Dr. Rajonale e Bujqësisë ▪ Ministria e Bujqësisë ▪ Min. e Transporteve ▪ Bashkia (Dep. Mjedisit) ▪ AKM dhe ARM ▪ Roja e Gjelbër ▪ Policia Bashkiake/ Policia e Shtetit ▪ Bashkia ▪ Ministria e Mbrojtjes ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit, Fakulteti i Gjeologji – Minieriave ▪ Instituti i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Na, Cl, SO₄, trashësia humusore, raporti Mg/Cl, aciditeti, raporti N/C, metalet e rënda ▪ Sasia e tokës së humbur (ton/km²) ▪ Nr. dhe lloji i fragmentimit ▪ Vlera e tokës djerr ▪ Përqëndrimi i kimikateve dhe pesticideve në tokat bujqësore ▪ Sipërfaqet e ndotura nga industria e naftës. ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga shkarkimet të ndryshme dhe depozitime të mbetjeve urbane e industriale ▪ Shkalla e pjelloris në raport me të dhënat kombëtare 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 10 vende, 2 herë / vit ▪ Raportim 12 herë / vit ▪ Analizat biologjike dhe kimike të tokës, 4 herë / vit
2.	Uji	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësia ujërave sipërfaqësore ▪ Cilësia e ujërave nëntokësore ▪ Cilësia e ujërave për ujitje ▪ Pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura industriale. ▪ Pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Autoriteti i Menaxhimit të Baseneve Ujore ▪ Instituti i Hidrometrologjisë ▪ Instituti i Kërkimeve Biologjike ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ NBO₅ ▪ NKO ▪ Metalet e rënda (Pb, Zn, Cu, Ni, Co, Cr, Cd, etj.) ▪ Aciditeti ▪ Pehashi (pH) 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja e 4 stacioneve të monitorimit (2 për lumin Osum dhe 2 për Devollin)



DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësia e ujit për konsum publik ▪ Koeficienti i shfrytëzimit të ujit ▪ Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura ▪ Popullsia e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura ▪ Disiplinimi i ujërave të larta 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Këshilli Teknik i Ujit ▪ Agjencia Kombëtare e Mjedisit ▪ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Instituti i Gjeoshkencave Enejisë, Ujërave dhe Mjedisit ▪ Ministria e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujërave ▪ Ministria e Mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koeficienti i shfrytëzimit të ujërave të ëmbla ▪ Temperatura ▪ Mineralizimi ▪ Fortësia ▪ Mbetjet e thata ▪ Përmbajtja e natriumit, kalciumit, natriumit, magnezit, amoniakut, klorit, sulfateve ▪ Përmbajtja e nitriteve dhe nitrateve ▪ Përmbajtja e pesticideve ▪ Niveli statik dhe dinamik i ujërave nëntokësore ▪ Përcjellshmëria ▪ HCO₃ dhe CO₃ 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorim 2 herë në muaj të rezervuarëve të ujërave të ëmbla ▪ Monitorim 2 herë në muaj për depot e ujit të pijshëm dhe pusshpimeve. ▪ 12 herë në vit për ujërat nëntokësore ▪ 4 herë në vit mbi cilësinë e ujërave për bujqësi
3.	Ajri	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sasitë vjetore të shkarkimeve në qendrat urbane ▪ Shpërndarja e shkarkimeve (trëndafili i erës) ▪ Sasia vjetore e elementëve të rëndë ▪ Vëllimi vjetor i reshjeve ▪ Niveli i grimcave PM në ajër ▪ Niveli i gazit sulfurik në ajër ▪ Cilësia e ajrit në 5 pikat kryesore të qytetit ▪ Cilësia e ajrit në qendrat e NjA-ve ▪ EShkarkimet nga transporti ▪ Rregjistër i shkarkimeve nga industria ▪ Gjëndja e filtrave dhe sistemeve të shkarkimit nga industria e rëndë dhe sektori privat. ▪ Ditët nën trysni nga shkarkimet industriale dhe nga transporti ▪ Krijimi i inventarit të shkarkimeve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Agjencia Kombëtare e Mjedisit ▪ Agjencia Rajonale e Mjedisit ▪ Drejtoria e Mjedisit në Bashki ▪ Ojftë ▪ Ministria e Mjedisit ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës ▪ Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit ▪ Fakulteti i Gjeologji – Minieriave ▪ Instituti i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ PM_{2.5} dhe PM₁₀ ▪ SO_x ▪ NO_x ▪ GHG ▪ Pb ▪ CO dhe CO₂ ▪ CFCs ▪ Vizibiliteti ▪ Shkalla e errësimit ▪ Dioksina dhe furanet ▪ Benzenet C₆H₆ ▪ Ozoni O₃ 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja e stacioneve të përhershme të monitorimit. ▪ GMonitorim në kohë reale i cilësisë së ajrit



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

4.	Pyjet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përcaktimi i taksonometrisë ekzistuese. ▪ Realizimi i inventarit ▪ Rritja vjetore sipas llojeve ▪ Sasia vjetore e vjelur ndarë në lëndë për përpunim dhe dru zjarri ▪ Sasia e biomasës ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga zjarri e stuhia, etj. ▪ Llojet e rrezikuara ▪ Pyje të shëndetshme/sëmura ▪ Identifikimi i tipologjisë dhe origjinës së sëmundjes ▪ Mirëmbajtja në Zona Natyrore ▪ Kullotat ▪ Ripyllëzim i zonave të dëmtuara ▪ Gjendja e tokës në sipërfaqet e fondit pyjor 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve ▪ Roja e Gjellbër ▪ Njësitë Administrative ▪ Universiteti Bujqësor ▪ Bashkia ▪ Ministria e Mjedisit ▪ Ojft-të 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Niveli i riprodhimit ▪ Tipet e pemëve ▪ Nr. total / Mosha / Statusi ▪ Tipi i sëmundjes ▪ Sipërfaqe për mbushje ▪ Sipërfaqe për riprëritje ▪ Plan Menaxhimi ▪ Ton/Vit – përpunim ▪ Ton/Vit – Dru zjarri ▪ Raporti C/N, kapaciteti i këmbimit, pehashi, 	<p>Inventarizimi, proces që zgjat në varësi të madhësisë së fondit pyjor dhe kullusor. Dixhitalizimi. Monitorimi 12 herë / vit</p>
5.	Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikimi i habitateve ▪ DLarmia e ekosistemeve ▪ Identifikimi i specieve në territorin e Bashkisë ▪ Xhepat natyrorë në sipërfaqet ujore ▪ Shtigjet natyrore ▪ Inventarizimi (të gjitha kategoritë) ▪ Specifikimi i standardeve sipas trajtimit të BE-së ▪ Identifikimi i specive të rrezikuara, të kërcënuara dhe të zhdukura ▪ Shqetësimi nga zhurmat 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ▪ Administrata e Zonave të Mbrojtura ▪ Drejtoria e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit. ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve ▪ Ojft-të ▪ Ministria e Mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sipërfaqja e zonave të mbrojtura ▪ Sipërfaqja e mbuluar me bimësi natyrore dhe pyje. ▪ Numri i habitateve të identifikuar ▪ Rregjistri i specieve në rrezik dhe atyre endemike të rralla. ▪ Habitata të reja ▪ Statusi i shtigjeve natyrore ▪ Makrofitet ▪ Gjitarë, zogj, zvarranik, amfib ▪ Jovertebrorë ▪ Kërpudhat ▪ Likenet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Çdo muaj 12 herë / vit
6.	Peizazhi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sipërfaqet e gjelbërta urbane ▪ Gjendja e parqeve të bashkisë ▪ Sip. me gjelbërim të infrastrukturës Rrugore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ▪ Inspektoriati i Mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sip e gjelbër për banorë në qytet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi në terren, i vazhdueshëm



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ripyllëzimi i hapsirave të parashikuara në PPV. ▪ Mbushja e kodrës me pemë prodhuese (Vreshta/Frutorë) ▪ Zonat ripariane përgjatë brigjeve të Lumenjve Devoll e degët ▪ Korsitë e biçikletave dhe shtigjet e gjelbërta ▪ Dëmtimet nga karrierat dhe guroret ▪ Dëmtimet nga erozioni, zjarret, shpyllëzimet ▪ Kullat metalike të puseve të naftës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dr. e Urbanistikës ▪ Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit si edhe Ministria e Mjedisit ▪ Bashkia (Dep. Mjedisit) ▪ ARM ▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë ▪ Ojft-të ▪ Roja e Gjelbër ▪ Policia Bashkiake/ Policia e Shtetit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sip e pyllëzuar/park për banorë në Bashki ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga guroret dhe karrierat ▪ Siperfaqet e rehabilituara të zonave ripariane ▪ Brezat e gjelbërimit përgjatë infrastrukturës rrugore ▪ Inventarizimi i problemeve peizazhstike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ dhe i përditshëm ▪ Raportimi 4 herë në muaj
7.	Klima	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkarkimet e gazrave serë. ▪ Shkarkimet sipas burimit të shprehura në njësi matëse dhe % ▪ Energjia e përdorur në territorin e Bashkisë (Konsumi i elektricitetit, gazit, naftës, biomasës, të rinovueshme) ▪ Rregjistri i temperaturës shprehur në cikël 24orë ▪ Rregjistri i rreshejve atmosferike shprehur në mm/ditë ▪ Rrezatimi mesatar diellor ▪ Shpejtësia mesatare e erës km/orë (në ditë) ▪ Niveli i gazit karbonik në atmosferë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria Mjedisit ▪ Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit ▪ Ministria e Energjitikës ▪ Ministria e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujërave ▪ ARM – AKM ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës ▪ Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit ▪ Fakulteti i Gjeologji – Minierave ▪ Institui i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM ▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor – pranë Bashkisë ▪ IKMT ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ Dr. e Urbanistikës ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sasia e gazrave serë çlirar në atmosfer(referuar për çdo sektor) ▪ Konsumi në Këë i energjisë nga elektrike, BER, biomas, naftë dhe gaz. ▪ Të dhënat meteorologjike për Bashkinë . ▪ Sasia e reshjeve atmosferike ▪ Temperaturat ditore / vjetore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja e stacionit të matjeve meteorologjike për Bashkinë. ▪ Analizimi laboratorik 6 herë në vit i shkarkimeve të gazrave serë në mjedis ▪ Monitorim mujor i konsumit të energjisë elektrike ▪ Raportim 3-mujor ▪ Buletin mujor mbi klimën
8.	Kultura	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Objektet e kultit fetar ▪ Objektet e trashëgimisë kulturore ▪ Objektet e trashëgimisë historike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria e Kulturës ▪ Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjendja e objekteve të kultit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorim mujor



**DOKUMENTI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pasuritë arkeologjike ▪ Sitet arkeologjike ▪ Trashëgimia arkitektonike dhe mjedisore ▪ Muzeu arkeologjik dhe aulturor ▪ Godina dhe vepra me vlera të larta historike e arkitektonike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shërbimi Arkeologjik Shqiptar ▪ Drejtoria Rajonale e Kulturës ▪ IKMT ▪ Bashkia ▪ Instituti i Monumenteve të Kulturës. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjendja e objekteve dhe vendeve të trashëgimisë historike e kulturore ▪ Inventarizimi i elementëve përbërës, pjesë e trashëgimisë kulturore dhe historike ▪ Numri i vizitorëve në këto objekte 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Raportim herë në vit 4
9.	Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Jetëgjatësia mesatare e popullsisë ▪ Përmbajtja e hidrokarbureve në ajër ▪ Niveli i zhurmave ▪ Aksidentet në punë dhe në rrugë ▪ Rregjistri i sëmundjeve kardiovaskulare ▪ Rregjistri i sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes ▪ Rregjistri i vdekjeve jonatyrale ▪ Familjet nën minimumin jetik ▪ Disponueshmëria e shërbimit shëndetësor ▪ Niveli i trajtimit të urgjencave ▪ Disponueshmëria e ilaçeve farmaceutike ▪ Shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ujërave të ndotura, tokës së ndotur dhe ndotjeve mikrobiologjike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria e Shëndetësisë ▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Inspektoriati Mjedisor ▪ Inspektoriati i Punës ▪ AKM-ARM ▪ Bashkia 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mosha mesatare vjet/muaj/ditë ▪ Nr. i aksidenteve ▪ Nr. i të Sëmurëve (kardio-respirator-toksik) ▪ Statusi dhe niveli i Shërbimit shëndetësor ▪ Mjekimet e munguara ▪ Përbërja mercologjike e ndotjes në Bashki 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorim mujor ▪ Raportim herë në vit 4
10	Socio-Ekonomia	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Niveli Arsimit të popullatës ▪ Gjinnazet, shkollat, kopshtet, çerdhet ▪ Shërbimet publike ▪ Të ardhurat mesatare për frymë ▪ Niveli i papunësisë ▪ Zanatat 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria e Ekonomisë ▪ INSTAT ▪ Bashkia Gramsh ▪ Prefektura Elbasan ▪ Zyra e Punsimit ▪ Ministria e Mirëqënies Sociale 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Profesionistët ▪ Teknikët ▪ Zanatçinjtë ▪ Qëndrat e edukimit ▪ Pagat dhe të ardhurat për frymë ▪ Ndhima sociale 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorim mujor ▪ Raportim herë në vit 4

Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017.



7.2 Çështjet institucionale, ligjore dhe instrumentet që lidhen me masat mjedisore

Hartimi i Planit të Monitorimit të Mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së është bazuar në Vendimin Numër 1189, datë 18 nëntor 2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” dhe “Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2015”. Ky program parashikon monitorimin e ajrit, zhurmave, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, tokës, pyjeve e biodiversitetit^{cccliv}.

Ajri monitorohet në 51 stacione monitorimit të vendosura në 14 qytete, duke përfshirë Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier dhe Korçë. Në Bashkinë e Gramshit nuk ka stacione monitorimi fikse. Monitorimi ndodh rutinë në qytetet me stacione të përhershme dhe në qytetet kryesore ku janë vërejtur tejkalime (Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës, dhe Elbasan). Në Bashkinë Gramsh nuk parashikohen monitorime të tilla. Gjithashtu, monitorimi nënkupton edhe shqyrtimin paraprak të niveleve të ndotjes në qytete që nuk mbulohen nga monitorimi sistematik deri më tani (Berat, Lushnje, Gjirokastrë, Pogradec, Krujë, Lezhë dhe Sarandë, Laç dhe Kavaje). Parametrat që synohet të monitorohen gjatë viti 2017 sipas Planit të Monitorimit të Mjedisit 2016 (PMM) janë SO₂, NO₂ (NO_x), CO, O₃, Benzene, PM₁₀ (PM_{2.5}) dhe metalet e rënda

Monitorimi i Ujërave sipërfaqësore (duke përfshirë edhe bio-cilësinë) është parashikuar të kryhet në 54 pika për lumenjtë, 13 për liqenet, 17 për Lagunat, 44 për sedimentet dhe 19/81 për ujërat bregdetarë (81 stacione për treguesit bakteriologjikë). Parametrat që janë parashikuar të maten përfshijnë parametrat meteorologjike, parametrat hidrologjike, pH, O₂, kripësia, TOC, PM, lëndë ushqyese (N, P), metalet e rënda dhe parametrat organike bazë. Lidhur me shpeshësinë e monitorimit, në lumë parashikohet 4 herë në vit për ushqyesit e ujit, 1 herë në vit për kampionët dhe parametrat e tjerë dhe 1 në 3 vite për sedimentet.

Lidhur me ujërat nëntokësore, monitorimi i tyre konsiderohet me përparësi të lartë dhe parametrat që janë parashikuar për matje janë pH, temperatura, TOC, PD, ushqyesit (N, P), metalet e rënda, parametrat organikë bazë dhe mikrobiologjia. Ndërkohë nuk monitorohen parametra me bazë *përbërjet klorure dhe PCB* si dhe *pesticidet dhe PAHs* për shkak të mungesës së kapaciteteve të laboratorëve për matjen e parametrave të tillë.

Monitorimi i tokës përfshin 19 vënde. Ushqyesit maten çdo dy vjet minimumi, ndërsa metalet mund të monitorohen në frekuencë të ulët në varësi të kushteve lokale. Parametrat që janë planifikuar për t'u monitoruar janë parametrat fizike, ushqyesit (NP), metalet e rënda dhe organike.

Në PPM është përfshirë edhe monitorimi i pyjeve dhe biodiversitetit. Sipas PPM-së, për vitin 2015, procesi i monitorimit të pyjeve parashikon tregues të kriterëve Pan - Evropiane C2 dhe C4 dhe në rast mbështetje financiare për treguesin C4.2 ndërsa monitorimi i biodiversitetit përfshin 50 stacione monitorimi.

Institucionet që ngarkohen nga Vkm Nr. 1189, Datë 18.11.2009 Për Zbatimin e PKM-së janë Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe Ministria e Mjedisit.

- Çështje ligjore dhe institucionale me ndikim në monitorimin e mjedisit:

Vitet e fundit, vendi ynë ka bërë hapa të mëtejshme për monitorimin e mjedisit. Me hartimin e Planit Kombëtar të monitorimit i jep rëndësi identifikimit të problematikave të përbërësve fizikë të mjedisit me qëllim përmirësimin e gjendjes së tij. Kjo është përkthyer në monitorime me një



frekuencë të caktuar kryesisht vjetore në bazë të të cilave përgatitet edhe Raporti i Gjendjes në Mjedis. Sot, ky raport është instrumenti kryesor që paraqet gjendjen reale të mjedisit.

Gjatë zbatimit të PPV-së së Bashkisë Gramsh, do të jetë monitorimi i mjedisit që do të pasqyrojë ndikimin në shkallë të gjerë të zbatimit të PPV-së në mjedis. Megjithatë, duke patur parasysh se monitorimi i mjedisit ka kufizimet e tij, supozohet që matja e ndikimit real të projekteve të PPV-së në territor gjatë fazës së zbatimit, mund të mos jetë i plotë. Kjo për shumë arsye të ndryshme të cilat janë shtjelluar më poshtë së bashku me masat që rekomandohet të merren për *përmirësimin e monitorimit të gjendjes në mjedis në të ardhmen*:

Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit: Institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit në vendin tonë janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Mjedisit (VKM nr. 1189 i datës 18 nëntor 2009). Një mangësi që vihet re është fakti se institucionet e ngarkuara me ligj për monitorimin e mjedisit nuk janë të pajisura me laboratorë. Zakonisht, monitorimi i treguesve të dukurive natyrore të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit kryhet nga institucione monitoruese të specializuara të cilat lidhin marrëdhënie kontraktuale me institutet e monitorimit. Pra, institucionet shtetërore nuk monitorojnë drejtpërsëdrejti gjendjen e mjedisit natyral duke lënë kështu hapësira për vonesa apo mangësi të ndryshme në monitorimin e mjedisit për shkak të procedurave të tenderimit që nevojitet të ndiqen në rastet e kontraktimit.

Mungesa e laboratoreve me kapacitete për monitorimin e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve, dhe PAHs: parametrave të tillë janë të pranishëm në vendet ku vepron industria e rëndë e cila është e pranishme pothuajse në të gjitha qytetet ose rajonet kryesore të vendit, dhe mbi të gjitha në Bashkinë Gramsh. Si rrjedhojë, lind nevoja e monitorimit të tyre të vazhdueshëm, sidomos në ujërat nëntokësore, për të patur një pasqyrë të gjendjes së tyre si dhe për të kuptuar ndikimin e ndotësve në shëndetin e njeriut. Duke qenë se shumë nga këto ndotës janë të rrezikshëm për shëndetin e njeriut, monitorimi i tyre është i domosdoshëm. Megjithatë, me gjithë rëndësinë që parametrat në fjalë kanë si tregues të gjendjes së ujërave nëntokësore, nuk monitorohen për shkak të mungesës së kapaciteteve të laboratoreve për të kryer matje të tilla. Në këtë mënyrë, është pothuajse e pamundur të kuptohet se cili është ndikimi i shumë industrive që shkarkojnë ndotës të tillë në shëndetin e popullsisë të zonave përreth.

